- Masat për mos lejimin e ndotjes së lumenjve, ujërave nëntokësore dhe sipërfaqësore nga ujërave të përdorura dhe ndyta prej kapaciteteve industriale duke përfshirë edhe VINEKS-in duke montuar dhe kompletuar aparate pastrimi të ujërave të përdorura.
- Mbrojtje e veçantë për burimet gurrën e Binçës, gurrën e Letnices, gurrat e Terpezes e të Shoshares në komunën e Vitisë; Për rrjedhat e epërme të terreneve të Golemarekes, të lumit të Letnices, lumi Uji i Mirë dhe lumi i Mullajve në fshatin Gushicë.
- Mbrojtje e veçantë e ujërave duhet ti kushtohet edhe nga përdorimi i pa kontrolluar i plehrave artificiale për bujqësi (nitratet, nitritet, fosfatet dhe nutrient tjerë.
- Mbrojtje nga mbeturina (të gjitha tipet e mbeturinave) duke planifikuar deponi që janë të organizuara dhe të cilat kanë marr parasysh ketë faktor deri te planifikimi i varrezave kolektive të kafshëve në raste emergjente.

Biodiversiteti

- Mbrojtja e plotë e biodiversitetit dhe zoodiversitetit
- Projekte të përbashkëta me komunat tjera, dhe me shtetin fqinjë (Republika e Maqedonisë së Veriut) për mbrojtjen dhe zhvillimin e zonës së Ilex aquifolium (Ashja), mbrojtja dhe zhvillimi i zonës “Mllaka” në Sllatinë, varrezat e fshatit Sllatinë, Trenat që shtrihen në fshatin Vërban dhe në kufi me Komunën e Kaçanikut.
- Inventarizimi i florës dhe faunës në gjithë territorin e komunës, duke specifikuar çka duhet mbrohet dhe çka mundë shfrytëzohet .
- Rezervati për ruajtjen e kaprrollt (Capreolus capreolus) areali i të cilit është mjaft i rrezikuar që do të shtrihet në zonën ndërkufitar në zonat e larta të fshatrave Lubishtë, Shashare etj.
- Ruajtja e racës autoktone të lopës bushe( qumështi i së cilës ka një vlerë të lartë ushqyese dhe mjekuese), kryesisht në fshatrat kufitare me IRJ të Maqedonisë.
- Revitalizimi i ekosistemeve pyjore për parandalimin e shkatërrimit të habitateve të shumë llojeve bimore dhe shtazore, në territorin e komunës së Vitisë.

Toka

- Mbrojtja në kuptimin e hapësirës së tokës dhe resurseve tokësore nga tjetërsimi për qëllime jo bujqësore, me kufizim të shtrirjes së ndërtimeve vetëm brenda kufijve ndërtimor të planifikuar (harta “Konceptet e zhvillimit të Vendbanimeve”).
- Mbrojtja e tokës bujqësore nga ndotja, për të mundësuar prodhimtari të rregullt dhe të sigurtë me qëllim të mbrojtjes së njerëzve, botës bimore, shtazore dhe ambientit,
- Mbrojtja e tokës bujqësore nga ndotja përmes kufizimit dhe parandalimit nga bartja direkte, bartja përmes ujit dhe ajrit e materieve të dëmshme dhe ndërmarrja e masave për ruajtje dhe përmirësim të plleshmërisë.
- Ndalohimi i lëshimit të lëndëve të dëmshme dhe të rrezikshme, të cilat e dëmtojnë dhe ndryshojnë aftësinë prodhuese të tokës bujqësore apo kualitetin e kulturave bujqësore, si dhe ndalimi i përdorimit jo të drejtë të plehrave minerale, organike dhe mjeteve për mbrojtjen e bimëve.
- Monitorimi dhe kontrolli i vazhduëshem i plleshmërisë së tokës bujqësore.

- Përfundimi i fazave II dhe III të rregullimit të tokës bujqësore (me masa komosative)
- Ujitja e tokës bujqësore dhe masa tjera për të ngritur shkallën e bonitetit te toka e cila ka bonitet më të ulët.
- Mbrojtja nga vërshimet përmes rregullimit të shtrateve të lumenjëve dhe përrockave (shih hartën e vërshimeve dhe erozioneve), te toka e cila ka bonitet të lartë dhe masa tjera për të mbrojtur dhe ngritur shkallën e bonitetit.
- Mbrojtja nga erozionet, nga shpërlarja e elementeve përbërëse të tokës me anë të pyllëzimit, dhe melorimit të zonave të degraduara. (Harta Pyllzimi)
- Mbrojtja nga degradimi natyror ose ndikimi i njeriut.
- Mbrojtja e pjellorisë natyrore të tokës, përmes carkullimit bimorë në tokat bujqësore, dhe kthimit të materieve organike (të mos digjen serrishtat ose mbetjet bimore).
- Parashikohet ri-zhvillimi i tokës në zonat e mbuluara nga deponitë.

Menaxhimi i Mbeturinave

- Ndërtimi i deponive tranzite të mbeturinave inerte (ndërtimtarisë) gati në të gjitha fshatrat
- Ndërtimi i deponive tranzite të mbeturinave komunale në çdo lokalitet,
- Ndërtimi i varrezave të kafshëve në zonën kadastrale të Ramjanit,
- Ndërtimi i një deponie të mbeturinave inteligjente në fshatin Budrikë e Eperme
- Ndërtimi i një deponie të qëndrueshme për riciklimin e mbeturinave, në zonën kadastrale të fshatit Zhiti
- Intervenime te vendi i deponisë së vjetër të qytetit (rehabilitimi i zonës dhe izolimi)
- Rehabilitimi i vendit ku janë rialokuar mbeturinat e deponisë së vjetër në rrugën Viti – Letnicë).
- Grumbullimi dhe trajtimi i mbeturinave që jan hudhur në mënyrë të pakontrolluar në brigjet e lumit Morava, dhe në hapësira të ngjashme.
- Futja në sistem të menaxhimit të mbeturinave të vendbanimeve ku nuk ka fare menaxhim,
- Futja në sistem të plotë të menaxhimit të mbeturinave të vendbanimeve ku ka menahxim të pjesshëm
- Fuqizimi i sistemit të menaxhimit të mbeturinave përmes infrastrukturës dhe elementeve tjera përbërëse, në vendbanimet në të cilat aktualisht bëhet menaxhimi i mbeturinave.

## 1.4. UDHËZIMET, PËRGJEGJËSITË DHE KËRKESAT E "PLANIT HAPËSINOR TË KOSOVËS – STRATEGJIA E ZHVILLIMIT HAPËSINOR 2010 – 2020+"

Bazuar në strukturat hapësinore të zhvillimit që i përcakton Plani Hapësinor i Kosovës, Komuna e Vitisë bënë pjesë në "Hapësirën e Verdhë" apo Urat e Kosovës, bashkë me tërë rajonin e Ferizajt dhe Gjilanit. Kjo hapësirë karakterizohet me toka bujqësore të kualitetit të lartë, me resurse të ujërave minerale, hapësira të lira të gjelbra, me aktivitete ekonomike tregtare, industriale dhe turistike-malore, transitore dhe shëndetësore.

Vizioni për këtë hapësirë është: *"Urë e zhvillimit të lidhjes së Kosovës me rajonin, rrjet funksional i fuqishëm i qyteteve dhe fshatrave, atraktive për të jetuar dhe punuar në to, me aktivitete ekonomike tregtare, industriale dhe turizëm, atraktive për investitime dhe ndërmarrësi në industrinë përpunuese, agrobiznes, turizëm shërues e rekreativ me plotësimin e kritereve për mbrojtje të mjedisit."*

Synimet kryesore për strukturën hapësinore "Hapësira e Verdhë-Urat e Kosovës" janë:

- Zhvillimi i rrjetit të vendbanimeve që siguron qasje të lehtë dhe kushte për jetë dhe punë atraktive në qytetet: Gjilan, Ferizaj, si dhe nëpër fshatrat e këtyre rajoneve.
- Përkrahja e ekonomisë së qëndrueshme të urbanizmit lokal, konkurrencës në tregjet e brendsheme dhe të jashtme.
- Zhvillimi i infrastrukturës (transport rrugor, hekurudhor, ajror, teknologjinë e informimit dhe komunikimit TIK), për të krijuar lidhje të përshtatshme-ndërurbane me pjesët e tjera të Kosovës, dhe jashtë vendit.

## 1.5. INFORMATA PËR PROCESIN E PLANIFIKIMIT

Plani Zhvillimor Komunal i Komunës së Vitisë dhe Vlerësimi Strategjik Mjedisor janë hartuar nga Komuna e Vitisë me mbështetje të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe kompanisë konsulente UBT – Universiteti për Biznes dhe Teknologji.

Gjatë procesit të planifikimit janë mbajtur disa takime pune të ekipit planifikues komunal në të cilat është diskutuar mbi procesin e hartimit të Planit Zhvillimor Komunal. Është bërë vlerësimi i të dhënave aktuale me të cilat disponpremia komuna në atë kohë, identifikimi i nevojave për gjenerimin e të dhënave të reja si dhe mënyrat e menaxhimit të procesit të sigurimit të të dhënave të nevojshme. Është hartuar edhe Kalendari i Aktiviteteve dhe i Debateve Publike për tërë procesin e planifikimit. Përfaqësuesit e komunës si dhe ata të drejtorive janë zotuar për përshpejtimin e procesit të mbledhjes së të dhënave. Gjatë takimeve tjera është bërë vlerësimi i të dhënave të gjeneruara pas takimit të parë, identifikimi i nevojave për gjenerimin e të dhënave të reja si dhe mënyrat e menaxhimit të procesit të sigurimit të dhënave të nevojshme. Është rishikuar edhe Kalendari i Aktiviteteve dhe i Debateve Publike për tërë procesin e planifikimit. Tutje, në takimet vijuese është diskutuar për draftin e Profilit Komunal, janë identifikuar nevojat për intervenim me qëllim të plotësimit të draftit të profilit, para fillimit të debateve publike. Janë bërë përgaditjet për debatet publike, në mënyrë që ekipi i planifikimit të jenë të gatshëm t'i sinkronizojnë dhe t'i inkorporojnë sygjerimet e qytetetarëve dhe grupeve tjera të interesit, pjesëmarrës në debatet publike.

Diskutimi i parë publik për PZHK Viti 2022-2030 është mbajtur me datë 17.03.2021, në Sallën e Shtëpisë së Kulturës në Viti. Për shkak të rrethanave të krijuara nga pandemia COVID-19, por edhe duke marrë për bazë faktin e ndërldhishmërisë së fazës së Profilit Komunal dhe Analizës së Gjendjes Ekzistuese; grupi punues i projektit, bashkë me organet vendimmarrëse të komunës ka vlerësuar se përfshirja e të gjitha vendbanimeve në një debat publik, për fazën e Profilit dhe Analizës, është më e përshtatshme se përsëritja e debatit në disa vendbanime, krejt kjo me qëllim të menaxhimit më të lehtë të procesit në kushte pandemie. Prandaj, qytetarët dhe grupet e interesit nga të gjitha vendbanimet janë ftuar në debatin publik për Profilin Komunal dhe Analizën e Gjendjes Ekzistuese. Në këtë takim u janë shpjeguar qytetarëve procedurat ligjore për hartimin e PZHK-së dhe rëndësia e pjesëmarrjes publike nga zyrtarët e MMPHI-së. Më pas është prezantuarr drafti i Profilit Komunal dhe Analizës së Gjendjes Ekzistuese, me të dhënat e gjeneruara nga grupi punues për hartimin e planit. Pas prezantimit, u është dhënë fjala qytetarëve pjesëmarrës, për t'i shprehur pikëpamjet e tyre për këtë fazë, ndërsa sygjerimet e tyre janë marrë parasysh gjatë procesit në vijim. Disa të dhëna, të rëndësisë kyce, janë azhurnuar dhe/ose janë ndryshuar si rezultat i këtij debati publik.

Pas diskutimit publik kane vazhduar takimet e ekipit planifikues komunal. Në këto takime është bërë përmbledhja e procesit deri në atë datë, përmbledhja e Debatit Publik për fazën e Profilit Komunal dhe Analizës së Gjendjes Ezkistuese, është diskutuar azhurnimi i të dhënave si rezultat i këtij debati si dhe është planifikuar Punëtoria për Vizionimin e Komunës dhe Skenarëve Zhvillimor për Komunën e Vitisë.

Si rezultat i diskutimeve në këtë takim është vendosur që Punëtoria për Vizionimin e Komunës dhe Skenarët Zhvillimor për Komunën e Vitisë të zhvillohet në qytetin e Durrësit, dhe atë mes datave 09.06 – 11.06.2011. Janë përgaditur ftesat dhe thirrja publike për këtë punëtori. Në këtë takim është diskutuar po ashtu edhe për raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor.

Punëtoria për Vizionimin e Komunës dhe Skenarët Zhvillimor për Komunën e Vitisë është zhvilluar në qytetin e Durrësit, mes datave 09.06 – 11.06.2011. Në këtë punëtori kanë qenë pjesëmarrës përfaqësues të organeve vendimmarrëse të komunës së Vitisë, kryesuesi i Kuvendit Komunal të Vitisë bashkë me anëtarë të Asamblesë Komunale, përfaqësues të të gjitha drejtorive komunale, përfaqësues të shoqërisë civile dhe komunitetit të biznesit, si dhe përfaqësues të kompanisë konsulente.

Gjatë punëtorisë janë bërë prezantime të Profilit Komunal dhe Analizës së Gjendjes Ekzistuese, është bërë përmbledhja e tërë procesit para punëtorisë dhe janë bërë prezantime dhe diskutime për mënyrat/metodat e caktimit të Vizionit dhe Skenarëve Zhvillimor për komunat.

Më pas janë krijuar Grupet Punuese, të ndara sipas Fushave Tematike të planit zhvillimor komunal. Secili grup punues, pas diskutimeve dhe punës grupore, kanë prezantuar sygjerimet e tyre për Vizionin e Komunës, Skenarët Zhvillimor por edhe për Planifikimin Sektorial. Të gjitha propozimet janë bazuar në të dhënat e Gjendjes Ekzistuese në komunë.

Sygjerimet e grupeve punuese për Vizionin e Komunës, Skenarët Zhvillimor si dhe Planifikimin Sektorial janë janë debatuar nga të gjithë pjesëmarrësit dhe në fund janë sintetizuar. Vendimet finale për Vizionin e Komunës, Skenarët Zhvillimor si dhe Planifikimin Sektorial janë reflektuar në draft Planin Zhvillimor Komunal dhe si të tilla janë diskutuar me qytetarët e të gjitha vendbanimeve në Debatet Publike për Vizionimin, Skenarë Zhvillimor dhe Planifikimin Sektorial, të cilat jëna zhvilluar pas kësaj Punëtorie, përkatësisht mes datave 01-07-07-07.2021.

Këto takime patën për qëllim të ju ofrojnë qytetarëve, përfaqësuesve të shoqërisë civile, komuniteteve të ndryshme, grupeve të ndryshme të interesit mundësinë për të diskutuar rreth propozimeve të bëra dhe atyre potenciale rreth Vizionit, Skenarëve Zhvillimor dhe Planifikimit Sektorial në komunën e Vitisë. Sygjerimet e qytetarëve, të dala nga këto debate janë reflektuar në Draftin Final të Planit Zhvillimor Komunal të Komunës së Vitisë për periudhën 2022-2030 (Shih Shtojcën Raporti mbi Procesin e Takimeve dhe Diskutimeve Publike për PZHK Viti 2022-2030 dhe VSM). Në të gjitha këto debate është diskutuar edhe për Vlerësimin Strategjik Mjedisor.

Nga procesi i përmbledhur më lart janë përmbyllur të gjitha fazat e analizave dhe planifikimit për PZHK Viti 2022-2030 duke përfshirë edhe vizionin, konceptet e zhvillimit hapësinor, propozimi i skenarëve për zhvillim, qëllimet dhe objektivat si dhe plani i veprimit.

Sa i përket përmbajtjes së PZHK Viti 2022-2030, pas kompletimit të Profilit dhe Analizës së Çështjeve, të cilat janë bërë në përputhje me U.A. MMPH Nr. 11/2015 është vazhduar me Kornizën e Zhvillimit Hapësinor si dhe me të gjitha fazat e parapara me Udhëzimin Administrativ në fjalë.

Korniza e Zhvillimit Hapësinor të Komunës së Vitisë paraqet zhvillimet e planifikuara dhe orientimet e zhvillimit socio-ekonomik, infrastrukturor dhe hapësinor në të ardhmen. Caqet e zhvillimit afatgjatë janë përcaktuar përmes një bashkëpunimi dhe pjesëmarrje në diskutime e debate gjithëpërfshirëse. Ndërsa e gjithë

kjo është realizuar në bazë të vlerësimit të gjendjes ekzistuese të komunës, SWOT analizës si dhe kapaciteteve zhvillimore dhe investuese të komunës.

Bazuar në vizionin e PHK-së, vizionin e planit paraprak zhvillimor PZHK 2010-2020+ si dhe në nevojat dhe trendet e planifikuara të zhvillimit në komunë, synim kryesor i Planit Zhvillimor Komunal të Vitisë për periudhën 2022-2030 është që përmes strategjive të përcaktuara sektoriale, brenda 8 viteve të ardhshme, të arrihet ky vizion i komunës:

**"Vitia djep kulturor i shkollës shqipe.**

Urë e ndërlidhjeve dhe zhvillimit të qëndrueshëm, modern, të fuqishëm, funksional me të gjitha përmbajtjet dhe duke siguruar cilësi të lartë të jetës.

Komunë me zhvillim të balancuar hapësinor, socio-ekonomik dhe infrastrukturë të qëndrueshme, e fokusuar në mbrojtjen e mjedisit dhe resurseve natyrore dhe kulturore."

**Koncepti i përgjithshëm i zhvillimit hapësinor** të komunës së Vitisë bazohet në vlerësime reale të përparësive krahasuese të komunës të tilla si pozita e saj gjeografike dhe resurset natyrore, dhe mundësive reale të zhvillimit konkurrues të potencialeve të saja zhvillimore: ekonomike, turistike, infrastrukturore dhe resurseve njerëzore.

Nga 3 skenarët e analizuar (**Skenari 0**: Trendi aktual; **Skenari 1**: Zhvillim kompakt - Monocentrik; **Skenari 2**: Zhvillim Policentrik), Skenari 2 - **Zhvillimi gjithëpërfshirës dhe i integruar** është vlerësuar nga komuna dhe akterët pjesëmarrës si skenari më i favorshëm për zhvillimin e komunës gjatë 8 viteve të ardhshme. Prandaj, koncepti i zhvillimit hapësinor të komunës së Vitisë është bazuar në këtë skenar, pra Vitia do të zhvillohet si **Komunë Policentrike.**

Për të realizuar skenarin e përzgjedhur zhvillimor janë identifikuar edhe Tërësitë Hapësinore Funksionale:

- Zona bujqësore – Pjesa qendrore e komunës;
- Zona e Karadakut – Pjesa jugore dhe jug-lindore e komunës;
- Zona Kodrinore - Pjesa veriore e komunës;
- Zona urbane – qyteti i Vitisë me pozitë qendrore,

Si dhe nyjet, korridoret mes nyjeve, plotësimi dendësimi, mbajtja nën kontroll, mbrotja dhe zonat e rritjes.

Për të realizuar vizionin e përcaktuar me këtë PZHK, si dhe për të realizuar skenarin e përzgjedhur zhvillimor, dokumenti ka paraparë Qëllime dhe Objektiva të qarta zhvillimore.

17 Objektivat e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim të Qëndrueshëm janë përvetësuar nga Plani Zhvillimor Komunal Viti 2022-2030 si objektiva të përgjithtshmë për zhvillim të qëndrueshëm hapësinor, socio-ekonomik, infrastrukturor dhe mjedisor, ndërsa si të tilla janë reflektuar në mënyre direkte dhe indirekte në Qëllimet dhe Objektivat e kësaj PZHK-je.

Më poështë është bërë përmbledhja e Qëllimeve Zhvillimore sipas fushave tematike:

- Infrastruktura Publike (Arsimi, shëndetësia dhe administrata publike)

Qëllimi 1: Shërbime cilësore dhe gjithëpërfshirje në arsim

Qëllimi 2: Ngritja e nivelit të shërbimeve shëndetësore dhe mirëqenies sociale

Qëllimi 3.  Administratë efikase

- Infrastruktura sociale (kultura, sporti, hapësirat publike, varrezat)

Qëllimi 4. Sigurimi i infrastrukturës adekuate sociale dhe mirëmbajtja e saj

Qëllimi 5. Promovimi i artit, sportit dhe kulturës

- Zhvillimi Ekonomik

Qëllimi 6: Zhvillim i qëndrueshëm ekonomik i bazuar në shfrytëzimin e potencialit real zhvillimor, shtim të aktiviteteve ekonomike dhe rritje të punësimit, luftim të informalitetit dhe zbutje të zhvillimit të pa-balancuar ekonomik

Qëllimi 7: Orientimi i zhvillimit ekonomik drejt ekonomisë së bazuar në Bujqësi, Industri të Lehtë, Industri Bujqësore dhe Përpunuese si dhe Turizëm Natyror, Rural dhe Kulturor

- Infrastruktura Rrugore dhe Teknike

Qëllimi 8: Rrugë të asfaltuara të kualitetit të lartë dhe qasje për të gjithë banorët

Qëllimi 9: Përmirësimi i sistemit aktual dhe ndërtimi i sistemit të ujit të pijes për vendbanimet periferike

Qëllimi 10: Trajtimi i ujrave të zeza për rrjetin e kanalizimit

Qëllimi 11: Shtrija e rrjetit të kanalizimeve për ujëra të bardha (atmosferike)

Qëllimi 12: Përmirësim të rrjetit energjetik

Qëllimi 13: Organizim i grumbullimit të mbeturinave dhe riciklimi i tyre

Qëllimi 14: Ndriçimi publik i rrugëve në zona të frekuentuara

Qëllimi 15 Shtrirja e internetit në të gjitha vendbanimet

Qëllimi 16: Shtrirja e telefonisë fikse në vendbanimet e dendura

- Mjedisi dhe Sipërfaqet me Rrezikshmëri

Qëllimi 17. Mbrojtja dhe shfrytëzimi i qëndrueshëm i resurseve mjedisore (uji, toka, ajri)

Qëllimi 18. Zvogëlimi i rrezikut nga fatkeqësitë natyrore

- Trashëgimia Kulturore dhe Natyrore

Qëllimi 19: Mbrojtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore për zhvillim të qëndrueshëm

Qëllimi 20: Mbrojtja dhe promovimi i trashëgimisë natyrore për zhvillim të qëndrueshëm

- Banimi, Vendbanimet dhe Vendbanimet Jo-Formale

Qëllimi 21: Krijimi i kushteve për zhvillimin e banimit cilësor e të qëndrueshëm

Qëllimi 22. Shtrirja e vendbanimeve sipas parimit të kompaktësisë dhe multifunksionalitetit

- Shfrytëzimi i Tokës

Qëllimi 23. Shfrytëzim racional i tokës dhe konsolidim i tokës bujqësore të klasit I-IV

Për të gjitha këto Qëllime Zhvillomore janë paraparë edhe objektivat, të cilat e mbështesin realizimin e këtyre qëllimeve. Ndërsa për t'i realizuar objektivat e parapara me këtë PZHK janë planifikuar afër 120 veprime

konkrete. Të gjitha këto (Qëllimet Zhvillimore, Objektivat dhe Veprimet konkrete) janë paraparë në Planin e Veprimit të kësaj PZHK-je.

# 2. PROFILI I KOMUNËS DHE VLERËSIMI I GJENDJES EKZISTUESE

## 2.1. ZHVILLIMI HISTORIK I KOMUNËS

Për shkak të mungesës së të dhënave, koha e saktë e themelimit të Vitisë është vështirë të përcaktohet, por sipas disa materialeve mund të konstatohet se ajo është e vjetër së paku nga koha e mesme. Një kohë, territori i komunës së Vitisë ishte nën pushtimin serbo-sllavë, ndërsa në vitin 1389 sikur edhe pjesa tjetër e Kosovës pushtohet nga osmanët. Në regjistrimin osman të vitit 1455, Vitia si vendbanim kishte 104 bashkësi (shtëpi familjare) me një obligim tatimorë prej 18801 akçe të ardhurave vjetore. Drejtues i Nahisë së Moravës, ishte Çaudar Ahmedi i Guliam Begut. Në vitin 1912, sikurse dhe pjesët tjera të Kosovës, edhe Vitia okupohet nga Serbia. Gjatë luftës së Dytë Botërore, ishte pjesë e zonës së okupuar nga Bullgaria, ndërsa në nëntor të vitit 1944, ripushtohet nga Jugosllavia komuniste. Në pikëpamje administrative, Vitia me 1912 ishte shpallur komunë, ndërsa gjatë mbretërisë jugosllave, ishte pjesë përbërëse e Banonisë së Vardarit me qendër në Shkup. Në vitin 1952, në qarkun e Gjilanit formohen tri rrethe: Gjilani, Dardana dhe Vitia, ndërsa në vitin 1959 transformohen rrethet. Edhe Vitia, shndërrohet në komunë më vete, siç është deri më sot.

Sipas disa burimeve të ndryshme arkivore (ndërkombëtare), arsimi shqip në Kosovë gjenezën e ka në Komunën e Vitisë, më saktë në Stubëll, në vitin 1584. Për këtë shkollë, e cila me ndërprerje të herëpashershme, për shkak të rrethanave tejet të pafavorshme në të cilat u gjend populli ynë (nën pushtimin otoman e serb), ka punuar për gjithë këta shekuj (në fshehtësi të madhe), kanë shkruar një numër i madh i studiuesve vendës e të huaj, si: Akademik Jashar Rexhepagiqi, Akademik Dh. Shuteriqi, Prof. dr. Hajrullah Koliqi, Prof. dr. Shefik Osmani, A. Kasoruho, Noel Malkolm, Dr. M. Vanino, M. Korade, R. Rajeviq, Dr. A. Nikiq, Akademik A. Urosheviq, A. Komulovic, Tommaso Raggio, Prof. dr. K. Gostentschnigg e një çetë e tërë studiuesish të tjerë. Muzeu i Shkollës së Parë Shqipe në Kosovë, në Stubëll, ruan mbi një mijë faqe dokumente që argumentojnë ekzistencën dhe funksionimin e shkollës në Stubëll, dhe libra të vjetër në gjuhën shqipe që nga viti 1664. Kjo shkollë ndër shekuj dha mësimdhënës e personalitete të vlerësuara, të cilët vepruan jo vetëm në rrafshin kombëtar, por dhe në atë ndërkombëtar.

Tradita e shkollës shqipe në Komunën e Vitisë vazhdon me shkollën e Pozheranit. U themelua në fund të vitit 1909, ndërsa ndërpreu punën në fillim të vitit 1910, si pasojë e kryengritjeve dhe luftës kundër otomanëve.

Luftërat ballkanike, dhe më pas pushtimi i Kosovës nga Mbretëria SKS, nuk lejuan funksionimin e kësaj shkolle në gjuhën shqipe. Tek Lufta e Dytë Botërore hapi mundësi të reja për shkollën dhe arsimin shqip në Komunën e Vitisë. Kështu, shkolla shqipe në Pozheran, do rifillojë mësimin në gjuhën shqipe në vitin 1941. Mësimi do ndërpritet në tetor të vitit 1944, për të vazhduar sërish në shtator të vitit 1945. Gjatë Luftës së Dytë Botërore, kanë funksionuar shkollat shqipe edhe në Sllatinë të Epërme, në vitin 1942/43 dhe në Vërban, në vitin 1943/44. Krahas shkollave të sipërpërmendura, pas Luftës së Dytë Botërore u hapën dhe shkolla tjera në gjuhën shqipe, si në: Smirë (1945), Gjylekar (1946), Ramjan (1947), Kabash (1948), Radivojc (1948), Stubëll (1950), Zhiti (1952), Gërmovë (1966) etj.

Komuna e Vitisë ishte një komunë e përbashkët me atë të Kllokotit. Me 8 janar 2010 është formuar komuna e re e Kllokotit që shtrihet në brendinë e territorit të Komunës së Vitisë. Komuna e Kllokotit ka 4 vendbanime me një territor prej rreth 27 km$^2$ në të cilin jetojnë rreth 2,500 banorë. Deri në vitin 2010, komuna e Vitisë kishte një territor prej 297 km$^2$ dhe 43 vendbanime. Pas formimit të komunës së Kllokotit, komuna e Vitisë tani ka një sipërfaqe prej rreth 270 km$^2$ dhe 39 vendbanime.

## 2.2. KARAKTERISTIKAT E PËRGJITHSHME TË KOMUNËS

### 2.2.1. Pozita Gjeografike

Komuna e Vitisë gjendet në pjesën jug-lindore të Kosovës, respektivisht është e përfshirë në rajonin e Anamoravës me një sipërfaqe prej 270 km2. Komuna e cila përbëhet nga zona urbane dhe 38 fshatra gjendet rreth 40 km në jug të Prishtinës dhe kufizohet me Gjilanin, Ferizajn, Kaçanikun dhe me Republikën e Maqedonisë së Veriut. Pozita e mirë gjeografike në të cilën shtrihet komuna e Vitisë i mundëson lidhje të mira me qendrat e tjera të Kosovës dhe të rajonit.



Harta 1 Pozita Gjeografike e Komunës së Vitisë në Hartën e Republikës së Kosovës *(Kliko për hartën me rezolucion të lartë)*

Qyteti shtrihet në një fushëgropë të gjerë. Ka kushte të mira për bujqësi dhe njihet si qytet agro-industrial. Në veri-lindje kufizohet me komunën e Gjilanit, në perëndim me komunën e Ferizajt, në jug-perëndim me komunën e Kaçanikut dhe krejtësisht në jug-lindje me Republikën e Maqedonisë së Veriut. Komuna e Vitisë lidhjet e komunikacionit rrugor automobilistik i ka kryesisht me qytetet e Gjilanit dhe Ferizajt, të cilët i ka në largësi të barabartë prej 21 km.

Qendra komunale e Vitisë ka një specifikë të veçantë, sepse ndodhet në mesin e të gjitha fshatrave të saj dhe distanca më e largët nga qendra komunale është vetëm 12 km. Gjithashtu, struktura e qendrave institucionale është e rregulluar me qasje të mirë si p.sh. shtëpia e shëndetit ndodhet afër qendrës për punë sociale. Gjykata dhe Policia në rrugën "Adem Jashari", ndërtesa e komunës, Shtëpia e Kulturës dhe shumë shërbime institucionale gjenden në qendër të qytetit.

Nga magjistralja Prishtinë – Shkup, Vitinë e ndajnë vetëm 13 km rrugë. Me Prishtinën, lidhet më rrugë automobilistike në dy drejtime: përmes Ferizajt (55 km) dhe Gjilanit (67km).

Vitisë i nevojitën vetëm 13 km për t'u kyçur në hekurudhat e Kosovës, kurse deri në aeroportin e Prishtinës duhet kaluar 80 km. Me pikën kufitare me Maqedoninë, Hanin e Elezit, e ndajnë 37 km rrugë, me Shkupin 60 km, ndërkaq me aeroportin e këtij qyteti 82 km.

## 2.2.2. Veçoritë Mjedisore

### *2.2.2.1. Gjeomorfologjia*

Territori i Komunës së Vitisë ka një reliev mjaft të përshtatshëm pasi që shtrihet në një hapësirë relativisht të rafshët. Pjesa qëndrore e komunës shtrihet në një rrafshinë deri në 600 m. të lartësisë mbidetare, ndërsa pjesa më e lartë e komunës shtrihet në jug-lindje me latësi mbi 1000 m.. Janë 37.10 % e sipërfaqes që gjendën në pjesën e rrafshët deri në 600 m. të lartësisë mbidetare dhe kjo pjesë është mjaft e përshtatshme për prodhimtarinë bujqësore.

Vitia ka një sipërfaqe relativisht të rrafshët, një tokë mjaftë pjellore, sipërfaqe të konsiderueshme pyjore (si pjesa e Karadakut të Shkupit, me majën e Kopilaçës me një lartësi praj 1,490 m., male këto që formojnë edhe kufirin natyror mes Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut), por edhe rrjedha të mjaftueshme të lumenjëve (Morava e Binçës, Letnica etj.). Gjithashtu Vitia ka një sasi të ujërave minerale dhe jo metale.

Mbi 90% e territorit të komunës shtrihet në lartësi deri në 900 m. Nërësa, pjesa e lartë e trritorit të komunës me mbi 900 m. nuk arrinë as 10% të gjithë territorit të komunës.

Tabela 1 Lartësia mbidetare në komunën e Vitisë, sipërfaqja dhe pjesmarrja në %

| Lartësia | Sipërfaqja (km²) | % |
|---|---|---|
| **Deri 600** | 100.07 | 37.11 |
| **600-900** | 147.36 | 54.65 |
| **900-1200** | 18.54 | 6.88 |
| **Mbi 1200** | 3.67 | 1.36 |
| **Gjithsej** | 269.64 | 100 |




Harta 2 Lartësia mbidetare në Komunën e Vitisë

Element mjaft i rëndësishëm sa i përket relievit është edhe ekspozicioni i terrenit. Komuna e Vitisë ka poashtu ka një ekspozicion mjaft të përshtatshëm që është i ndikuar kryesisht nga vet terreni i rrafsht që është mjaft i shprehur.

Tabela 2 Drjetimi i uljes së terrenit

| Drejtimi i uljes (Aspects) | Shkalla | Vlera e thyerjes | Siperfaqe/ ha |
|---|---|---|---|
| Rrafshët | (-01) | 0.00 | 0.07 |
| Veri | 0 - 22.5 | 6.25 | 1685.55 |
| Veri-Lindje | 22.5 -67.5 | 12.45 | 3357.63 |
| Lindje | 67.5 - 112.5 | 12.55 | 3384.60 |
| Jug-Lindje | 112.5 - 157.5 | 12.50 | 3371.11 |
| Jug | 157.5 - 202.5 | 12.50 | 3371.11 |
| Jug-Perëndim | 202.5 - 247.5 | 12.50 | 3371.11 |
| Perëndim | 247.5 - 292.5 | 12.50 | 3371.11 |
| Veri-Perëndim | 292.5 - 337.5 | 12.50 | 3371.11 |
| Veri | 337.5 - 360 | 6.25 | 1685.56 |
| Total | | **100.00** | **26,968.96** |

Siç shihet edhe nga harta, ekspozicioni i rrafshët, ai jug-perëndimor dhe verior dominojnë në territorin e komunës. Këto ekspozicione të terrenit përfshijnë mbi 70% të gjithë territorit të komunës. Pjesa tjetër është më pakë e shprehur dhe ka nën 30% të territorit. Pjesa e rrafshët përfshinë kryesisht pjesën qendrore të

komunës, ndërsa ekspozicioni jug-perëndimor është I shprehur në disa pjesë të komunës e sidomos në pjesë jug-lindore, lindore dhe veriore. Sa i përket relievit, element tjetër mjaft I rëndësishëm është edhe pjerrtësia e terrenit. Bazuar në format relievore të komunës, edhe pjerrtësia e terrenit është mjaft e përshtatshme pasi që dominojnë pjerrtësitë e vogla nga 0 deri 4 shkallë e që shtrihen në pjesën qendrore dhe të rrafshet të komunës së Vitisë. Duke shkuar në pjesën jugore dhe jug-lindore të komunës kemi një rritje të pjerrtësisë së terrenit bazuar edhe ngritjet relievore. Po ashtu pjesa veriore e komunës ka një pjerrtësi më të madhe të terrenit

### *2.2.2.2. Gjeologjia*

Territori i Komunës së Vitisë në aspektin gjeologjik është mjaft kompleks. Në ndërtimin gjeologjik të tij marrin pjesë formacionet gjeologjike të moshave dhe vjetërsive të ndryshme - nga ato të Paleozoikut (të përfaqësuara nga rreshpe dhe llojet e tyre) e deri në Kuaternar (rëra, zhavori, argjila me rërë dhe zhavor). Hulumtimet në lidhje me ndërtimin gjeologjik të territorit të komunës së Vitisë lidhen kryesisht me hulumtimet regjionale të kryera për gjithë territorin e Republikës së Kosovës. Një ndërtim gjeologjik më idetajuar për gjithë territorin e Republikës së Kosovës, respektivisht ku ndodhet edhe territori i komunës së Vitisë, jepet në hartën gjeologjike në shkallë 1: 00 000 dhe 1: 200 000. Brenda këtij territori si pasojë e zhvillimi të proceseve të ndryshme dhe të shumëllojshme gjeologjike janë formuar vendburime të rëndësishme të mineraleve të dobishme metalore dhe jo metalore. Sipas vendburimeve të njohura të mineraleve të dobishme, sasisë së rezervave xeherore të vërtetuara, si dhe potencialit mineralmbajtës, territori i Komunës së Vitisë paraqet interes për hulumtim, shfrytëzim dhe valorizim ekonomik të potencialeve mineralmbajtëse.

Në territorin e gjerë të Komunës së Vitisë, paraqiten xeheroret sulfurore të bakrit, zinkut dhe plumbit, mandej xeherorët e hekurit, ndërsa nga jometalet më interesantet janë kuarcitet, tufet, leucitet dhe bentonitet.




Harta 3 Gjeologjia e komunës së Vitisë

### *2.2.2.3. Pedologjia*

Në komunën e Vitisë kemi kryesisht këtë përbërje pedologjike të tokës:

**Tokë aluviale deltinore** gjendet në pjesën më të madhe të zonës urbane të Vitisë, në një shirit hapësinor që përshkon Kabashin dhe Bincën, në një pjesë të madhe të Sllatinës, në një pjesë të Gërmovës dhe Drobeshit si dhe në një pjesë të vogël të Sadovinës së Cerkezëve, Sadoviës së Jerlive, Pozharanit, Beguncës, Ramnishtes dhe Podgorcit. Toka e njëjtë gjendet edhe në pjesën veri-lindore dhe lindore të komunës, përkatësisht në zonat kadastrale si vijon: në një pjesë të madhe të Budrigës së Epërme, një pjesë të madhe të Gjylekarit, si dhe në pjesë të vogla të Radivojcit dhe Remnikut.

**Tokë livadhore deltinore** gjendet në një pjesë të madhe të Pozharanit, si dhe në një pjesë të vogël të zonës urbane, Sllatinës dhe Gjylekarit.

**Tokë e kuqrremët, kafe, rërë, deltinë, mbi sedimente të kuqrremta** gjendet kryesisht në veri të komunës, përkatësisht në zonat kadastrale si vijon: në një pjesë të madhe të Tërpezës, në gjysmën e Novosellës dhe gjysmën e Ramjanit. Ndërsa gjendet edhe në një pjesë të vogël të Sadovinës se Cerkezëve dhe Terstenikë, në veri-perëndim të komunës.

**Tokë kafe e cekët mbi ranor** është lloji më i përhapur i tokës në komunën e Vitisë dhe gjendet në zonat kadastrale si vijon: në pjesën më të madhe të Pozharanit, Sllatinës, Sadovinës së Cerkezëve, Sadovinës së Jerlive, Gërmovës, Drobeshit, në një pjesë të Smirës Kabashit dhe Zhitisë si dhe në një pjesë të vogël të Vitisë (zona urbane), Bincës, Beguncës, Ramnishtes, Pogdorcit, Ballances, Tërpezës, Cifllakut, Novosellës dhe Tërstenikut.

**Tokë Solonece** gjendet kryesisht në pjesën lindore të komunës, përkatësisht në zonat kadastrale si vijon: në pjesën më të madhe të Remnikut, Gjylekarit, Godenit të Madh dhe Stubllës së Epërme, komplet Stubllën e Poshtme, në një pjesë të madhe të Smirës si dhe në një pjesë të vogël të Kabashit.

**Tokë podzolake-pseudogleje** gjendet në një pjesë të madhe të Vërnezit.

**Tokë kafe e cekët mbi flish** gjendet në zonat kadastrale si vijon: Tërpezë, Ballancë, Zhiti dhe Devajë në Veri; Gushicë, Smirë dhe Kabash në Jug.

**Tokë smonicë kafe** gjendet kryesisht në jug-lindje të komunës, përkatësisht në zonat kadastrale si vijon: Bince, Beguncë, Ramnishtë, Buzovik, Lubishtë, Podgorc, Shashare dhe Letnicë. Në sipërfaqe më të vogla gjendet në pjesën lindore, veriore dhe veri-perëndimore të komunës, përkatësisht në zonat kadastrale si vijon: Gjylekar, Remnik, Budrigë e Epërme, Radivojc, Devajë, Zhiti, Tërpezë, Novosellë, Ramjan dhe Cifllak.

**Tokë e verdhë-kafe humusore mbi argjila liqenore** gjendet vetëm në pjesën veriore dhe veri-lindore të komunës, edhe atë në zonat kadastrale si vijon: Tërpezë, Ballancë, Zhiti, Devajë, Radivojc dhe Budrigë e Epërme.

**Tokë aluviale, rërë, deltinore** gjendet kryesisht në pjesën jugore të komunës, edhe atë në zonat kadastrale si vijon: Vërban, Gushicë, Smirë, Kabash, Bince, Mjak, Debelldeh, Buzovik, Beguncë, Lubishtë, Shashare, Letnicë, Vërnez, Vërnakollë, Podgorc. Ajo po ashtu gjendet në lindje të komunës, përkatësisht në zonat kadastrale Gjylekar dhe Remnik; në veri të komunës, përkatësisht në zonat kadastrale Ballancë, Tërpezë, Novosellë dhe Ramjan, si dhe në perëndim të komunës, përkatësisht në zonat kadastrale Sllatinë, Sadovinë e Cerkezëve, Terstenik dhe Sadovinë e Jerlive.

**Tokë kafe mesatarisht e thellë mbi rreshpe** kryesisht gjendet në pjesën jug-lindore të komunës, dhe atë në zonat kadastrale si vijon: Vërnakollë, Vërnez, Letnicë, Shashare, Lubishtë, Buzovik dhe Debelldeh.

**Tokë e aglejuar mineralo-mocalike argjilore** gjendet kryesisht në pjesën perëndimore dhe jug-perëndimore të komunës, përkatësisht në zonat kadastrale si vijon: Sllatinë, Sadovinë e Cerkezëve dhe Sadovinë e Jerlive.

**Tokë kafe e lisevuar mbi argjilë liqenore** gjendet kryesisht në pjesën jug-perëndimore të komunës, dhe atë në zonat kadastrale si vijon: Vërban, Gushicë dhe Smirë.

**Tokë kafe mesatarisht e thellë mbi ranor** gjendet në disa pjesë të komunës, dhe atë në zonat kadastrale si vijon: Ballancë dhe Zhiti në veri; Vërban në jug-perëndim; Smirë, Kabash dhe Bincë në jug.




Harta 4 Pedologjia në Komunën e Vitisë

### *2.2.2.4. Kushtet klimatike*

Klima e Vitisë është e ndikuar nga vetë pozita gjeografike dhe morfologjia e terrenit. Kryesisht dominon klima kontinentale me ndërrimin e katër stinëve të vitit të cilat ndikojnë në jetën dhe veprimtarinë ekonomike të popullsisë. Të dhënat më të reja për klimën janë marr nga stacioni meteorologjik i Ferizajit pasi që në komunën e Vitisë nuk ka stacion meteorologjik.

**Temperatura e ajrit -** Sipas të dhënave për vitin 2018, temperatura mesatare vjetore në komunën e Vitisë është 11.2 °C. Nëse krahasohet me periudhë para 10 viteve, mund të konstatojmë se nuk kemi ndonjë ndryshim të theksuar të temperaturave pasi që temperature mesatare vjetore për vitin 2008 ishte 11.5 °C dhe në vitin 2002 ishte 10.9 °C.

Temperaturat më të ulëta janë në muajt Dhjetor, Janar dhe Shkurt ku gjatë vitit 2018 është shënuar temperature më e ulët e vitit me -16°C. Muajt më të nxehtë janë ata të stinës së verës: gushti, korriku dhe qërshori dhe temperatua maksimale e regjistruar është 30.6 °C në muajin korrik të vitit 2018.

**Lagështia relative e ajrit** në komunën e Vitisë ka vlerë mesatare vjetore prej 77,4%, me mesataren më të ultë prej 68% gjatë muajt e verës dhe më të lartë prej 87 % gjatë muajit dhjetor.




Grafika 1 Lagështia relative e ajrit sipas muajve e shprehur në %

**Diellosja ose Insolacioni -** Është element klimatik i cili ka rëndësi në veprimtaritë e ndryshme ekonomike (bujqësi, turizëm, mjekësi) etj. Zgjatja e diellosjes varet nga faktorët astronomik, meteorologjik dhe nga relievi. Diellosja është më e vogël në luginat e ngushta dhe grykat lumore si dhe në viset malore për shkak të rritjes së vranësirave me rritjen e lartësisë mbidetare. Në bazë të vrojtimeve të diellzimit në katër stacionet meteorologjike (Prishtinë, Ferizaj, Prizren, Pejë), Kosova ka mesatarisht 2066 orë me diell gjatë vitit ose mesatarisht 5.7 orë në ditë. Vlerën më të madhe të diellosjes e ka Prishtina me 2140 orë në vit, Peja me 1958 orë, Ferizaj 2067 orë dhe Prizreni me 2099 orë më diell gjatë vitit. Gjatë vitit në muajin korrik ka më së shumti diellosje, kurse në dhjetor më së paku[1].

**Erërat -** Pozita gjeografike e komunës së Vitisë ka mundësuar kushte të favorshme sa i përket erës. Sipas të dhënave nga vjetari hidrometeorologjik i Kosovës për vitin 2018 është konstatuar se në këtë komunë kemi rreth 100 ditë gjatë gjithë vitit pa erë. Në pjesën tjetër të vitit ku kemi erë, dominon kryesisht drejimi veri-perëndimor, verior dhe veri-lindor. Në këto drejtime edhe shpejtësia e erës është më e madhe dhe sillet rreth 10-12 m/s e në disa raste edhe më e madhe se kaq. Kemi po ashtu edhe drejtimin jug-lindor që ka një dominim të konsiderueshëm.

[1] Burimi: prof. Dr, Ruzhdi Pllana, Gjeografia e Kosoves 8




Grafika 2 Erërat në komunën e Vitisë

Nëse e analizojmë dominimin e drejtimeve sipas muajve të vitit mund të konstatojmë se në muajt Shkurt, Prill dhe Dhjetor ka dominuar drejtimi veri-perëndimor. Në muajt qershor, korrik dhe shtator kemi dominim të drejtimit verior. Drejtimi jug-lindor kryesisht ka dominuar në muajt: mars, maj, tetor dhe nëntor. Në muajin janar ka dominuar drejtimi jug-perëndimor dhe në muajin gusht drejtimi veri-lindor.

**Reshjet –** Sipas të dhënave për vitin 2018 janë regjitruar gjithësej 980.3 mm reshje gjatë gjith vitit. Numri i ditëve me reshje ishte 118. Sasia më e madhe e reshjeve është regjistruar kryesisht në muajt maj dhe qërshor. Shpërnarja e reshjeve në territorin e komunës së Vitisë ndryshon varësisht pozita dhe karakteristikat gjeomorgologjike. Në pjesët më të larta të komunës, edhe sasia e reshjeve është më e madhe, ndërësa në pjesët më të ulta edhe sasia e reshjeve është vogël.




Harta 5 Harta e Reshjeve në komunë

Në pjesën më të madhe të territorit të komunës së Vitisë janë regjistruar sasitë më të vogla të reshjeve që janë 600 dhe 700 mm. Sasi më e madhe e reshje është regjistruar në pjesën jugore dhe jug-lindore të komunës ku shtrihet edhe pjesa malore e komunës. Në këto hapësira reshjet janë 800 deri 1000mm.

### *2.2.2.5. Hidrografia*

Komuna e Vitisë është e pasur me ujëra sipërfaqësor por edhe me ujëra nëntokësor. Kjo komunë ka një rrjetë mjaft të dendur hidrografik. Ujërat sipërfaqësor të Vitisë, ndahen në lumenj që arrijn gjatësinë 55586.29m, dhe prroska 386946.95 m. Rrjeti hidrgrafik i komunës së Vitisë përfshin këta lumenj kryesor: Morava e Binçës, Lumi i Letincës, Lumi i Gelbushit, prroi i Gërnçarit dhe përroi i Debelldehut.

Lumi kryesor I këaj komune është Morava e Binçës, i cili mbledhë gjithë lumenjtë e vegjël, me një prurje mesatare mujore prej 6.7 m3/sec. Morava e Binçës, është pjesë burimore e Moravës jugore. Ajo buron në masivin Bilak, që është pjesë e Karadakut të Shkupit. Gjatësia e këtij lumi në territorin e Kosovës është 60km, kurse sipërfaqja e pellgut 1.560 $m^2$, ndërsa rrjedha mesatare e saj në të dalur nga teritori i Kosovës, është 11.0 $m^3$/sec. Në Moravën e Binçës rrjedhje më të mëdha të ujit shfaqen gjatë muajit mars, shkurt dhe maj, kurse më të vogla gjat muajit gusht dhe shtator.

Komuna e vitisë poashtu është e pasur edhe me burime të shumta ujore si një resurs mjaft i rëndësishëm sidomos në aspektin e furnizimit me ujë. Ka burime natyrore pothuaj të shpërndara në të gjitha pjeset e komunës dhe gjithashtu edhe burime të kaptuara.

Janë mbi 40 burime ujore natyrore dhe mbi 10 burime të kaptuara që shtrihen kryesisht në pjesën jug-lindore, jugore dhe jug-përendimore të komunës. Poashtu edhe pjesa veriore është e pasur me burime ujore. Këto pjesë të komunës janë me lartësi më të madhe mbidetare dhe shtrihen terrenet kodrinoro-malore si hapsira të përshtatshme për burime ujore. Vlen të përmendet se në këtë komunë gjenden edhe ujrat termomineral në fshatin Zhiti.




<u>Harta 6 Rrjeti Hidrografik në Komunën e Vitisë</u>

Varësisht nga karakteristikat gjeomorfologjike dhe gjeologjike të komunës së Vitisë, kemi edhe shpërnarjen e resuseve ujore nëntokësore. Për të shqyrtuar potencialin e ujërave nëntokësore, qarkullimin e tyre dhe, mbi të gjitha, furnizimin me ujë ose vlerësimin e marrjes së ujit në vende të caktuara, të gjitha masat shkëmbore janë të ndara në bazë të kritereve të mëposhtme: Përbërjes litologjike; Shkallës së shkatrrimit mekanik dhe Tipit të porozitetit, ujëpërshkueshmërisë dhe koeficienti të filtrimit.

Sipas llojit të porozitetit, të gjitha masat shkëmbore në territorin e Komunsë së Vitisë klasifikohen në dy grupe: Shkëmbinjtë me lloj poroziteti intergranular dhe Shkëmbinj me lloj poroziteti të çarë ose të çarë-kavernoze.

Secili lloj i porozitetit ndahet në katër grupe sipas përshkueshmërisë së ujit:

- Shkëmbinj praktikisht të papërshkueshme nga uji;
- Komplekse shkëmbore të papërshkueshëm nga uji dhe i papërshkueshëm nga uji;
- Me përshkueshmri të ultë të ujit me koeficientrationt e filtrimit nga 10–5 deri në 10–7 m/s;
- Shkëmbinj me ujëpërshkueshmëri të mirë me koeficientë të filtrimit më të lartë se 10-15 m/s;




Harta 7 Harta Hidrogjeologjike në komunën e Vitisë

Tabela 3 Sipërfaqja në km2 sipas tipit të akuiferit dhe pjesmarrja në %

| Tipi i akuiferit | Sipërfaqja (km²) | % |
|---|---|---|
| Terrene me ujë pak (akuifer të dobet te ujërave nëntokesore) | 120.75 | 44.8 |
| Akuifer me porozitet të plasave dhe çarjeve | 50.14 | 18.6 |
| Akuifer me porozitet intergranular me koeficient filtrimi të lartë | 74.29 | 27.5 |

| | | |
|---|---|---|
| Akuifer me porozitet intergranular me koeficient filtrimi mesatar deri të ulët | 24.50 | 9.1 |

Nga harta dhe tabela më lartë, mund të kuptohet se në komunën e Vitisë dominojnë terrenet me ujë pak (akuifer të dobet te ujërave nëntokesore), me 44.8% të sipërfaqes së përgjithshme, duke u pasuar nga Akuifer me porozitet intergranular me koeficient filtrimi të lartë, me 27.5 % të sipërfaqes së përgjithshme të analizuar në këtë kategori.

Akuiferet më vulnerabel në territorin e komunës së Vitisë janë akuiferet me porozitet intergranular të cilet nga aspekti litologjik ndërtohen nga rëra dhe zhavorre. Këto tipe të akuifereve shtrihen kryesisht në pjesen qendrore, respektivisht përgjatë luginave lumore (lugina e lumit Morava e Binçës etj.). Nga aspekti hidrogjeologjik këta akuiferë janë me prioritet për furnizim me ujë të pijshëm dhe kërkesa tjera. Po ashtu vulnerabel është edhe akuiferi me prorozitet të plasave dhe çarjeve i cili përhapet në pjesen verilindore dhe jugperëndimore të territorit të komunës së Vitisë. Këta dy tipe të akuiferve janë mjaftë vulnerabël nga ndotja e cila vjen nga ujërat sipërfaqësore kryesisht nga reshjet (shiu etj.). Monitorimi dhe njohja e shkallës së ndotjes së këtyre ujërave është me interes të veçantë për institucionet në komunën e Vitisë me qëllim të ndërmarrjes së masave për parandalimin e përkeqësimit, mbrojtjes dhe ruajtjes së cilësisë së ujërave në to.

#### *2.2.2.6. Biodiversiteti*

Komuna e Vitisë është e pasur me pasuri natyrore botanike, hidrologjike, gjeomorfologjike, si dhe peizazhore. Në vitin 2005, nga Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës janë evidentuar 20 monumente të natyrës në Komunën e Vitisë, prej tyre 14 janë propozuar për mbrojtje. Prej monumenteve të natyrës të propozuara për mbrojtje 8 janë Monumente Natyrore Botanike III, 3 janë Monumente Natyrore Hidrologjike III, 2 janë Peizazh i Mbrojtur V dhe 1 është Monument Natyror Gjeomorfologjik.

Këto zona dhe monumente të natyrës aktualisht janë në gjendje jo të mirë, madje disa prej tyre, p.sh Trungu i Qarrit (Qurcus cerris) në Viti, është zhdukur fare. Në rrezik janë pyjet e ahut në Debelldeh, të cilat e përbëjnë një fitocenoz të shkëlqyer të ahut si dhe Ilex aquifolium (Ashja), që gjendet në këto pyje dhe e cila përbënë një lloj të rrallë në Kosovë. Gjatë rekognozimit të zonave të mbrojtura në komunën e Vitisë në vitin 1986 janë evidentuar edhe këto vlera natyrore: një Monument memorial i natyrës në Ramjan, Pyjet e ahut në Debelldeh si dhe Ilex Aquifolium në Karadak.

Në bazë të hulumtimeve të bëra më herët (Krasniqi, F. 1972 & Rexhepi, F.1982;1994) në vegjetacionin e territorit të komunës së Vitisë është konstatuar se ekzistojnë disa individume të fitocenozave mjaft interesante dhe disa fitocenoza të cilat janë mjaft të begatshme dhe interesante në aspektin ekonomik, shkencor dhe mjekësor.

Si individume të fitocenozave më interesante janë: Individumet e Ass. Quercetum- farnetto cerris (Llojet karakteristike janë: Shpardhi (Quercus frainetto), Qarri (Q. Cerris), Thana (Cornus mas), Kulumria (Pronus spinosa) etj. të cilat janë të dëmtuara tej mase nga faktori antropogjen, Individumet e Ass. Querco-carpinetum moesiacum, (Llojet karakteristike: Shkozëbardhë (Carpinus betulus), Bungu (Quercus petraea), Ahu (Fagus moesiaca) etj.

Individumet e Ass. Coryletum avellanae (Lloj edifikator është Lajthia (Coryllus avellana).

Si fitocenozë e njohur në këtë territor është Ass. Salici - populetum nigrae. Pran luginave të lumit Morava e Binçës dhe degëve të tij i cili është vazhdimisht nën ndikimin e faktorit antropogjen. Llojet që e përbëjnë këtë asociacion janë: (llojet e shelgjeve (Salix), plepave (Populus) nganjëher edhe verri (Alnus). Janë të përhapura në toka rarorë telttyrore, aluvium teltyrore. Këto asociacione janë vetëm mbeturina të pyjeve të dikurshme shumë të përhapura të cilat janë shkatërruar nga njeriu për të krijuar tokë për kultura të ndryshme. Në katin

përdhes të këtij asociacioni zhvillohen llojet higrofite siç janë Solanum dulcamara, Lythrum salicara, Lycopus europaeus, Rubus caesius var. aquaticus etj.

### Fauna

Fauna në territorin e Vitisë ashtu si edhe fauna e tërë Kosovës nuk është e studiuar sa duhet, mirëpo nga të dhënat nga terreni dhe shënimet nga literatura relevante vërehet një përbërje mjaft e begatshme e llojeve shtazore. Sipas të dhënave nga IKMN, territori i komunës së Vitisë është i pasur me shtazë të egra në mesin e të cilave ka edhe lloje që konsiderohen si të rrezikuara. Numri më i madh i shtazëve të egra gjenden në zona malore të kësaj komune që janë në kufi me Republikën e Maqedonisë, ndonëse fauna e egër është prezentë edhe në rajonet tjera malore të kësaj komune.

### Gjitarët

Përfaqësohen me llojet nga ato më të mëdha deri te ato më të imëta të mishngrënësve si: Ariu i murrmë (Ursus arctos), Rrëqebulli (Lynx lynx), Macja e egër (Felis sylvestris), Dhelpra (Vulpes vulpes), Ujku (Canis lupus), Lundërza (Lutra lutra), Bukla e vogël (Mustela nivalis), Kunadhja (nga gjinia Mustela), Baldosa evropiane (Meles meles), Lakuriqi (nga gjinia Myotis, Rhinolopus). Barngrënësit përfaqësohen me kaprollin (Capreolus capreolus), jo përtypësit me derrin e egër (Sus scrofa) që është në numër të madh të kopulacionit. Prej brejtësve: Ketri (Sciurus vulgaris), Lepuri (Lepus europaeus), llojet e minjve të fushës dhe të pyllit, këlyshi i verbër (Spalax monticola) etj. Llojet insektengrënëse urithi (Talpa europeae), iriqi (Erinaceus concolor), dhe rrëmihësi i rëndomtë (Sorex araneus).

### Shpezët

Prania e shpezëve është me numër të madh në biotopet malore, mirëpo kohëve të fundit është konsideruar zhdukja e një numri të madh të tyre. Nga familja e shqiponjave (Accipitridae) janë prezentë: (Buteo buteo) i cili gjendet në zonat: Binçë, Smirës dhe Goshicës. (Buteo rufini) i cili gjendet në zonat: Letnicë, Zagraxhë, Vërnez, Shoshare. Mirëpo disa nga llojet që më par kanë polenizuar sot mungojnë, siç është rasti me Shqiponjen e maleve (Aquila chrysaetos) dhe (Aquila heliaca), të cilat kanë jetuar më herët në malet e Karadakut, kurse sot nuk gjenden as çerdhet e tyre. Kurse nga familja e Fajkonjëve (Falconidae), (Falco tinnunculus) është prezent në këto zona: Remnik, Budrikë dhe Devajë. Nga familja e Hutinëve (Strigidae): huti malorë (Strix aluco), kukuvajka (Athene noctua), (Bubo bubo). Nga familja e Fazanëve (Phasianidae), dy lloje të thëllëzave, ajo fushore (Perdix perdix) dhe gurore (Alectoris graeca) të cilat kanë qenë me kopulacione më të mëdha. Sot për shkak të ndikimit të bujqësisë dhe gjuetisë së tepërt dhe të pa kontrolluar, jetojnë me numër të kufizuar dhe janë në rrezik të zhdukjes nga arealet e tyre të më hershme. Prej familjes së pëllumbave (Culumbidae), pllumbi i egër (Columba livia dhe C. oenas) dhe kumria (Streptotelia decaocta). Nga familja e korbave (Corvidae): laraska (Pica pica), stërqoka (Pyrrhocorax pyrrhocorax), sorra (Corvus monedula), korbi (Corvus sp.). Nga familja e qukapikëve (Picidae) me disa lloje të qukapikëve (Dryocopus lineatus). Familja e qyqeve (Cuculidae), me qyqen (Cuculus canarus), Nga familja (Upupidae), si përfaqësues është pubëza (Upupa epops). Nga familja (Upupidae), si përfaqësues është pubëza (Upupa epops). Përfaqësues nga familja (Alaudidae), laureshat Pulëdushke (Scolopax rusticola), nga familja (Scolopacidae). Dallëndyshet nga familja (Hirundinidae). Përgjatë rrjedhës së lumit Morava e Binçës dhe rrjedhave të sajë hasen lloje nga familja e patave. Gjithashtu shihen këtu edhe llojet e shpendëve këngëtarë me numër të madh, pastaj llojet mizangrënëse dhe një numër i shpendëve shtegtarë të cilët vijnë kohë pas kohe sidomos për gjatë luginës së Moravës.

### *2.2.2.7. Herpetofauna*

Në territorin e Vitisë nuk është e studiuar sa duhet, por nga shënimet që posedojmë dhe nga të dhënat e qytetarëve vërehet se ekziston një përbërje solide me lloje nga dy klasat: Zvarranikëve dhe Ujëtokësorëve. Nga Zvarranikët llojet e familjes (Testudinae), me breshkën e pyllit (Testudo hermani) dhe breshkën e moçaleve (Emys orbicularis). Llojet e familjes (Lacertidae): hardhucae murit (Podarcis muralis), hardhuca e përhime (Lacerta agilis).

Llojet nga familja e gjarpërinjve: (Vipera ammodytes), por shpesh vërehen edhe lloje të familjes së bollave (Colubrinae), të cilat hasen më rrallë.

Klasa e Ujëtokësorëve: hasen ujëtokësorët me bisht (Urodella) dhe ato pa bisht (Anura), llojet më të shpeshta janë ato te bretkosave (Bufo bufo, Bufo viridis, Rana esculenta, Rana ridibunda Pall.). Rrjedha me e rëndësishme ujore ne territorin e Vitisë është lumi Morava e Binçës dhe rrjedhat e tjera qe derdhen ne ketë lumenj. Këtu hasen lloje të peshqve por që numri i tyre është i vogël për shkak të ndotjes së tyre. Si edhe në çdo pjesë tjetër të Kosovës, edhe në ketë komune Fauna është e rrezikuar nga gjuetia ilegale dhe e pa kontrolluar si dhe nga prerja e pyjeve me ç'rast vije deri te dëmtimi i ekosistemeve te tyre nga ana e faktorit njeri. Marrja ne mbrojtje e zonave natyrore qe shquhen me biodiversitet të faunës se egër do të ishte një ndër hapat e rëndësishëm që do të ndihmonte në mbrojtjen dhe ruajtjen e tyre.




<u>Harta 8 Biodiversiteti në komunën e Vitisë</u>

## 2.3. DEMOGRAFIA

### 2.3.1. Zhvillimi Demografik

Në analizën e zhvillimit demografik të komunës së Vitisë janë marrë të dhënat nga regjistrimet e popullsisë nga viti 1948 deri në regjistrimin e fundit atë të vitit 2011. Gjithashtu janë analizuar edhe të dhënat nga vlerësimet e popullsisë deri në vitin 2020. Për vitin 1991 janë vetëm vlerësim nga fakti se këtë regjistrim e ka bojkotuar popullsia shqiptare. Regjistrimi i fundit i popullsisë, ai i vitit 2011 prezanton vetëm numrin e popullsisë rezidente. Sipas regjistrimit të vitit 2011, komuna e Vitisë kishte 46987 banorë, por sipas vlerësimit zyrtar nga ASK për vitin 2020, në këtë komunë jetojnë 47896 banorë, prej të cilëve 5019 jetojnë në qytetin e Vitisë.

Tabela 4 Të dhënat për popullsinë dhe ekonomitë familjare për periudhën 1948 – 2020

| Viti | Popullsia | | Ekonomitë (EF) | Familjare | Madhësia e familjes (numri i anëtareve në ekonomitë familjare) | | Pjesëmarrja e qytetit në komunë (%) | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Komuna | Qyteti | Komuna | Qyteti | Komuna | Qyteti | Ekonomitë familjare | Popullsia |
| **1948** | 25527 | 1781 | 3819 | 318 | 6.7 | 5.6 | 7.7 | 6.5 |
| **1953** | 28443 | 2279 | 4156 | 438 | 6.8 | 5.2 | 9.5 | 7.4 |
| **1961** | 31265 | 2377 | 4710 | 470 | 6.6 | 5.1 | 9.1 | 7 |
| **1971** | 37160 | 2620 | 5292 | 526 | 7 | 5 | 9 | 6.6 |
| **1981** | 44731 | 3108 | 6191 | 652 | 7.2 | 4.7 | 9.5 | 6.5 |
| **1991** | 52981 | 4309 | 7350 | 889 | 7.2 | 4.8 | 10.8 | 7.5 |
| **2011** | 42063 | 4924 | 7520 | 895 | 5.6 | 5.5 | 10.6 | 10.5 |
| **2020** | 42877 | 5019 | 7664 | 910 | 5.6 | 5.5 | 10.6 | 10.5 |

Sipas të dhënave, komuna e Vitisë ka pasur rritje të numrit të popullsisë dhe ekonomive familjare nga viti 1948 deri në vitin 2020. Në vitin 1948 kishte 27308 banorë dhe 4137 ekonomi familjare. Ndërsa në vitin 2020 ka 47896 banorë dhe 8574 ekonomi familjare. Gjatë kësaj periudhe 72 vjeçare popullsia e komunës së Vitisë është rritur për 20588 banorë dhe 4437 ekonomi familjare. Qyteti i Vitisë ka shënuar një rritje të konsiderueshme gjatë kësaj periudhe ku popullsia gati është trefishuar. Në këtë qytet jetojnë rreth 10% e popullsisë dhe ekonomive familjare të gjithë komunës. Madhësia mesatare e familjes nuk ka dallim të theksuar mes vendbanimeve rurale dhe qytetit të Vitisë. Në qytet është 5.5 anëtar për familje dhe në vendbanimet rurale është 5.6 anëtar.

**Lëvizjet natyrore të popullsisë –** Të dhënat e shtimit natyror janë analizuar nga statistikat e lindjeve dhe vdekjeve në Kosovë për vitin 2020. Gjatë vitit 2020 në komunën e Vitisë janë shënuar 724 lindje dhe 320 vdekje. Bazuar në këto të dhëna është llogaritur shkalla e natalitetit, mortalitetit dhe shtimit natyror në promilë dhe në përqindje. Shkalla e natalitetit në komunën e Vitisë ka shënuar rënie të konsiderueshme në krahasim me periudhat e më hershme kohore dhe sot është 15.1 promil apo 1.5 %. Shkalla e mortalitetit është 6.7 promil apo 0.67 %. Në bazë të këtyre shkalleve të natalitetit dhe mortalitetit del se shtimi natyror i popullsisë në komunë është 8.4 promilë apo 0.84 %.




Grafika 3 Nataliteti, mortaliteti dhe shtimi natyror në promila për komunën e Vitisë në vitin 2020




Grafika 4 Shtimi natyror në promila për komunën e Vitisë sipas viteve

## 2.3.2. Strukturat e popullsisë

### *2.3.2.1. Struktura e popullsisë sipas moshës dhe gjinisë*

Gjatë analizës së të dhënave demografike për vitin 2020 vërehen ndryshime në strukturën e popullsisë. Këto ndryshime mund ti dallojmë më çart përmes piramidës së popullsisë. Në vitin 2020 forma e piramidës ndryshon duke u ngushtuar baza e sajë dhe kjo si pasojë dy faktorëve: migrimeve dhe tendencave të zvogëlimit të natalitetit. Nga piramida e popullsisë vërehet se grup-moshat e reja 0 deri 4 vjeç kanë pjesëmarrje më të vogël në popullsinë e përgjithshme në krahasim me grup-moshën 5 deri 9 vjeç, 10 deri 14 vjeç, 15-19 dhe 20-24 vjeç. Grup-mosha 10 – 14 vjeç dominon me numër të popullsisë në krahasim me grup-moshat tjera.




Grafika 5 Piramida e popullsisë së komunës së Vitisë në vitin 2020

Në përgjithësi grup-moshat e reja të popullsisë (0 deri 19 vjeç) dominojnë dukshëm në popullatën e përgjithshme të komunës, dhe kjo është një indikator mjaft i rëndësishëm që tregon se në të ardhmen do të ketë natalitet të lartë, nga fakti se këto grup-mosha në të ardhmen japin një përqindje të konsiderueshme të popullsisë fertile që konsiderohet si burim i lindshmërisë.




Grafika 6 Tri grup-moshat e popullsisë së komunës së Vitisë

Mbi 40 % e popullsisë së përgjithshme në Komunë janë me moshë të re (0 deri 19 vjeç), ndërsa grup-moshat mbi 65 vjeç kanë pjesëmarrje të vogël me rreth 6 % të popullsisë së përgjithshme. Struktura gjinore e popullsisë në komunën e Vitisë ka karakteristikat e veta me dominim jo të madh të gjinisë mashkullore. Koeficienti i maskulinitetit është rreth 1,027, që do të thotë se mesatarisht ekzistojnë 1,027 meshkuj për çdo 1,000 femra.

Struktura e krijuar e moshës dhe gjinisë dhe ndryshimet e tyre gjatë kohës kanë krijuar efekte të reja socio-ekonomike dhe demografike. Këto dy struktura kanë ndikuar në krijimin e kontingjenteve të rëndësishme siç janë: Kontingjenti i punës, fertil, shkollor, i moshuar etj.

Tabela 5 Kontingjentet më të rëndësishëm të strukturës së moshës dhe gjinisë në %

| Kontingjentet e rëndësishëm | Përqindja |
|---|---|
| Kontingjenti parashkollor dhe me shkollim të obligueshëm (0-14 vjet) | 30,2 % |
| Popullsia fertile femërore (15-49 vjet) | 26,2 % |
| Kontingjenti i punës (15-64/m dhe 15-59/f) | 61,8 % |
| Kontingjenti i moshuar (mbi 65 vjet) | 6,4 % |

### 2.3.2.2. *Struktura arsimore e popullsisë*

Niveli i shkollimit të popullsisë është një element mjaft i rëndësishëm për të cilin janë evidentuar të dhëna gjatë regjistrimit të popullsisë.




Grafika 7 Popullsia e moshës mbi 10 vjeç sipas nivelit të shkollimit

Është analaziuar niveli i shkollimit te popullsia mbi 10 vjeç ku numri i përgjithshëm i tyrte është 38,117 banorë. Sipas të dhënave nga grafikoni vërehet se pjesa më e madhe e popullsisë së komunës së Vitisë është me të mesëm të ulët dhe shkollim të mesëm të lartë. Me këtë nivel të shkollimit janë gjithësej 24,473 banorë apo rreth 64 %. Vetëm me shkollim të mesëm të ulët janë 13,856 persona apo rreth 36%, ndërsa me shkollim të mesëm të lartë janë 10,617 persona apo rreth 28%. Është me rëndësi të theksohet se në këtë komunë kemi një numër të konsiderueshëm edhe të përsonave që janë të diplomuar dhe me diploma pasuniversitare. Numri i tyre është gjithësej 2444 apo mbi 6%.

### *2.3.2.3. Struktura Etnike*

Në aspektin etnik komuna e Vitisë ka një popullsi mjaft homogjene ku 99.3 % e popullsisë janë shqiptar. Sipas regjistrimit të popullsisë të realizuar në vitin 2011 nga ASK, në këtë komunë jetojnë gjithësej 46,987 banorë dhe prej tyre 46,669 banorë janë shqiptar. Etnitetet tjera kanë pjesëmarrje shumë të vogël dhe përbëjnë më pakë se 1% të popullsisë së përgjithshme të komunës së Vitisë. Në këtë komunë jetojnë 113 serbë, 25 boshnjak, 14 ashkali, 12 rom, 7 goran, 4 turq dhe janë 143 banorë të tjerë. Të gjitha etnitetet tjera jo shqiptare përbëjnë vetëm 0.7 % të popullsisë së përgjithshme të komunës.

## 2.3.3. Lëvizja mekanike e popullsisë - Migrimet

Të kushtëzuar nga një varg faktorësh, komuna e Vitisë ka një emigrim të shprehur si brenda ashtu edhe jasht vendit. Migrimet e jashtme në këtë komunë janë intensifikuar vazhdimisht që nga vitet e 70-ta dhe sot ekzistojnë rreth 28 % e popullsisë që jetojnë, punojnë dhe veprojnë jashtë shtetit. Edhe migrimi i brendshëm është mjaft i shprehur në komunën e Vitisë. Migrimet e brendshme kryesisht kanë të bëjnë me lëvizjet fshat qytet, ku më i theksuar është migrimi drejt qendrave më të mëdha urbane.

Agjencia e Statistikave të Kosovës, gjatë realizimit të regjistrimit të popullsisë në vitin 2011 i kanë regjistruar edhe emigrantet. Sipas të dhënave që janë grumbulluar gjatë këtij regjistrimi del se ekzistojnë 13,180 banor të komunës së Vitisë që jetojnë jashtë Kosovës.




Grafika 8 Numri i popullsisë dhe numri i emigranteve në komunën e Vitisë

## 2.3.4. Dendësia e popullsisë

Dendësia e popullsisë në komunën e Vitisë është rreth 177 banorë në 1 km², ku 47,896 banorë jetojnë në 270 km². Brenda territorit të komunës së Vitisë ekzistojnë dallime të theksuara sa i përket dendësisë së popullsisë. Përderisa në disa vendbanime që kanë numër më të madh të popullsisë dendësia është shumë më e lartë, në vendbanimet që kanë numër të vogël të popullsisë dendësia është shumë më e vogël.




Harta 9 Dendësia e popullsisë sipas vendbanimeve në komunën e Vitisë

## 2.3.5. Papunësia

Bazuar në rezultatet nga regjistrimi i popullsisë del se shkalla e papunësisë në komunën e Vitisë është më e lartë se ajo e Kosovës. Papunësia në këtë komunë është (48%). Popullsia e moshës mbi 15 vjeç në komunën e Vitisë është 32,819 banorë apo rreth 70%. Nga ky numër, popullsi aktive janë 13,147 banorë apo rreth 40%. Numri i të papunëve në këtë komunë është 6308 përsona apo nese krahasohet ky numër me numrin e popullsisë aktive del që papunësia është rreth 48%. Të punësuar janë 6,839 përsona apo rreth 52%.

Nëse analizohet shkalla e papunësisë aipas gjinisë në komunën e Vitisë, mund të konstatojm se papunësia është më e theksuar te gjinia femrore.




Grafika 9 Shkalla e punësimit dhe papunësisë sipas gjinisë në komunën e Vitisë

Numri i të papunëve tek gjinia femërore është 2,261 persona apo 65%. Ndërsa tek gjinia mashkullore është 4,047 persona apo rreth 42%.

## 2.3.6. Varfëria

Bazuar në të dhënat e Qendrës për Punë Sociale të komunës për numrin e familjeve dhe banorëve me asistencë sociale, në komunën e Vitisë na paraqitet një shkallë e lartë e varfërisë ekstreme. Këto të dhëna, na ndihmojnë sadopak në paraqitjen e gjendjes ekzistuese të popullsisë për secilin vendbanim të komunës. Në këtë komunë shkalla e varfërisë ekstreme është mbi 4%, ndërsa ajo e varfërisë së përgjithshme duhet të jetë shumë fish më e lartë.

Me shkallë minimale të varfërisë (0%) na paraqiten vendbanimet si vijon: Çifllak, Goden i Madh dhe Shashare. Gjithashtu me shkallë 0% i kemi edhe vendbanimet Vërnez e Mjak, por këto dy vendbanime nuk kanë as banor dhe pothuajse janë zbrazur tërësisht. Në anën tjetër kemi edhe vendbanime që kanë shkallë më të lartë të varfërferisë. Këto vendbanime janë: Debelldeh (17.9 %), Vërnakollë (15.3 %), Stubëll e Poshtme (15.3 %), Buzovik (12.4 %), Lubishtë (10.7 %) dhe Letnicë (9.5 %). Këto vendbanime janë kryesisht të vendosura në pjesët kodrinoro – malore të komunës, janë zona kufitare apo afër këtyre zonave, larg nga qendrat e zhvilluara urbane etj. Zakonisht kanë edhe numër të vogël të banorëve dhe përballën me vështirësi të shumta ekzistenciale.

Për ta analizuar shkallën e varfërisë në komunën e Vitisë janë analizuar të dhënat sipas deviacionit standart. Sipas këtyre kalkulimeve del se shkalla mesatare e varfësisë është 4.3 %.

Për ta analizuar nivelin e varfëris në aspektin hapësinor për tërë territorin e komunës, kemi ndar vendbanimet në tri shkallë të varfërisë bazuar në devijimin standart:

**Vendbanimet me shkallë të ulët të varfërisë nga 0 deri 1.5 %** janë vendbanimet nën devijimin standard dhe atë: Ballancë (1.2%), Budrikë e Epërme (0.5%), Çifllak (0%), Devajë (1.3%), Goden i Madh (0%), Mjak (0%), Ramjan (1.2%), Sllatinë e Epërme (1.2%), Stubëll e Epërme (1.1%), Shashare (0%), Vërban (1%) dhe Vërnezë (0%).

**Vendbanimet me shkallë të mesme të varfërisë nga 1.5 deri 8.6** - janë vendbanimet brenda shkallës së devijimit standard dhe atë: Beguncë (4.9%), Binçë (4.5%), Drobesh (4.5%), Gërmovë (4.5%), Gjylekar (3.7%), Kabash (4.9%), Novosellë (7.5%), Podgorc (3.1%), Pozharan (1.8%), Radivojcë (2.6%), Ramnishtë

(6%), Remnik (2.6%), Sadovinë e çërkezve (3%), Sadovinë e Jerlive (1.8%), Sllatinë e Poshtme (1.9%), Smirë (2.4%), Tërpezë (4.4%), Tërstenik (4.4%) dhe Zhiti (3.9%).

**Vendbanimet me shkallë të lartë të varfërisë mbi 8.6 % janë vendbanimet mbi shkallën e deviacionit standard si:** Debelldeh (17.9%), Vërnakollë (15.3%), Stubëll e Poshtme (15.3%), Buzovik (12.4%), Lubishtë (10.7%) dhe Letnicë (9.5%).

Janë edhe dy vendbanime që nuk paraqitet fare varfëri por në faktë ato vendbanime nuk kanë edhe banor. Është fshati Vërnez që në regjistrimin e popullsisë ka të regjistruar vetë 1 banor dhe fshati Mjak që nuk ka të regjistruar asnjë banor.




Harta 10 Shtrirja hapësinore e varfërisë në komunën e Vitisë

## 2.4. KAPACITETET NJERËZORE DHE FINANCIARE TË KOMUNËS

### 2.4.1. Kapacitetet njerëzore

Bazuar në të dhënat nga regjistrimi i popullsisë në vitin 2011, në komunën e Vitisë dominon kryesisht niveli i shkollimit të mesëm të lartë. Rreth 25% e popullsisë e kanë të përfunduar këtë nivel të shkollimit. Megjithatë, dallimi i madh gjinor i atyre që kanë përfunduar shkollimin e mesëm të lartë mbetët mjaft shqetësues. Numri i femrave me këtë nivel të shkollimit është gati përgjysmë më i vogël se te gjinia mashkullore. Derisa në shkollimin fillor dhe të mesëm të ulët dominon gjinia femrore si rezultat i shkollimit të obligushëm.

Tabela 6 Popullsia e komunës së Vitisë sipas nivelit të shkollimit

| Niveli i shkollimit | Meshkuj | Femra | Gjithsej | % |
|---|---|---|---|---|

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Nuk kanë përfunduar arsimin | 1702 | 2816 | 4518 | 11.9 |
| Me shkollë fillore | 2890 | 3792 | 6682 | 17.5 |
| Me shkollë të mesme të ulët | 5946 | 7910 | 13856 | 36.3 |
| Me shkollë të mesme të lartë | 6966 | 3651 | 10617 | 27.9 |
| Të diplomuar | 1594 | 723 | 2317 | 6.1 |
| Me diploma universitare (Master, PhD) | 100 | 27 | 127 | 0.3 |
| Gjithsej | 19198 | 18919 | 38117 | 100 |

Numri i atyre që kanë përfunduar shkollimin e lartë është rreth 5 %, ndërsa i atyre me diploma pasuniversitare është 0.3%. Dallimi gjinor është i theksuar edhe në këtë nivel të shkollimit. Ajo që mbetet ende shqetësuese është numri jo i vogël i atyre që nuk dinë shkrim-lexim dhe i atyre që nuk kanë të përfunduar shkollimin fillor. Janë mbi 4% e popullsisë që nuk dinë shkrim-lexim dhe mbi 10% që nuk kanë të përfunduar asnjë nivel të shkollimit. Në vazhdim janë paraqit të dhënat rreth kapaciteteve administrative të Komunës së Vitisë, ku janë prezantuar numri i të punësuarve gjatë periudhës 2015-2021. Gjatë këtij periudhe kemi një numër të njejtë të punësuarve në të gjithë sektorët.

Tabela 7 Pasqyra dhe trendet e punesimit të sherbyesve civil në administratë sipas drejtorive, 2015- 2021

| Drejtoria: | Të punësuar sipas viteve | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 2015 | 2016 | 2017 | 2018 | 2019 | 2020 | 2021 |
| Zyra e kryetarit | 36 | 36 | 36 | 36 | 36 | 36 | 36 |
| Administratë dhe përsonel | 35 | 35 | 35 | 35 | 35 | 35 | 35 |
| Buxhet e Financa | 26 | 26 | 26 | 26 | 26 | 26 | 26 |
| Inspekcioni | 12 | 12 | 12 | 12 | 12 | 12 | 12 |
| Shërbime publike dhe komunale | 32 | 32 | 32 | 32 | 32 | 32 | 32 |
| Bujqësi Pylltari dhe Zh. Rural | 14 | 14 | 14 | 14 | 14 | 14 | 14 |
| Kadaster , Gjeodezi, Pronësi | 9 | 9 | 9 | 9 | 9 | 9 | 9 |
| Urbanizëm, Planifikim , Mjedis | 5 | 5 | 5 | 5 | 5 | 5 | 5 |
| Kulturë Rini e Sport | 14 | 14 | 14 | 14 | 14 | 14 | 14 |
| Zkk | 3 | 3 | 3 | 3 | 3 | 3 | 3 |
| Shëndetsia dhe mireqenja sociale | 139 | 139 | 139 | 139 | 139 | 139 | 139 |
| Sherbimet sociale | 10 | 10 | 10 | 10 | 10 | 10 | 10 |
| Arsimit dhe shkenës | 816 | 816 | 816 | 816 | 816 | 816 | 816 |
| Gjithsej: | 1151 | 1151 | 1151 | 1151 | 1151 | 1151 | 1151 |

Sa i përket përvojës së punës, mbi gjysma e shërbyesve civil në administratë kanë përvojë pune 16-20 vite (594).

Tabela 8 Përvoja e punës e shërbyesve civil në admininstratë sipas drejtorive, 2021

| Drejtoria: | Vite pervojë pune: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | 0- 5 | 6- 10 | 11- 15 | 16- 20 | Gjithsej |
| Zyra e kryetarit | 7 | 8 | 6 | 15 | 36 |
| Administratë dhe përsonel / komunikimi | 2 | 8 | 10 | 15 | 35 |
| Buxhet e Financa | 1 | 2 | 2 | 21 | 26 |
| Inspekcioni | | 3 | | 9 | 12 |
| Shërbi publ komun dhe em | 9 | 8 | 3 | 12 | 32 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Bujqësi Pylltari dhe Zh. Rural** | 2 | 6 | | 6 | 14 |
| **Kadaster , Gjeodezi, Pronësi** | | 2 | 2 | 5 | 9 |
| **Urbanizëm, Planifikim , Mjedis** | | 1 | 1 | 3 | 5 |
| **Kulturë Rini e Sport** | 1 | 2 | 1 | 10 | 14 |
| **Zkk** | | 1 | 2 | | 3 |
| **Shëndetsia dhe mireqenja sociale** | 8 | 14 | 31 | 86 | 139 |
| **Sherbimet sociale** | 1 | | | 9 | 10 |
| **Arsimit dhe shkenës** | 120 | 149 | 144 | 403 | 816 |
| **Gjithsej:** | 151 | 204 | 202 | 594 | 1151 |

### 2.4.2. Kapacitetet financiare

Komuna e Vitisë është një komunë jo shumë e madhe dhe gjithashtu kemi edhe kapacitete mjaft të kufizuara financiare. Në vazhdim do të paraqesim pasqyrën dhe trendet e realizimit të të hyrave vetanake sipas kategorive kryesore për vitet 2015 - 2021

Tabela 9 Pasqyra dhe trendet e realizimit të të hyrave vetanake sipas kategorive kryesore, 2015- 2021

| Kategoria e të hyrave vetanake: | Të hyrat- viti: | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 2015 | 2016 | 2017 | 2018 | 2019 | 2020 | 2021 |
| **Tatimi në prone:** | 308831.71 | 377042.38 | 292114.9 | 329525.2 | 434109.17 | 331345.81 | 475146.22 |
| **Regjistrimi i automjeteve:** | 77800 | 83540.5 | 88760 | 91720 | 96450 | 91750 | 103259 |
| **Lejet e ndërtimit:** | 14107.15 | 48222.4 | 46736.15 | 19590.58 | 102383.9 | 25610.56 | 93126.54 |
| **Regjistrimi i trashegimisë:** | 69589.9 | 81521.5 | 84392.5 | 85737.55 | 78708.5 | 58431.5 | 95958 |
| **Ndeërrim i destinimit të tokeës:** | 8277.5 | 12882.5 | 16439.25 | 7572 | 38433 | 3561.5 | 3461 |
| **Dokumentet e gjendjes civile:** | 52689 | 54129.5 | 53335 | 47382 | 52830 | 31762 | 38426 |
| **Veprimtaritë afariste:** | | | | | | | |
| **Shfrytëz. i pronës publike** | 31112.2 | 34682.23 | 30789.45 | 23912 | 39491.65 | 17180.75 | 20975.6 |
| **Participimet në Arsim dhe Shëndetësi:** | 77296.3 | 77383.2 | 85796.2 | 81857.4 | 89538.3 | 52892 | 84537.3 |
| **Tjera:** | 141903.5 | 185155.01 | 69563.77 | 104694.52 | 208577.25 | 166870.55 | 238981.32 |
| **Gjithsej:** | 282555.01 | 954559.22 | 767927.22 | 791991.25 | 1140521.8 | 779404.67 | 1153871 |

Siç shihet edhe nga tabela, pjesa më e madhe e të hyrave realizohen nga tatami në pronë.

Tabela 10 Pasqyra dhe trendet e të hyrave vetanake sipas inkasimit, 2015- 2021

| Kategoria e të hyrave vetanake: | Te hyrat- viti: | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 2015 | 2016 | 2017 | 2018 | 2019 | 2020 | 2021 | |
| Direkte:(te hyrat tatimore) | 308831.71 | 377042.38 | 292114.9 | 329525.2 | 434109.17 | 331345.81 | 475146.22 | |
| Indirekte:(Te hyrat jo tatimore) | 334610.55 | 577516.84 | 414961.1 | 365044.53 | 507378.03 | 292403.31 | 457718.3 | |
| Gjithsej: | 643442.26 | 954559.22 | 707076 | 694569.73 | 941487.2 | 623749.12 | 932864.52 | |

Tabela 11 Pasqyra dhe trendet e donacioneve sipas prejardhjes, 2015- 2021

| Kategoria e donacioneve: | Donacionet- viti: | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 2015 | 2016 | 2017 | 2018 | 2019 | 2020 | 2021 | |
| Te brendshme: | 2450 | 4853.94 | 7737.56 | 5188.5 | | 3960 | 10182.5 | |
| Te jashtme: | 54250 | 157346.5 | 176939.36 | 62328 | 69023 | 16080.44 | | |
| Gjithsej: | 56700 | 162200.44 | 184676.92 | 67516.5 | 69023 | 20040.44 | 10182.5 | |

Tabela 12 Pasqyra dhe trendet e donacioneve sipas prejardhjes, 2015- 2021

| Sektori: | Shpenzime kapitale- viti: | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 2015 | 2016 | 2017 | 2018 | 2019 | 2020 | 2021 | |
| Infrastrukture sociale dhe publike | 1140581.2 | 1015049.9 | 985590.54 | 1285957.8 | 1519293.5 | 1488065.6 | 1022483.1 | |
| Infrastrukture transportuese: | 1005453.7 | 698149.43 | 487478.39 | 837523.33 | 667541.84 | 1130170.5 | 1238099.7 | |
| Infrastrukture teknike: | 15123 | 56400 | | 58118 | 29329 | 58938.8 | 40614.05 | |
| Gjithsej: | 2161157.9 | 1769599.3 | 1473068.9 | 2181599.1 | 2216164.3 | 2677174.9 | 2301196.8 | |

Tabela 13 Pasqyra dhe trendet e planifikimit të buxhetit sipas kategorive ekonomike, 2015- 2020

| Kategoria ekonomike: | Buxheti i planifikuar- viti: | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | 2015 | 2016 | 2017 | 2018 | 2019 | 2020 |
| Rroga dhe paga: | 6480000 | 6677482 | 6928119 | 7203838 | 7366159.24 | 7576505.72 |
| Mallëra dhe sherbime: | 857203 | 899991 | 953534 | 1281874 | 1403369.41 | 1978272.83 |
| Shpenzime komunale: | 200862 | 200862 | 200862 | 200862 | 221000.00 | 304000.00 |
| Subvencione dhe transfere: | 213000 | 197712 | 197712 | 197712 | 224095.88 | 351733..38 |
| Shpenzime kapitale: | 2183422 | 1511937 | 1739071 | 2213699 | 2257039.73 | 2733662.42 |
| Gjithsej: | 9934487 | 9487984 | 10019298 | 11097985 | 11471664.26 | 12592440.97 |

Tabela 14 Pasqyra dhe trendet e shpenzimit të buxhetit sipas kategorive ekonomike, 2015- 2020

| Kategoria ekonomike: | Buxheti i shpenzuar- viti: | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | 2015 | 2016 | 2017 | 2018 | 2019 | 2020 |
| Rroga dhe paga: | 6709183.59 | 6890047.63 | 6874613.58 | 7142576.47 | 7295880.63 | 7575623.82 |
| Mallera dhe sherbime: | 941112.82 | 974180.18 | 941905.83 | 1063318 | 1383762.39 | 1740444.65 |
| Shpenzime komunale: | 200798.21 | 200286.57 | 200580.41 | 198831.85 | 220631.37 | 303996.79 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Subvencione dhe transfere: | 193459.88 | 163002.97 | 272706.05 | 260486.45 | 211322.50 | 251600.26 |
| Shpenzime kapitale: | 2161157.88 | 1769599.3 | 1473068.93 | 2181599.11 | 2216164.32 | 2677174.88 |
| Gjithsej: | 10205712.4 | 9997116.65 | 9762874.8 | 10846811.88 | 11327761.21 | 12548840.40 |




Grafika 10 Buxheti i shpenzuar në komunën e Vitisë në vitet 2015-2020

## 2.5. ZHVILLIMI EKONOMIK

### 2.5.1. Historik i shkurtër i zhvillimit ekonomik

Komuna e Vitisë menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore trashëgoi një përqindje të lartë të popullsisë bujqësore, si pasojë e lënies krejtësisht pasdore të zhvillimit ekonomik dhe shoqëror. Në periudhën e pas Luftës së Dytë Botërore kalimi i popullsisë bujqësore në veprimtari jobujqësore vazhdimisht rritej në komunën e Vitisë, gjë që është ligjësi e përgjithshme në kuadër të zhvillimit ekonomik. Transferi i popullsisë nga bujqësia dhe të shumtën edhe nga fshati në veprimtari jobujqësore dhe në qytet zhvillohej në mënyrë të drejtpërdrejtë, pa përgatitje profesionale dhe arsimore, në një anë, dhe në mënyrë indirekte, përmes shkollimit të gjeneratës së re dhe të ndryshimit të pozitës socio-ekonomike të popullsisë, në anën tjetër. Është karakteristik e përgjithshme se bujqësinë e braktis popullsia e re, vitale dhe e arsimuar. Por është e vështirë të konstatohet numri i saktë i kalimit të popullsisë agrare në veprimtari joagrare. Angazhimi i popullsisë në veprimtari primare ekonomike vazhdon të jetë i lartë edhe pse kohëve të fundit ka një rritje të angazhimit në sektor të tjerë ekonomik siç janë: tregtia, prodhimi, ndërtimtaria dhe arsimi. Megjithatë, bujqësia me degët e veta paraqet një aktivitet me rëndësi ekonomike në këtë komunë dhe në raste të shumta bujqësia dhe blegtoria përdoren si aktivitete dytësore ekonomike. Bazuar në të dhënat e regjistrimit të vitit 2011, del se 69 % nga popullsia e përgjithshme janë popullsi mbi moshën 15 vjeç. Sipas statusit të aktivitetit ekonomik, pjesa më e madhe e kësaj popullsie (60 %) janë ekonomikisht jo aktive, ndërsa ekonomikisht aktiv janë vetëm 40% prej tyre. Ajo që mund të theksohet në këtë rast është se shkalla më e ulët e aktivitetit ekonomik është tek gjinia femërore.

Sipas të dhënave të siguruara nga ARBK, aktualisht në komunën e Vitisë, Aktivitete Sherbyese zënë vendin e parë në klasifikimin e sektorëve ekonomik sipas numrit të të punësuarve. Sektori i Ndërtimtarisë zë vendin e dytë në këtë klasifikim, duke u pasuar nga sektori i Industrisë Përpunuese, I renditur në vendin e tretë, sektori i Furnizimit me uje; kanalizimi, menaxhimi me mbeturina dhe aktivitetet rehabilituese, në pozitën e katërt etj..

Edhe pse komuna ka potencial shumë të madh dhe kushte optimale për zhvillimin e bujqësisë dhe blegtorisë, me potencial real të bazimit të zhvillimit ekonomik në këtë sektor, bashkë me atë të turizmit, gjendja aktuale dikton një mos-shfrytëzim adekuat të këtij potenciali si dhe një mbetje prapa edhe sa i përket zbatimit të politikave të parapara dhe të planifikuara me Planin Zhvillimor Komunal 2010-2020+.

## 2.5.2. Përmbajtjet ekonomike dhe komerciale

Në këtë nënkapitull është bërë përshkrimi dhe klasifikimi i sektorëve ekonomik sipas numrit të ndërmarrjeve aktive, të regjistruara në komunën e Vitisë, Agjensinë e Regjistrit të Bizneseve në Kosovë (ARBK) si dhe në ministritë relevante. Klasifikimi i sektorëve ekonomik është bërë edhe sipas numrit të punëtorëve të regjistruar. Në këtë kontekst fillimisht është bërë klasifikimi i ndërmarrjeve të regjistruara sipas pronësisë, pastaj Klasifikimi i Sektorëve Ekonomik sipas numrit të ndërmarrjeve të regjistruara, Klasifikimi i Sektorëve Ekonomik sipas numrit të të punësuarve si dhe është paraqitur shpërndarja gjeografike e ndërmarrjeve të regjistruara.

### *2.5.2.1. **Klasifikimi i ndërmarrjeve të regjistruara sipas pronësisë***

Sa i përket klasifikimit të ndërmarrjeve të regjistruara sipas pronësisë, 1167 ndërmarrje (97.5 % e numrit të përgjithshëm të ndërmarrjeve të regjistruara) janë private, 14 ndërmarrje (1.2 % e numrit të përgjithshëm të ndërmarrjeve të regjistruara) janë Publike-Komunale, 9 ndërmarrje (0.8 % e numrit të përgjithshëm të ndërmarrjeve të regjistruara) janë Publike-Shoqërore dhe 7 ndërmarrje (0.6 % e numrit të përgjithshëm të ndërmarrjeve të regjistruara) janë Publiko (Komunale) – Private. Në komunën e Vitisë nuk është e regjistruar asnjë ndërmarrje e kategorisë Publiko (Shoqërore) – Private.

Sa i përket numrit të të punësuarve, 85.1 % e numrit të përgjithshëm të të punësuarve punojnë në sektorin privat, 8.9 % e tyre punojnë në ndërmarrje Publike-Shoqërore, 6 % punojnë në ndërmarrje Publiko (Komunale) – Private. Ndërsa, sa u përket ndërmarrjeve Publike-Komunale, në 14 ndërmarrjet e kësaj kategorie nuk është i regjistruar asnjë i punësuar.

Grupi punues vlerëson se, përveç këtyre shifrave, në sektorin e bujqësisë në mënyrë aktive janë të angazhuar të pakten 1875 persona, në ekonomi familjare. Kjo shifër është nxjerrë nga numri i fermerëve të komunës së Vitisë të cilët kanë aplikuar për subvencione dhe grante gjatë vitit 2020.

Tabela 15 Klasifikimi i ndërmarrjeve të regjistruara, sipas pronësisë [2]

| Nr | Pronësia | Nr. i Ndermarrjeve | % e Totalit të | Nr. i të punesuarve | % e Totalit të të |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Private | 1167 | 97.5 | 2248 | 85.1 |
| 2 | Publike- Komunale | 14 | 1.2 | 0 | 0.0 |
| 3 | Publike- Shoqerore | 9 | 0.8 | 235 | 8.9 |
| 4 | Publiko(Komunale)- Private | 7 | 0.6 | 159 | 6.0 |
| 5 | Publiko (Shoqerore)- Private | 0 | 0.0 | 0 | 0.0 |
| TOTALI | | 1197 | 100 | 2642 | 100 |

[22] ARBK, 2020

Më poshtë, klasifikimi I ndërmarrjeve të regjistruara, sipas pronësisë në komunën e Vitisë është krahasuar me gjendjen në komunat e Istogut dhe Skënderajt.

Tabela 16 Krahasimi klasifikimit të ndërmarrjeve të regjistruara me komuna tjera

| KOMUNA | VITI | ISTOG | SKËNDERAJ |
|---|---|---|---|
| | % | % | % |
| **Private** | 97.5 | 91.5 | |
| **Publike- Komunale** | 1.2 | | |
| **Publike- Shoqerore** | 0.8 | | |
| **Publiko (Komunale)- Private** | 0.6 | | |
| **Publiko (Shoqerore)- Private** | 0 | | |

### 2.5.2.2. *Klasifikimi i Sektorëve Ekonomik sipas numrit të ndërmarrjeve të regjistruara dhe numrit të të punësuarve*

Nga të gjithë sektorët ekonomik në komunën e Vitisë, sa i përket numrit të ndërmarrjeve të regjistruara, Aktivitetet Shërbyese zënë vendin e parë, me 58.2 % të numrit të përgjithshëm të ndërmarrjeve të regjistruara dhe 33.5 % e numrit të përgjithshëm të punëtorëve të regjistruar. Bujqësia zë vendin e dytë për sa i përket numrit të punëtorëve të regjistruar[3], me 28.8 % të numrit të përgjithshëm të punëtorëve të regjistruar. Ndërtimtaria zë vendin e tretë, me 12.3 % të ndërmarrjeve të regjistruara dhe 9 % të punëtorëve të regjistruar. Ndërsa vendin e katërt e zë Tregtia me shumicë dhe pakicë; riparimi i mjeteve motorike dhe motoçikletave, me 9.9 % të ndërmarrjeve të regjistruara dhe 5.1 % të punëtorëve të regjistruar. Në pozitën e dhjetë dhe të fundit sa i përket numrit të ndërmarrjeve të regjistruara radhitet sektori i Furnizimit me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër për kondicionim, me vetëm 0.3 % të numrit të ndërmarrjeve të regjistruara dhe vetëm 0.6 % të numrit të përgjithshëm të të punësuarve.

Tabela 17 Renditja e Sektorëve Ekonomik sipas numrit të ndërmarrjeve të regjistruara[4]

| Nr. | Sektori | Nr i Ndermarrjeve | % e Totalit të Ndërmarrjeve | Nr. i të punesuarve | % e Totalit të të punësuarve |
|---|---|---|---|---|---|
| **1** | Aktivitete Sherbyese | 697 | 58.2 | 885 | 33.5 |
| | Bujqësia[5] | / | / | 760 | 28.8 |
| **2** | Ndertimtaria | 147 | 12.3 | 239 | 9.0 |
| **3** | Tregtia me shumicë dhe pakicë; riparimi i mjeteve motorike dhe motoçikletave | 119 | 9.9 | 135 | 5.1 |
| **4** | Industria Perpunuese | 112 | 9.4 | 222 | 8.4 |

[3] Të dhënat e regjistrimit të vitit 2011 konstatojnë se numri i personave të angazhuar në bujqësi dhe degët e saj është 760, ndërsa sipas të dhënave nga Drejtoria Komunale për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, në sektorin e bujqësisë në mënyrë aktive ushtrojnë aktivitetin e tyre të pakten 1875 ferma, si ekonomi familjare. Kjo shifër është nxjerrë nga numri i fermerëve të komunës së Vitisë të cilët kanë aplikuar për subvencione dhe grante gjat vitit 2020.

[4] ARBK, 2020

[5] Të dhënat e regjistrimit të vitit 2011 konstatojnë se numri i personave të angazhuar në bujqësi dhe degët e saj është 760, ndërsa sipas të dhënave nga Drejtoria Komunale për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, në sektorin e bujqësisë në mënyrë aktive ushtrojnë aktivitetin e tyre të pakten 1875 ferma, si ekonomi familjare. Kjo shifër është nxjerrë nga numri i fermerëve të komunës së Vitisë të cilët kanë aplikuar për subvencione dhe grante gjat vitit 2020

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 5 | Transporti dhe Magazinimi | 52 | 4.3 | 71 | 2.7 |
| 6 | Akomodimi dhe aktivitetet e shërbimit të ushqimit | 50 | 4.2 | 91 | 3.4 |
| 7 | Furnizimi me uje; kanalizimi, menaxhimi me mbeturina dhe aktivitetet rehabilituese | 8 | 0.7 | 157 | 5.9 |
| 7 | Xeheroret dhe gurëthyesit | 8 | 0.7 | 66 | 2.5 |
| 8 | Furnizimi me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër për kondicionim | 4 | 0.3 | 16 | 0.6 |
| TOTALI | | 1197 | 100 | 1882 | 100 |

Bazuar në kalsifikimin e sektorëve sipas numrit të ndërmarrjeve të regjistruara dhe numrit të të punësuarve, dominojnë: Aktivitet shërbyese, Ndërtimtaria dhe Tregëtia me shumicë dhe pakicë. Ndërësa, në vendin e fundit në këtë klasifikim renditet sektori i Furnizimit me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër për kondicionim..

Më poshtë, klasifikimi i sektorëve ekonomik, sipas përqindjes së ndërmarrjeve të regjistruara në komunën e Vitisë është krahasuar me gjendjen në komunat e Istogut[6] dhe Skënderajt[7].

Tabela 18 Ndërmarrjet e regjistruara në komunën e Vitisë, Istogut dhe Skenderajit

| | KOMUNA | VITI | ISTOG | SKËNDERAJ |
|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Sektori** | **% e Totalit të Ndërmarrjeve** | **% e Totalit të Ndërmarrjeve** | **% e Totalit të Ndërmarrjeve** |
| 1 | Aktivitete Sherbyese | 58.2 | 13.40 | 47.0 |
| 2 | Ndertimtaria | 12.3 | 6.26 | 12.7 |
| 3 | Tregtia me shumicë dhe pakicë; | 9.9 | 17.93 | 7.2 |
| 4 | Akomodimi dhe aktivitetet e shërbimit të ushqimit | 4.2 | 9.33 | 4.8 |
| 5 | Të tjera | | | 28.3 |
| TOTALI | | 100 | 100 | 100 |

Sa i përket shpërndarjes së bizneseve sipas vendbanimeve, në kontekst të raportit vendbanim urban dhe periferik, 77.2 % e ndërmarrjeve janë të vendosura (ose veprimtarinë primare e zhvillojnë në) në zona periferike (jashtë zones urbane), ndërsa vetëm 22.8 % e tyre janë të vendosura vendosura (ose veprimtarinë primare e zhvillojnë në) në zonën urbane.

Ndërsa sa i përket numrit të të punësuarve nëpër ndërmarrjet e shpërndara sipas vendbanimeve; 1305 punëtorë (69.3 % e numrit të përgjithshëm të të punësuarve) punojnë në ndërmarrjet e vendosura në zona periferike, përderisa 577 punëtorë (30.7 % e numrit të përgjithshëm të të punësuarve) punojnë në ndërmarrjet e vendosura në zonën urbane.

[6] PZHK Istog 2018-2026, Komuna Istog - Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit.

[7] PZHK Skënderaj 2017-2025, Komuna Skënderaj – Drejtoria për Urbanizëm

Tabela 19 Renditja e venbanimeve (urbane dhe rurale) sipas numrit të bizneseve të regjistruara[8]

| Nr. | Lloji i Vendbanimit | Nr i Ndermarrjeve | % e Totalit të Ndërmarrjeve | Nr i te punesuarve | % e Totalit të të punësuarve |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Vendbanimi B (Zonat Periferike) | 924 | 77.2 | 1305 | 69.3 |
| 2 | Vendbanimi A (Zona Urbane) | 273 | 22.8 | 577 | 30.7 |
| TOTALI | | 1197 | 100 | 1882 | 100 |

### 2.5.2.3. *Shtrirja Gjeografike e Ndërmarrjeve Ekonomike në Komunën e Vitisë*

Sa i përket shtrirjes gjeografike të ndërmarrjeve ekonomike në komunën e Vitisë, 22.8 % e ndërmarrjeve të regjistruara veprimtarinë e tyre ekonomike e zhvillojnë në qytetin e Vitisë (zona urbane), ndërsa në vendin e dytë me përqindjen më të madhe të koncentrimit të bizneseve gjendet Pozharani me 14.5 % të ndërmarrjeve të regjistruara. Vendbanimet në të cilat pjesëmarrja e biznese është më e ulët se 1 % janë si vijon: Binça, Tërsteniku, Letnica, Devaja, Podgorci, Godeni i Madh dhe Çifllaku. Këto fshatrja kanë një përqindje e cila varion nga 0.5 deri në 0.1. Ndërsa vendbanimet të cilat nuk kanë asnjë ndërmarrje ekonomike të regjistruar, e numri i të cilave është vetëm 5, janë si vijon: Mjak, Stubëll e Poshtme, Shashare, Vërnakollë dhe Vërnez.

Tabela 20 Shpërndarja e bizneseve sipas vendbanimeve[9]

| Renditja | Vendbanimi | % |
|---|---|---|
| 1. | Vitia (Zona Urbane) | 22.8 |
| 2. | Pozharan | 14.5 |
| 3. | Drobesh | 4.8 |
| 4. | Smirë | 4.5 |
| 5. | Gjylekar | 4.0 |
| 6. | Kabash | 3.8 |
| 7. | Vërban | 3.8 |
| 8. | Beguncë | 3.6 |
| 9. | Sllatinë e Epërme | 3.3 |
| 9. | Radivojc | 3.3 |
| 10. | Tërpezë | 2.9 |
| 11. | Sadovinë e Çerkezve | 2.8 |
| 12. | Budrigë e Epërme | 2.3 |
| 13. | Sadovinë e Jerlive | 2.2 |
| 14. | Lubishtë | 2.1 |
| 15. | Sllatinë e Poshtme | 2.0 |
| 16. | Ramnishtë | 1.8 |
| 17. | Remnik | 1.7 |
| 18. | Gushicë | 1.5 |
| 19. | Ramjan | 1.5 |
| 19. | Novosellë | 1.5 |
| 20. | Ballancë | 1.4 |
| 21. | Stubëll e Epërme | 1.3 |
| 21. | Buzovik | 1.3 |
| 21. | Gërmovë | 1.3 |

[8] ARBK, 2020

[9] ARBK, 2020

| | | |
|---|---|---|
| **22.** | Debelldeh | 1.1 |
| **23** | Zhiti | 1.0 |
| **24.** | Binçë | 0.5 |
| **25.** | Tërstenik | 0.4 |
| **26.** | Letnicë | 0.3 |
| **26.** | Devajë | 0.3 |
| **27.** | Podgorc | 0.2 |
| **27.** | Goden i Madh | 0.2 |
| **28.** | Çifllak | 0.1 |

## 2.5.3. Sektorët kryesor ekonomik

### 2.5.3.1. *Bujqësia me degët e saj*

Pozita gjeografike, toka pjellore, kushtet klimatike dhe resurset natyrore e favorizojnë zhvillimin e bujqësisë dhe veprimtarive tjera primare, degë të cilat tradicionalisht kanë pasur rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të Komunës së Vitise.  Komuna e Vitisë ka një sipërfaqe prej 26,969 hektarë tokë, prej së cilës 11,329 hektarë (42 % e sipërfaqes totale) është tokë bujqësore. Vetëm në zonën urbane ka 706 ha tokë bujqësore, ndërsa vendbanimet tjera që posedojnë më së shumti tokë bujqësore janë si vijon: Sllatina me 901 Ha, Pozherani me 853 Ha, Zhitia me 703 Ha, Sadovina e Çerkezve me 629 Ha, Gërmova me 522 Ha, Ramjani me 507 Ha etj.. Edhe pse bujqësia ka qenë gjithmonë degë e rëndësishme e ekonomisë për komunën e Vitisë, vërehet një rënie e interesimit për tu angazhuar në këtë veprimtari, përkundër kushteve të favorshme natyrore dhe traditës. Të dhënat e regjistrimit të vitit 2011 konstatojnë se numri i personave të angazhuar në bujqësi dhe degët e saj është 760, ndërsa sipas të dhënave nga Drejtorina Komunale për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, në sektorin e bujqësisë në mënyrë aktive ushtrojnë aktivitetin e tyre të pakten 1875 ferma, si ekonomi familjare. Kjo shifër është nxjerrë nga numri i fermerëve të komunës së Vitisë të cilët kanë aplikuar për subvencione dhe grante gjat vitit 2020.

Në komunën e Vitisë sipërfaqja e tokës punuese për kokë banori llogaritet të jetë diku rreth 0.23 hektar, kurse madhësia e tokës punuese për familje në mesatare, është rreth 1.1 ha. Sa i përket prodhimtarisë bujqësore, toka në mbjelljet vjeshtore mbillet kryesisht me grurë, përderisa në mbjelljet pranverore mbillet me miser dhe bimë foragjere për blegtori. Kulturat tjera të rëndësishme janë perimet, patatet, shalqiri etj. Shumica e prodhuesve janë ekonomi bujqësore familjare, dhe vetëm 76 prodhues janë të organizuar në ndërmarrje bujqësore.

Pas luftës është vërejtur dukuria e shpërndarjes së pa kontrolluar urbane, e cila e degradon tokën bujqësore, ky fenomen  Komunës së Vitisë i ka kushtuar me humbjen e 8.6 ha tokë bujqësore vetëm gjatë periudhës 2015-2020.

**Prodhimtaria Bujqësore (Lavërtaria, Perimkultura dhe Pemëtaria)**

Nga e gjithë sipërfaqja bujqësore e planifikuar për mbjellje për vitin 2020 (9.266 ha), prej prodhimtarisë bimore të kultivuar dominojnë prodhimet e Grurit me 4,850 ha dhe Misrit me 3,255 ha. Pas tyre vijnë perimet me 719 ha, Patatet me 110 ha, Misëri i Gjelbër me 105 ha  etj..

Numri i fermerëve të cilët merren me kultivimin e perimeve në serra me sipërfaqe prej 0.20 ha e më tepër është 15, ndërsa sipërfaqja totale e serrave është 4.76 ha. Llojet e perimeve të cilat kultivohen në serra janë: Specë, domate, tranguj, sallatë e gjelbër dhe qepë të njoma.

Ndërsa kur jemi tek pemëtaria; relievi i rrafshet në disa pjesë të Komunës së Vitise është shumë i përshtatshëm për kultivimin e pemëve, një veprimtari  tradicionale e fermerëve të kësaj ane. Në veçanti me

sukses kultivohet kultura e mollës. Bazuar në të dhënat nga Regjistrimi i Bujqësisë për vitin 2020, në Komunën e Vitis janë rreth 143.69 ha pemishte, kurse 10.81ha pemë të imëta.

Tabela 21 Sipërfaqja bujqësore e planifikuar për mbjellje për vitin 2020 dhe kulturat bujqësore

| Kultura | Sip. e planifikuar per mbjellje (Ha.) | % e sip. së planifikuar për mbjellje |
|---|---|---|
| Grurë | 4850 | 51.48 |
| Misër | 3255 | 34.55 |
| Perime | 719 | 7.63 |
| Patate | 110 | 1.17 |
| Misër i gjelbër | 105 | 1.11 |
| Jonxhë | 85 | 0.90 |
| Bari i mbjellur | 70 | 0.74 |
| Tërfil | 30 | 0.32 |
| Bimë foraxhere | 20 | 0.21 |
| Thekër | 8 | 0.08 |
| Tërshërë | 7 | 0.07 |
| Elb birre | 4 | 0.04 |
| Elb pranveror | 3 | 0.03 |
| Mollë | 52.53 | 0.56 |
| Kumbull | 18.34 | 0.19 |
| Dardhë | 0.31 | 0.003 |
| Arrë | 47.35 | 0.50 |
| Vishnje | 24.15 | 0.26 |
| Qershi | 0.33 | 0.00 |
| Lajthi | 0.68 | 0.01 |
| Dredhëz | 4.08 | 0.04 |
| Mjedër | 6.73 | 0.07 |
| TOTALI | 9420.5 | 100 |

Sa i përket rendimentit të kulturave bujqësore në komunën e Vitisë, rendimenti i grurit sillet diku rreth 5000 kg/ha, ai i misrit diku rreth 6500 kg/ha, kurse rendimentet e perimeve sillen diku rreth 35.000 kg/ha. Kur jemi tek vlera financiare e kulturave dhe produkteve bujqësore (e nxjerrë nga llogaritja e rendimentit te pritshem dhe çmimit per kg në tregun e Kosovës për vitin 2020) totali i vlerës financiare, nga të gjitha kulturat dhe produktet bujqësore të cekura më lartë është 34,259,195 Eur..

PZHK 2010-2020+ ka paraparë që me ndërmarrjen e masave adekuate do të mund të rritej shumë prodhimi i grurit dhe i misrit, por edhe ai i prodhimeve industriale kopshtare dhe të bimëve foragjere.

Sa i përket shpërndarjes hapësinore të fermerëve të regjistruar në komuën e Vitisë, numri më i madh i tyre vjen nga fshati Gjylekarë, me 275 fermerë (15.1 % e totalit) të regjistruar, në vendin e dytë në këtë renditje vjen fshati Pozharan me 155 fermerë (8.5 % e totalit) të regjistruar, i pasuar nga fshati Remnik me 109 (apo 6.0 % e totalit) dhe fshati Smirë me 102 (5.6 % e totalit). Lubishta e cila renditet e pesta në këtë kategorizim, ka 101 fermerë (5.5 % e totalit) të regjistruar. Pas Lubishtes, shperndarja hapësinore e fermerëve të regjistruar sipas vendbanimeve është si vijon: Terpeza, Verbani, Sadovina e Jerlive, Sllatina e Epërme, Vitia (zona urbane), Begunca, Debelldeh etj.. Në 3 pozitat e fundit për sa i përket numrit të

fermerëve të regjistruar janë vendbanimet si vijon: Godeni i Madh me 3 fermerë, fshati Shashare me 2 si dhe fshati Vernez me vetëm 1 fermer të regjistruar.

### Klasifikimi Tokës sipas përshtatshmërisë për prodhimtari bujqësore

Sa i përket klasifikimit të tokës sipas përshtatshmërisë për prodhimtari bujqësore, Komuna e Vitisë ka në disponim këto sipërfaqe:

Tabela 22 Sipërfaqja dhe përqindja e tokës bujqësore sipas klasave të përshtatshmërisë - Bonitetit

| Përshtatshmëria e Tokës Bujqësore | Sipërfaqja (Ha) | % |
|---|---|---|
| Klasa 1 | 5288.7 | 19.6 |
| Klasa 2 | 4280.3 | 15.9 |
| Klasa 3 | 4216.0 | 15.6 |
| Klasa 4 | 1761.3 | 6.5 |
| Klasa 5 | 4084.4 | 15.1 |
| Klasa 6 | 6652.7 | 24.6 |
| Klasa 7 | 476.0 | 1.8 |
| Klasa 8 | 234.3 | 0.9 |
| Gjithsej | 26994 | 100 |

Këto të dhëna tregojnë për një kualitet të lartë të tokës bujqësore në komunën e Vitisë. Mbi 50% e tokës bujqësore I takon kategorisë I deri IV, që konsiderohet si klasë me bonitet të lartë. Tokat Bujqësore e Klasit I,II,III dhe IV së bashku përbëjnë 15531.3 Ha., apo 57.1 % të të gjithë Tokës Bujqësore në Komunën e Vitisë. Kategorizimi i tillë i tokave bujqësore është bërë me qëllim të nxjerres së totalit të tokave që i takojnë klasave 1-4, e të cilat janë më të përshtatshme për zhvillimin e aktiviteteve bujqësore dhe si të tilla duhet të mbrohen nga ndërtimet eventuale. Nga kjo mund të konstatohet se komuna ka një potencial të lartë për zhvillimin e prodhimtarisë bujqësore.

Më poshtë, përqindja e tokës së përshtatshme bujqësore (Klasa 1-3) në raport me totalin e tokës bujqësore në komunën e Vitisë është krahasuar me gjendjen në komunat e Istogut dhe Skënderajt:

Tabela 23 Përshtatshmëria e tokës bujqësore

| | VITI | ISTOG | SKËNDERAJ |
|---|---|---|---|
| Përshtatshmëria e Tokës Bujqësore | Sipërfaqja (%) | | |
| Klasa 1 - 3 | 51.1 | 9.51 | 25 |
| Të tjera | 48.9 | 90.49 | 75 |
| Gjithsej | 100 | 100 | 100 |




Harta 11 Përshtatshmëria e Tokës Bujqësore në Komunën e Vitisë

Tokat e Klasit I gjenden në zonat kadastrale si vijon: Viti (pjesa më e madhe e zonës kadastrale), Drobesh (pjesërisht), Gërmovë (pjesërisht), Vërban (një pjesë shumë e vogël), Sllatinë (pjesërisht), Sadovinë e Jerlive (një pjesë e vogël), Sadovinë e Çerkezëve (një pjesë shumë e vogël), Pozheran (një pjesë shumë e vogël), Budrigë e Epërme[sa1]  (një pjesë e madhe e zonës kadastrale), Gjylekar (pjesërisht), Rmenik (një pjesë e vogël), Radivojcë (një pjesë e vogël), Podgorc (një pjesë shumë e vogël), Binçë (një pjesë shumë e vogël) dhe Kabash (një pjesë shumë e vogël).

Tokat e Klasit II gjenden në zonat kadastrale si vijon: Viti (një pjesë e vogël), Pozherani (pjesërisht), Çifllak (pjesa më e madhe e zonës kadastrale), Zhiti (një pjesë shumë e vogël), Radivojcë (pjesërisht), Budrigë e Epërme (një pjesë e vogël), Gjylekar (një pjesë e vogël), Remnike (një pjesë e vogël), Letnicë (një pjesë shumë e vogël), Shashare (një pjesë shumë e vogël), Lubishtë (një pjesë shumë e vogël), Buzovik (një pjesë shumë e vogël), Beguncë (një pjesë e vogël), Ramnishtë (një pjesë e vogël), Binçë (një pjesë e vogël), Kabash (një pjesë e vogël), Smirë (një pjesë shumë e vogël), Gushicë (një pjesë shumë e vogël), Sadovinë e Çerkezëve (një pjesë shumë e vogël), Terstenikë (një pjesë shumë e vogël), Ramjan (një pjesë shumë e vogël), Novosellë (një pjesë shumë e vogël), Terpezë (një pjesë shumë e vogël).

Tokat e Klasit III gjenden në zonat kadastrale si vijon: Pozheran (pjesa më e madhe e zonës kadastrale), Drobesh (pjesa më e madhe e zonës kadastrale), Smirë (një pjesë e vogël), Gërmovë (pjesa më e madhe e zonës kadastrale), Vërban (pjesërisht), Sadovinë e Jerlive (pjesa më e madhe), Sadovinë e Çerkezëve (pjesa më e madhe), Sllatinë (pjesërisht), Ramjan (pjesërisht), Novosellë (një pjesë e vogël), Tërpezë (pjesërisht), Ballancë (një pjesë shumë e vogël), Zhiti (pjesërisht), Devajë (një pjesë e vogël), Radivojcë (një pjesë e vogël), Budrikë e Epërme (një pjesë shumë e vogël),  Remnik (një pjesë shumë e vogël), Gjylekar (një pjesë

shumë e vogël), Shashare (një pjesë shumë e vogël), Lubishtë (një pjesë shumë e vogël), Podgorc (një pjesë shumë e vogël), Beguncë (një pjesë shumë e vogël), Buzovik (një pjesë shumë e vogël), Binçë (një pjesë shumë e vogël), Kabash (një pjesë e vogël).

Tokat e Klasit IV gjenden në zonat kadastrale si vijon: Kabash (një pjesë shumë e vogël), Smirë (një pjesë shumë e vogël), Vërban (një pjesë e vogël), Terstenikë (një pjesë shumë e vogël), Sadovinë e Çerkezëve (një pjesë e vogël), Sllatinë (një pjesë e vogël), Ramjan (një pjesë e vogël), Novosellë (një pjesë e vogël), Terpezë (një pjesë e vogël), Ballancë (një pjesë shumë e vogël), Zhiti (një pjesë shumë e vogël), Radivojcë (një pjesë shumë e vogël), Budrikë e Epërme (një pjesë shumë e vogël), Remnik (një pjesë shumë e vogël), Gjylekar (një pjesë shumë e vogël), Vërnakollë (një pjesë e vogël), Letnicë (një pjesë shumë e vogël), Shashare (një pjesë shumë e vogël), Lubishtië (një pjesë e vogël), Podgorc (një pjesë e vogël), Buzovik (një pjesë shumë e vogël), Binçë (një pjesë shumë e vogël)/

**Ujitja e Sipërfaqeve Bujqësore dhe Masat e Komasacionit**

Sa i përket ujitjes së tokës bujqësore, përkundër projekteve të hartuara, në mënyrë të organizuar është ujitur vetëm një sipërfaqe minimale e tokës. Momentalisht, pjesa më e madhe e tokës e cila ujitet, bëhet nga sektori privat duke shfrytëzuar puset dhe lumenjët me pompa të thjeshta me kapacitete të ulëta.

Sa i përket procesit të komasacionit; deri në vitin 2021, vetëm një sipërfaqe e vogël në komunën e Vitisë i është nënshtruar procesit të komasacionit. Procesi i komasacionit ka përfunduar për, parcelat kadastrale në zonat të cilat i përkasin kategorisë së tokave bujqësore I-IV, për zonat kadastrale si vijon: Budriga e Epërme (pjesërisht), Rmeniku (një pjesë e vogël), Gjylekari (një pjesë e vogël), Vërbovci (pjesa më e madhe), Podgorci (një pjesë e vogël), Gërnçari (një pjesë e vogël), Ramnishta (një pjesë e vogël), Begunca (një pjesë e vogël) si dhe Binça (një pjesë e vogël).

Edhe pse me PZHK 2010-2020+ është planfikuar që procesi i komasacionit, në zonat të cilat i përkasin kategorisë së tokave bujqësore I-IV të përfundojë në katër faza pas konsultimit me Ministrinë e Bujqësisë është kuptuar që këto faza nuk mund të zbatohen. Prandaj, në territorin e komunës së Vitisë nuk planifikohen zona të reja që do t'i nënshtrohen procesit të komasacionit të tokës.

Me PZHK 2010-2020+ komuna e Vitisë ka bërë edhe planfikimin për zhvillimet optimale në bujqësi. Sipas këtij planifikimi janë identifikuar kulturat bujqësore bashkë me hapësirat për kultivimin e tyre. Në këtë mënyrë, në pjesën më të madhe të sipërfaqeve bujqësore është planifikuar mbjellja e mollës dhe kumbullës, në pjesën qendrore dhe jugore të komunës është planfikuar mbjella e dredhëzës, në pjesën jug-lindore të komunë është planifikuar mbjellja e mjedrës dhe manaferës.

Zhvillimi i perimtarisë është planifikuar kryesisht në pjesën qendrore dhe në pjesen veri-lindore të komunës, duke përfshirë këto vendbanime dhe zona kadastrale: Viti, Pozharan, Radivojc, Gjylekar, një pjesë e vogël e Gernçarit si dhe një pjesë shumë e vogël e Vërbovcit.

Kultivimi i drithërave është planfikuar në mënyrë të shpërndarë në pothuajse gjithë territorin e komunës, duke përjashtuar vetëm qendrën dhe pjesën veri-lindore të komunës, aty ku është planifikuar zhvillimi i perimtarisë. Në këtë mënyrë, kultivimi i drithërave në pjesën veriore është planifikuar në këto vendbanime dhe zona kadastrale: Ballanca, Tërpeza, Novosella, Ramjani, Zhitia, Devaja si dhe një pjesë e vogël e Radivojcit.

Kultivimi i drithërave në pjesën lindore është planifikuar në këto vendbanime dhe zona kadastrale: Budriga e Epërme, Remniku, gjysma e Gjylekarit, pjesa më e madhe e Gërnçarit, një pjesë e vogël e Stubllës së Poshtme, një pjesë e vogël e Godenit të Madh, pjesa më e madhe e Stubllës së Epërme si dhe një pjesë e vogël e Vërnakollës.

Vërboci, Podgorci, Ramnishta, Begunca në Jug-Lindje; Drobeshi, Gërmova, Sadovina e Jerlive në perëndim janë planifikuar tërësisht si vendbanime dhe zona kadastrale për kultivimin e drithërave.

Binça, Kabashi, Smira dhe Gushica në Jug; Sadovina e Çerkezëve, Tërsteniku dhe Sllatina në perëndim janë planifikuar pjesërisht si vendbanime dhe zona kadastrale për kultivimin e drithërave.

Përveç kësaj, në zonat kadastrale në Gushicë, Gërmovë dhe Sllatinë janë planifikuar Zona për Zhvillime Bujqësore.

**Sektori i blegtorisë**

Zhvillimi i blegtorisë në Viti është në varshmëri nga trendët e zhvillimit të përgjithshëm ekonomik të vendit. Komuna e Vitisë ka resurse të mira natyrore për zhvillim të blegtorisë pasiqë ka tokë të mirë bujqësore ku zhvillohen me sukses kulturat bimore siq janë drithërat, elbi, tërshëra, thekra, jonxha etj.. Së bashku me to edhe potenciali i kullosave si dhe ai i livadheve janë një garancë e mirë për zhvillimin e blegtorisë si dhe paraqesin një bazë të mirë ushqimore për sektorin.

Bazat për hartimin e politikave në këtë sektor janë cekur në Librin e Gjelbër të Ministrisë përkatëse, përmes së cilit synohet zhvillimi i politikës me një qasje të pjesëmarrjes aktive të të gjitha institucioneve relevante, OJQ-ve (gjithsej 13 OJQ aktive në komunën e Vitisë) që veprojnë në këtë sektor dhe organizatat e fermerëve, përpunuesit dhe tregtarët. Synim kryesorë i politikës në aspektin afat shkurtër-mesëm është që të gjenerojë vende të reja pune dhe të ngrisë të ardhurat e fermerëve të varfër të ekonomive të vogla bujqësore, të ndihmojnë në zgjerimin e aktiviteteve etj..

Komuna e Vitisë ka një fond blegtoral mjaft të pasur dhe të larmishëm. Ky fond përbëhet kryesisht nga: Gjedhët, delet, dhitë, pulat etj.

Gjedhëtaria e cila paraqet edhe bazën kryesore momentale të zhvillimit të bujqësisë në komunë numëron 2403 krerë lopë qumështi që mbarështohen nëpër ferma komerciale të mëdha, të mesme dhe të vogla por me tendencë rritjeje. Ky sektor është duke vënë në lëvizje edhe sektorin e drithrave dhe kulturave forragjere nga i cili siguron bazën ushqimore. Në anën tjetër, sektori i qumeshtit është relativisht i zhvilluar, mirëpo vazhdon të mbetet si potencial ende i pashfrytëzuar mirë në krahasim me resurset të cilat i posedon komuna.

**Lopët qumështore:** Dominon raca Simental dhe metisët e sajë, Hollshtajn Frizis, Hollshtajn, Red Hollshtajn, Monte Biliard etj., por që nuk dihet saktë numri dhe përqindja e racave të lopëve qumështore. Ky sektor mbështetet nga institucionet qendrore me subvencione direkte si për kokë lope ashtu edhe për litër qumështi sipas kualitetit të këtij të fundit. Mirëpo, fermerët që marrin subvencione sipas kualitetit të qumështit për litër janë të pakët sepse mungon një vetëdijësim i duhur i fermerëve për të aplikuar praktikat e mira të mbarështimit, higjienës, ushqimit dhe komplet menaxhimit të fermës.

Në komunën e Vitisë ka 83 ferma me nga dhjetë e më tepër krerë, me 1740 krerë lopë qumështore në total. Ndërsa numri total i lopëve qumështore në komunën e Vitisë është 2403 krerë.

**Gjedhet për trashje** Paraqesin një potencial të mirë të sigurimit të lëndës së parë ushqimore- mishit dhe produkteve tjera nga mishi. Komuna ka resurse të mira falë tokës bujqësore që dominon nga klasët e para dhe të dyta për të sigurauar bazë ushqimore në viset e rrafshta. Në anën tjetër, në pjesën kodrinoro malore ka mjaft kullosa dhe livadhe për të mbarështuar gjedhin për mish. Te gjedhi për mish dominojnë metisë të racave të ndryshme; më shumë nga Simentali dhe Busha dhe më pak të racave tjera. Në komunën e Vitisë ka 2 ferma me nga 30 e më shumë gjedhe për trashje.

**Delet dhe dhitë:** Komuna ka një fond të vogël të dhive dhe të deleve, siç edhe është elaboruar në tabelë. Mirëpo, kapacitetet e resurseve natyrore (livadhet, kullosat, pyjet, arat) mund të absorbojnë një fond deri 6 herë më të madh të dhive dhe 2 herë më të madh të deleve. Përderisa tek dhitë dominojnë racat ballkanike, tek delet dominojnë racat metisët e deles së Sharrit, Virtemberg dhe raca tjera por që nuk japin sa duhet rendimentë qumështi dhe mishi. Në këtë sektorë operojnë gjithësej 62 ferma.

**Pulat Vojse:** Nënsektori i Shpezëve (pula vojse) poashtu paraqet një potencial të mirë zhvillimor. Në këtë sektorë operojnë gjithsej 5 ferma.

**Brojlerët (zogjët për mish):** Kjo kategori e shpezëve është fare pak e zhvilluar edhe ate më shumë në ekonomi familjare por që duhet kushtuar një vëmendje të krijimit të fermave komerciale sepse ka një treg të mirë konsumi.

**Bletaria:** Përkundër një numri të konsiderueshëm të shoqërive bletësh që ka, ky sektor vlersohet ende i vogël, por edhe i pa shqfrytëzuar në raport me potencialin dhe kapacitetet ekzistuese, si për nga sasia ashtu edhe për nga rendimenti. Komuna e Vitisë ka resurse të mira për zhvillim të këtij sektori, mirëpo, ashtu sikur sektorëve tjerë blegtoral, edhe sektorit të Bletarisë i mungon aplikimi i praktikave të mira për mbarështim. Në këtë sektorë janë 98 fermerë, me mbi 30 koshere secili.

Tabela 24 Fondi Blegtoral në Komunën e Vitisë për vitet 2016-2020[10]

| Lloji/Viti | 2016 | 2017 | 2018 | 2019 | 2020 |
|---|---|---|---|---|---|
| Lopë qumështi | 2451 | 2495 | 2493 | 2142 | 2403 |
| Dele | 10782 | 11720 | 13.719 | 12.937 | 13.518 |
| Dhi | 572 | 800 | 1233 | 1190 | 1042 |
| Dosa | 61 | 181 | 248 | 108 | 199 |
| Pula vojse | 10500 | 12800 | 16500 | 17780 | 15681 |
| Bletë | 2884 | 3359 | 4697 | 6091 | 6861 |

### Ambulancat Veterinare

Komuna e Vitisë ka 6 ambulanca veterinare me gjithsje 12 të punësuarit që ndihmojnë vazhdimisht sektorët blegtoral. Ndihma ofrohet në disa aspekte si: në preventivë, kurime dhe vakcinime por edhe përmirësim racor përmes inseminimeve artificiale, e cila paraqet një infrastrukturë të mirë mbështetëse të sektorit.

### Barnatoret Bujqësore

Komuna e Vitisë ka 6 barnatore bujqësore aktive, me gjithsej 18 të punësuar, të cilat poashtu paraqesin një aset shtesë dhe shumë mbështetës të sektorit duke furnizuar prodhuesit me inpute agrare.

### Qumështoret dhe Pikat Grumbulluese të qumështit

Fermerët Vitias qumështin e distribuojnë kryesisht në 2 qumështore: Në qumështoren Kabi –Gjilan, si dhe në atë Magic ICE - rruga Prishtinë-Ferizaj. Komuna ka 2 pika grumbulluese të qumështit, me 4 të punësuar, të cilat lehtësojnë në masë të madhe punën e prodhuesve të qumështit.

### Therrtoret dhe Industria e Mishit

[10] Komuna Viti, Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural

Komuna ka 3 therrtore të cilat e bëjnë më të qëndrueshëm sektorin e trashjes së kafshëve, e sidomos gjedhit. Në këto therrtore janë të punësuar gjithsej 3 persona.

### Tregu i kafshëve

Në komunën e Vitisë, kemi dy tregje të kafshëve: Njëri në qytetin e Vitisë, ndërsa tjetri në Pozheran. Këto tregje administrohen nga ndërmarrja publike ,,Univerzal'', njëherit nga kjo ndërmarrje edhe mblidhen taksat dhe të hyrat e tjera në komunë. Të dy tregjet e kafshëve janë në gjendje të mirë.

Me PZHK 2010-2020+, zhvillimi i blegtorisë është planfikuar kryesisht në këto vendbanime dhe zona kadastrale:

- Në pjesën veriore të komunës: Ballancë, Terpezë, Novosellë, Ramjan, Zhiti, Devajë, Radivojc, Budrigë e Epërme,
- Në pjesën lindore të komunës: Remnik, Stubëll e Poshtme, Goden i Madh,
- Në pjesën jug-lindore të komunës: Vërnakollë, Vërnez, Letnicë, Shashare
- Në pjesen jugore të komunës: Lubishtë, Buzovik, Debëlldeh, Binqi, Mjak, Kabash, Smirë, Gushicë,
- Në pjesën perëndimore të komunës: Vërban, Sadovinë e Çerkezëve, Sllatinë, Tërstenik.

### Pylltaria

Pylltaria është dege specifike e ekonomisë, në të cilën proceset e prodhimit janë të ngadalshme dhe ato nuk mund të ndryshohen shpejt. Kusht primar i zhvillimit afatgjate të ekonomisë pyjore, në radhë të parë të prodhimit pyjor, si bazë e saj, është programimi real i vëllimit dhe i strukturës së konsumit të prodhimit të nxjerre nga eksploatimi i pyjeve dhe shtimi i funksioneve të përgjithshme të dobishme të pyllit.

Sipas vlerësimit të shfrytëzimit të tokës në Komunën e Vitisë rezulton se 11,329 hektarë, apo 42 % të territorit të komunës janë Tokë Bujqësore, ndërsa 12,265 hektarë, apo 45.2 % e territorit të komunës janë Sipërfaqe Pyjore dhe Kullosa.

Tabela 25 Shfrytëzimi aktual i tokës në komunën e Vitisë

| SIPËRFAQJA TOTALE E KOMUNËS | 26993.59 (Ha) | |
|---|---|---|
| **LLOJI I SHFRYTËZIMIT** | **SIPERFAQJA (Ha)** | **%** |
| **Tokë bujqësore** | 11,329.67 | 42 |
| **Pyje dhe Kullosa** | 12,265.42 | 45.2 |
| **Sipërfaqe e Ndërtuar** | 3,115.95 | 11.5 |
| **Sipërfaqe tjera** | 257.96 | 4 |
| **TOTALI** | 26,969 Ha | 100 |

Pjesa më e madhe e sipërfaqes pyjore shtrihet në pjesën jugore dhe jug-lindore të komunës, me një sipërfaqe tjetër e cila shtrihet në skajin verior të komunës. Kështu, sipërfaqet pyjore ne pjesën jugore dhe atë jug-lindore të komunës mbulojnë vendbanimet dhe zonat kadastrale si vijon: Vërban (pjesërisht), Gushica (pjesërisht), Smira (pjesërisht), Kabashi, Binça, Mjaku, Debëlldehu, Buzoviku (pjesërisht), Lubishta (pjesërisht), Shasharja (pjesrëisht), Podgorci (pjesërisht), Letnica (pjesa më e madhe), Vërnezi (pjesa më e madhe), Vërnakolla (pjesërisht), Stublla e Epërme (pjesëirsht), Godeni i Madh (pjesërisht), Stublla e Poshtme (pjesërisht), Gërnçari (pjesa më e madhe), Gjylekari (një pjesë e vogël) dhe Remniku (pjesërisht).

Në pjesën veriore të komunës, sipërfaqet pyjore mbulojnë vendbanimet dhe zonat kadastrale si vijon: Devaja (një pjesë shumë e vogël), Zhitia (një pjesë e vogël), Ballanca (pjesa më e madhe), Tërpeza (pjesëirsht) si dhe Novosella (pjesërisht).

Sllatina, Tërsteniku, Sadovina e Çerkezëve, Sadovina e Jerlive si dhe Gërmova, vendbanimet të cilat gjenden në pjesën perëndimore dhe jug-perëndimore të komunës, mbulohen vetëm në sipërfaqe shumë të vogla me sipërfaqe pyjore.

5 vendbanimet me sipërfaqen më të madhe pyjore në komunën e Vitisë janë: Smira (1,202 Ha), Binça (904 Ha), Vërnezi (809 Ha), Debelldeh (805 Ha) dhe Shasharja (750 Ha).

Ndërsa vendbanimet dhe zonat kadastrale të cilat nuk kanë fare sipërfaqe pyjore janë si në vijim: Budrigë e Epërme, Çifllak, Drobesh, Pozharan, Radivojc, Ramnishtë dhe Viti.

Shkurre në pyje, në sipërfaqe retalitivisht të vogla, gjenden në këto vendbanime dhe zona kadastrale: Debëlldeh në Jug; Letnicë dhe Stubëll e Epërme në lindje si dhe Tërpezë në veri.

Ndërsa më poshtë është paraqitur tabela e shpërndarjes së sipërfaqeve pyjore në komunën e Vitisë, sipas vendbanimeve.

Tabela 26 Shpërndarja e sipërfaqeve pyjore në komunën e Vitisë, sipas vendbanimeve

| Vendbanimi | Sip. Pyjore |
|---|---|
| Ballancë | 548.26 |
| Beguncë | 16.90 |
| Binçë | 904.00 |
| Budrikë e Epërme | |
| Buzovik | 314.06 |
| Çifllak | |
| Debelldeh | 805.66 |
| Devajë | 169.94 |
| Drobesh | |
| Gërmovë | 18.39 |
| Goden i Madh | 131.75 |
| Gushicë | 775.02 |
| Gjylekar | 403.54 |
| Kabash | 349.32 |
| Letnicë | 352.39 |
| Lubishtë | 708.90 |
| Mjak | 602.53 |
| Novosellë | 206.31 |
| Podgorc | 170.60 |
| Pozharan | |
| Radivojc | |
| Ramjan | 74.43 |
| Ramnishtë | |
| Remnik | 606.35 |
| Sadovinë e Çerkezve | 59.35 |
| Sadovinë e Jerlive | 24.02 |

| | |
|---|---|
| Sllatinë | 28.84 |
| Smirë | 1,202.26 |
| Stubëll e Epërme | 423.01 |
| Stubëll e Poshtme | 110.90 |
| Shashare | 751.78 |
| Tërpezë | 715.52 |
| Tërstenik | 13.25 |
| Vërban | 381.33 |
| Vërnakollë | 431.39 |
| Vërnez | 809.31 |
| Viti | |
| Zhiti | 91.22 |
| TOTAL | 12,200.51 |

Me PZHK 2010-2020+ komuna e Vitisë ka paraparë edhe pyllëzimin e disa sipërfaqeve, në vendbainme dhe zona të ndryshme kadastrale, me një sipërfaqe totale prej 506 Ha. Pyllëzimi më i madh për nga sipërfaqja është planifikuar për pjesën veriore të komunës, përkatësisht në zonën kadastrale Ramjan (gjysma e zonës kadastrale) si dhe Novosellë (një pjesë e vogël e zonës kadastrale). Budriga e Epërme (një pjesë e vogeël), Devaja (një pjesë e vogël), Radivojci (një pjesë e vogël), Gjylekari (një pjesë e vogël), Gërnçari (një pjesë e vogël), Stublla e Epërme (një pjesë e vogël), Lubishta (një pjesë e vogël), Buzoviku (një pjesë e vogël), Debelldehu (një pjesë e vogël), Smira (një pjesë shumë e vogël), Gushica (një pjesë shumë e vogël) dhe Vërbani (një pjesë shumë e vogël) janë po ashtu ndër zonat kadastrale për të cilat është planifikuar pyllëzimi. Në kuadër të këtij pyllëzimi është planifikuar edhe favorizimin e drurit të vlefshëm që rritet shpejtë. Tutje, shndërrimi gradual (natyral dhe artificial ) i pyjeve të ulëta në pyje të larta, përmes metodës së konversionit dhe përmes pyllëzimit është planifikuar po ashtu me PZHK 2010-2020+. Zona në Tërpezë, Vërban, Goshicë, Smirë, Kabash, Letnicë, Podgorc, Gërnçar, me një sipërfaqe totale prej 218 Ha., janë planifikuar të trajtohen me metodën e konversionit.

Përveç pyllëzimit, me PZHK 2010-2020+ është paraparë edhe melorizimi i pyjeve dhe atë në dy lokacione, me një sipërfaqe totale prej 33 Ha. Kështu, në pjesën lindore të komunës është planifikuar melorizimi i pyjeve, sipërfaqja e të cilave përshinë një pjesë të Remnikut dhe Gjylekarit. Sipërfaqja e planifikuar për melorizim në pjesën veriore të komunës përfshnië një pjesë të Ballancës dhe një pjesë të Tërpezës.

Mirëmbajtja intensive e pyjeve të larta të ruajtura është po ashtu ndër masat e parapara dhe planfikuara me PZHK 2010-2020+. Sipas këtij plani, zonat pyjore në të cilat duhet pasur kujdes dhe angazhim maksimal profesional me qëllim të ruajtjes dhe përmirësimit të gjendje së pyjeve të larta (me prejardhje prej farës) janë: Zona e pyjeve të Letnicës, Shasharës, Lubisht – Buzovik, Dobëlldeh, Mjak, Smirë dhe kulturat pyjore në zonën e Tërpezës – Fshat i Ri.

Tutje; sa i përket shfrytëzimit të masës drusore, me planin e njëjtë është  propozuar orientimi në shfrytëzimin e drurit teknik së pari, e pastaj mbetja në dru zjarri, ndërsa vëllimi i përgjithshëm I prerjes do të orientohej në baza reale me gjendjen e pyllit, duke u harmonizuar me rritjen.

Ndërtimi i rrugëve pyjore në 1. Letnicë- Ibrishim – kufiri me Maqedoninë e Veriut; 2. Buzovik - Kufiri me Maqedoninë e Veriut, si dhe 3. Smirë -Drenoglla është planfikuar në funksion të realizimit dhe implementimit të masave të parapara me planin e njëjtë.

### 2.5.3.2. ***Tregtia***

Në komunën e Vitisë kemi të regjistruara 1.197 ndërmarrje në total, prej të cilave 1,167 vijnë nga sektori privat. Nga të gjitha ndërmarrjet e regjistruara 119, apo 9.9% e totalit të ndërmarrjeve të regjistruara i takojnë sektorit të Tregtisë. Duke u bazuar në këto të dhëna, konstatohet se tregtia është sektori i katërt më i rëndësishëm ekonomik në komunën e Vitisë. Ndërsa sa i përket numrit të të punësuarve, me gjithsej 135 të punësuar, tregtia është sektori i pestë më i madh në komunën e Vitisë. Në komunën e Vitisë kemi dy tregje: tregun e gjelbërt dhe tregun e kafshëve. Këto tregje administrohen nga ndërmarrja publike „Univerzal", Institucionet, organizatat dhe shoqatat që stimulojnë aktivitetin tregtar në komunën e Vitisë janë: shoqata e afaristëve, shoqata e ekonomistëve, shoqata e blegtorëve etj.. PZHK 2010-2020+ e tregtinë e ka cilësuar si sektor primar ekonomik, ndërsa ka paraparë fuqizimin e këtij sektori përmes koncentrimit të bizneseve të tregtisë me shumicë në zona ekonomike, ofrimit të infrastrukturës së nevojshme për këto lloje të biznesit si dhe përkrahjen edhe të bizneseve të tregtisë me pakicë duke u ofruar atyre edhe hapësirë por edhe infrastrukturë të nevojshme.

### 2.5.3.3. ***Industria***

Gjendja eksistuese e industrisë në komunën e Vitisë është mjaft e pa volitshme. Në komunën e Vitisë, veprojnë disa njësi të vogla punuese për prodhimin e konstruktimeve metalike (dyer, dritare, tavolina, karrige, si dhe konstruksione kulmi e ndërtimi), kombinim i llamarinës dhe hekurit në sektorin privat, ndërsa fabrika për prodhimin e vidave të vogla, të dorezave dhe të hallkave për mobile në Viti, tashmë është privatizuar. Përveç kësaj, në komunën e Vitisë, veprojnë disa njësi të vogla punuese për prodhimin e produkteve të drurit: dyer, dritare, tavolina, karrige, por edhe konstruksione prej druri me të gjitha elementet konstruktive. Në komunë veprojnë edhe disa njësi të vogla punuese për prodhimin e produkteve të plastikës: dyer, dritare. Ndërsa sa i përket industrisë ushqimore, ajo është deri në një masë e zhvilluar, me prodhimin e bukës dhe të disa nënprodukteve kryesisht në sektorin privat, të bazuar në disa kapacitete për prodhimin e miellit nga drithërat e bardha (Kabash, Terpezë, Pozheran, Vërban etj.).

Sa i përket ndërmarrjeve ekonomike, në sektorin e industrisë kemi pak a shumë këtë gjendje: Pjesërisht punon N.P. „VINEX" për përpunimin e metalit, në industrinë e drurit operon fabrika për terjen e drurit në fshatin Drobesh, kurse në industrinë e tekstilit operon N.P. „Kosovarja", e cila merret me qepjen e rrobave por që punon me një numër shumë të vogël të punëtorve. Nga gurthyesit operon N.P. „Guri" dhe disa ndërmarrje të tjera punuese që merrën me bluarjen e gurit. Ndërmarrjet shoqërore kohëve të fundit kanë shënuar rënje të konsiderueshme ekonomike, ndërkaq nga ato private, e veçanërisht ato të prodhimit që ndikojnë në ngritje të ekonomisë mund të dallohen: Kompania e rrjetit të armatures "Besa F" në Drobesh, "Rreze Gëzimi" në Pozheran, N.P. , "Beti Commerc", kompania për prodhim të elementeve të ujit prej mesingu, N.P. "Metaliku S", ajo e përpunimit të llamarinës si dhe disa ndërmarrje të tjera të vogla që merren me përpunimin e drurit, të llamarinës etj.. Nga të gjitha ndërmarrjet e regjistruara, 120 ndërmarrje (10% e totalit të ndërmarrjeve të regjistruara) i takojnë sektorit të Industrisë. Prej tyre 112 ndërmarrje, apo 9.4 % e totalit të ndërmarrjeve të regjistruara i takojnë Industrisë Përpunuese, ndërsa 8 ndërmarrje, apo 0.7 % e totalit të ndërmarrjeve të regjistruara i takojnë sektorit të Xeheroreve dhe Gurëthyesve.

Ndërsa sa i përket numrit të të punësuarve, Industria në komunën e Vitisë gjeneron 288 vende pune në total. Prej këtyre të punësuarve, 222 punojnë në Industrinë Përpunuese, ndërsa 66 punojnë në sektorin e Xeheroreve dhe Gurëthyesve.

Për të gjeneruar zhvillim më të madh ekonomik dhe për të rritur numrin e punësimit, Komuna e Vitisë në planet paraprake (Plani Zhvillimor Komunal 2010-2020+, Plani Zhvillimor Urban 2010-2015+, Plani

Rregullues i Hollësishëm "Zona Ekonomike me Statusin Parku Industrial") ka paraparë krijimin e këtyre Zonave Ekonomike:

- Ruajta e Zonës Ekonomike në Viti
- Zona Ekonomike me statusin Parku Industrial, në Budrigë të Epërme, me një sipërfaqe totale prej 155,000 m2 e për të cilën në vitin 2011 është hartuar edhe Plani Rregullues i Hollësishëm[11];
- Zona Ekonomike në Sllatinë
- Zona Ekonomike në Sadovinë e Jerlive (në pjeën jug-perëndimore të vendbanimit, në kufi me zonën kadastrale të Vërbanit)
- Zona Ekonomike në Drobesh (në pjeën jug-perëndimore të vendbanimit, në kufijë me zonat kadastrale Gërmovë dhe Smirë).

Përveç kësaj, zonat kadastrale Binçë dhe Gjylekarë janë identifikuar si vendbanime me mundësi për zhvillimin e industrisë së përpunimit të drurit; zonat kadastrale Viti dhe Pozharan janë identifikuar si vendbanime me mundësi për zhvillimin e industrisë së përpunimit të drurit, plastikës dhe metalit. Shiriti hapësinor që kalon përmes Gërnçarit, kufirit perëndimorë të Stubllës së Epërme, kufirit perëndimorë të Vërnakollës si dhe kufirit veriorë të Letnicës është identifikuar si hapësirë me mundësi për zhvillimin e industrisë së lehtë.

Zonat e parapara ekonomike janë planifikuar për zhvillim kryesisht të blegtorisë dhe industrisë së përpunimit dhe finalizimit të produkteve nga blegtoria, për industrinë e lehtë, të përpunimitt të drurit, industrinë e përpunimit të plastikës si dhe industrinë ushqimore.

Kryesisht është respektuar parimi që objektet industriale të vendosen në hapësirat ku toka është e bonitetit të dobët për zhvillimin dhe kultivimin e kulturave bujqësore. Për më tepër, këto zona (hapësira) nuk posedojnë pasuri nëntokësore. Infrastruktura rrugore si dhe infrastruktura tjetër përcjellëse po ashtu janë paraparë dhe propozuar me planet paraprake.

**Zona Ekonomike me statusin Parku Industrial** gjendet në pjesën verilindore të qytetit të Vitisë. Ajo gjendet në zonën kadastrale Budrikë. Ka sipërfaqe prej 15.5 ha. Në pjesën veriore ka dalje në rrugën Ferizaj-Gjilan. Në pjesën jugore kalon lumi Morava. E gjithë zona e dedikuar për zonë ekonomike është e paraparë në një parcel të vetme, përkatësisht parcela kadastrale P-70101012-00641-1. Kjo parcelë është pronë komunale dhe aktualisht brenda kufirit të saj dhe zonës përreth saj nuk ka ndërtime.

---

[11] Komuna e Vitisë, Dokument Planifikimi - Plani Rregullues i Hollësishëm "Zona Ekonomike me statusin Parku Industrial"




Harta 12 Zonat Ekonomike në Komunën e Vitisë, të parapara me PZHK 2010-2020

### 2.5.3.4. *Zejtaria*

Në PZHK 2010-2020+ zejtaria është trajtuar si një fushë e cila vazhdon të mbetet e rëndësishme për zhvillimin ekonomik në komunën e Vitisë. Ekzistimi i një përvoje të konsiderueshme në veprimtaritë zejtare, qoftë në zejtarinë prodhuese, shërbyese, artistike dhe të artizanateve konsiderohet përparësi për zhvillimin ekonomik. Zejtaritë ekzistuese prodhuese janë të fokusuara në përpunimin dhe prodhimin e produkteve për treg, kryesisht në seri të vogla e që nuk kanë veçori të prodhimit industrial (instrumente muzikore, vegla për bujqësi etj). Në komunën e Vitisë janë të njohur edhe zejtarët që merren me zejtari shërbyese në kuptimin e mirëmbajtjeve dhe riparimin e prodhimeve, stabilimenteve, objekteve si dhe kryerjen e shërbimeve të tjera. Mirëpo gjendja aktuale në terren dëshmon se ky sektor nuk është i zhvilluar në nivelin e pritshëm, ndërsa edhe interesimi për të është gjithnjë në rënje.

### *2.5.3.5. Turizmi*

Edhe përkundër mundësive të mjaftueshme dhe potencialit zhvillimor, në komunë e Vitisë turizmi nuk është i zhvilluar. Deri para ndarjes së komunës së Kllokotit, në Viti është zhvilluar turizmi shëndetësor, me Banjën e Kllokotit e cila edhe sot vizitohet nga mijëra vizitorë në baza mujore. Karakteri multi etnik, multi fetar e multi kulturor i popullsisë së Vitisë ka reflektuar edhe në shumësinë e festave kulturore e fetare (trashëgimi jo materiale) por edhe në diversitetin arkitekturor e rrjedhimisht në diversitetin e trashëgimisë arkitekturore. Në ditët e sotme, turizmi kulturor është i bazuar kryesisht në vizitat e objekteve të trashëgimisë arkitekturore si dhe në numrin e madh të vizitorëve gjatë festave të ndryshme fetare. Komuna e Vitisë ka potencial të mirë për zhvillim edhe të turizmit natyror e dimëror, por edhe të atij rural dhe kulturor. Ndërsa Plani Zhvillimor Komunal 2010-2020+ i komunës së Vitisë ka propozuar disa hapa për zhvillimin e këtyre llojeve të turizmit, përfshirë edhe qëllimet për zhvillimin e zonave turistike dhe rekreative në Letnicë, Debëllde, Stubëll, Binçë etj..

### Turizmi natyror

Sa i përket potencialeve për turizëm natyror, e posaqerisht të atij malor; monumentet trashëgimisë natyrore, sikur në fshatin Sllatinë e Epërme, si dhe biodiversiteti i pasur paraqesin pika të atraksioneve turistike, krahas kësaj, zona malore e komunës shquhet për potenciale të mëdha në këtë sektor. Me PZHK 2010-2020+ fshatrat Debelldeh, Letnicë, te Shushtë dhe pjesa mbi Kabash janë konsideruar si fshatra me potencial të madh për këtë lloj turizmi, ndërsa me po të njëjtin plan janë paraparë edhe zhvillimi i infrastrukturës dhe përmbajtjeve për sporte malore si shtigje të ecjes dhe shëtitje, vrapime dhe çiklizmi malor, kalërimi etj.. Këto aktivitete të rekreacionit janë planifikuar së bashku me shërbimet e akomodimit privat nëpër fshatra, ndërsa masa të tilla mund të sjellin të ardhura shtesë për fermerët.

Përveç kësaj, me PZHK 2010-2020+ fshati Debëlldeh është konsideruar si zonë me potencial për zhvillimin e hotelerisë, në funksion të përkrhajes së turzimit veror dhe atij dimëror. Fshati Letnicë, për shkak të natyrës dhe peizazhit, karakteristikave arkitekturore dhe trashëgimisë shpirtërore është konsideruar si vendbanime me potencial të madh për zhvillimin e turizmit natyror dhe rural, por edhe turizmit kulturor.

Në zonat e lartpërmendura ka potencial edhe për zhvillimin e turizmit rural, i cili gjithsesi është i lidhur ngushtë edhe me zhvillimin e bujqësisë dhe blegtorisë, mirëpo gjithnjë i kushtëzuar me zhvillimin dhe përmirësimin e infrastrukturës së nevojshme teknike.

### Turizmi kulturor

Siç është përshkruar edhe tek pjesa e Trashëgimisë Kulturore në këtë plan; Smira, Stublla, Letnica, Tërpeza, Pozherani, Binqa, Gërmova, Gërnçari, Tërpeza dhe Qiflaki janë vendbanime me trashëgimi të pasur arkeologjike, arkitektonike dhe shpirtërore, si të tilla, këto fshatra përbëjnë potencial të madh për zhvillimin e turizmit kulturor.

### Turizmi shëndetësor

Me PZHK 2010-2020+; ajri i pastër, mjedisi i qetë dhe peizazhet e bukura në malet e Letnicës dhe Dobulldehit si dhe uji termal dhe termo mineral në Radivojc, janë konsideruar si potenciale të rëndësishme për zhvillimin e turizmit shëndetësor. Ndërtimi i një spitali në Stubëll, bashkë me ndërtimin e një qendre rehabilituese për sëmundjet e mushkrive janë konsideruar si investime të nevojshme për zhvillimin e këtij lloji të turizmit.

## *2.5.3.6.* ***Shërbimet***

Me 697 ndërmarrje të regjistruara dhe me 885 punëtorë të punësuar, sektori i shërbimeve është sektori më i zhvilluar në komunën e Vitisë, përkatësisht radhitet në pozitën e parë edhe për sa i përket numrit të ndërmarrjeve të regjistruara por edhe për sa i përket numrit të të punësuarve. Vetëm në vitin 2019 në këtë sektor janë regjistruar 67 ndërmarrje të reja, me 82 të punësuar. Ndërsa deri në Gusht të Vitit 2020 në këtë sektor janë regjistruar 43 ndërmarrje të reja me 53 të punësuar. Duke u bazuar në trended regjionale, kombëtare por edhe ato globale, sektori i shërbimeve pritet të rritet në vazhdimësi, andaj edhe në komunën e Vitisë pritet që ky sektor të shënoj rritje të vazhdueshme, edhe për sa i përket themelimit/hapjes së bizneseve të reja, por edhe krijimit të vendeve të reja të punës. Përveç kësaj, zhvillimi i planifikuar i sektorit të turizmit do të ndikojë drejtpërdrejt edhe në zhvillimin e sektorit të shërbimeve, sidomos nënsektorit të hotelerisë dhe gastronomisë, përderisa të dyja këto sektore kanë një lidhje dhe varshmëri të ndërsjelltë. Zhvillimi më i madh dhe i mire planifikuar i turizmit, bashkë me sektorin e shërbimeve do të mundësojë edhe zhvillimin e më tutjeshëm të sistemit bankar, qoftë për shkak të rritjes së

nevojës për kredi për investime në këto sektore, qoftë për shkak të rritjes së nevojave dhe kërkesave për pagesa dhe transaksione.

### *2.5.3.7. Pasuritë Nëntokësore*

Territori i komunës së Vitisë ndodhet në pjesën juglindore të Republikës së Kosovës dhe ka sipërfaqe prej 297 km2. Në aspektin morfologjik pjesa më e madhe e territorit paraqet reliev të rrafshët dhe pjesërisht të valëzuar (kodrinor-malor). Brenda këtij territori si pasojë e zhvillimeve të proceseve të ndryshme e të shumëllojshme gjeologjike dhe ndërtimit gjeologjik janë formuar vendburimet të rëndësishme të lëndëve të para minerale, jominerale dhe lëndëve të para ndërtimore. Aktualisht, edhe për kundër vlerës së madhe ekonomike, lëndët e para minerale në komunën e Vitisë nuk eksploatohen. Pjesërisht eksploatohen shkëmbinjt si p.sh. N.P. Guri, si dhe disa ndërmarrje tjera të cilat merren me përpunimin, respektivisht bluarjen e shkëmbit. Njohja, hulumtimi dhe eksploatimi i lëndëve të para minerale dhe jominerale për komunën e Vitisë tani dhe në perspektivën e zhvillimit ekonomik do të ketë një rëndësi të veçantë.

**Resurset minerale në territorin e komunës së Vitisë**

Bazuar në të dhënat ekzistuese, në territorin e Komunsë së Vitisë janë lokalizuar një numër i vendburimeve metalore dhe jometalore të cilat paraqesin potencial për zhvillimin ekonomik të kësaj komune. Hulumtimet e më herëshme gjeologjike tregojnë se në disa lokalitete të kësaj komune gjenden vendburime të bakrit (lokalitetet: Lubishtë, Gërnqar, Beguncë, Debellde etj.). Në lokalitetet Gernçar, Letnicë dhe Shashare janë gjetur pasuri nëntokësore të hekurit, bakrit dhe antimonit të cilat në aspektin e valorizimit ekonomik janë të rëndësishme si lëndë e parë për industrinë e kozmetikës. Në pjesen lindore të lokalitetit Gernqar dhe Skifteraj gjenden vendburime të bakrit, zinkut dhe plumbit. Lëndet e para të argjilës janë të lokalizuara në lokalitetin Sadovinë e Jerlive të cilat janë me vlerë dhe mundësi për zhvillimin e industrisë për porodhimin e materialit ndërtimorë (tulla, blloka etj.). Vendburime të bendotniteve janë gjendur në lokalitetin (fshatin) Goshicë, e cila mund të përdoret në industri për prodhimin e detergjenteve. Vendburime të leociteve janë të lokalizuara në lokalitetin Radivojcë, të cilat në industri mund të përdoren për prodhimin e plehrave artificiale të cilat janë të nevojshme për përdorim në bujqësi. Në lokalitetin Tërpezë, gjendet pasuria nëntokësore e tufit dhe gurit gëlqeror. Tufi, është lëndë e parë e cila mund të përdoret për prodhimin e çimentos, ndërsa shkëmbi gëlqeror është lëndë e parë nga i cili prodhohet gëlqerja. Edhe pse pasuritë minerale dhe jominerale (pasuri nëntokësore) me të cilat posedon komuna e Vitisë, përfshirë edhe metaloidet si Bentonit, janë një bazë e fuqishme për zhvillim ekonomik, mungesa e kapaciteteve dhe infrastrukturës në nivel kombëtar për përpunimin dhe përdorimin e këtyre pasurive pritet ta lë këtë sektor në plan të dytë.

Me Planin Zhvillimor Komunal 2010-2020+, komuna e Vitisë ka paraparë edhe masat për mbrojtjen e resurseve natyrore, përfshirë edhe pasuritë minerale.

## 2.5.4. Fuqia punëtore, punësimi dhe papunësia

### *2.5.4.1. Popullsia aktive*

Bazuar në të dhënat e regjistrimit të vitit 2011, del se 69 % nga popullsia e përgjithshme janë popullsi mbi moshën 15 vjeç. Sipas këtyre të dhënave në komunën e Vitisë sot ekzistojnë 32.819 banor të moshës së aftë për punë. Sipas statusit të aktivitetit ekonomik, pjesa më e madhe e kësaj popullsie janë ekonomikisht jo aktive. Janë gjithësej 19672 banorë apo rreth 60% ekonomikisht jo aktiv, ndërsa ekonomikisht aktiv janë 13147 banor apo rreth 40% prej tyre. Ajo që mund të theksohet në këtë rast është se shkalla më e ulët e aktivitetit ekonomik është te gjinia femrore dhe kjo është mjaft e theksuar.

### 2.5.4.2. *Veprimtaritë kryesore ekonomike të të punësuarve*

Sa i përket veprimtarive kryesore ekonomike të të punësuarve, në komunën e Vitisë numër më të madh të të punësuarve ka në veprimtaritë tregtare me shumicë dhe pakicë, riparimi i automjeteve motorrike, motoçikletave, artikujve përsonale dhe shtepike me gjithsej 17% të numrit total të të punësuarve. Pastaj kemi angazhimin në prodhim, në ndërtimtari, arsim, bujqësia me degët e saj, administratë etj.. Sa i përket angazhimit të femrave në aktivitetin ekonomik, ato kryesisht janë të angazhuara në shëndetësi, arsim, administrat por me numër më të vogël edhe në veprimtari të tjera. Ndërsa sipas të dhënave të siguruara nga ARBK, Aktivitetet Sherbyese, me 885 punëtorë (47 % e numrit të përgjithshëm të të punësuarve) të regjistruar zënë vendin e parë në klasifikimin e sektorëve ekonomik sipas numrit të të punësuarve. Sektori i Ndërtimtarisë, me 239 punëtorë (12.7 % e numrit të përgjithshëm të të punësuarve) të regjistruar zë vendin e dytë në këtë klasifikim, duke u pasuar nga sektori i Industrisë Përpunuese, I renditur në vendin e tretë me 222 punëtorë (11.7 % e numrit të përgjithshëm të të punësuarve) të regjistruar, sektori i Furnizimit me uje; kanalizimi, menaxhimi me mbeturina dhe aktivitetet rehabilituese, në pozitën e katërt, me 157 punëtorë (8.3 % e numrit të përgjithshëm të të punësuarve) të regjistruar etj..

Më poshtë, përqindja e të punësuarve sipas sektorëve kryesore ekonomik në komunën e Vitisë është krahasuar me gjendjen në komunën e Istogut dhe Skënderajt.

Tabela 27 Përqindja e të punësuarve në komuna tjera

| SEKTORI | VITI | ISTOG | SKËNDERAJ |
|---|---|---|---|
| **% e të punësuarve** | | | |
| **Industri** | 13.55 | 7.6 | 3.0 |
| **Bujqësi** | 11.11 | 12.3 | 2.2 |
| **Ndërtimtari,Tregti dhe Shërbime** | 26.12 | 38.5 | 29.4 |
| **Adm. Publike, Arsim, Shëndetësi, Shër. Soc.** | 26.9 | 40.6 | 47.5 |
| **Të tjerë** | 22.32 | 1 | 17.9 |

### 2.5.4.3. *Papunësia*

Bazuar në rezultatet nga regjistrimi i popullsisë nga viti 2011 del se shkalla e papunësisë në komunën e Vitisë është më e lartë se ajo e Kosovës. Papunësia në këtë komunë është 48%. Popullsia e moshës mbi 15 vjeç në komunën e Vitisë është 32.819 banorë apo rreth 70%. Nga ky numër, popullsi aktive janë 13.147 banorë apo rreth 40%. Numri i të papunëve në këtë komunë është 6.308 persona. Të punësuar janë 6.839 përsona apo rreth 52%. Nëse analizohet shkalla e papunësisë sipas gjinisë në komunën e Vitisë, papunësia është më e theksuar tek gjinia femërore. Shkalla e papunësisë tek gjinia femërore është rreth 65%. Ndërsa tek gjinia mashkullore shkalla e papunësis është 42%. Bazuar në të dhënat për punëkërkuesit sipas statistikave nga Agjencia e Punësimit, në komunën e Vitisë gjatë vitit 2019 kemi të regjistruar 6.584 punëkërkues. Shkalla e lartë e papunësisë ka prekur pothuaj të gjitha grup moshat e popullsisë, por më e theksuar është te grup moshat e e mesme 35 dei 44 vjeç. Papunësia më e lartë është e shprehur tek grup mosha e popullsisë 35-44 vjeç (33.567%). Shkalla e papunësisë zvogëlohet te grup moshat më të vjetra. Me shkallë më të lartë të papunësisë paraqitet popullsia me kualifikime fillore (56.78%), më pas me shkallë të papunësisë pak më të vogël përfaqësohet popullsia me nivel të shkollimit të mesëm (42.87%) dhe me shkallë shumë më të ulët është e përfaqësuar popullsia me nivel të lartë të shkollimit (0.33%).

Më poshtë, përqindja e popullsisë aktive, punësimi dhe shkalla e papunësisë në komunën e Vitisë është krahasuar me gjendjen në komunat e Istogut dhe Skënderajt:

Tabela 28 Papunësia në komunën e Vitisë, Istogut dhe Skenderajt

| SEKTORI | VITI | ISTOG | SKËNDERAJ |
|---|---|---|---|
| | % | % | % |
| Popullsia Aktive | 40 | 40.5 | 22.85 |
| Punësimi | 52 | 55.7 | 43.7 |
| Shkalla e Papunësisë | 48 | 44.3 | 56.3 |

# 2.6. INFRASTRUKTURA TEKNIKE

## 2.6.1. Infrastruktura e Ujësjellësit

### 2.6.1.1. *Uji i pijes*

Në qytetin e Vitisë dhe në disa fshatra ka sisteme të instaluara të ujësjellësve. Në qytetin e Vitisë, 95 % e popullsisë janë të kyçur në rrjetin publik të furnizimit me ujë. Pjesa e vendbanimeve rurale ka një përqindje mjaft të ulët (35 %) sa i përket kyçjes në rrjetin e ujit të pijes. Pjesa tjetër e popullsisë rurale, e mbetur jashtë rrjetit, përdorë ujin e puseve të cekëta dhe të pambrojtura. Pavarësisht se 95 % e popullsisë urbane janë të kyçur në rrjetin publik të furnizimit me ujë, ky sistem nuk është pa probleme. Disa lagje të qytetit, për shkak të kaptazit në Letnicë, përballen me reduktime në furnizim, e të cilat zgadhin deri 8 orë në ditë. Këto reduktime, ndër të tjera vijnë edhe si pasojë e humbjeve të mëdha teknike dhe administrative në sistemin e ujësjellësit. Vendbanimet që furnizohen me ujë janë paraqitur në formë tabelare duke përfshirë kapacitetin e burimeve, numrin e kyçjeve shtëpiake, gjatësinë e tubacioneve, vëllimin e rezervuarit, etj..

Tabela 29 Vendbanimet që furnizohen me ujë

| Nr | Vendbanimet | Rrjetat (m) | Rezervarët ($m^3$) | Burimi me rënje të lirë | Burimi me pompa | Nr. i konsumatoreve | Nr. i Banorëv | Kapaciteti (l/s) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Viti-Ramnishtë | 34.000 | 560 | Po | - | 1.600 | 5465 | **35** |
| 2 | Shashare-Letnicë | 2.658 | 150 | Po | - | 30 | 421 | **10** |
| 3 | Skifteraj | 8.000 | 380 | - | Po | 350 | 2547 | **7.5** |
| 4 | Binçë-Kabash | 15.900 | 260 | Po | - | 520 | 3518 | **11** |
| 5 | Beguncë | 13.700 | 150 | Po | - | 380 | 2174 | **15** |
| 6 | Terpezë | 9.958 | 180 | Po | - | 300 | 1853 | **5** |
| 7 | Pozhoran | 37.000 | 1000 | - | Po | 740 | 4329 | **41** |
| 8 | Zhiti | - | - | - | Po | 0 | 615 | **7** |
| **9** | **Drobesh** | **11.000** | **I perb Viti** | **Po** | | **350** | **1880** | **10** |

Sa i përket ujitjes së tokës bujqësore, përkundër projekteve të planfikuara, për shkak të mos realizimit të tyre, deri më tani vetëm një sipërfaqe minimale është duke u ujitur në mënyrë të organizuar. Momentalisht, pjesa më e madhe e tokës së ujitur ujitet nga sektori privat duke shfrytëzuar puset dhe lumenjët me pompa të thjeshta me kapacitete të ulëta.

### 2.6.1.2. *Burimet e Furnizimit*

Qyteti i Vitisë ka 8000 banorë dhe furnizohet me ujë nga 3 burime. Me rrjedhje direkte të tri kaptimet e ujit shkojnë në fabrikën për trajtimin e ujërave në Letnicë dhe nga aty përmes rezervuarit grumbullues me vëllim V=560m3 (560,000 l) furnizohet pjesa urbane.

Norma e shpenzimit për një banorë në 24 h është n=150 lb/d.

Humbjet në rrjetin kryesore janë 30%, ndërsa në total 50%.

Tabela 30 Kapaciteti i burimit të ujit të pijes dhe lloji i burimit

| Nr. | Emri i Burimit | Koordinatat (X, Y, Z) | Kapaciteti në burim (l/s) | Lloji i burimit |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Burimi Letnicë | 7538244.259; 4682819.770; 672.00 | 13 | Kaptazhë |
| 2 | Pusi 1 Pozharan | 7529449.839; 4690911.395; 487.00 | 1.5 | Pus nëntokesor |
| 3 | Pusi 2 Pozharan | 7529348.489; 4690648.245; 487.00 | 1.5 | Pus nëntokesor |

### 2.6.1.3. *Fabrika për trajtimin e ujit*

Burimi kryesor për furnizim me ujë të pijshëm për qytetin e Vitisë është fabrika për prodhimin e ujit në fshatin Letnicë, e cila daton nga viti 1970 me një kapacitet të vogël për prodhimin e ujit - afërsisht 30 l/s e që i plotësonte nevojat minimale të asaj kohe, ndërsa ne vitin 2002 është bërë një renovim dhe është paisur me nje teknologji moderne elektrike nga donacionet e qeverisë Zvicerane me një vlerë investimi (afërsisht 1.4 milion CHF Zvicrane). Në këtë investim pësuan ndryshime të mëdha ku Fundërruesi, Sistemi i Filtrimit, Sistemi i Dozimit të kemikaleve dhe laboratori tani në çdo moment kontrollon ujin e trajtuar dhe të patrajtuar. Tani kjo fabrikë funksionon në mënyrë automatike dhe me këtë është rritë kualiteti i ujit. Ppërparësi tjetër e FPU-it është se në kohë reale përcillët procesi i përpunimit të ujit nga dhomat komanduese nëpërmes sistemit kompjuterik SCDA-s, ku njëkohësisht bëhet edhe ruajtja e të dhënave në Data Bazë.





Figura 1 Fabrika për prodhimin e ujit në Letnicë

### 2.6.1.4. *Zona urbane – Burimet e ujit të pijes dhe gjendja ekzistuese e furnimit me ujë të pijes*

**Rrjeti Shpërndarës Ekzistues**

Fabrika e ujit në Letnicë, e cila furnizon me ujë të pijes zonën urbane dhe fshatin Ramnishtë karakterizohet me këto specifika:

- Numri I kyçjeve përfshinë 1500 konsumatorë
- Gjatësia e përgjithshme e rrjetit në pjesën urbane me furnizim me ujë të pijshëm është L=53,328m'
- Materialet në sistemin e ujësjellsit janë AC, PE dhe PVC.

Tabela 31 Numri i rezervuarëve

| Nr. | Emri i rezervuarit | Koordinatat (X, Y, Z) | Vëllimi i rezervuarit (m3) | Lloji i Rezervuarit |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Rezervuari Letnicë | 7536912.079; 4685324.040; 584.00 | 360 | Rez. Nëntokësor |
| 2 | Rezevuari Pozheran | 7527978.952; 4694263.768, 489.00 | 1000 | Rez. Mbitokësor |
| Total V: | | | 1360 | |

Tabela 32 Numri i pompave

| Nr. | Emri i stacionit të pompimit | Koordinatat (X, Y, Z) | Fuqia Instaluese (kË) | Nr. i pompave |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Stac. Letnicë | 7536902.129; 4688324.340; 582 | 7.5 | 2 |
| 2 | Stacioni i pompimit Pozheran | 7529191.822, 4690859.986, 489 | 15 | 2 |

Tabela 33 Materiali i tubave

| Nr. | Emertimi | Materiali | Diametri | Njësia matëse | Sasia |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Gypi kryesor prej Letnices deri në qytet | Azbest betoni | 250 | m | 12,000 |
| 2 | Rrjeta kryesore prej burimit deri te vendi i quajtur baqja e popit | Azbest betoni | 160 | m | 5,000 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 3 | Rrjeti kryesor nëpër qyqtet | Azbest çimento | 0.8 | m | 4,700 |
| 4 | Viti 2009-2010 | Gyp plastik | 0.9 | m | 3,300 |
| 5 | | Gyp plastik | 0.63 | m | 9,000 |
| Total | | | | | 34000 m |

### 2.6.1.5. *Zona rurale – Burimet e ujit të pijes dhe gjendja ekzistuese e furnimit me ujë të pijes*

Burimet kryesore të furnizimit me ujë të pijes në fshatrat e Vitisë janë burime nëntokësore të cilat shfrytëzohen përmes puseve me anë të sistemit të pompimit thithës, këto puse ndodhen në zona të caktuara.

**Rrjeti shpërndarës ekzistues**

Fshati Letnicë ka realizuar projektin për sigurimin e ujit të pijshëm këtë vit (2020), ndërsa ky projekt është realizuar në bashkepunim mes komunës së Vitisë me Dorsch/CDI dhe është financuar nga qeveria zvicerane. Menaxhimi i furnizimit me ujë të pijës për këtë fshatë bëhet nga KRU "Hidromorava" në Gjilan. Po ashtu edhe në fshatin Gërmovë në këtë vit (2020) është realizuar rrjeti i ujësjellesit, i cili u siguron të gjithë banorëve qasje në ujë të pijës. Ndërsa vendbanimet që janë në proces të instalimit të rrjetit të ujësjellësit, në vitin 2020, janë të paraqitura në tabelën vijuese:

Tabela 34 Vendbanimet në proces të instalimit të rrjetit të ujësjellësit

| Nr. | Vendbanimi | Burimi dhe kapaciteti (l/s) | Nr. I banorëve | Nr. I shtëpive | Gjatësia (m) |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Sllatin e Epërme | | 2362 | / | 16 254.00 m' |
| 2 | Sllatin e Pshtme | | 1200 | / | 6 854.00 m' |
| 3 | Sadovin e Çerkezve, | | 1286 | / | 8 257.00 m' |
| 4 | Gushica | | 817 | / | Duke u punuar |

Vendbanimet të cilat nuk kanë rrjet të ujësjellsit, mirëpo me planet paraprake është planifikuar ndërtimit i sistemit të ujësjellësit janë paraqitur në tabelën vijuese:

Tabela 35 Vendbanimet të cilat nuk kanë rrjet të ujësjellsit, mirëpo me planet paraprake është planifikuar ndërtimit i sistemit të ujësjellësit

| Nr. | Vendbanimi | Burimi dhe kapaciteti (l/s) | Nr. i banorëve | Nr. i shtëpive | Gjatësia (m) |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Ballanca | | 643 | / | / |
| 2 | Novosella | | 557 | / | / |
| 3 | Ramjani | | 912 | / | / |
| 4 | Çifllak | | 92 | / | Ka ujësjellës |
| 5 | Smira | | 3947 | / | / |
| 6 | Sadovina e Jerlive | | 1122 | / | 2 855.00 m' |
| 7 | Devaja | | 298 | / | / |
| 8 | Tërsteniku | | 784 | / | 9 548.00 m' |
| 9 | Vërbani | | 2047 | / | Duke u punuar |
| 10 | Radivojci | | 1269 | / | / |
| 11 | Drobeshi | | 1880 | / | 9 370.00 m' |
| 12 | Mjak | | 0 | / | / |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 13 | Debëlldeh | | 346 | / | 5.5 km |
| 14 | Buzovik | | 531 | / | / |
| 15 | Lubishtë | | 1473 | / | / |
| 16 | Podgorc | | 386 | / | / |
| 17 | Gjylekar | | 2547 | / | 1 170.00 m' |
| 18 | Vërnez | | 1 | / | / |
| 19 | Vërban | | 2047 | / | Duke u punuar |
| 20 | Vërnakolla | | 13 | / | / |
| 21 | Stublla e epërme | | 1150 | / | Duke u punuar |
| 22 | Godeni I madh | | 82 | / | / |
| 23 | Stublla e poshtme | | 78 | / | / |
| 24 | Remniku | | 1880 | / | / |
| 25 | Budrika e epërme | | 915 | / | / |
| 26 | Letnicë | | 272 | / | Ka ujësjellës |
| 27 | Gërmovë | | 903 | / | Duke u punuar |

Nga të gjitha të dhënat e paraqitura më sipër, rezulton se nga 39 fshatra sa ka komuna e Vitisë:

- 10 fshatra kanë sistem të ujësjellësit;
- 6 fshatra sistemin e ujësjellësit e kanë në ndërtim e sipër ndërsa punimet pritet të përfundojnë gjatë vitit 2021 dhe
- 23 fshatra nuk kanë ende sistem të ujësjellësit




Harta 13 Qasja në rrjetin e ujësjellësit në komunën e Vitisë

Numri i konsumatorëve, materialet ekzistuese të rrjetit ,gjatësia e rrjetit dhe objektet përcjellëse janë si vijon:

- Numri i kyçjeve: 1500 konsumatorë
- Lloji i konsumatorëve: Amvisëri, biznese të vogla, biznese të mëdha, Industri dhe Institucione
- Gjatësia e përgjithshme e rrjetit me furnizim me ujë të pijshëm: L= 53328m' ose L=53.328km;
- Materialet në sistemin e ujësjellësit: Gypa AC, PE dhe PVC
- Numri i pompave: 4
- Numri i rezervuarëve: 2 (me vëllime nga V=1360 m3).

## 2.6.2. Infrastruktura e Kanalizimit

### 2.6.2.1. *Rrjeti ekzistues i ujërave të zeza, atmosferike dhe industriale*

Në komunën e Vitisë, rreth 46% e popullsisë së përgjithshme është e kyçur në sistemin e kanalizimit të ujërave të zeza. Përderisa 94 % e popullsisë e cila jeton në në zonën urbane ka kyçje në sistemin e kanalizimit, gjendja qëndron shumë e rënduar në pjesët rurale të komunës, me vetëm 40 % të popullsisë rurale e cila ka kyçje në sistemin e kanalizimit. Vendbanimet që kanë rrjet të kanalizimit janë paraqitur në tabelën vijuese.

Tabela 36 Vendbanimet që kanë rrjet të kanalizimit

| Vendbanimi | Gjatësia (m) | Vendbanimi | Gjatësia (m) |
|---|---|---|---|
| Begunca | 6 300.00 m' | Sadovinë e Çerkezve | 11 000.00 m' |
| Budriga | 6 301.00 m' | Sadovinë e Jerlive | 2 855.00 m' |
| Çifllaku | 955.00 m' | Sllatinë e Eperme | 16 254.00 m' |
| Drobeshi | 9 370.00 m' | Sllatinë e Poshtme | 6 854.00 m' |
| Gërmova | 5 150.00 m' | Smira | 18 639.00 m' |
| Gushica | 7 200.00 m' | Stubell e Eperme | 13 300.00 m' |
| Kabashi | 11 398.00 m' | Shushte | 700.00 m' |
| Lubishta | 11 575.85 m' | Tërsteniku | 9 548.00 m' |
| Podgorci | 3 500.00 m' | Tërpeza | 16 639.00 m' |
| Radivojci | 5 270.00 m' | Vërbani | 18 800.00 m' |
| Ramjan | 5 633.97 m' | Zhitia | 7 000.00 m' |
| Ramnishta | 1580.00 m' | Shushe- Binçe | 3 200.00 m' |
| Remnik | 13 191.89 m' | | |

Mirëpo, pavarësisht se fshatrat Goshicë, Binqë, Beguncë, Smirë, Stubell, Radivojcë dhe Sadovinë kanë sistem të kanalizimit, gjendja e këtij sistemi nuk është e mirë, madje sistemi është jashtë funksioni. Vendbanimet që kanë pjesërisht rrjet të kanalizmit janë paraqitur në tabelën vijuese.

Tabela 37 Vendbanimet që kanë pjesërisht rrjet të kanalizimit

| Vendbanimi | Gjatësia (m) |
|---|---|
| Binça | 2 500.00 m' |
| Buzoviku | 1 200.00 m' |
| Debelldehu | / |

| | |
|---|---|
| Devaja | 1 050.00 m’ |
| Letnica | / |
| Pozhorani | 31 366.00 m’ |
| Vitia | 7 000.00 m’ |

Ndërsa fshatrat si Ballanca, Goden i Madh, Mjak, Stubell e Poshtme, Vernakolle dhe Vernez nuk kanë fare sistem të kanalizimit.

Përveç kësaj, edhe në vendbanimet ku ekziston rrjeti i kanalizimit, ai nuk trajtohet nga impiantet, për pasojë, ujërat e zeza derdhen në gropa septike dhe në lumin Morava. Gropat septike të hapura në disa lokalitete kanë zbutur gjendjen, por nuk e kanë zgjidhur problemin tërësisht. Në komunën e Vitisë nuk ka asnjë impiant për pastrimin e ujërave të zeza, këto të fundit vazhdojnë të jenë ndër ndotësit kryesorë të lumenjve dhe ujërave nëntokësore, prandaj shtrohet nevoja e ndërtimit të fabrikave për trajtimin dhe pastrimin e tyre. Impiantet për pastrimin e ujërave të ndotura janë planifikuar në nivel regjional nga MMPHI, gjegjësisht IPH-ja, mirpo trajtimi i ujrave të zeza kërkon veprim më urgjent. Në fund të vitit 2009, qendra e qytetit të Vitisë është rregulluar me kanalizim, trotuare, ndriçim dhe asfalt të ri. Mirëpo, kanalizimi është jo funksional dhe me rastin e reshjeve më të vogla të shiut qendra e Vitisë vërshohet nga uji, në disa raste duke hyrë edhe në lokalet përreth. Po ashtu, sistemi i kanalzimit në qytet nuk e bënëë trajtimin e ujërave të zeza, por i derdhë ato direkt në lumin Morava.




Harta 14 Qasja në rrjetin e kanalizimit në komunën e Vitisë

### 2.6.2.2. *Materialet e përdorura*

Më poshtë janë shënuar karakteristikat teknike të sistemit të kanalizimit në komunën e Vitisë:

- Materialet e përdorura në rrjetin e kanalizimit: PVC
- Gjatësia e rrjetit të në pjesën Urbane: L=9600m’ ose L=9.6 km.

### 2.6.3. Infrastruktura e Ujitjes dhe drenazhimit

Tokat bujqësore në komunën e Vitisë nuk kanë shtrirje të sistemit të ujitjes. Kjo paraqitet si sfidë për zhvillimin e bujqësisë në tokat e klasit I-IV dhe sipas mundësive dhe kapaciteteve financiare dhe teknike të komunës do të shqyrtohet planifikimi i shtrirjes së një rrjeti të ujitjes në zonat bujqësore kualitative.

### 2.6.4. Infrastruktura e Energjisë Elektrike

Kosova ka rezerva të mëdha të linjitit si burim primar i energjisë, që mundësojnë një siguri të prodhimit të energjisë elektrike afatgjate, mirëpo mbetet si problem ndikimi në mjedis për shkak të emetimit të gazrave serrë dhe ndotësve tjerë. Po ashtu vendi ynë disponon me potenciale të BRE-ve siç janë: energjia e ujit, energjia e erës, energjia diellore, biomasa, etj. Kapacitetet prodhuese të energjisë elektrike në Kosovë janë kryesisht nga termocentralet të cilat përbëjnë 90.02 % të kapacitetit instalues apo 87.36 % të kapacitetit operativ, dhe pjesa tjetër janë hidrocentrale dhe burimet të ripërtritshme të energjisë (hidrocentrale, centrale me erë dhe panele fotovoltaike). Rrjeti i transmetimit të sistemit elektroenergjetik të Kosovës plotëson nevojat vendore të transmetimit si furnizues e cila mbetet me furnizim radial. Nëpër rrjetin e transmetimit ka rrjedha të konsiderueshme të energjisë për të mbuluar kërkesën e konsumatorëve nga prodhimi vendor dhe importi por edhe për eksportet eventuale të tepricave të energjisë elektrike, e po ashtu edhe për energjinë e cila transitohet nga vendet tjera. Kërkesat për energji dhe plani hapsinor për zhvillim strategjik ndryshon në periudha zhvillimore dhe për shkak të këtij ndryshimi vështirësohet balancimi i sistemit. Për të parë këtë ndikim, sidomos për rastin e sistemit elektroenergjetik të Kosovës, është me rëndësi analiza e diagramit ditor të konsumit për çdo orë të ditës për tërë periudhën vjetore.

Vitia me rrethinën furnizohet nga nënstacioni 220/110 kV/kV Prishtina 4, me linjen transmetuese 110 kV e cila furnizon Komunën e Gjilanit në nënstacionin 110/35 kV/kV, ku e njejta kyçje vazhdon me linjen furnizuese deri në Komunën e Vitis në fshatin Ramnishtë në nënsatcionin 110/35 kV/kV, dhe pastaj nga kjo linjë 110 kV vazhdon për në Sharr.

Rrjeti elektrik i përçuesve ajror dhe kabllor për nivelin e tensionit 10(20)/04 kV/kV i Komunës së Vitisë është i shtrirë në të gjitha vendbanimet e Komunës. Nënstacioni i nivelit 400KV në Sojevë paraqet një mundësi të mirë për furnizim dhe zhvillim të qëndrueshëm energjetik të rrymës elektrike në Komunë e Vitisë duke eliminuar dobësit e vazhdueshme furnizuese me energji elektrike në Komunë.

Në figurën e mëposhtme është paraqitur harta e Kosovës, skema gjeografike dhe skema njëpolare 400/220/110 kV nëpër tërë Kosovën, ashtu si edhe lidhja e Kosovës me vendet fqinje me anë të linjave 400/220 kV, dhe po ashtu, është paraqitur kalimi i linjës 110 kV në rajonin e Vitisë[12].

[12] Njësia e KEK-ut në Viti




Figura 2 Skema njëpolare 400/220/110 kV në hartën gjeografike të Kosovës




Harta 15 Pozicionimi i trafostacionetve dhe linjat 110/35/10 kV në rajonin e Vitisë

Në rajonin e Vitisë, është i instaluar një transformator 110/35 kV me fuqi të instaluar 20 MVA, dhe dy transformator 35/10 kV në punë paralele me fuqi instaluese (8+8)=16 MVA në fshatin Rrafshin të Vitisë, dhe dy transformator 35/10 kV në punë paralele me fuqi instaluese (8 + 8)=16 MVA në Kllokot, dhe gjithsej ekzistojnë 9 dalje të largpërçueseve 10 kV.

Katër dalje të largpërçuesve 10 kV, janë nga trafostacionin 35/10 kV në fshatin Rrafshin të komunës së Vitisë, ndërsa tetë dalje të largpërçuesve 10kV janë nga trafostacionin 35/10 kV në Kllokot.

Gjashtë dalje të largpërçuesve 10 kV nga trafostacionin 35/10 kV në Rrafshin janë: Dalja e Stublles, Gërmovës, Vitisë, Smires, Binqes, Begunces.

Tetë dalje nga trafostacioni 35/10 kV në Kllokot, janë: Dalja e Sllatines, Stacionarit, Kllokot-Skifteraj, Industrialit, VINEX-it, Tërpezës, Jetës, Pozharanit.

Në tabelën 33 është paraqitur gjatësija e linjave 10 kV, fuqia instaluese e daljes furnizuese, numri i transformatorve energjetik dhe numri i konsumatorve për daljen 10(20) kV Rrafshninë.

Tabela 38 Daljet 10-20_ KV për daljen Rrafshinë

| | Gjatesija e Linjes, fuqia, numri I Transformatorve, konsumatorve ne Daljet 10(20) kV-Rrafshinë | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Emri I Daljes 10(20) kV | Gjatsija e linjes | | Seksioni | Fuqia ins. E daljes | Nr. I Trans. | Nr.Konsuma |
| | | km | | mm | MVA | | |
| | | Ajrorë | Kabllovik | | | | |
| 1 | Dalja e Stublles | 23.05 | 0.19 | AlFe (50, 35), XHE 150 | 6.51 | 25 | 1020 |
| 2 | Dalja e Germoves | 15.4 | 2.2 | AlFe (70, 50, 35), XHE 150 | 4.56 | 22 | 1280 |
| 3 | Dalja e Vitise | 4.7 | 4.6 | AlFe (70, 50, 35), XHE 150 | 10.31 | 22 | 2900 |
| 4 | Dalja e Smires | 9.6 | 2.9 | AlFe (70, 50), XHE 150 | 4.3 | 28 | 1400 |
| 5 | Dalja e Binqes | 21.1 | 1.5 | AlFe (35, 25), XHE 150 | 5.04 | 19 | 1130 |
| 6 | Dalja e Begunces | 15.6 | 0.1 | AlFe (50, 35, 25), XHE 150 | 2.5 | 13 | 937 |
| | | | | totale | 33.22 | 129 | 8667 |

Në tabelën 34 është paraqitur gjatësija e linjave 10 kV, fuqia instaluese e daljes furnizuese, numri i transformatorve energjetik dhe numri i konsumatorve për daljen 10(20) kV Kllokot.

Tabela 39 40 Daljet 10(20) kV për daljen Kllokot

| | Gjatësija e Linjës, fuqia, numri i Transformatorve, konsumatorve në Daljet 10(20) kV-Kllokot | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Emri I Daljes 10(20) | Gjatësija e linjës | | Seksioni | Fuqia ins. E | Nr. i | Nr.Kons. |
| | | km | | mm | MVA | | |
| | | Ajrorë | Kabllovik | | | | |
| 1 | Dalja e Sllatines | 20.1 | 0.05 | AlFe (50, 35, 25), XHE 150 | 6 | 27 | 1537 |
| 2 | Dalja e Stacionarit | 1.9 | 1.4 | AlFe (50), XHE 150, XH | 4.35 | 9 | 220 |
| 3 | Dalja e kllokot-Skifteraj | 20.9 | 0.15 | AlFe (70, 35, 35), XHE 150 | 7 | 28 | 1780 |
| 4 | Dalja e Industrijalit | 9.4 | 0.64 | AlFe (35, 50), XHE 150, | 5.22 | 34 | 490 |
| 5 | Dalja e VINEXit | 3.54 | 1.1 | AlFe (50), XHE 150 | 2.15 | 3 | 9 |
| 6 | Dalja e Terpezes | 21.4 | 1.21 | AlFe (35, 25), XHE 150 | 3.46 | 22 | 950 |
| 7 | Dalja e Jetes | 0.56 | 0.1 | AlFe (50), XHE 150 | 0.63 | 1 | 1 |
| 8 | Dalja e Pozheranit | 13.8 | 0.2 | AlFe (70, 35, 35), XHE 150 | 5.28 | 28 | 1520 |
| | | | | Total | 34.09 | 152 | 6507 |

Në tabelën 35 është paraqitur fuqia instaluese e transformatorve energjetik 35/10(20) kV/kV në MVA dhe linja ajror me seksion të përçuesve në mm në fshatin Rrafshninë.

Tabela 40 Fuqia instaluese e transformatorve energjetik 35/10(20) kV/kV në MVA

| | Emri I Daljes 10(20) kV | Gjatësija e linjës | | Seksioni | Fuqia ins. e daljës | Nr. i Trans. | Nr.Konsuma |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | km | | mm | MVA | | |
| | | Ajrorë | Kabllovik | | | | |
| 1 | Rrafshine 110/35/20 | 0 | 0 | | 2(8+8)=16 | 2 | |
| 2 | Kllokot | 0 | 0 | | 2(8+8)=16 | 2 | |

Në tabelën 36 është paraqitur gjatësia e linjes 35 kV me përques ajror dhe nëntokësor në fshatin Rrafshninë-Kllokot.

Tabela 41 Gjatësia e linjes 35 kV me përques ajror dhe nëntokësor

| | Emri I Daljes 10(20) kV | Gjatësia e linjës | | Seksioni | Fuqia ins. e daljës | Nr. i Trans. | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | km | | mm | MVA | | |
| | | Ajrorë | Kabllovik | | | | |
| 1 | Rrafshine- Kllokot | 4.93 | 0 | AlFe(185), XHE 150 | 2(8+8)=16 | 2 | |
| 2 | Kllokot-Llodovë | 11.5 | 0 | AlFe(95), XHE 150 | 2(8+8)=16 | 2 | |

Modeli i rrjetit të distribucionit dhe transmisionit të energjisë elektrike të qytetit të Vitisë me rrethinë 110/35/10 kV, dhe pozicionimi i trafostacioneve 110/35 kV dhe 35/10 kV, është paraqitur në figurën në fig.2. Në rajonin e Vitisë rreth 70% të linjave 10 kV janë me seksion tërthor të vogël (Al/Fe – 25 mm2 dhe 35 mm2) dhe kjo është njëra nga arsyet e shkaktimit të rënieve të mëdha tensionit në rajonin e Vitisë.

Në figurën e më poshtme, janë paraqitur seksionet tërthor të linjave elektrike ajrore të tensionit të mesëm 35/10 kV, dhe pozicionimi i transfostacioneve 110/35 kV dhe 35/10 kV në qytetin dhe rrethinën e Vitisë. (Harta 1. Rrjeti energjetik i Vitisë).

## 2.6.5. Infrastruktura e Telekomunikimit

**Telefonia Fikse** – Rrjeti i telefonisë fikse në komunën e Vitisë është i lidhur nëpërmjet tri formave, si: fibrit optik, teknologjisë me Bakër dhe teknologjisë hibride. Ky rrjet menaxhohet nga njësia e PTK-së, njësia në Viti e cila ka vetëm një objekt postar dhe ka centralin e lidhur me fibër optik. Kapaciteti total i centralit të postës në Vitisë është gjithsej 850 çifte [1] nga fibri optik, 136 nga fibri optik me bakër dhe përmes teknologjisë hibride, por prej të cilave 193 shfrytëzohen, ndërsa pjesa tjetër është e pa shfrytëzuar.

Nga gjithsej 39 vendbanime sa ka komuna administrative e Vitisë, vetëm 13 vendbanime kanë qasje direkt në rrjetën e telefonisë fikse.

Tabela 42 Pjesëmarrja e popullsisë në rrjetin e telefonisë fikse

| Total banorë në komunën e Vitisë | 47,896 banorë |
|---|---|
| Popullsia me qasje në telefoni fikse | 25,085 banorë |
| % e popullsisë me qasje në telefoni fikse | 52.37% |

Nga tabela mund të shohim se rrjeti i telefonisë fikse në komunën e Vitisë është i shtrirë në 33.33% të vendbanimeve me gjithsej 52.37% të popullsisë. Nga kjo mund të konstatojmë se pjesëmarrja e popullsisë

në nivel të komunës nuk është e kënaqshme dhe se ky rrjet mbulon një pjesë të vogël të vendbanimeve, por kryesisht me nr. të madh të popullsisë.

**Telefonia Mobile** – në territorin e Vitisë është e mbuluar mjaftë mirë, të gjitha vendbanimet kanë qasje në shërbimet e telefonisë mobile, të cilat ofrohen nga tre operatorët e licencuar nga ART-ja. Të tre operatorët mobil i kanë të shpërndara antenat individuale në lokacione të ndryshme të komunës. Numri i antenave të vendosura nga operatorët mobil sipas vendbanimeve dhe operatorëve në tërë territorin e komunës është 11.

Shërbimet e Internetit – Ekzistojnë disa operator të cilët bëjnë shpërndarjen e shërbimeve të internetit në komunën e Vitisë. Territori i komunës nuk është i mbuluar plotësisht me shërbime të internetit, kryesisht nuk janë të mbuluara viset malore. Operatorët me ndikim më të madh, që ofrojnë shërbime të internetit janë:

1. PTK - Darda NET, nëpërmjet telefonisë fikse
2. IPKO – ofron shërbime të internetit nëpërmjet të antenave (individuale) dhe
3. KUJTESA - ofron shërbime të internetit nëpërmjet të antenave (individuale)
4. TELKOS

Radiotelevizioni – Rrjeta e Radiotelevizionit në komunën e Vitisë është e shpërndarë pothuajse në tërë territorin e komunës. Në këtë komunë ekzistojnë disa forma të shfrytëzimit të valëve radio-televizive të ndara në dy grupe:

1. Radio-televizionet Nacionale – RTK, RTV21 dhe KTV
2. Radio - lokale –radio Vitii
3. Radio-televizionet nëpërmjet antenave Satelitore.
4. Radio-televizionet nëpërmjet sistemeve kabllore të operatorëve të cilët bëjnë shprendarjen edhe të intenetit.

Tabela 43 Shtrirja e rrjetit të telefonisë fikse në komunën e Vitisë

| Nr. | Vendbanimi | Nr. I popullsisë | Qasja në telefoni fikse | Lloji I centrallës | Antena | Kapaciteti I porteve (çifteve) |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Ballancë | 638 | JO | III | JO | III |
| 2 | Beguncë | 2157 | PO | Teknologji me Baker | PO | 150(çifte) |
| 3 | Binçë | 1139 | PO | Teknologji me Baker | JO | 10(çifte) |
| 4 | Budrikë e | 909 | JO | III | JO | III |
| 5 | Buzovik | 527 | JO | III | PO | III |
| 6 | Çifllak | 91 | JO | III | JO | III |
| 7 | Debelldeh | 343 | JO | III | JO | III |
| 8 | Devajë | 295 | PO | Teknologjime Optikë | PO | 64 |
| 9 | Drobesh | 1864 | PO | Teknologji me Baker | JO | 30 |
| 10 | Gërmovë | 896 | PO | Teknologji me Optikë | JO | 96 |
| 11 | Goden i Madh | 81 | JO | III | JO | III |
| 12 | Gushicë | 810 | JO | III | JO | III |
| 13 | Gjylekar | 2527 | JO | III | JO | III |
| 14 | Kabash | 2350 | PO | Teknologji me Baker | JO | 140(çifte) |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 15 | Letnicë | 270 | JO | III | JO | III |
| 16 | Lubishtë | 1461 | JO | III | JO | III |
| 17 | Mjak | 0 | JO | III | JO | III |
| 18 | Novosellë | 552 | JO | III | JO | III |
| 19 | Podgorc | 383 | PO | Teknologji me Baker | JO | 10 |
| 20 | Pozharan | 4294 | PO | Teknologji me Optikë& | PO | Optikë - 8; Cu - 1192 |
| 21 | Radivojc | 1258 | PO | Teknologji me Baker | PO | 192 |
| 22 | Ramjan | 905 | JO | III | JO | III |
| 23 | Ramnishtë | 443 | PO | Teknologjime Baker | JO | 30( çifte) |
| 24 | Remnik | 1864 | JO | III | JO | III |
| 25 | Sadovinë e | 1276 | JO | III | PO | III |
| 26 | Sadovinë e Jerlive | 1113 | PO | Teknologji me Optikë | JO | 32 |
| 27 | Sllatinë e Epërme | 2343 | JO | III | JO | III |
| 28 | Sllatinë e | 1190 | JO | III | JO | III |
| 29 | Smirë | 3915 | PO | Teknologji me Optikë | PO | 96 |
| 30 | Stubëll e Epërme | 1140 | JO | III | JO | III |
| 31 | Stubëll e Poshtme | 78 | JO | III | JO | III |
| 32 | Shashare | 148 | JO | III | JO | III |
| 33 | Tërpezë | 1838 | JO | III | PO | III |
| 34 | Tërstenik | 778 | JO | III | JO | III |
| 35 | Vërban | 2030 | JO | III | JO | III |
| 36 | Vërnakollë | 13 | JO | III | PO | III |
| 37 | Vërnez | 1 | JO | III | JO | III |
| 38 | Viti | 4978 | PO | Teknologji me Optikë& | PO | Optikë - 128; Cu-1464 |
| 39 | Zhiti | 610 | JO | III | PO | III |

### 2.6.6. Infrastruktura e Menaxhimit te Mbeturinave

Komuna e Vitisë, në kuadër të bashkëpunimit me PPP, ka kontraktuar kompaninë Eco-Higjiena sh.p.k Gjilan – Njësia punuese Viti, e cila ofron shërbimin e menaxhimit të mbeturinave komunale dhe disa shërbime sekondare si: mirëmbajtja e hapësirave publike (të gjelbërta), pastrimi i rrugëve dhe trotuarëve, përderisa pastrimi i zonave të tregut të gjelbërt janë të kontraktuara si sherbime nga operatorë tjerë. Kjo kompani grumbullon dhe transporton mbeturinat e Komunës së Vitisë në Deponinë regjionale të Velekincës. Në grafikët më poshtë është paraqitur sasia e mbeturinave të prodhuara gjatë gjithë muajve të vitit 2018:




Grafika 11 Sasia e mbeturinave të prodhuara gjatë vitit 2018 në Komunën e Vitisë [Burimi: „Eco-Higjena sh.p.k Gjilan Njësia Punuese Viti“

Nga grafiku shohim se sasia më e madhe e mbeturinave të grumbulluara në komunën e Vitisë është në periudhën e muajve të verës, përkatësisht 404.17 tonë në muajin Qershor, 529.35 tonë muajin Korrik dhe 631.88 tonë në muajin Gusht, ndërsa totali vjetor i mbeturinave të prodhuara shkon në 5,106 tonë mbeturina. Kjo kompani kryen faturimin dhe inkasimin e të hyrave nga tarifat e pastrimit nga amvisëritë, bizneset dhe institucioneve publike, të cilat i ka në sistem në sajë të kontratës „në shtëpi“. Sipas të dhënave të komunës, nga 8,369 konsumatorë në territorin e komunës (ekonomi familjare, biznese dhe institucione), vetëm 3,768 prej tyre janë në sistem, ku specifikisht 45% e ekonomive familjare janë në sistem, 39% e bizneseve janë në sistem dhe 100% e institucioneve janë në sistem, siç tregohet edhe në tabelën më poshtë:

Tabela 44 Situata e klientëve në Komunën e Vitisë për shërbimin e menaxhimit të mbeturinave[13]

| Komuna | Klientë gjithsej në zonën kadastrale | | | | Klientë të faturua = shërbyer | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Qyteti/Fshat | Ekonomi familjare | Biznese | Institucione | Gjithsej | Ekonomi familjare | Biznese | Institucione | Gjithësej |
| Viti | 7,520 | 800 | 49 | 8,369 | 3,404 | 315 | 49 | 3,768 |

## 2.7. TRANSPORTI DHE INFRASTRUKTURA E TIJ

### 2.7.1. Infrastruktura Rrugore

Pozita gjeografike dhe relievi i komunës së Vitisë kanë mundësuar një zhvillim të mirë të infrastrukturës rrugore. Kjo komunë ka relativisht lidhje të mira si brenda komunës ashtu edhe me qendrat tjera më të mëdha siç janë: Gjilani, Ferizaji dhe Prishtina. Shumë pranë kësaj komune dhe vet qytetit të Vitisë kalon autostrada që mundëson një lidhje të mirë me gjithë Kosovën dhe rajonin.

Përmes rruges (M25-3), Vitija si qendër e vogël urbane gjindet larg nga autostrada Arbër Xhaferi vetëm 14 km. Në nivel të komunës administrative janë të shtrira gjithsejtë 313.48 km rrugë të të gjitha kategorive. Ky rrjet rrugor mbulon sipëfaqen prej 534.54 ha në gjith territorin e komunës. Në nivel lokal karakterizohet me lidhje shumë të mira të komunikacionit rrugor të cilat ndihmojnë zhvillimin e transportit të udhëtareve dhe të mallrave. Shtrirja e rrugëve Regjionale kryesisht në pjesën qendrore dhe perëndimore të komunës ia ka shtuar rëndësinë kësaj hapësirë.

[13] Kompania "Eco-Higjiena sh.p.k Gjilan, Njësia Operative Viti

Në komunën e Vitisë ekzistojn katër kategori të rrugëve (të klasifikuara në Kosovë), duke filluar prej rrugëve magjistrale e deri tek ato të pa kategorizuara. Rrjeti rrugor përbehet nga:

- Rrugë regjionale - M25-3 Gjilanë – Ferizaj
- Rrugë urbane – brenda qytetit të Vitisë
- Rrugë publike (rrugët të cilat i lidhin 38 komuna kadastrale, duke përfshire edhe rrugët që lidhin lagjet më të rëndësishme të vendbanimeve)
- Rrugë qasëse (të cilat lidhin lagjet e fshatit si dhe i lidhin të gjitha hapësirat në të cilat zhvillohen aktivitete socio-ekonomike).

Nga totali i përgjithshëm i rrugëve bazuar në shtrirjen hapësinore pjesëmarrje më të madhe kanë rrugët lokale me 135 km (43.06%), pastaj rrugë lokale me 133.5 km (42.59%), rrugë urbane 30.88 km (9.85%) dhe rrugë regjionale 14.1 km (4.5%).




Grafika 12 Sipërfaqja në ha dhe gjatësia e rrugëve në km sipas kategorive në komunën e Vitisë

Tabela 45 Sipërfaqja në ha e rrugëve sipas kategorive në komunën e Vitisë

| Nr | Përshkrimi | Gjatësia Km | % | Sip në ha me rrugë/nivel komune | % | Gjendja |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Rrugë regjionale | 14.1 | 4.50 | 8.46 | 1.58 | Asfalt |
| 2 | Rrugë lokale | 133.5 | 42.59 | 320.08 | 59.88 | Asfalt |
| 3 | Rrugë urbane | 30.88 | 9.85 | 25 | 4.68 | Asfalt |
| 4 | Rrugë qasëse | 135 | 43.06 | 181 | 33.86 | Pa asfalt |
| **Total** | | **313.48** | **100.00** | **534.54** | **100.00** | |
| **Siperfaqja e Komunës** | | | | 26989.60 | | |
| **Rrugë regjionale** | | | | 0.03 | | |
| **Rrugë lokale** | | | | 1.19 | | |
| **Rrugë urbane** | | | | 0.09 | | |
| **Rrugë qasëse** | | | | 0.67 | | |
| **Sipërfaqja e mbuluar me rrugë në nivel komune (%)** | | | | 1.98 | | |

Duke iu referuar ortofotove (v.2018) dhe analizave të bëra në nivel të komunës, janë nxjerr edhe sipërfaqet e mbuluara me rrugë dhe aktivitete të tjera përcjellëse sipas kategorisë së tyre. Në nivel komune vlerësohet se rrugët mbulojnë rreth 1.98% të sipërfaqës. Pjesëmarrje më të madhe kanë rrugët lokale me 320.08 hektar (59.88%), tlokalet zën 181 ha (33.86%), rrugët urbane me 25 ha (4.68%) dhe rrugë regjionale 4.5 ha (1.58%). Rrugët e kategorisë së katërt (të pa kategorizuara) nuk janë të asfaltuara dhe kanë shtrirje kryesisht në zonat periferike të komunës.

Nga gjithësejt 39 vendbanime të komunës, Vitia përfaqëson kategorinë e rrugëve urbane, dhe pesë vendbanime tjera kanë qasje në kategorinë e rrugëve regjionale, ndërsa të tjerat kanë rrugë lokale.

Numri i banorëve që lidhen me rrugën regjionale dhe kanë qasje direkt në të është 7918/b, ose 16.67% e totalit të popullsisë së komunës d.m.th. se vetem një pjesë e vogël e popullsisë kanë qasje në këtë kategori të rrugëve. Kjo nga fakti se vetëm vendbanimi i Pozharanit (si i dyti me numër të popullsisë në nivel komune) klasifikohet si vendbanim me qasje në këtë kategori të rrugëve.

Tabela 46 Numri i banorëve me qasje direkt në rrugët sipas kategorive dhe të asfaltuara

| Nr. | Vendbanimi | Nr. i popullsisë 2020 | Qasje | Gjendja |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Ballancë | 643 | Lokale | Asfalt |
| 2 | Beguncë | 2157 | Lokale | Asfalt |
| 3 | Binçë | 1149 | Lokale | Asfalt |
| 4 | Budrikë e Epërme | 915 | Magjistrale | Asfalt |
| 5 | Buzovik | 531 | Lokale | Asfalt |
| 6 | Çifllak | 92 | Lokale | Asfalt |
| 7 | Debelldeh | 346 | Lokale | Asfalt |
| 8 | Devajë | 298 | Lokale | Asfalt |
| 9 | Drobesh | 1880 | Lokale | Asfalt |
| 10 | Gërmovë | 903 | Lokale | Asfalt |
| 11 | Goden i Madh | 82 | Lokale | Asfalt |
| 12 | Gushicë | 817 | Lokale | Asfalt |
| 13 | Gjylekar | 2547 | Lokale | Asfalt |
| 14 | Kabash | 2369 | Lokale | Asfalt |
| 15 | Letnicë | 272 | Lokale | Asfalt |
| 16 | Lubishtë | 1473 | Lokale | Asfalt |
| 17 | Mjak | 0 | Lokale | Asfalt |
| 18 | Novosellë | 557 | Magjistrale | Asfalt |
| 19 | Podgorc | 386 | Lokale | Asfalt |
| 20 | Pozharan | 4329 | Magjistrale | Asfalt |
| 21 | Radivojc | 1269 | Magjistrale | Asfalt |
| 22 | Ramjan | 912 | Magjistrale | Asfalt |
| 23 | Ramnishtë | 446 | Lokale | Asfalt |
| 24 | Remnik | 1880 | Lokale | Asfalt |
| 25 | Sadovinë e Çerkezve | 1286 | Lokale | Asfalt |
| 26 | Sadovinë e Jerlive | 1122 | Lokale | Asfalt |
| 27 | Sllatinë e Epërme | 2362 | Lokale | Asfalt |
| 28 | Sllatinë e Poshtme | 1200 | Lokale | Asfalt |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 29 | Smirë | 3947 | Lokale | Asfalt |
| 30 | Stubëll e Epërme | 1150 | Lokale | Asfalt |
| 31 | Stubëll e Poshtme | 78 | Lokale | Asfalt |
| 32 | Shashare | 149 | Lokale | Asfalt |
| 33 | Tërpezë | 1853 | Lokale | Asfalt |
| 34 | Tërstenik | 784 | Lokale | Asfalt |
| 35 | Vërban | 2047 | Lokale | Asfalt |
| 36 | Vërnakollë | 13 | Lokale | Asfalt |
| 37 | Vërnez | 1 | Lokale | Asfalt |
| 38 | Viti | 5019 | Urbane | Asfalt |
| 39 | Zhiti | 615 | Lokale | Asfalt |
| **Total** | | **47896** | | |

**Rrugë urbane –** konsiderohen rrugët të cilat i lidhin lagjet brenda zonës urbane, dhe janë në gjendje shumë të mirë.

**Rrugë lokale –** konsiderohen rrugët të cilat i lidhin të gjitha vendbanimet e komunës duke u nisur nga qendra e vendbanimit dhe rrugët e tjera të rëndësishme, të cilat mundësojnë lidhje të mira ndërmjet qendres adminsitaive dhe vendbanimeve, përfshirë këtu edhe rrugët brenda lagjës së vendbanimit. Të tilla janë rrugët që lidhin vendbanimet e 38 fshatave të komunës, me gjatësi prej 114 km ose 38.3% nga totali i përgjithshëm i rrugëve.

**Rrugë qasëse** - konsiderohen të gjitha sipërfaqet të cilat shfrytëzohen për realizimin e aktiviteteve bujqësore, socio-ekonomike dhe të tjera si në brendësi të vendbanimeve, po ashtu edhe në sipërfaqet e tjera të komunave kadastrale. Kjo kategori e rrugëve nuk është e asfaltuar, mirëpo rrugët të cilat shfrytëzohen për lidhjen hapësirave në brendësi të vendbanimeve, si dhe ato të cilat i lidhin vendbanimeve në thellësi të komunës, përkatësisht të viseve malore janë të shtruara me rërë dhe zhavorr. Ndërsa rrugët e tjera të kësaj kategorie janë rrugë të cilat shfrytëzohen për aktivitete bujqësore.

**Gjendja e rrugëve në komunën e Vitisë -** nga të gjitha rrugët të cilat e përbëjnë rrjetin e rrugëve të komunës me gjatësi prej 297.6 km, rrugë magjistrale janë 6.2 km (2.1 %), rrugë regjionale 64.3 km (21.6%), rrugë lokale 114 km ose (38.3%) dhe rrugë qasëse 82.5 km (27.7%). Dy kategoritë e para të rrjetit të rrugëve janë të asfaltuara dhe mirëmbahen nga MTPTK. Gjatësia e rrugëve të asfaltuara të këtyre dy kategorive në komunën e Vitisë është 70.5 km ose 23.7% . Ndërsa rrugët lokale të komunës të cilat kanë shtrirje prej 114 km (38.3%) vetëm 49.3 km (43.2%)[14] e tyre janë të asfaltuara. Rrugët e kategorisë së katërt (të pa kategorizuara) nuk janë të asfaltuara dhe kanë shtrirje prej 82.5 km (27.7%). Tabela në vijim do të paraqet statusin e rrugëve sipas kategorisë.

[14] Të dhënat janë digjitalizuar nga ortofotot 2004 (Agjensia Kadastrale e Kosovës)




Harta 16 Infrastruktura Rrugore

#### 2.7.1.1. *Urat*

Të gjitha urat e identifikuar në territorin e komunës së Vitisë, i takojnë kategorisë së komunikacionit rrugor, varësishtë nga kategoria e rrugëve ku janë të vendosura. Nga gjithësejt 58 ura sa ka në territorin e komunës, vetëm 12.07% janë të ndërtuara në rrugë regjionale, rrugë urbane 8.62%, rrugë lokale 44.83% dhe në rrugë të pakategorizuara janë 34.48%. Është me rendësi të përmendim se 5 prej tyre kan funkësion të mbikalimit për qytetar.

**Urat në rrugë regjionale –** janë ndërtuara mbi shtratin e prrockave dhe mundësojnë rrjedhjen e ujrave nga pjesa veriore në drejtim të lumit Morava e Binqës. Konfiguracioni i terrenit ka imponuar që në gjithsej 14.1 km rrugë rajonale në komunën e Vitisë të ndërtohen 7 ura të rëndësishme për qarkullim në këtë kategori të rrugëve. Ato prekin zonat kadastale Ramjan i Poshtëm 1 (gjatësi 14m, gjërësi 13 m), Pozharan 1, (gjatësi 10m e gjërësi 13m), Radivojc 3 (gjatësi 4m e gjërësi 10m), Budrigë e Epërme 1 (gjatësi 5m e gjërësi 10m). I bie që afërsisht në 2 km është e ndërtuar një urë.

Urat kryesore janë të ndërtuara mbi lumin Moava e Bines, kanë gjatësi minimale 6 dhe maksimale deri 30m, ndërsa gjërësi prej 1 deri 7m. Ato që shtrihen në rrugë lokale kanë gjatësi minimale 2 dhe maksimale deri 85m, ndërsa gjërësi prej 4 deri 27m. Në rrugë të pakategorizuara janë të ndërtuara gjithësejtë 20 ura, me gjatësi minimale 2m dhe gjatësi maksimale deri 17m, ndërsa gjërësi prej 7 deri 11m., kanë gjatësi prej 4 deri 40m.

**Urat në rrugë urbane –** janë ndërtuara mbi shtratin e lumit Morava e Binqës, kryesisht pjesë e zonës kadastrale Viti. Janë të ndërtuara 5 ura, me gjatësi min. 17 deri 36 metër dhe gjerësi nga 4 deri 85 metë.

Në përgjithësi janë në gjendje të mirë, por rreth 30 % e tyre kanë nevojë për renovim dhe mirëmbajtje sipas standarde ndërtimore.

Tabela 47 Urat sipas kategorisë së rrugëve

| Pershkimi | Nr. i urave | % | Gjatësi min.(m) | Gjatësi max. (m) | Gjerësi min. (m) | Gjerësi max. (m) |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Ura në rrugë regjionale | 7 | 12.07 | 4 | 12 | 7 | 11 |
| Rrugë qasëse | 20 | 34.48 | 2 | 17 | 1 | 7 |
| Rrugë Lokale | 26 | 44.83 | 2 | 85 | 4 | 27 |
| Rrugë Urbane | 5 | 8.62 | 17 | 36 | 4 | 85 |
| Total | 58 | 100.00 | 25 | 150 | 16 | 130 |

## 2.7.2. Transporti Publik

Shtrirja e vendbanimeve në distanca relativisht të mëdhë për nivelin lokal, ka bërë që transporti publik të jetë i rendësishëm për qarkullimin e qytetarëve dhe mallrave. Vendbanimet nga qendra urbane e Vitisë shtrihen në largëësi të ndrushme dhe shkojn deri 15.2 km (Mjak), ndërsa vendbanimi më i afërtë është Dobreshi me 2.3 km. Distanca mesatare është 8.5km. Janë gjithësejt 8 operator që e mundësojnë transpotin në territorin e komunës. Është e rendësishme të përmendet se përveq linjave lokale, kemi edhe një linjë regjionale me qytetin e Gjilani (19.8km) dhe një ndërkombëtare me qytetin e Shkupit (56.7km). Stacioni i autobusëve si piknisje për qarkullim lokal, regjional e ndërkombëtar është i vendosur në zonën urbane.

Tabela në vijim paraqet vendbanimet të cilat nuk kanë qasje në transportin publik, dhe atyre që kanë sipas numrit të banorëve.

Tabela 48 Vendbanimet pa qasje në transportin publik

| Nr | Vendbanimi | Nr. i pop. Qasje | Drejtimi | Distanca/km |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Ballancë | 643 | Viti - Bllacë | 10.4 |
| 2 | Beguncë | 2157 | | 4.6 |
| 3 | Binçë | 1149 | | 3.6 |
| 4 | Budrikë e Epërme | 915 | Viti-Remnik | 10.2 |
| 5 | Buzovik | 531 | | 6.4 |
| 6 | Çifllak | 92 | | 7.2 |
| 7 | Debelldeh | 346 | | 11.1 |
| 8 | Devajë | 298 | Devajë - Viti | 10 |
| 9 | Drobesh | 1880 | Smirë - Viti - Remnik i Ri | 2.3 |
| 10 | Gërmovë | 903 | Verban - Viti - Remniku i ri | 3.7 |
| 11 | Goden i Madh | 82 | | 13 |
| 12 | Gushicë | 817 | Gushicë - Viti | 6.9 |
| 13 | Gjylekar | 2547 | Gjylekar - Viti | 8.7 |
| 14 | Kabash | 2369 | | 2.8 |
| 15 | Letnicë | 272 | | 12.4 |
| 16 | Lubishtë | 1473 | | 8.5 |
| 17 | Mjak | 0 | | 15.1 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **18** | Novosellë | 557 | Sudovinë - Viti | 9 |
| **19** | Podgorc | 386 | | 6.8 |
| **20** | Pozharan | 4329 | Terstenik - Viti & Sudovinë - Viti | 6.2 |
| **21** | Radivojc | 1269 | Devajë – Viti - Remnik | 8 |
| **22** | Ramjan | 912 | Sudovinë Ç - Viti | 9.6 |
| **23** | Ramnishtë | 446 | Gjylekar - Viti | 3.4 |
| **24** | Remnik | 1880 | Viti - Remnik - Remnik i ri- Viti | 14 |
| **25** | Sadovinë e Çerkezve | 1286 | Terstenik - Viti - Sudovine e Ç. | 9 |
| **26** | Sadovinë e Jerlive | 1122 | Sudovine e Ç.- Viti - Verban - Remnik i Ri - Viti | 5.5 |
| **27** | Sllatinë e Epërme | 2362 | Terstenik - Viti - Sudovine e Ç. | 10.6 |
| **28** | Sllatinë e Poshtme | 1200 | Terstenik - Viti | 9.4 |
| **29** | Smirë | 3947 | Smirë – Viti - Remniku i Ri | 5.1 |
| **30** | Stubëll e Epërme | 1150 | | 11.8 |
| **31** | Stubëll e Poshtme | 78 | | 13.3 |
| **32** | Shashare | 149 | | 9 |
| **33** | Tërpezë | 1853 | Viti - Tërpezë | 9.2 |
| **34** | Tërstenik | 784 | Terstenik - Viti | 10 |
| **35** | Vërban | 2047 | Gjylekar - Viti | 8.7 |
| **36** | Vërnakollë | 13 | | 14.1 |
| **37** | Vërnez | 1 | | 14.5 |
| **38** | Viti | 5019 | | 0 |
| **39** | Zhiti | 615 | Viti - Ballancë | 9.4 |
| **Popullsia** | | **47896** | Distanca mesatare | 8.55 km |

Transporti publik organizohet nëpërmjet autobusëve duke siguruar që mbi 78% e qytetarëve të kenë qasje në transport publik. Shikuar nga numri i vendbanimeve që kanë transport publik, nga 39 vendbanime sa ka komuna e Vitisë 23 prej tyre kanë qasje në transport publik nëpërmjet të autobusëve, dhe 16 vendbanime nuk kanë transport publik.

Nga grafiku mund të vërejmë së transporti publik në komunën e Vitisë është mirë i organizuar, pejashtuar vendbanimet në periferi. Të gjitha vendbanimet të cilat shtrihen në pjesën më të frekuentuar të komunës kanë qasje në transport publik nëpërmjet të autobusëve dhe kombi-busve, ndërsa pa transport publik janë të gjitha ato vendbanime të cilat janë në zona të thella të komunës, ku përthyeshmëria e relievit është mjaft e madhe, si dhe numri i popullsisë së atyre vendbanimeve është i vogël.




Grafika 13 Pjesëmarrja e popullsisë në transport publik

## 2.8. INFRASTRUKTURA PUBLIKE DHE SOCIALE

### 2.8.1. Administrata Publike

Në tabelë janë dhënë institucionet e administrates dhe kapacitetet hapësinore. Janë identifikuar institucionet, përkatësisht objektet përcjellëse të tyre, që shtrihen në kuadër të territorit të Komunës së Vitisë.

Tabela 49 Infrastruktura e administrates

| Institucionet administrative | Vendbanimi | Sip. e parcelës (ha) | Sip. e parcelës $m^2$ | Nr. i katëve |
|---|---|---|---|---|
| Objekti i komunës së re | Viti | 0.54217 | 5421.7 | |
| Objekti i komunës së vjetër | Viti | 0.29489 | 2948.9 | |
| Objekti i kryetarit të komunës | Viti | 0.14112 | 1411.2 | |
| Agjencia e Regjistrimit Civil dhe muzeu i komunes | Viti | 0.14112 | 1411.2 | |
| Gjykata Themelore, Dega ne Viti dhe Stacioni policor | Viti | 0.22549 | 2254.9 | |
| Objekti i ish Drejtorise se Arsimit | Viti | 0.11631 | 1163.1 | |
| Objekti i Ri i Zjarrefikseve | Viti | 0.44986 | 4498.6 | |
| Objekti i vjeter i zjarrfikseve | Viti | 0.66378 | 6637.8 | |
| Qendra per Pune dhe Mireqenie Sociale | Viti | 1.29052 | 12905.2 | |
| Gjithsej | | 3.86526 | 38652.6 | |

## 2.8.2. Institucionet Arsimore

Struktura organizative e sistemit arsimor në komunën e Vitisë është e organizuar në katër nivele: arsimin parashkollor (5 - 6 vjeçar), arsimin fillor (I – V), arsimin e mesëm të ulët (VI – IX) dhe arsimin e mesëm të lartë (X – XII). Numri i objekteve të shkollave fillore të mesme të ulëta gjithsejtë është 35. Kemi edhe 3 objekte shkollore të shkollave të mesme dhe dy çerdhe. Nga të gjitha shkollat fillore 17 prej tyre janë amë dhe 18 të tjera janë satelite (paralele të ndara). Në procesin edukativo-arsimor janë të angazhuar gjithësej 813 punëtor. Prej tyre 705 mësimdhënës, 32 punëtorë administrativ dhe 76 punëtor teknik. Numri i nxënësve gjithsejtë është 8403, çka do të thotë se kemi 11.92 nxënës /mësimdhënës.

**Çerdhe dhe kopshte –** Komuna e Vitisë posedon dy çerdhe. Kemi çrdhën "Gëzimi Ynë" në Viti për fëmijë të moshës nën 5 vjet, me kushte solide. Kjo çerdhe ka 100 nxënë ku janë të angazhuar 8 mësimdhënës, 2 punëtor administrativ dhe 5 punëtor teknik. Ka një hapësirë prej 520 $m^2$ dhe oborrin me një hapësirë prej $2800^2$. Sipas këtyre shënimeve del se në këtë çerdhe kemi 5.2 $m^2$ hapësirë shkollore për nxënës si dhe mesatarisht 12.5 nxënës për mësimdhënës.

Kemi edhe një çerdhe private „Hello" me 70 fëmijë dhe me haëpsirë të brendshme 150 m2, ndërësa hapësirë të jashtme nuk ka.

**Arsimi fillor dhe i mesëm i ulët (i obliguar) -** në tërë territorin e komunës mësimi fillor dhe i mesëm i ulët zhvillohet në 35 objekte shkollore, mësimet i ndjekin 6441 nxënës. Mesatarisht rreth 2.12 $m^2$ hapësirë e brendshme shkollore i takojnë një nxënësi ne këtë nivel. Me hapësirë shkollore më të vogël për kokë nxënësi na paraqiten shkollat në këto vendbanime: Drobesh (1.58 m2 për nxënës), Smir (1.8 m2 për nxënës), Ramnisht ( 2.1 për nxënës së shkollës fillore), Viti (2.9 mm2 për nxënës).




Grafika 14 Mesatarja e hapësirës shkollore për kokë nxënësi sipas shkollave




Harta 17 Shtrirja hapësinore e Objekteve shkollore në komunën e Vitisë

Raporti nxënës/mësimdhënës në këto hapësira shkollore sillet rreth 12 nxënës mesatarja për 1 mësimdhënës me dallime të theksuara nga njëra shkollë në tjetrën.

Arsimi i mesëm i lartë - përfshin tri vite të shkollimit për nxënësit e grup-moshës 15 deri 18 vjeç. Në këtë komunë janë tri shkolla të mesme: Gjimnazi "Kuvendi i Lexhës" dhe Shkolla e Mesme profesionale "Januz Zejnullahu" në Viti si dhe shkolla e Mesme mikse "Kongresi i Manastirit" në Pozheran. Në këto shkolla numri i nxënësve që i ndjekin mësimet është 1862 nxënës, me një kuadër të mësimdhënësve prej 160 që janë të angazhuar në procesin edukativo-arsimor. Rreth 5.4 $m^2$ hapësirë e brendshme shkollore i takojnë një nxënësi. Ndërsa, raporti nxënës/1mësimdhënës në shkollat e mesme është 11.6 nxënës për 1 mësimdhënës.

### 2.8.3. Institucionet Shëndetësore

Në komunën e Vitisë shëndetësia është e organizuar në sektorin publik, ku ofrohen shërbime të nivelit parësor, dhe në sektorin privat i cili ofron shërbime parësore të lëmive të specializuara mjekësore. Në sektorin publik, kujdesi shëndetësor është i organizuar në 12 institucione shëndetësore të mjekësisë familjare:

- Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në qytetin e Vitisë;
- 1 Qendër e Mjekësisë Familjare në Pozheran;
- 10 ambulanca të Mjekësisë familjare të organizuara në vendbanimet: Beguncë, Gjylekar, Letincë, Remnik, Sadovinë e Jerlive, Sllatinë e Epërme, Smirë, Stubëll e Epërme, Tërpezë dhe Zhiti.

- Ekzistojnë edhe dy ambulanca të tjera në fashtrat Remnik dhe Zhiti por ato nuk janë funksionale.

Tabela 50 Objektet shëndetësore në komunën e Vitisë

| | Numri | Mjek të përgjithshëm | Teknik | Sipërf. Oborrit(ha) | Sipërf. Ndërtuar (m2) |
|---|---|---|---|---|---|
| QKMF | 1 | 16 | 65 | 0.99 | 2761 |
| QMF | 1 | 6 | 14 | 0.3 | 852 |
| AMF | 10 | 1 | 7 | 7.62 | 1743.86 |

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) në Viti, si bartëse  e kujdesit primarë, është e vendosur në qytetin e Vitisë dhe gjendja e objektit është jo aq e mirë. Kjo qendër mbulon me shërbime territorin e Vitisë me të gjitha vendbanimet. Në këtë institucion janë të punësuar gjithsej 81 punonjës, prej tyre 16 mjek që kanë bazë kualifikuese fakultetin dhe specializime në fusha të caktuara. Punojnë poashtu edhe 65 infermier dhe teknik. Në këtë qendër puna është e organizuar në dy ndërrime, derisa emergjenca ofron shërbime 24 orëshe.

Qendra e Mjekësisë Familjare në Pozheran ka objektin në gjendje relativisht të mirë. Në këtë qendër punojnë 6 mjek dhe 14 infermiere. Mjekët janë të gjithë me fakultet dhe infermierët me shkollim përkatës. Në këtë qendër gravitojnë vendbanimet: Pozheran, Tërpezë, Sllatinë e Poshtme, Ramjan, Novosellë, Ballancë, Radivojc dhe Zhiti. Këtu ofrohen shërbimin shëndetësore për 12,053 banorë ose 23.75 % të popullatës së komunës.




Harta 18 Shtrirja e objekteve shëndetësore në komunën e Vitisë

Dhjetë ambulanca në fshatrat: Beguncë, Gjylekar, Letincë, Remnik, Sadovinë e Jerlive, Sllatinë e Epërme, Smirë, Stubëll e Epërme, Tërpezë dhe Zhiti, ofrojnë shërbime parësore mjekësore për 18,987 banorë ose 37.4 % të popullsisë së përgjithshme të komunës. Në këto ambulanca nuk ka mjek që punon me orar të plotë pos në Sllatinë të Epërme, por sherbimet me orar të plotë kryhen nga infermierët e ambulancave.

Në të gjitha këto institucione shëndetësore në sektorin publik janë të punësuar gjithsej 109 punonjës, 23 mjek dhe 86 infermier. Kryesisht është i mbuluar i gjithë territori i komunës me shërbime shëndetësore. Gjithashtu në këtë komunë shërbimet shëndetësore kryhen edhe në sektorin privat. Ekzistojnë disa ordinanca specialistike që ofrojnë shërbime shëndetësore si dhe rreth 13 farmaci.

### 2.8.4. Institucionet e Mirëqenies Sociale

Për problemet e shumta sociale në Komunën e Vitisë kryesisht përkujdeset Qendra për Punë Sociale që vepron në kuadër të MPMS. Ndërsa në kuadër të Kuvendit Komunal rreth çështjeve sociale përkujdeset Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale. QPS merret me: Mbrojtjen Sociale të Fëmijëve dhe Rinisë Përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijëve pa kujdes prindëror Mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve me nevoja të veçanta dhe atyre me sjellje të çrregulluara Mbrojtjen sociale të të rriturve me gjendje të nevojës sociale.

Tabela 51 Mirëqenia Sociale në komunën e Vitisë

| Kategoria | Periudhat tremujore gjatë vitit 2020 | | | |
|---|---|---|---|---|
| | TM1 | TM2 | TM3 | TM4 |
| Nr. Familjeve | 442 | 458 | 470 | 497 |
| Nr. Anëtarëve | 1962 | 2030 | 2075 | 2175 |
| Pensionet bazike të moshës | 3831 | 3959 | 3964 | 3964 |
| Pensionet kontribut paguese të moshës | 599 | 613 | 612 | 608 |
| Pensinoet e përsonave me aftësi të kufizuara | 345 | 461 | 456 | 480 |
| Familjet me fëmijë me aftësi të kufizuara | 46 | 46 | 44 | 45 |
| Pensionet familjare | 46 | 46 | 48 | 50 |
| Pensionet paraplegjike dhe tetraplegjike | 72 | 72 | 67 | 62 |
| Skema për kompensimin e punonjësve të arsimit për vitet 90/91 deri në vitin 98/99 | 261 | 267 | 272 | 276 |
| Pensionet për familjet e dëshmorëve dhe invalidëve të luftës | 93 | 94 | 94 | 92 |
| Pensionet e veteranëve të luftës | 314 | 315 | 315 | 320 |
| Pensionet për trupat mbrojtëse të Kosovës | 11 | 12 | 12 | 13 |
| Pensionet për forcat e sigurisë së Kosovës | 6 | 6 | 6 | 6 |
| Kompensimet për përsonat e verbër | 59 | 60 | 60 | 58 |
| Numri i fëmjëve të braktisur | 0 | 0 | 1 | 0 |

### 2.8.5. Institucionet Kulturore dhe sportive

#### 2.8.5.1. *Kultura*

Kultura tregon të kaluarën dhe të tashmen e një populli. Në komunën e Vitisë zhvillimet kulturore kanë zënë vend qe një kohë të gjatë. Sot në këtë komunë ekzistojnë 11 klube kulturore-artistike që zhvillojn aktivitetet e tyre në fusha të ndryshme të artit dhe kulturës. Këto klube gjenden në këto vendbanime të komunës së Vitisë: 1 në Pozheran, 1 në Smirë, 1 në Stubëll e Epërme dhe 8 në Viti. Në tri vendbanime të komunës së Vitisë gjenden biblotekat dhe atë në Pozheran, Sllatinë e Epërme dhe Viti. Në biblotekën e Pozheranit kemi 3003 libra dhe 10984 ekzemplar me një numër të lexuesve rreth 257. Në biblotekën e Sllatinës së Epërme kemi 2773 libra dhe 3687 ekzemplar me një numër të lexuesve rreth 186. Në Viti kemi 11948 libra, 50062 ekzemplar dhe numri i lexuesve është rreth 1042. Në këtë komunë ekzisojnë edhe dy shkolla muze në vendbanimet Pozheran dhe Stubëll e Epërme.

### *2.8.5.2.**Rinia***

Rinia paraqet grup moshën më të madhe të popullsisë në këtë komunë, njëjtë si në nivel të Kosovës. Rreth 57% e popullsisë së përgjithshme e përfaqëson rinia nën moshën 30 vjeç. Në këtë komunë mund të thuhet se kushtet për zhvillimin e aktiviteteve rinore janë relativisht të mira. Aktivitetet rinore zhvillohen në 7 fusha sportivemtë hapura dhe 10 fusha spotive të mbuluar. Këto fusha sportive gjenden në këto vendbanime të komunës: Në Beguncë një fushë e hapur, në Budrikë e Epërme 1 fushë e mbuluar, në Dobroshë një fushë e mbuluar, në Kabash një fushë e hapur, në Novosellë një fushë e mbuluar, në Pozheran janë dy fusha të mbuluara dhe një e hapur, në Ramjan një e hapur, në Ramnishtë një e mbyllur, në Sadovinë e çerkezve një e mbyllur, në Sadovinë e Jerlive 2 të hapura, në Stubëll e Epërme 1 e mbyllur, dhe në Viti 2 fusha të mbyllura dhe një e hapur.

### *2.8.5.3.**Sporti***

Një ndër lëmit më të preferuar nga të gjitha shtresat e shoqërisë është sporti. Sporti në komunën e Vitisë zhvillohet në mënyrë ekipore dhe individuale. Në këtë komunë zhvillohen lëmi të ndryshme të sportit si: futboll, hendboll, basketboll, shah etj. Në këtë komunë aktivitetet e veta i zhvillojnë 17 klube sportive. Vetëm në Viti ekzistojnë 14 klube sportive dhe gjithashtu kemi edhe dy klube në Pozheran dhe një klub sportiv në vendbanimin Sadovinë e Jerlive.




<u>Harta 19 Institucionet Publike dhe Sociale në Komunën e Vitisë</u>

## 2.8.6. Hapësirat e Gjelbërta dhe Parqet publike

Sot qytetet dhe lagjet e reja që po ndërtohen në Kosovë duhet të planifikohen dhe ndërtohen sipas disa kriterve mjedisore, që ndryshe njihen si principe ekologjike në rregullimin e qyteteve. Sipas standardeve minimale të sugjeruara nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) dhe të miratuara nga Organizata e Kombeve të Bashkuara e Bujqësisë dhe Ushqimit (FAO), kufiri minimal i hapësirës së gjelbër në qytete është 9 m2/banor. Ndërsa sipas standardeve të aprovuara me UA nr. 08/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor, ky standart në Kosovë është 2 m2/banor në kuadër të vendbanimit dhe për brezat përgjatë rrjedhave ujore, e 1 m2/banor për brezat përgjatë rrugëve.

Hapësirat e gjelbëra në Komunën e Vitisë përfshijnë parqet urbane të Qytetit të Vitisë, gjelbërimin e rrugëve (trotuareve), përgjatë rrugëve kryesore të qytetit dhe rreth lumit "Morava", parqet në disa fshatra, hapësirat e gjelbëra afër godinave institucionale, shkollave, lapidarëve, varrezat e deshmorëve etj. Mirëpo, këto hapësira, në zonën urbane janë në konkurrencë të vazhdueshme me ndërtimet duke rrezikuar të humbasin nga presioni i ndërtimit. Komuna e Vitisë e ka të hartuar Planin për Menaxhimin e Hapësirave të Hapura Publike (2017-2021) i cili i trajton këto hapësira në sfondin urban. Në Plan janë të identifikuara dhe të koduara sipas tipologjisë hapësirat publike me rëndësi për zhvillimin e jetës shoqërore dhe publike në qytetin e Vitisë, të tilla si: parqet, sheshet, hapësirat për parkim automjetesh, trotuaret, varrezat dhe hapësirat për rreth objekteve sakrale dhe monumentale që shfrytëzohen për rekreacion, sport, ecje, relaksim etj.. Aktualisht, në komunën e Vitisë hapësira gjelbëruese dhe të hapura për kokë banori është 2.73 m2, më e ulët se mesatarja në Kosovë. Sa i përket sipërfaqeve aktuale të HHP-ve në qytetin e Vitisë, nga inventarizimi i sipërpërmendur janë marrë të dhëna mbi sipërfaqet e hapësirave në raport me numrin e banorëve, të cilat janë treguar në tabelat në vijim.

Tabela 52 Hapësirat e hapura dhe të gjelbëra publike në Komunën e Vitisë, sipas kategorizimit të tyre[15].

| Nr | Klasifikimi i hapsirave sipas përdorimit | Sipërfaqja ne m2 | Numri i banorëve | Siperfaqet m2 /banorë. |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Hapësirat e gjelbëra- parqe | 18,181 | 47,896 | 0.38 |
| 2 | Sheshe | 21,795 | 47,896 | 0.45 |
| 3 | Shëtitore pranë lumit | 1,879 | 47,896 | 0.04 |
| 4 | Shtrat i lumit | 37,184 | 47,896 | 0.77 |
| 5 | Fushë sporti | 34,639.45 | 47,896 | 0.72 |
| 6 | Siperfaqe e gjelbër/ Rrethrrotullim | 110 | 47,896 | 0.002 |
| 7 | HHP-të pranë lapidarëve dhe përmendoreve | 3,810 | 47,896 | 0.08 |
| 8 | Varreza të dëshmorëve dhe martirëve | 10,671 | 47,896 | 0.22 |
| | Gjithsej hapësirë e hapur publike dhe e gjelbërt | 128,269 | 47,896 | 2.67 |

Nga tabela e lartëshënuar, është evidente se standardet lokale ekzistuese nuk përkojnë me ato projektuese dhe të synuara për hapsira publike (sheshe, parqe dhe rekreacion), ndërsa për gjendjen e tanishme në përgjithësi mund të thuhet se sipërfaqja aktuale e hapësirave të hapura publike për rekreacion aktiv dhe pasiv është 2.67 m2/banor, ndërsa sipërfaqja aktuale e hapësirave të hapura publike për parqe dhe hapësira te gjelbëra është 0.16 m2/banor.

[15] Plani i mirëmbajtjës së hapësirave të hapura publike në komunën e Vitisë 2017-2021

## 2.8.7. Objektet fetare dhe varrezat publike

### *2.8.7.1. Objektet Fetare*

Komuna e Vitisë ka objekte fetare pothuaj se në të gjitha vendbanimet. Objektet fetare të evidentura në këtë komunë janë gjithsej 35 objekte fetare ku prej tyre kemi 28 xhamija dhe 7 kisha. Xhamijat gjenden në vendbanimet: Balance, Begunce, Binçë, Budrikë, Buzovik, Debelldeh, Devaj, Drobesh, Gërmovë, Gjylekar, Gushicë, Kabash, Katun i Ri, Lubishte, Podgorc, Pozharan, Radivojc, Ramjan, Remnik, Sadovinë e Çerkezve, Sadovinë e Jerlive, Sllatinë, Smirë, Tërpezë, Tërstënik, Verban, Viti dhe Zhiti. Ndërësa Kishat gjenden në vendbanimet: Binçë, Kabash, Letincë, Stubëll e Epërme, Vernakoll dhe dy kisha në qytetin e Vitisë. Gjithësej sipërfaqja e parcelave kadastrale ku janë të vendosura objektet fetara është 111371.8 m² apo rreth 11 ha. Sipërfaqja e parcelave kadastrale ku gjenden gjamijat kanë sipërfaqen prej 84052.3 m² apo rreth 8.4 ha dhe sipërfaqja e parcelave kadastrale ku gjenden kishat është 27319.5 apo rreth 2.7 ha.

### *2.8.7.2. Varrezat Publike*

Çdo vendbanim i banuar në komunën e Vitisë ka varreza. Në disa vendbanime, ka dy ose ma shumë varreza. Janë identifikuar lokacionet e varrezave në tërë territorin e komunës së Vitisë, dhe është konstatuar se një pjesë e tyre i plotëson kërkesat edhe për 8 vitet e ardhshme. Porse, kërkohen masa për plotësim me infrastrukturë, mirëmbajtje dhe menaxhim.

Sipërfaqja e parcelave kadastrale ku gjenden varrezat në komunën e Vitisë është 477152.1 m² apo rreth 47.7 ha.




<u>Harta 20 Objektet Fetare dhe Varrezat Publike në Komunën e Vitisë</u>

# 2.9. MJEDISI DHE SIPËRFAQET ME RREZIKSHMËRI

## 2.9.1. Ndotja e mjedisit

Problemet kryesore në fushën e mjedisit janë: urbanizimi i pa kontrolluar dhe ndërtimet e egra, cilësa e dobët e ujit në lumenjë, cilësia e dobët e ujit të pijshëm, përdorimi i papërshtatshëm i tokës bujqëesore, zhurma etj.. Ndërsa, ndotësit kryesor të mjedisit janë mbeturinat komunale, kanalizimi dhe aktivitetet bujqësore.




Harta 21 Ndotja e Mjedisit

## 2.9.2. Ndotja e ajrit

Cilësia e ajrit të pastër është e lidhur në mënyrë përmbajtjesore me shëndetin e njeriut. Aktualisht kontribuesit më të mëdhenjë të ndotjes së ajrit në Viti janë burimet statike dhe ato lëvizëse. Vitia është një vend me industri tejet të varfër dhe si rezultat ndotja e ajrit është e “kursyer” në këtë aspekt. Si ndotës kryesorë mund të llogaritet sektori i transportit, gurëthyesit dhe lokacionet ku ilegalisht hudhen dhe digjen mbeturinat.

Kur jemi tek transporti si ndotësi kryesor i ajrit në komunën e Vitisë; rrugët rajonale Gërlicë-Viti dhe Viti-Letnicë, si dhe magjistralja Ferizaj- Gjilan janë vendet të cilat më së shumti i ekspozohen ndotjes nga transporti. Këto rrugë janë mjaftë të ngarkuara me automjete të të gjitha llojeve, ndërsa i përshkojnë këto vende: qytetin e Vitisë me fshatrat që shtrihen për gjatë këtyre rrugëve, pastaj fshatrat Budrikë, Radivojcë, Ramjan dhe Pozharan. Sektori i transportit karakterizohet me numër të madh të makinave të vjetëruara dhe përdorim të karburanteve jo adekuate dhe jo cilësore andaj edhe ndikon në ndotjen e ajrit.

Po ashtu njëri ndër sektorët të cilët kontribojnë në ndotjen e ajrit, kryesisht përmes djegies së biomasës (hamulloreve, mbetjeve të drunjëve), është edhe ai i bujqësisë. Tutje, sikur në të gjithë Kosoven, edhe në komunën e Vitisë krijohen zona ilegale për hudhjen dhe djegien e mbeturinave të cilat paraqesin një burim serioz të ndotjes së ajrit. Ndotja e ajrit shkaktohet po ashtu edhe nga ekonomitë familjare dhe institucionet e ndryshme të cilat përdorin qymyrin apo karburantet për ngrohje. Në të shumtën e rasteve ndotja paraqitet në formë të emisioneve të dioksidit të sulfurit (SO2), oksid të azoti (NOx), ozon (O3), plumb (Pb), benzoli, dioksid karboni (CO2), pluhur, tym, grimca të patretshme, dioksine dhe metale të rënda.

## 2.9.3. Ndotja e ujit

Rrjedhja e ujërave të zeza në gjithë territorin e komunës është problem mjaft i madh. Vetëm 30% e banorëve llogaritet të kenë kyçje në rrjetën e kanalizimit. Ujërat e zeza barten në lumin " Morava" dhe janë të pa trajtuara, ndërsa rrjetat e kanalizimit të ndërtuara pas luftës në disa fshatra paraqesin problem në vete ngasë derdhja e tyre bëhet në ambient të hapur, jashtë standardeve dhe në mënyrë të egër. Vlenë të përmendet se një pjesë e qytetit nuk është e kyçur në rrjetin e kanalizimit gjë që shkakton probleme për mjedisin. Në analizat e bëra nga Instituti Hidrometerologjik i Kosovës në lumin Morava e Binçës në Viti, prej vitit 2002 deri në vitin 2008 shihen ndryshime në vlera të pH-së, të Nitriteve dhe Nitrateve dhe gjithë parametrave tjerë kimik si pasojë e shkarkimit të pa kontrolluar të ndotësve në ujërat e lumit Morava e Binçës. Ndotja e ujërave në lumin Morava vërehet edhe në florën algale. (Metallari, N. 2009). Me hulumtimet algologjike në një pjesë të lumit Morava e Binçës në tetor 2007 dhe shkurt 2008, janë regjistruar 35 lloje të algave. Prej tyre boshtin kryesor e përbëjnë algat Bacillariophyta (30 lloje). Nga algat Bacillariophyta, gjinitë dominuese kanë qenë: Nitzschia me (7 lloje), dhe Navicula me (6 lloje). Ndarja Cyanophyta ka qenë e njohur me (2 lloje), ndarja Chlorophyta me (2 lloje) dhe ndarja Rhodophyta me (1 lloj).

## 2.9.4. Ndotja nga zhurma

Nuk ka të dhëna konkrete për komunën e Vitisë. Planifikimi i dobët urbanistik, ndërtimet industriale, banimi, mbajtja e tubimeve publike, organizimi i manifestimeve argëtuese, sportive dhe aktiviteteve tjera në vende publike të hapura ose të mbyllura mund të rezultojnë me ndotje nga zhurma në zonat e banuara.

## 2.9.5. Sipërfaqet me rrezikshmëri

### *2.9.5.1. **Tërmetet***

Territori i komunës së Vitisë ka për karakteristikë zonën e burimeve sizmike të njohur si Zona sizmogjene Ferizaj – Viti – Gjilan, me magnitude maksimale M= 6.1 shkalla Riter.

Kjo zonë e burimeve sizmike, ka gjeneruar në të kaluarën dhe mund të gjenerojë edhe në të ardhmen termete të forta. Ndër tërmetet më të fuqishme që kanë goditur rajonin janë tërmeti i vitit 1755 dhe 1921. Tërmeti i vitit 1921, me të njëjtin intensitet me atë të vitit 1755, çka do të thotë se është përsëritur këtu pas 166 vjetësh.

Tërmeti i vitit 1921, është shoqëruar nga shumë pasgoditje të forta, 7 e 8 ballë shkalla MCS, që kanë zgjatur për një vit: nga gushti 1921 deri më shtator 1922.

Karakteristike është se, në rajonin Ferizaj – Gjilan janë regjistruar tërmetet me magnitudë nën 5.0 shkallë të Riterit, dhe intensitet epiqendrore rreth 6–7 ballë, me sa vijon:

- Tërmeti i 5 marsit 1936, me magnitudë 4.9 dhe intensitet epiqendror 6-7 ballë.

- Tërmeti i 8 qershorit 1956, me magnitudë 4.6 dhe me intensitet epiqendror 6 ballë.

Nga kjo shihet se, pas vitit 1956 nuk është regjistruar ndonjë termet me intensitet epiqendror 6, ose mbi 6 ballë. Dhe vetëm më 24 prill 2002, një termet me intensitet epiqendror prej 7.5 ballë MSK-64, goditi rajoni e Gjilanit.

Si rezultat i këtyre të dhënave, mund të themi se territori i komunës së Vitisë si dhe pjesa më e madhe e territorit të Kosovës, janë nën ndikimi sizmik aktiv, e me rrezikshmëri sizmike të lartë, njëlloj si vendet fqinje me të.




Harta 22 Zonat Seizmologjike në Komunën e Vitisë

## 2.9.5.2. *Erozioni*

Territori i komunës së Vitisë, karakterizohet me një pjesëmarrje të sipërfaqeve erozive sipas këtyre kategorive:

1. Sipërfaqet të cilat i janë nënshtruar erozionit të dobët përfshijnë sipërfaqen rreth 86.13 km2, ose rreth 29% të territorit.
2. Erozioni i mesëm, vepron në sipërfaqe prej 130.68 km2, ose 44 % të territorit të komunës.
3. Hapësirat me erozion të fortë në komunën e Vitisë, përfshijnë sipërfaqe prej 74.25 km2 ose 25%.
4. Erozioni shumë i fortë, shtrihet në një sipërfaqe prej 5.94 km2 ose 2% të territorit të komunës.




Harta 23 Erozioni në komunën e Vitisë

## *2.9.5.3. Vërshimet*

Sipërfaqet të cilat janë nën ndikimin e vërshimeve në territorin e komunës së Vitisë përbëjnë 548.39 ha. Komuna e Vitisë, vite me radhë ballafaqohet me problemin e vërshimeve si të lokaliteteve të banuara, ashtu edhe tokave bujqësore. Dëmet kryesore të shkaktuara nga këto vërshime koniderohen të jenë:1.

1. Dëmet ekonomike
2. Rrezikimi i shëndetit të njeriut
3. Ndotje permanente e ambientit
4. Përhapje e epidemive etj.

Vërshimet ndodhin nga këta lumenjë dhe përroje: Letnicë, Gërqar, Vërbovc, Podgorc, Ramnishtë, Mogillë (pjesa veriore), Kabash, Binçë, Viti, Kllokot (mbi urë), Budrikë, Gjylekar, Remnik, Radivojcë, Zhiti, Pozharan, Sllatinë e Ulët, Sllatinë e Epërme, Sadovinë e Çerkezve, Sadovinë e Jerlive, Gërmovë.




Harta 24 Zonat e rrezikuara nga fatkeqësitë natyrore në komunën e Vitisë

### *2.9.5.4.Rrëshqitjet e bores*

Rrëshqitje të borës në komunën e Vitisë, mund të ketë vetëmnë zonat e larta malore të cilat nuk paraqesin ndonjë rrezik për popullatën e Vitisë dhe ekonominë e saj.

### *2.9.5.5.Era e fortë*

Duke u bazuar në atë se Vitia shtrihet në luginën e lumit Morava, dhe si i tillë është i mbrojtur nga ndikimet e erërave të forta të cilat do të rrezikonin popullatën e Vitisë dhe ekonominë e saj.

### *2.9.5.6.Breshëri*

Gati të gjitha të reshurat që vijnë prej anës veri-lindore, gjegjësisht rrymat e erës me re të cilat vijnë prej luginës së Moravës, në drejtim të zonave më të larta malore përcillen edhe me breshër. Për këtë arësye breshëri, i cili është rrezik i përhershëm për kulturat bujqësore, mund të konsiderohet si rrezik për ekonominë e komunës së Vitisë.

### *2.9.5.7.Akulli*

Në kohët tona, territori i Vitisë përfshihet nga akulli dhe bora vetëm në zonat e larta malore, gjatë sezonit dimëror dhe nuk paraqesin ndonjë rrezik për ekonomin dhe bujqësinë.

### *2.9.5.8. Thatësira*

Thatësira mund të konsiderohet si rrezik për rendimentet e kulturave bujqësore gjatë sezonit verorë, kryesisht gjatë muajve Korrik dhe Gusht, kur temperaturat janë më të larta dhe të reshurat janë më të rralla. Ndikimi i temperaturave të larta në përgjithësi, redukton prodhimin bujqësor, në veçanti kulturat pranverore, siç është misri, kultura të cilat domosdoshmërish gjatë korrikut dhe gushtit kërkojnë ujitje, ndërsa ekipet komunale kanë parashikuar ndërtimin e pendës te Shushtë, dhe një sistemi të përbërë edhe nga një numër pandash të vogla.

### *2.9.5.9. Radioaktiviteti (Jonizues Dhe Jo Jonizues)*

Gjatë punës, grupet punuese kanë trajtuar edhe informatën për vendin ku është goditur me uranium të varfëruar nga NATO, gjatë luftës së fundit në Kosovë. Për shkak të efekteve të dëmshme që ka rrezatimi mbi shëndetin e popullatës dhe gjallesave tjera, në këtë zonë është paraparë që të bëhet izolim profesional i zonës në fshatin Podgorc.

### *2.9.5.10. Zjarret*

Zjarret e shkaktuara në territorin e komunës së Vitisë për periudhën Janar-Prill 2019, kanë regjistruar 160 interventime në zjarre nga to 138 zjarre ishin në sipërfaqe të hapura, konkretisht 61 prej tyre ishin zjarre malore, 69 fushore si dhe 8 zjarre në mbeturina. Zjarret malore kanë përfshirë edhe territorin e komunës së Vitisë, saktësisht zjarret që janë përhapur në fshatrat: Buzovik, Letnicë, Novoselë si dhe disa fshatra të tjera, nga këto zjarre janë prekur gjithsej mbi 56 hektar pyje të kësaj komune qoftë private apo publike.

# 2.10. TRASHËGIMIA KULTURORE, NATYRORE DHE ASETET TURISTIKE

## 2.10.1. Trashëgimia Natyrore e Komunës së Vitisë

Komuna e Vitisë është e pasur me monumente natyrore botanike, hidrologjike, gjeomorfologjike, si dhe peizazhore. Në vitin 2005, nga Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës janë evidentuar 20 monumente të natyrës në Komunën e Vitisë, prej tyre 14 janë propozuar për mbrojtje. Prej monumenteve të natyrës të propozuara për mbrojtje, 8 janë Monumente Natyrore Botanike III, 3 janë Monumente Natyrore Hidrologjike III, 2 janë Peizazh i Mbrojtur V dhe 1 është Monument Natyror Gjeomorfologjik.

Tabela 53 Lista e zonave të propozuara për mbrojtje nga IKMN-ja

| Nr | Emërtimi i zonave | Vendi | Shtrirja gjeografike | | | Kategoritë e propozuara |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | X | Y | Lart. mbid. | |
| 1 | Lisi i dushkut (Quercus sp.) | Viti | 0528941 | 4686518 | 504 | Monument natyre (botanik) III |
| 2 | Lisi dushkut i bungut (Quercus sp.) | Zhiti | 0530447 | 4694648 | 560 | Monument natyre (botanik) III |
| 3 | Burimet e ujit mineral në fshatin Ballanc | Ballancë | 0528856 | 4695908 | 633 | Monument natyre (hidrologjik) III |
| 4 | Kompleksi i trungjeve në fshatin Ballanc | Ballancë | 0529374 | 4695440 | 639 | Monument natyre (botanik) III |
| 5 | Burimii ujit mineral në fshatin Zhiti | Zhiti | 05297454 | 4693280 | 546 | Monument natyre (hidrologjik) III |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 6 | Tetë lisat e dushkut (Quercus sp.) në fshatin Binçë | Binçë | 0529993 | 4682342 | 547 | Monument natyre (botanik) III |
| 7 | Burimii ujit në fshatin Samakovë te Shushet | Samakovë | 0528844 | 4679165 | 603 | Monument natyre (hidrologjik) III |
| 8 | Bashkimi i dy rrjedhave të lumit Morava | Samakovë | 0825301 | 4678574 | 635 | Peisazh i mbrojtur V |
| 9 | Dushku i kaprollit specie dekorative natyrale | Debelldeh | 053408 | 4678224 | 1091 | Monument natyre (botanik) III |
| 10 | Lisi i qarrit (Quercus cerris) në Gërmovë | Gërmovë | 0525368 | 4685556 | 525 | Monument natyre (botanik) III |
| 11 | Pylli i dushkut | Sllatinë e Epërme | 0523876 | 4689210 | 514 | Monument natyre (botanik) III |
| 12 | Kompleksi i trungjeve të dushkut | Sllatinë e Poshtme | 0524984 | 4688249 | 511 | Monument natyre (botanik) III |
| 13 | Reke e Vërnezit | Vërnakollë | | | 800 | Peisazh i mbrojtur V |
| 14 | Guri i blinave | Skifteraj | 0535398 | 4687106 | 671 | Monument natyre (gjeomorfologjik) |

Këto zona dhe monumente të natyrës aktualisht janë në gjendje jo të mirë, madje disa prej tyre, p.sh Trungu i qarrit (Qurcus cerris) në Viti, është zhdukur fare. Në rrezik janë pyjet e ahut në Debelldeh, të cilat e përbëjnë një fitocenoz të shkëlqyer të ahut si dhe Ilex aquifolium (Ashja), që gjendet në këto pyje dhe e cila përbënë një lloj të rrallë në Kosovë. Gjatë rekognozimit të zonave të mbrojtura në komunën e Vitisë në vitin 1986 janë evidentuar edhe këto vlera natyrore: një Monument memorial i natyrës në Ramjan, Pyjet e ahut në Debelldeh si dhe Ilex Aquifolium në Karadak.

## 2.10.2. Trashëgimia Kulturore e Komunës së Vitisë

Komuna e Vitisë që njihet si një vendbanim shumë i lashtë karakterizohet me një trashëgimi të pasur arkeologjike, arkitekturore dhe shpirtërore. Kjo pasuri nën trajtimin e duhur mund të vendos Vitinë si destinacion turistik duke nxitur zhvillimin social dhe ekonomik dhe përforcuar identitetin e vendit. Bazuar në shënimet e Zyrës për Trashëgimi Kulturore në Viti, si dhe informatave tjera të mbledhura gjatë procesit të hartimit të Planit Zhvillimor Komunal, në Komunën e Vitisë janë identifikuar këto objekte dhe asete të trashëgimisë kulturore të prekshme:

- Shkolla e parë shqipe legale e Kosovë në Stubëll të Epërme
- Manastiri i Binaçit, Buzovik, Viti
- Kalaja qytezë e shekullit II-XIV, Tërpezë
- Binçë – Kalaja qytezë e shekullit IV-VI
- Kalaja e Mjakut
- Shkolla e vjetër muze në Pozheran
- Përmendoret e dëshmorëve të luftës së UÇK-së dhe luftërave tjera
- Lapidarit të lirisë së shtypit “Kerim Leëton”
- Shtëpia e dëshmorit të kombit Rexhep Bislimi në fshatin Stubëll e Poshtme
- Shtëpia e dëshmorëve të kombit Gursel e Bajram Sylejmani në Sodovinë të J.

- Shtëpia e dëshmorëve të kombit Njazi Azemit në Mogillë
- Shtëpitë e dëshmorëve të nacional demokratikës në Stubëll të Epërme
- Xhamia në fshatin Gërmovë
- Xhamia në fshatin Sllatinë
- Kisha katolike në Stubëll të Epërme
- Letnicë truporja e drurit e zojës Cërnagore,
- Truproja e Shën Rrokut, tri pllakat e gurit dhe libri amë i të lindurve dhe të pagëzuarve
- Mulliri me valovicë në fshatin Binçë
- Shtëpia në fshatin Stubëll e Poshtme që shërbeu si spital gjatë luftës së UÇK-së
- Mullinjtë në Letnicë
- Mulliri në fshatin Binçë
- Shtëpia kullë në Radivojc
- Kompleksi i varrezave të dëshmorëve në Viti
- Kisha katolike në Viti
- Kisha katolike në Letnicë
- Kullat në Radivojc, Skifetraj, Stubëll
- Kolegji i rangut të institutit të lartë në Stubëll (1584)
- Themelet e Kishës së vitit 1866-1929, Letnicë
- Kroi i Kishës në Smirë

Ndërsa si vlera të trashëgimisë shpirtërore janë identifikuar:

- Manifestimi tradicional "Flakadani i Karadakut"
- Takimet e Dom Mikel Tarabolluzit në Stubëll
- Ditët e "Zojës Crnagore" në Letnicë
- Dita e manastirit Buzovik
- Ditët botërore të shtegtimeve për "Nënë Terezën"
- Dita botërore e fjalës së lirë "Kerim Leëton"
- Dita e Çlirimit të Vitisë

Megjithatë, në Mbrojtje të Përkohshme nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit janë marrë vetëm një pjesë e trashëgimisë arkeologjike dhe arkitekturore të Komunës së Vitisë. **Lista e Trashëgimisë Kulturore Për Mbrojtje Të Përkohshme (për perudhën 10.10.2020-10.10.2021)** e aprovuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit me date 10.10.2020, përfshinë vetëm këto Asete të Trashëgimisë Kulturore nga Komuna e Vitisë:

**I.Kategoria: Trashëgimia Arkeologjike**

## Nënkategoria: Lokalitet Arkeologjik/Rezervat

Tabela 54 Lista e trashëgimisë arkeologjike

| Nr. | Emërtimi | Periudha | Vendi/ Komuna | Statusi | Nr. unik në |
|---|---|---|---|---|---|
| 392 | Shenjtore e shpellës (Parahistori) | Parahistori | Gërnçarë, Viti | | 2744 |
| 393 | Lokaliteti arkeologjik 'Qyteza' | Romake, Antikitet i | Gërnçarë, Viti | | 1237 |
| 394 | Lokaliteti arkeologjik 'Priboj' | Antikitet i Vonë | Gërnçarë, Viti | | 2749 |
| 395 | Lokaliteti arkeologjik "Qyteza" | Antikitet i vonë, | Tërpezë, Viti | | 2748 |
| 396 | Lokaliteti arkeologjik "Kalaja - Qyteza" | Romake | Binçë, Viti | | 2751 |
| 397 | Manastiri i Binaçit | Shek. XIV | Buzovik, Viti | ZVM | 2745 |
| 398 | Gradina e Gushicës së Vitisë | Antikiteti i vonë | Gushicë, Viti | | 3622 |
| 424 | Vendbanimi Budrikë | Neolit | Budrikë e Epërme, Viti | | 4492 |

## II. Kategoria: Trashëgimia Arkitekturore

## Nënkategoria: Monument/Ansambël

Tabela 55 Lista e trashëgimisë arkitekturore

| Nr. | Emërtimi | Periudha | Vendi/ Komuna | Statusi | Nr. unik në databazë |
|---|---|---|---|---|---|
| 15 | Shtëpi me çardak e Sejdi Ismajl Budrigës | 1908- | Budrigë, Viti | | 1201 |
| 22 | Përmendore e LNÇ | Shek. XX | Ramjan, Viti | | 2746 |
| 23 | Kullë në Letnicë (e Ivanit) | Shek. XX | Letnicë, Viti | | 2698 |
| 2 | Shtëpi-kullë në Letnicë (e Josipit) | Shek. XIX | Letnicë, Viti | | 2700 |
| 26 | Shtëpi banimi në Letnicë - (Nikollë Mitës) | Shek. XX | Letnicë, Viti | | 2737 |
| 836 | Mulliri – muze i Frrok Dokiqit | | Letnicë, Viti | | 2696 |
| 837 | Shkolla e parë shqipe | 1905 | Pozharan, Viti | | 2747 |
| 838 | Xhamia në fshatin Pozharan | 1890 | Pozharan, Viti | | 193 |
| 839 | Shtëpia-kullë e Don Lush Gjergjit | Shek. XIX | Stubëll, Viti | | 588 |
| 840 | Kisha e Shën Jozefit | 1969 | Stubëll e Epërme, | | 216 |
| 841 | Shtëpia e Heset Mehmetit | | Stubëll e Poshtme, | | 4254 |
| 842 | Kisha e Shën Ndout në Binçë | Shek. XIX | Binçë, Viti | | 217 |
| 843 | Mulli në fshatin Binçë | | Binçë, Viti | | 595 |
| 844 | Mulliri dhe velanica e Vishëve nga Verbani i ndërtuar në Binçë | Shek. XIX | Binçë, Viti | | 596 |
| 845 | Xhamia në fshatin Goden | 1490 | Goden, Viti | | 224 |
| 846 | Shtëpia kullë e Vesel Godenit | | Goden i Madh, Viti | | 4247 |
| 847 | Xhamia e Gërmovës | 1827 | Gërmovë, Viti | | 881 |
| 848 | Shtëpi banimi në Gërmovë (Ismet Jashar Misinit) | 1900 | Gërmovë, Viti | | 2687 |
| 849 | Xhamia e Sllatinës së Epërme | 1905- | Sllatinë e Epërme, | | 2738 |
| 850 | Shtëpia e Haxhi Ahmetit | Shek. XIX | Remnik, Viti | | 2685 |
| 851 | Oda e Haxhi Ahmetit | Shek. XIX | Remnik, Viti | | 2686 |
| 852 | Kulla e Januz Ahmet Lamallarit | 1870 | Mjak, Viti | | 4165 |

## III. Kategoria: Objektet e luajtshme

Tabela 56 Lista e trashëgimisë së luajtshme

| Nr. | Emërtimi | Periudhat | Signatura - konteksti i gjetjes dhe vendndodhja | Vendgjetja/ Komuna | Statusi |
|---|---|---|---|---|---|
| **203** | Truporja e drurit e Zonjës Caragore | Shek. XX | | Letnicë, Viti | |

Në **Listën e Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje të Përhershme**, të publikuar me datë 10.10.2016, e cila përmbanë 23 asete të trashëgimisë kulturore, nuk ka asnjë aset nga Komuna e Vitisë.




Harta 25 Trashegimia Natyrore dhe Kulturore në komunën e Vitisë

Edhe pse këto asete të trashëgimisë kulturore janë shpallur nën mbrojtje të përkohshme, shumë prej tyre nuk janë në gjendje të mirë fizike dhe kërkojnë intervenime restauruese. Gjithashtu këto objekte të trashëgimisë nuk e kanë të përcaktuar perimetrin dhe zonën mbrojtëse ashtu siç kërkohet me Ligjin për Trashëgimi Kulturore, si dhe sipërfaqen e mbrojtur, ashtu siç kërkohet me Ligjin për Planifikimin Hapësinor. Me shpalljen e tyre si zona të mbrojtura, do të kontrollohen zhvillimet e ardhme në këto zona, dhe do të parandalohet degradimi i mëtutjeshëm i vlerave të tyre dhe mjedisit rrethues.

## 2.11. VENDBANIMET

### 2.11.1. Tipologjia e vendbanimeve sipas madhësisë

Trajtimi i vendbanimeve në planet zhvillimore komunale është i domosdoshëm dhe kyç ngase i tërë aktiviteti dhe organizimi i jetës së njeriut dhe shoqërisë njerëzore ka qenë dhe është i lidhur për to.

Tipizimi i vendbanimeve sipas madhësisë është njëra ndër metodat më të rëndësishme për të pasqyruar karakteristikat e sistemit popullativ të hapësirës së caktuar si dhe mënyrën dhe cilësinë e jetës në vendbanimet e asaj hapësire, sepse vendbanimi më i madh nënkupton mënyrën e jetës më cilësore në shumë aspekte. Kurse vendbanimi më i vogël zakonisht tregon të kundërtën e asaj të parës. Pikërisht nga kjo arsye vendbanimet kategorizohen sipas madhësisë popullative dhe në bazë të shumë analizave të kësaj problematike përcaktohen pikat strategjike për zhvillim të mëtejmë të komunës apo edhe më gjerë.

Vendbanimet sipas madhësisë demografike në komunën e Vitisë mund t'i kategorizojmë në:

1. Vendbanime të vogla rurale,
2. Vendbanime të mesme rurale,
3. Vendbanime të mëdha rurale dhe
4. Vendbanime të karakterit urban.

Në komunën e Vitisë ekzistojnë 39 vendbanime gjithsej në 38 zona kadastrale. Sipas vlerësimit të popullsisë për vitin 2020 nga ASK, kemi grupin e vendbanimeve të vogla deri në 500 banorë mund të grupohen 12 vendbanime: Çifllak 92 banorë, Debelldeh 346 banorë, Devajë 298 banorë, Goden i Madh 82 banorë, Letnicë 272 banorë, Mjak 0 banorë, Ramnishtë 446 banorë, Podgorc 386 banorë, Stubëll e Poshtme 78 banorë, Shashare 149 banorë, Vërnakollë 12 banorë dhe Vërnez 1 banorë.

Në kategorinë e dytë të vendbanimeve të madhësisë 500-999 banorë janë 9 vendbanime: Ballancë 643 banorë, Budrikë e Epërme 915 banorë, Buzovik 531 banorë, Gërmovë 903 banorë, Gushicë 817 banorë, Novosellë 557 banorë, Ramjan 912 banorë, Tërstenik 784 banorë dhe Zhiti 615 banorë.

Në kategorinë e tretë të vendbanimeve të madhësisë 1000-1999 banorë janë 10 vendbanime: Binçë 1149 banorë, Drobesh 1880 banorë, Lubishtë 1473 banorë, Radivojc 1269 banorë, Remnik 1880 banorë, Sadovinë e Çerkezve 1286 banorë, Sadovinë e Jerlive 1122 banorë, Sllatinë e Poshtme 1200 banorë, Stubëll e Epërme 1150 banorë dhe Tërpezë 1853 banorë.

Në kategorinë e katërt të vendbanimeve të madhësisë 2000-4999 banorë janë 7 vendbanime: Beguncë 2174 banorë, Gjylekar 2547 banorë, Kabash 2369 banorë, Pozharan 4329, Sllatinë e Epërme 2362 banorë, Smirë 3947 banorë, Vërban 2047 banorë.

Një vendbanimet me mbi 5000 banorë është: Vitia me 5019 banorë.

Vitia si qendër komunale, shtrihet në pjesën fushore – në qendër të Moravës së Epërme nëpër të cilin vendbanim, rrjedh lumi Morava e Binçës. Ka një sipërfaqe prej, 1.079 hektarë. Në jug të këtij vendbanimi, gjinden themelet e lokalitetit iliro-dardan në vendin e quajtur "Gërmi", i cili vend shtrihet në mes të Vitisë dhe fshatit Kabash.

#### 2.11.1.1. ***Shtrirja hapësinore e vendbanimeve sipas madhësisë***

Gjithashtu edhe shtrirja hapësinore e vendbanimeve sipas madhësisë është e një rëndësie të veçantë për planifikimin dhe rregullimin e hapësirës. Në bazë të kësaj analize mund të përcaktohen kahet e zhvillimit dhe organizimit të më tejmë shoqëroro-ekonomik në hapësirën e caktuar. Madhësia mesatare e vendbanimeve në komunën e Vitisë është 1228 banorë. Dallimet në numrin e popullsisë të disa vendbanimeve janë të konsiderueshme dhe ato sillen në mes maksimumit 5019 banorë (Vitia) dhe minimumit 1 banorë (Vërnezë), që është dallim shumë i madh. Këto dallime janë të kushtëzuara nga pozita e vendbanimit dhe gjeomorfologjia e terrenit. Prandaj, është me rëndësi edhe analiza e shtrirjes së këtyre vendbanimeve sipas zonave të lartësisë mbidetare.

Përfaqësimi i disa vendbanimeve të kategorive të mëdha në rrjetin e vendbanimeve ka ndikim të rëndësishëm në organizimin e hapësirës dhe sistemin funksional të vendbanimeve. Karakteristikë e rrjetit të vendbanimeve në komunën e Vitisë është numri më i madh i vendbanimeve të vogla nga 0 – 499 banorë që janë 12 apo rreth 30% e të gjitha vendbanimeve. Gjithashtu numër të konsiderueshëm të vendbanimeve me madhësi të mesme nga 1000 – 1999 banorë janë 10 vendbanime apo rreth 25%. Numri i vendbanimeve me madhësi nga 500 – 999 banorë është 9 apo rrth 23%. Është me rëndësi të theksohet se në periudhat e fundit kohore kemi edhe rritje të numrit të banorëve në disa vendbanime dhe kemi 8 vendbanime që kanë mbi 2000 banorë apo rreth 23% të të gjitha vendbanimeve.

Sa i përket lëvizjes së numrit të popullsisë në vendbanimet e komunës së Vitisë sipas viteve vërehen ndryshime të theksuara. Në periudhat më të hershme kohore kishte një dominim shumë të theksuar të vendbanimeve me numër të vogël të popullsisë deri në 500 banorë, ndërësa në anën tjetër kishim shumë pakë apo aspak vendbanime të mëdha. Me kalimin e kohës dhe me zhvillimin e përgjithshëm ekonomik, social e të infrastrukturës kemi një rritje të vazhdueshme të vendbanimeve dhe kështu zvogëlohet numri i vendbanimeve të vogla duke u rrit numri i vendbanimeve të mesme dhe të mëdha.

Tabela 57 Struktura e vendbanimeve sipas madhësisë demografike në periudhën 1941-2011

| Madhësia e venbanimit | Numri i vendbanimeve sipas viteve dhe madhësisë | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 1948 | 1953 | 1961 | 1971 | 1981 | 1991 | 2011 |
| 0-499 | 19 | 17 | 16 | 10 | 8 | 6 | 12 |
| 500-9999 | 15 | 14 | 13 | 14 | 14 | 14 | 9 |
| 1000-1999 | 5 | 7 | 8 | 13 | 12 | 10 | 10 |
| 2000+ | 0 | 1 | 2 | 2 | 5 | 9 | 8 |
| Totali | 39 | 39 | 39 | 39 | 39 | 39 | 39 |




Grafika 15 Numri i vendbanimeve sipas madhësisë demografike për periudhën 1948-2011

Nga tabela dhe grafikoni shihet se vendbanimet e kategorisë së vogël deri në 500 banorë kanë pasur zvogëlim në numër, nga 19 sa ishin në vitin 1948, në 6 vendbanime në vitin 1991. Vlenë të theksohet se në vitin 2011 sëish kemi një rritje të vendbanimeve të vogla deri në 500 banorë. Ky numër sotë është 12 si

rezultat i migrimit dhe depopullimit kryesisht të vendbanimeve periferike dhe kushteve jo të favorshme për të jetuar.

Krahas zvogëlimit të numrit të vendbanimeve të vogla, vazhdimisht kishte një rritje të vendbanimeve të mesme dhe të mëdha. Vendbanimet me 1000 – 1999 banorë kanë shënuar një rritje nga 5 në vitin 1948 në 10 vendbanime në vitin 1999 dhe 2011. Numri i këtyre vendbanimeve është dyfishuar. Gjithashtu edhe vendbanimet e mëdha me mbi 2000 banorë kanë regjistruar rritje më të madhe. Në vitin 1948 nuk kishte asnjë vendbanim të kësaj madhësie. Më pas në vitin 1953 kemi një vendbanim, në vitin 1961 dhe 1971 kemi dy vendbanime, ndërsa në vitin 1991 kemi 10 të tilla dhe në vitin 2011 kemi 9 vendbanime. Bazuar nga këto të dhëna del se në të kaluarën kryesisht kanë dominuar vendbanimet e vogla rurale, ndërsa në periudhat e fundit kohore kemi rritje edhe të vendbanimeve të vogla edhe të atyre të mëdha. Kjo si rezultat i levizjeve të popullsisë nga viset rurale derjt qendrave më të zhvilluara. Kështu po zvoglohet numri i banorëve në vendbanimet periferike dhe njëkohësisht po rritet numri i vendbanimeve të vogla dhe gjithashtu në disa qendra po rritet numri i popullsisë dhe njëkohësisht po rritet numri i vendbanimeve të mëdha.




Harta 26 Ekonomitë Familjare sipas vendbanimeve

## 2.11.1.2. *Madhësia e vendbanimeve sipas lartësisë mbidetare në komunën e Vitisë*

Madhësia e vendbanimeve në komunën e Vitisë është e kushtëzuar dhe e ndërlidhur ngushtë edhe me shtrirjen e tyre sipas lartësisë mbidetare. Vëndbanimet e mëdha dhe më të zhvilluara janë të vendosura kryesisht në pjesën më të ulët të komunës ku edhe mundësit për zhvillim janë më të mëdha. Kemi vendbanimet më të mëdha të komunës që kanë mbi 3000 banorë si: Vitia, Pozharani dhe  Smirë, që

shtrihen në lartësinë mbidetare nga 500 deri në 550 m. Me rritjen e lartësisë mbidetare, edhe kushtët për zhvillim socio-ekonomik janë më të kufizuara dhe si rrjedhoj na paraqiten vendbanimet më të vogla të komunës që kanë më pak banorë. Vndbanimetqë kanë më pakë se 500 banorë, janë vendbanimet që kryesisht shtrihen në lartësit më të mëdha të komunës. Këto vendbanime shtrihen edhe deri në 1041m siç është rasti me fshatin Devajë.




Grafika 16 Numri i banorëve dhe lartësia mbidetare e vendbanimeve

### 2.11.2. Vendbanimet sipas dinamikës së popullsisë

Qyteti i Vitisë ka 4924 banorë dhe përfshin rreth 10% të popullsisë së gjithëmbarshme të komunës. Të gjitha vendbanimet tjera rurale kanë 42063 banorë apo rreth 90% të popullsisë.

Tabela 58 Popullsia, sipërfaqja dhe dendësia e popullsisë sipas vendbanimeve

| Nr. | Vendbanimi | Popullsia 2020 | Sip_Ha | Sip_km² | Banor në 1km² |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Ballancë | 643 | 755.16 | 7.55 | 85.17 |
| 2 | Beguncë | 2174 | 480.53 | 4.81 | 451.98 |
| 3 | Binçë | 1149 | 1236.22 | 12.36 | 92.96 |
| 4 | Budrikë e Epërme | 915 | 449.05 | 4.49 | 203.76 |
| 5 | Buzovik | 531 | 570.96 | 5.70 | 93.16 |
| 6 | Çifllak | 92 | 134.33 | 1.34 | 68.49 |
| 7 | Debelldeh | 346 | 924.92 | 9.25 | 37.41 |
| 8 | Devajë | 298 | 364.85 | 3.65 | 81.68 |
| 9 | Drobesh | 1880 | 291.01 | 2.91 | 646.03 |
| 10 | Gërmovë | 903 | 626.36 | 6.26 | 144.17 |
| 11 | Goden i Madh | 82 | 191.33 | 1.91 | 42.86 |
| 12 | Gushicë | 817 | 1155.92 | 11.56 | 70.68 |
| 13 | Gjylekar | 2547 | 1084.41 | 10.84 | 234.87 |
| 14 | Kabash | 2369 | 725.91 | 7.26 | 326.35 |
| 15 | Letnicë | 272 | 443.12 | 4.43 | 61.38 |
| 16 | Lubishtë | 1473 | 1084.82 | 10.85 | 135.78 |
| 17 | Mjak | 0 | 604.04 | 6.04 | 0.00 |
| 18 | Novosellë | 557 | 472.80 | 4.73 | 117.81 |
| 19 | Podgorc | 386 | 323.76 | 3.24 | 119.22 |
| 20 | Pozharan | 4329 | 1120.30 | 11.20 | 386.41 |
| 21 | Radivojc | 1269 | 365.87 | 3.66 | 346.84 |
| 22 | Ramjan | 912 | 675.65 | 6.76 | 134.98 |
| 23 | Ramnishtë | 446 | 94.76 | 0.95 | 469.47 |
| 24 | Remnik | 1880 | 1068.21 | 10.68 | 176.00 |
| 25 | Sadovinë e Çerkezve | 1286 | 840.76 | 8.41 | 152.96 |
| 26 | Sadovinë e Jerlive | 1122 | 285.55 | 2.86 | 392.93 |
| 27 | Sllatinë | 3562 | 1145.60 | 11.46 | 310.82 |
| 28 | Smirë | 3947 | 1723.62 | 17.24 | 228.99 |
| 29 | Stubëll e Epërme | 1150 | 652.78 | 6.53 | 176.11 |
| 30 | Stubëll e Poshtme | 78 | 163.74 | 1.64 | 47.56 |
| 31 | Shashare | 149 | 1050.98 | 10.51 | 14.18 |
| 32 | Tërpezë | 1853 | 1331.87 | 13.32 | 139.13 |
| 33 | Tërstenik | 784 | 376.47 | 3.76 | 208.25 |
| 34 | Vërban | 2047 | 803.87 | 8.04 | 254.64 |
| 35 | Vërnakollë | 13 | 556.74 | 5.57 | 2.34 |
| 36 | Vërnez | 1 | 842.48 | 8.42 | 0.12 |
| 37 | Viti | 5019 | 1078.51 | 10.79 | 465.36 |
| 38 | Zhiti | 615 | 875.24 | 8.75 | 70.27 |

| | Komuna VITI | 47896 | 26972.50 | 269.73 | 177.57 |
|---|---|---|---|---|---|

Mesatarisht kemi rreth 175 banorë që jetojnë në një km² dhe kjo dendësi e popullsisë dallon varësisht nga vendbanimi. Zakonisht te vendbanimet me popullsi më të madhe kemi edhe dendësinë e popullsisë më të lartë.

Tabela 59 Kategorizimet e vendbanimeve

| Nr | Vendbanimi | Kategoria | Morfologjia hapësinore | Dendësia ndërtimore | Relievi | Statusi i pipullsisë |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Ballancë | Qendër e rendit të ulët | Linear | Mesatare | I rrafsht 571m | Rritje e pop. |
| 2 | Beguncë | Qendër e rendit të ulët | Shpërndarë | E ulët | I rrafsht 621m | Rritje e pop. |
| 3 | Binçë | Qendër Bazike | Koncentruar | E ulët | I rrafsht 533m | Rritje e pop. |
| 4 | Budrikë e Epërme | Qendër e rendit të ulët | Linear | E lartë | I rrafsht 488m | Rritje e pop. |
| 5 | Buzovik | Qendër Bazike | Shpërndarë | E lartë | I përzier 669m | Rritje e pop. |
| 6 | Çifllak | Qendër e rendit të ulët | Koncentruar | E ulët | I rrafsht 514m | Zvogëlim |
| 7 | Debelldeh | Qendër e rendit të ulët | Koncentruar | E ulët | Malor 1041m | Konvergjent |
| 8 | Devajë | Qendër e rendit të ulët | Koncentruar | E ulët | I rrafsht 557m | Konvergjent |
| 9 | Drobesh | Qendër e rendit të ulët | Koncentruar | E lartë | I rrafsht 507m | Rritje e pop. |
| 10 | Gërmovë | Qendër e rendit të ulët | Koncentruar | Mesatare | I rrafsht 508m | Rritje e pop. |
| 11 | Goden i Madh | Qendër Bazike | Koncentruar | Mesatare | I rrafsht 505m | Konvergjent |
| 12 | Gushicë | Qendër e rendit të ulët | Koncentruar | E ulët | I rrafsht 529m | Rritje e pop. |
| 13 | Gjylekar | Qendër e rendit të ulët | Linear | E lartë | I rrafsht 503m | Rritje e pop. |
| 14 | Kabash | Qendër e rendit të ulët | Koncentruar | E lartë | I rrafsht 523m | Rritje e pop. |
| 15 | Letnicë | Qendër e rendit të ulët | Koncentruar | E ulët | I rrafsht 617m | Konvergjent |
| 16 | Lubishtë | Qendër e rendit të ulët | Koncentruar | Mesatare | I përzier 698m | Rritje e pop. |
| 17 | Mjak | Qendër Bazike | Koncentruar | E lartë | I përzier 867m | Zvogëlim |
| 18 | Novosellë | Qendër e rendit të ulët | Linear | E lartë | I rrafsht 553m | Rritje e pop. |
| 19 | Podgorc | Qendër e rendit të ulët | Linear | E lartë | I rrafsht 535m | Zvogëlim |
| 20 | Pozharan | Qendër e rendit të mesëm | Koncentruar | E lartë | I rrafsht 502m | Rritje e lartë |
| 21 | Radivojc | Qendër e rendit të ulët | Koncentruar | E lartë | I rrafsht 505m | Rritje e pop. |
| 22 | Ramjan | Qendër e rendit të ulët | Koncentruar | Mesatare | I rrafsht 529m | Rritje e pop. |
| 23 | Ramnisht | Qendër e rendit të | Linear | Mesatare | I rrafsht | Konvergjent |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | ulët | | | 517m | |
| 24 | Remnik | Qendër Bazike | Linear | Mesatare | I rrafsht 516m | Rritje e pop. |
| 25 | Sadovinë e Çerkezve | Qendër e rendit të ulët | Linear | E lartë | I rrafsht 508m | Rritje e pop. |
| 26 | Sadovinë e Jerlive | Qendër e rendit të ulët | Koncentruar | E lartë | I rrafsht 508m | Rritje e pop. |
| 27 | Sllatinë e Epërme | Qendër e rendit të ulët | Koncentruar | E ulët | I rrafsht 509m | Rritje e pop. |
| 28 | Sllatinë e Poshtme | Qendër e rendit të ulët | Koncentruar | E lartë | I rrafsht 504m | Rritje e pop. |
| 29 | Smirë | Qendër e rendit të ulët | Koncentruar | E lartë | I rrafsht 553m | Rritje e pop. |
| 30 | Stubëll e Poshtme | Qendër Bazike | Linear | E ulët | I përzier 729m | Rritje e pop. |
| 31 | Shashare | Qendër Bazike | Koncentruar | E lartë | I rrafsht502m | Rritje e pop. |
| 32 | Tërpezë | Qendër e rendit të ulët | Lineare | E lartë | I rrafsht 554m | Rritje e pop. |
| 33 | Tërstenik | Qendër e rendit të ulët | Lineare | E lartë | I rrafsht 501m | Konvergjent |
| 34 | Vërban | Qendër e rendit të ulët | Koncentruar | E lartë | I rrafsht 581m | Rritje e pop. |
| 35 | Vërnakollë | Qendër Bazike | Lineare | E lartë | I përzier 786m | Zvogëlim |
| 36 | Vërnez | Qendër Bazike | Lineare | E lartë | I përzier 783m | Zvogëlim |
| 37 | Viti | Qendër e rendit të mesëm | Koncentruar | E ulët | I rrafsht 502m | Rritje e lartë |
| 38 | Zhiti | Qendër e rendit të ulët | Koncentruar | E lartë | I rrafsht 537m | Konvergjent |

### 2.11.3. Sipërfaqet e ndërtuara dhe të pa ndërtuara

#### *2.11.3.1. Sipërfaqet e ndërtuara në kuadër të vendbanimeve*

Sipërfaqja e përgjithshme e komunës së Vitisë është 26898.56 ha, ndërësa sipërfaja e ndëruar është rreth 3520.14 ha që i bie se ndërtimi në këtë komunë zënë rreth 13% të territorit. Në vazhdim është paraqit sipërfaqja e ndërtuar për secilin vendbanim.

Tabela 60 Ndërtimi në komunën e Vitisë sipas vendbanimeve

| Nr. | Vendbanimi | Popullsia 2020 | Sip_Ha | Sip_km2 | Banor në | Sip. E ndertua | b/sip. ndert. | Objekte | Objekte bujqësor | Apartament |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Ballancë | 643 | 755.16 | 7.55 | 85.17 | 59.53 | 10.80 | 191 | 13 | |
| 2 | Beguncë | 2174 | 480.53 | 4.81 | 451.98 | 17.47 | 124.4 | 497 | 10 | |
| 3 | Binçë | 1149 | 1236.22 | 12.36 | 92.96 | 10.61 | 108.2 | 349 | 3 | |
| 4 | Budrikë e Epërme | 915 | 449.05 | 4.49 | 203.76 | 50 | 18.30 | 238 | 0 | |
| 5 | Buzovik | 531 | 570.96 | 5.70 | 93.16 | 71.4 | 7.44 | 99 | 2 | |
| 6 | Çifllak | 92 | 134.33 | 1.34 | 68.49 | 9.05 | 10.17 | 22 | 1 | |
| 7 | Debelldeh | 346 | 924.92 | 9.25 | 37.41 | 2.59 | 133.5 | 89 | 0 | |
| 8 | Devajë | 298 | 364.85 | 3.65 | 81.68 | 19.46 | 15.31 | 61 | 2 | |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 9 | Drobesh | 1880 | 291.01 | 2.91 | 646.03 | 115.14 | 16.33 | 499 | 8 | |
| 1 | Gërmovë | 903 | 626.36 | 6.26 | 144.17 | 48.58 | 18.59 | 170 | 19 | |
| 1 1 | Goden i Madh | 82 | 191.33 | 1.91 | 42.86 | 18.9 | 4.34 | 31 | 0 | |
| 1 | Gushicë | 817 | 1155.92 | 11.56 | 70.68 | 60.78 | 13.44 | 193 | 12 | |
| 1 | Gjylekar | 2547 | 1084.41 | 10.84 | 234.87 | 118.62 | 21.47 | 472 | 11 | |
| 1 | Kabash | 2369 | 725.91 | 7.26 | 326.35 | 128.8 | 18.39 | 624 | 25 | 2 |
| 1 | Letnicë | 272 | 443.12 | 4.43 | 61.38 | 30.57 | 8.90 | 97 | 0 | 1 |
| 1 | Lubishtë | 1473 | 1084.82 | 10.85 | 135.78 | 97.77 | 15.07 | 269 | 26 | |
| 1 | Mjak | 0 | 604.04 | 6.04 | 0.00 | | | | | |
| 1 | Novosellë | 557 | 472.80 | 4.73 | 117.81 | 58.36 | 9.54 | 129 | 6 | |
| 1 | Podgorc | 386 | 323.76 | 3.24 | 119.22 | 34.12 | 11.31 | 77 | 0 | 1 |
| 2 | Pozharan | 4329 | 1120.30 | 11.20 | 386.41 | 407.01 | 10.64 | 1012 | 34 | |
| 2 | Radivojc | 1269 | 365.87 | 3.66 | 346.84 | 69.88 | 18.16 | 315 | 2 | |
| 2 | Ramjan | 912 | 675.65 | 6.76 | 134.98 | 61.52 | 14.82 | 183 | 0 | |
| 2 | Ramnishtë | 446 | 94.76 | 0.95 | 469.47 | 92.52 | 4.82 | 114 | 3 | |
| 2 | Remnik | 1880 | 1068.21 | 10.68 | 176.00 | 84.95 | 22.13 | 381 | 10 | |
| 2 5 | Sadovinë e Çerkezve | 1286 | 840.76 | 8.41 | 152.96 | 80.89 | 15.90 | 243 | 0 | |
| 2 6 | Sadovinë e Jerlive | 1122 | 285.55 | 2.86 | 392.93 | 58.81 | 19.08 | 225 | 0 | 1 |
| 2 | Sllatinë | 3562 | 1145.60 | 11.46 | 310.82 | 243.64 | 14.62 | 801 | 12 | |
| 2 | Smirë | 3947 | 1723.62 | 17.24 | 228.99 | 177.78 | 22.20 | 697 | 2 | |
| 2 9 | Stubëll e Epërme | 1150 | 652.78 | 6.53 | 176.11 | 163.74 | 7.02 | 457 | 2 | |
| 3 0 | Stubëll e Poshtme | 78 | 163.74 | 1.64 | 47.56 | | | | | |
| 3 | Shashare | 149 | 1050.98 | 10.51 | 14.18 | 32.7 | 4.56 | 15 | 0 | |
| 3 | Tërpezë | 1853 | 1331.87 | 13.32 | 139.13 | 134.82 | 13.74 | 418 | 13 | |
| 3 | Tërstenik | 784 | 376.47 | 3.76 | 208.25 | 94.92 | 8.26 | 190 | 2 | 1 |
| 3 | Vërban | 2047 | 803.87 | 8.04 | 254.64 | 209.92 | 9.75 | 382 | 19 | |
| 3 | Vërnakollë | 13 | 556.74 | 5.57 | 2.34 | 99.8 | 0.13 | 3 | 0 | |
| 3 | Vërnez | 1 | 842.48 | 8.42 | 0.12 | 99.83 | 0.01 | 2 | 0 | |
| 3 | Viti | 5019 | 1078.51 | 10.79 | 465.36 | 396.6 | 12.66 | 1833 | 23 | 345 |
| 3 | Zhiti | 615 | 875.24 | 8.75 | 70.27 | 54.14 | 11.36 | 174 | 8 | |
| | **Komuna** | **47896** | **26972.5** | **269.73** | **177.5** | **3515.22** | **13.63** | **11552** | **268** | **351** |

### 2.11.4. Vendbanimet Joformale

Bazuar në Planin paraprak të komunës së Vitisë, kanë qënë të identifikuara 5 vendbanime joformale: Vitia 1, Vitia 2, Vitia 3, Drobeshi dhe Binçë. Në planin e kaluar është paraparë edhe trajtimi I këtyre vendbanimeve joformale dhe gjatë periudhës 10 vjeçare këto vendbanime janë trajtuar në nivelin e duhur sa i përket joformalitetit të tyre. Në bashkëpunim me institucionet locale të komunës së Vitisë, është konstatuar se aktualisht në këtë komunë nuk kemi vendbanime joformale.

### 2.11.5. Ndërtimet pa leje ndërtimore

Bazuar në regjistrin e ndërtimeve pa leje, në të gjitha vendbanimet e komunës së Vitisë del se janë 3170 ndërtime pa leje, prej të cilave vetëm 43 prej tyre janë në proces të legalizimit. Pjesa e mbetur e objekteve të ndërtuara pa leje duhet të trajtohen sipas Ligjit nr.06/L-024 për trajtimin e ndërtimeve pa leje.

## 2.12. BANIMI

Banimi cilësohet si një ndër faktorët themelor për mirëqenien e njeriut në pëgjithësi, përderisa kualiteti i njësive banimore ndikon direkt në kualitetin e jetës së banorëve të cilët jetojnë në njësitë e caktuara banesore. Në Kosovë, si rezultat i tranzicionit sidomos periudha e pas luftës karakterizohet me kualitet jo adekuat të njësive banesore si në terme të cilësisë ashtu edhe në aspektin funksional. Në komunën e Vitisë me rrethinë dominojnë ndërtesat individuale të banimit, ndërsa qendra karakterizohet me kombinim në mes të banimit individual dhe ndërtesave shumë-banesore. Ndërtesat afaristo-banesore shtrihen përgjatë rrugëve kryesore, aty ku frekuentimi i banorëve është më i lartë. Në përgjithësi këto ndërtesa nuk janë të kualitetit adekuat dhe mirëmbajtja e tyre bëhet nga iniciativa e vet banorëve të cilët jetojnë në ato ndërtesa. Qendra e qytetit karakterizohet me vendbanim kompakt, ndërsa brenditë e parcellave karakterizohen me sipërfaqe të mëdha dhe të pa shfrytëzuara, të cilat si rezultat i pa mundësive për tu qasur në rrugë kanë mbetur të pa shfrytëzuara. Shtëpitë individuale zakonisht posedojnë etazhitet P apo P+1, ndërsa ndërtesat shumë-banesore të cilat i hasim në qendër të qytetit posedojnë etazhitet P+3 deri në P+6. Viteve të fundit e sidomos periudha e pas luftës (vitet 1999 e tutje) karakterizohen me tendencë të ngritjes së etazhitetit te ndërtesat shumë-banesore. Duke u bazuar në kërkesat të cilat paraqiten në drejtorinë për Planifikim Urban, del se interesimi për ndërtimin e ndërtesave shumë –banesore afariste është tejet i madh sidomos në qendër të qytetit. Pjesa Jugore dhe Perendimore karakterizohet me ndërtime të reja - një zhvillim i hovshëm i vendbanimeve duke mos respektuar rregullat arkitektonike-proporcionet, distanca në mes të ndërtesave, materializimet etj. Në pjesën dërmuese të ndërtesave sidomos ato të ndërtuara pas vitit 1999, duket se arkitekti kishte rolin sekondar duke zënë në këtë mënyrë rolin kryesor investitori. Hapësirat e ndërtuara me banim individual karakterizohen si hapësira në të cilat nuk janë respektuar rregullat dhe kriteret urbanistike.

Tabela 61 Banesa ekonomi familjare dhe persona sipas tipit të vendbanimeve[16]

| Komuna dhe lloji i banesës | Gjithsej banesa ekonomi familjare dhe persona sipas tipit të vendbanimeve | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Gjithsej | | | Urban | | | Rural | | |
| | Banesa | Ekonomi Familjare | Persona | Banesa | Ekonomi Familjare | Persona | Banesa | Ekonomi Familjare | Persona |
| Viti | 7,496 | 7,520 | 46,987 | 893 | 895 | 4,924 | 6,603 | 6,625 | 42,063 |
| Banesa të zakonshme | 7,491 | 7,515 | 46,953 | 893 | 895 | 4,924 | 6,598 | 6,620 | 42,029 |
| Lloj tjetër banese | 5 | 5 | 14 | - | - | - | 5 | 5 | 14 |

Sipas të dhënave nga tabela, mund të konstatojm se numri më i madh i njësive banimore dominon në zonat rurale. Nga gjithsej 7496 banesa, 6603 prej tyre apo rreth 88% janë në zonën rurale. Bazuar në këtë, zakonisht dominojnë njësitë banesore të mëdha. Në komunën e Vitisë dominojnë njësitë banesore me më tepër se pesë dhoma, ndërsa njësitë banesore një dhomëshe janë në përqindje më të ulët.

Tabela 62 Banesa të zakonshme sipas numrit të dhomave dhe numrit të ekonomive familjare në banesë[17]

[16] Banesat dhe ndërtesat sipas komunave; Agjencia e statistikës së Kosovës, dhjetor 2013)

| Nr.i dhomave dhe banesave | Gjithsej banesa | Ekonomi familjare | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 |
| **Viti** | 7,491 | 7,470 | 18 | 3 | - | - | - |
| **1 dhomëshe** | 84 | 84 | - | - | - | - | - |
| **2 dhomëshe** | 637 | 634 | 3 | - | - | - | - |
| **3 dhomëshe** | 1,257 | 1,255 | 2 | - | - | - | - |
| **4 dhomëshe** | 2,152 | 2,146 | 4 | 2 | - | - | - |
| **5 + dhomëshe** | 3,361 | 3,351 | 9 | 1 | - | - | - |

Gjithsej janë 721 banesa një dhe dy dhomshe apo 9.6% e të gjitha banesave, ndërsa banesat me pesë e më tepër dhoma janë 3361 apo mbi 44% të të gjitha banesave. Bazuar në madhësin e banesave, edhe hapësira e banimit në komunën e Vitisë është relativisht e mirë. Në komunën e Vitisë dominojnë njësitë banesore ku sipërfaqja për një person është 15-20 m², ndërsa numri më i vogël i njësive banesore posedon 4 m² për person.

Tabela 63 Banesat e zakonshme sipas numrit të dhomave dhe siperfaqes mesatare për një person[18]

| Numri i dhomave ne banesa te zakonshme | Gjithsej banesa | Banesat për kah sipërfaqa për një person | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | deri në 4 $m^2$ | 4.1-6.0 | 6.1-8.0 | 8.1-10 | 10.1-12 | 12.1-15 | 15.1-20 | 20.1-25 | 25.1-30 | 30.1-40 | Mbi 40 $m^2$ |
| **Viti** | 7,491 | 164 | 487 | 917 | 917 | 897 | 1,083 | 1,387 | 578 | 327 | 380 | 354 |
| **1 dhomëshe** | 84 | 43 | 15 | 8 | 3 | 2 | 1 | 7 | 2 | 2 | - | 1 |
| **2 dhomëshe** | 637 | 49 | 120 | 182 | 85 | 67 | 40 | 43 | 13 | 8 | 21 | 9 |
| **3 dhomëshe** | 1,257 | 33 | 138 | 253 | 224 | 178 | 144 | 129 | 62 | 28 | 31 | 37 |
| **4 dhomëshe** | 2,152 | 26 | 132 | 279 | 300 | 313 | 352 | 366 | 143 | 74 | 99 | 68 |
| **5 +dhomëshe** | 3,361 | 13 | 82 | 195 | 305 | 337 | 546 | 842 | 358 | 215 | 229 | 239 |

Përveç funksionit të banimit, një numër jo i madh i banesave në këtë komunë shfrytëzohen edhe për veprimtari afariste. Janë gjithsej 216 banesa apo 2.8% prej tyre që shfrytëzohen për afarizëm. Banesat për afarizëm poashtu dominojnë në zonat rurale. Edhe për afarizëm, dominojnë banesat me hapësirë më të madhe siç janë ato me pesë e më tepër dhoma.

Tabela 64 Banesat në të cilat ushtrohet veprimtaria afariste sipas numrit të dhomave të njësisë banesore dhe numrit të dhomave të shfrytëzuar për qëllime afariste [19]

| Komuna dhe struktura e dhomave | Gjithsej | | | | | | Urban | Rural |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Gjithsej | 1 | 2 | 3 | 4 | 5+ | | |
| **Viti** | 216 | 126 | 63 | 16 | 6 | 5 | 91 | 125 |
| **1 dhomëshe** | - | - | - | - | - | - | - | - |
| **2 dhomëshe** | 6 | 5 | 1 | - | - | - | 4 | 2 |

[17] Banesat dhe ndërtesat sipas komunave; Agjencia e statistikës së Kosovës, dhjetor 2013)

[18] Banesat dhe ndërtesat sipas komunave; Agjencia e statistikës së Kosovës, dhjetor 2013)

[19] Banesat dhe ndërtesat sipas komunave; Agjencia e statistikës së Kosovës, dhjetor 2013)

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **3 dhomëshe** | 18 | 7 | 10 | 1 | - | - | 9 | 9 |
| **4 dhomëshe** | 40 | 29 | 10 | - | 1 | - | 18 | 22 |
| **5 + dhomëshe** | 152 | 85 | 42 | 15 | 5 | 5 | 60 | 92 |

Banesat që shfrytëzohen për veprimtari afariste kanë kryesisht hapësirë të vogël, që janë të mjaftueshme për zhvillimin e aktivitetit varësisht nga qëllimi. Gjysma e banesave që shfrytëzohen për afarizëm kanë deri në 40 m$^2$.

Tabela 65 Banesat në të cilat ushtrohet veprimtaria afariste sipas sipërfaqes në m2 dhe numrit të dhomave të shfrytëzuara për qëllime afariste [20]

| **Komuna** | | **Gjithsej** | **Sipërfaqja e dhomave për qëllime afariste** | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | < 20 m$^2$ | 21-30 | 31-40 | 41-50 | 51-60 | 61-70 | 71-80 | 81-100 | 101-120 | 120+ |
| **Viti** | Gjithsej | 216 | 37 | 28 | 48 | 21 | 22 | 18 | 13 | 9 | 6 | 1 |
| | 1 dhomë | 126 | 37 | 22 | 18 | 10 | 12 | 7 | 6 | 4 | 3 | 7 |
| | 2 dhoma | 63 | - | 6 | 29 | 6 | 5 | 6 | 5 | 2 | 2 | 2 |
| | 3 dhoma | 16 | - | - | 1 | 5 | 3 | 2 | - | 2 | 1 | 2 |
| | 4 dhoma | 6 | - | - | - | - | 1 | 3 | 1 | - | - | 1 |
| | 5+ dhoma | 5 | - | - | - | - | 1 | - | 1 | 1 | - | 2 |

Në komunën e Vitisë dominojnë ndërtesat me etazhitet të ulët kryesisht një dhe dy katëshe. Janë gjithsej 6486 ndërtesa, apo rreth 90% e totalit të ndërtesave, që kanë nga një dhe dy kate. Numri i ndërtesave me etazhitet me mbi pesë kate është shumë më i ulët.

Tabela 66 Ndërtesat me të paktën një banesë të zakonshme të shfrytëzuar sipas llojit, tipit të vendbanimit dhe numrit të kateve[21]

| **Lloji i ndërtesës** | **Tipi i vendbanimit** | | | **Numri i etazhave të ndërtesës** | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Gjithsej | Urban | Rural | Gjithsej | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6-9 | 10-14 | 15+ |
| **Viti** | 7163 | 733 | 6430 | 7163 | 1731 | 4755 | 607 | 57 | 7 | 4 | - | 2 |
| **Për banim** | 7158 | 732 | 6426 | 7158 | 1730 | 4752 | 607 | 56 | 7 | 4 | - | 2 |
| **Jo për banim** | 5 | 1 | 4 | 5 | 1 | 3 | - | 1 | - | - | - | - |

Në Komunën e Vitisë përqindja më e madhe e banorëve jetojnë në zonat rurale të cilat karakterizohen me ndërtesa individuale të banimit, ndësa ndërtesat shumë-banesore i hasim në qendër të qytetit, përgjatë rrugëve kryesore. Bazuar në llojin e ndërtesës, Vitia karakterizohet me numër më të lartë të shtëpive të veçuara - të ndara në mes vete, ndërsa përqindja e ndërtesave shumë-banesore dhe tipologjitë e tjera, kanë përqindje më të ulët.

Tabela 67 Ndërtesat sipas llojit dhe tipit të vendbanimit[22]

| **Komuna,tipi i vendbanimit** | **Lloji i ndërtesës** | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Gjithsej | Shtëpi e vequar e ndarë në vete | Shtëpi gjysmë e ndarë | Rresht apo varg shtëpishë (me të paktën tri banesa të lidhura apo të ngjitura secila me dalje të veçantë jashtë) | Ndërtesë ose blloqe apartamentesh | Tjetër |

[20] Banesat dhe ndërtesat sipas komunave; Agjencia e statistikës së Kosovës, dhjetor 2013)

[21] Banesat dhe ndërtesat sipas komunave; Agjencia e statistikës së Kosovës, dhjetor 2013)

[22] Banesat dhe ndërtesat sipas komunave; Agjencia e statistikës së Kosovës, dhjetor 2013)

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Viti** | 7,158 | 6,956 | 148 | 30 | 20 | 4 |
| **Urban** | 732 | 652 | 45 | 18 | 14 | 3 |
| **Rural** | 6,426 | 6,304 | 103 | 12 | 6 | 1 |

Nëse analizojmë kohën e ndëtimit, atëherë mund të konstatojmë se numri më i madh i objektëve janë ndërtuar në periudhën e pas vitit 1999. Prej vitit 1999 deri 2011 janë ndërtuar gjithsej 2390 objekte apo rreth 33%. Në periudhën 1990-1999 janë ndërtuar 1920 objekte, në periudhën 1980-1989 janë ndërtuar 1524 objekte dhe të tjerat para vitit 1980.

Tabela 68 Ndërtesat sipas llojit, vitit të ndërtimit dhe etazhitetit[23]

| **Etazhiteti** | **Viti i ndërtimit** | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Gjithsej | <1960 | 1960-196 | 1970-197 | 1980-198 | 1990-199 | 2000 | 2001 | 2002 | 2003 | 2004 | 2005 | 2006 | 2007 | 2008 | 2009 | 2010 | 2011 |
| **Viti** | 7,163 | 134 | 198 | 710 | 1,524 | 1,920 | 287 | 285 | 308 | 274 | 241 | 268 | 205 | 207 | 206 | 205 | 181 | 10 |
| **1 katësh** | 1,731 | 72 | 123 | 444 | 465 | 231 | 37 | 28 | 42 | 27 | 37 | 43 | 26 | 31 | 45 | 35 | 41 | 4 |
| **2 katësh** | 4,755 | 58 | 73 | 254 | 924 | 1,382 | 216 | 232 | 240 | 226 | 182 | 198 | 161 | 166 | 151 | 157 | 129 | 6 |
| **3 katësh** | 607 | 3 | 2 | 8 | 123 | 284 | 29 | 24 | 22 | 15 | 21 | 24 | 13 | 7 | 10 | 11 | 11 | - |
| **4 katësh** | 57 | 1 | - | 3 | 9 | 20 | 4 | 1 | 3 | 6 | 1 | 3 | 4 | 1 | - | 1 | - | - |
| **5 katësh** | 7 | - | - | - | 2 | 2 | 1 | - | 1 | - | - | - | 1 | - | - | - | - | - |
| **6-9 katësh** | 4 | - | - | 1 | 1 | 1 | - | - | - | - | - | - | - | 1 | - | - | - | 4 |
| **10-14 katësh** | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - |
| **15+ katësh** | 2 | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | 1 | - | 1 | - | - |
| **Për banim** | 7,158 | 134 | 198 | 708 | 1,521 | 1,920 | 287 | 285 | 308 | 274 | 241 | 268 | 205 | 207 | 206 | 205 | 181 | 10 |
| **1 katësh** | 1,730 | 72 | 123 | 443 | 465 | 231 | 37 | 28 | 42 | 27 | 37 | 43 | 26 | 31 | 45 | 35 | 41 | 4 |
| **2 katësh** | 4,752 | 58 | 73 | 253 | 922 | 1,382 | 216 | 232 | 240 | 226 | 182 | 198 | 161 | 166 | 151 | 157 | 129 | 6 |
| **3 katësh** | 607 | 3 | 2 | 8 | 123 | 284 | 29 | 24 | 22 | 15 | 21 | 24 | 13 | 7 | 10 | 11 | 11 | - |
| **4 katësh** | 56 | 1 | - | 3 | 8 | 20 | 4 | 1 | 3 | 6 | 1 | 3 | 4 | 1 | - | 1 | - | - |

[23] Banesat dhe ndërtesat sipas komunave; Agjencia e statistikës së Kosovës, dhjetor 2013)

| | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 5 katësh | 7 | - | - | - | 2 | 2 | 1 | - | 1 | - | - | - | 1 | - | - | - | - | - |
| 6-9 katësh | 4 | - | - | 1 | 1 | 1 | - | - | - | - | - | - | - | 1 | - | - | - | - |
| 10-14 katësh | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - |
| 15+ katësh | 2 | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | 1 | - | 1 | - | - |
| Jo për banim | 5 | - | - | 2 | 3 | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - |
| 1 katësh | 1 | - | - | 1 | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - |
| 2 katësh | 3 | - | - | 1 | 2 | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - |
| 3 katësh | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - |
| 4 katësh | 1 | - | - | - | 1 | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - |
| 5 katësh | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - |
| 6-9 katësh | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - |
| 10-14 katësh | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - |
| 15+ katësh | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - |

Sa i përket numrit të banesave në ndërtesë, kemi 7,163 ndërtesa me së paku një banesë të zakonshme të banueshme. Pastaj kemi mesatarisht 1,017 banesa në ndërtesë dhe gjithashtu kemi 2861 banesa të zbrazëta.

Tabela 69 Ndërtesat sipas numrit të ndërtesave[24]

| Komuna | Ndërtesë me së paku një banesë të banueshme të zakonshme | Numri mesatar i banesave për ndërtesë | Numri i banesave të zakonshme | Numri i banesave të zbrazëta |
|---|---|---|---|---|
| Viti | 7.163 | 1.17 | 8.369 | 2.861 |

Numri mesatar i ekonomive familjare për banesë është 1, ndërsa mesatarja e sipërfaqës së shfrytëzuar për kokë banori është 13.4m.

Tabela 70 Numri i banesave të zakonshme, numri mesatar i ekonomive familjare dhe mesatarja e sipërfaqes së shfrytëzuar për kokë banori[25]

[24] https://ask.rks-gov.net/media/2074/te-dhenat-kryesore.pdf;

[25] https://ask.rks-gov.net/media/2074/te-dhenat-kryesore.pdf;

| Komuna | Numri i banesave të zakonshme të banueshme | Numri mesatar i ekonomive familjare për banesë | Mesatarja e sipërfaqes së shfrytëzuar për kokuar (për kokë banori) |
|---|---|---|---|
| Viti | 7.491 | 1.00 | 13.4 |

Bazuar në numrin e antarëve të familjes, në Komunën e Vitisë dominojnë familjet me pesë dhe gjashtë anëtarë, ndërsa familjet me një, dy dhe tre antarë kanë një përqindje më të ulët.

Tabela 71 Ekonomitë familjare private sipas numrit të anëtarëve të komunës[26]

| Komuna | Numri i antarëve të ekonomisë familjare | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10+ | Gjithsej |
| Viti | 147 | 343 | 424 | 990 | 1,476 | 1,356 | 982 | 544 | 364 | 894 | 7,520 |

Tabela 72 Banesat e banuara të zakonshme sipas periudhës së ndërtimit të ndërtesës[27]

| Komuna | Periudha e ndërtimit | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | <1960 | 1960-1969 | 1970-1979 | 1980-1989 | 1990-1999 | 2000-2009 | 2010 | 2011 | Gjithsej |
| Viti | 152 | 209 | 751 | 1,632 | 2,004 | 2,549 | 184 | 10 | 7,491 |

## 2.12.1. Banimi social

Në Republikën e Kosovës shumë pak është trajtuar dhe dokumentuar qështja e strehimeve publike në përgjithësi, e aq më pak ajo e ndërtesave sociale. Pas vitit 2000 të gjitha ndërtesat si individuale ashtu edhe ato shumë-banesore u ndërtuan nga sektori privat, ndërsa sektori publik ishte ai i cili i ndërtoi vetëm një numër të vogël të ndërtesave sociale të banimit. Pas vitit 1999 këto ndërtesa janë ndërtuar me sistem skeletor dhe blloqe nga argjila, karakteristikë e së cilave është mungesa e ashensorëve pa marr parasyshë faktin se aty jeton një numër i konsideruar i banorëve me atësi të kufizuara. Sygjerimet për politikat e reja në fushën e banimit social të cilat do të ndërtohen në të ardhmen do të kishin efekte pozitive në aspektin social për banorët. Prandaj është shumë me rëndësi të shqyrtohen mënyra dhe strategji të ofrimit të një strehimi adekuat. Në vitin 2012, nga ana e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale në Viti është ndërtuar një ndërtesë shumë-banesore, e cila posedon 25 njësi banesore. Ndërtesa posedon 5 njësi banesore dy dhomëshe si dhe 20 njësi banesore tre dhomëshe.

Tabela 73 Numri i njësive banesore; Viti 2012

| Viti 2012-Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale | |
|---|---|
| Banesa dy dhomëshe | Banesa tre dhomëshe |
| 5 | 20 |
| Gjithsej; 25 njësi banesore | |

Gjatë hulumtimeve të bëra, e ku janë pëfshirë 88 % e banorëve të cilët jetojnë në atë ndërtesë shumë-banesore, është kuptuar se banorët nuk janë të kënaqur me njësitë banesore në të cilat ata jetojnë, ndërsa përqindja më e madhe e banorëve janë shprehur se ata janë të kënaqur me lokacionin ku ndodhet ndërtesa, por ndihen të diskriminuar nga pjesa tjetër e popullsisë. Prandaj, është i rëndësishëm fokusimi në ndërtimin e njësive banimore më të mëdha për familjet me asistencë sociale, dhe ato me patjetër t'i plotësojnë kriteret minimale të projektimit.

[26] https://ask.rks-gov.net/media/2074/te-dhenat-kryesore.pdf

[27] https://ask.rks-gov.net/media/2074/te-dhenat-kryesore.pdf;

## 2.13. SHFRYTËZIMI AKTUAL I TOKËS

Komuna e Vitisë ka një sipërfaqe totale prej 26.950.57 ha, nga e cila 45.57% janë pyje dhe kullosa, 41.04% janë tokë bujqësore, 10.77% banim i përhershëm, 0.56% rrjetet e transportit, 0.76% industri dhe pjesa tjetër e territorit të komunës shfrytëzohet nga kategori të tjera si në tabelën më poshtë.

Tabela 74 Shfrytëzimi aktual i tokës në komunën e Vitisë

| KODI HILUCS | LLOJI I SHFRYTËZIMIT | SIPERFAQJA (Ha) | % |
|---|---|---|---|
| 1.1. | Bujqësi | 11061.7 | 41.04% |
| 1.2. | Pylltari | 12281.89 | 45.57% |
| 2.2. | Industri prodhimeve të rënda | 168.9 | 0.63% |
| 2.3. | Industri e prodhimeve të lehta | 36.1 | 0.13% |
| 2.4. | Prodhim i energjisë | 31.4 | 0.12% |
| 3.1. | Shërbim tregtar | 90.2 | 0.33% |
| 3.3. | Shërbim i komunitetit | 106.4 | 0.39% |
| 3.4. | Shërbim kulturor, argëtues dhe rekreativ | 10.6 | 0.04% |
| 4.1. | Rrjetet e transportit | 150.7 | 0.56% |
| 5.1. | Banim i përhershëm | 2902.8 | 10.77% |
| 6.3 | Siperfaqe Ujore | 107.7 | 0.40% |
| | **TOTALI** | **26950.57 Ha** | **100%** |

*Sipërfaqet Bujqësore* shtrihen kryesisht në pjesën qendrore të komunës dhe përbëhen nga tokat pjellore të kualitetit të lartë. Përveç pjesës qendrore, tokat bujqësore shtrihen edhe në pjesën jugore, veriore dhe veri-lindore të komunës. Zonat kadastrale të cilat dominohen plotësisht dhe/ose në masë të madhe nga toka bujqësore (bashkë me sipërfaqet e ndërtuara) janë si vijon: Vitia, Pozharani, Ramjani, Sllatina, Tersteniku, Sadovina e Çerkezëve, Sadovina e Jerlive, Gërmova, Vërbani, Gushica, Drobeshi, Smira, Kabashi, Begunca, Ramnishta, Lubishta, Gjylekari, Remniku, Budriga e Epërme, Radivojci, Devaja, Zhitia, Tërpeza dhe Çifllaku.

*Sipërfaqet Pyjore* shtrihen kryesisht në pjesën jugore, jug-lindore, lindore si dhe në pjesën më verirore të komunës, ndërsa zonat kadastrale me sipërfaqet më të mëdha pyjore janë si vijon: Smira, Vërnezi, Binça, Debelldeh, Gushica, Lubishtja dhe Shasharja.

*Sipërfaqja e Ndërtuar:* Zonat kadastrale me më së shumti sipërfaqe të ndërtuar janë si vijon: Vitia me 426,92 Ha., Pozharani me 236.82 Ha., Sllatina me 209 Ha., Gjylekari me 171 Ha., Sadovina e Çerkezëve me 142.85 Ha., Remniku me 136.58 Ha., Tërpeza me 132.93 Ha. dhe Kabashi me 131.48 Ha., sipërfaqe të ndërtuar.

Ndërsa pesë zonat kadastrale me sipërfaqen më të vogël të ndërtuar janë si vijon: Godeni i Madh me 9.83 Ha., Çıfllaku me 10.06 Ha., Mjaku me 1.30 Ha., Stublla e Poshtme me 8.43 Ha. dhe Vërnezi me 14.17 Ha. sipërfaqe të ndërtuar.

Përveç kësaj, me PZHK 2010-2020+ është paraparë edhe ruatja dhe zgjerimi i Zonës Ekonomike në Viti, me sipërfaqe prej 141.5 Ha., si dhe ndërtimi i katër zonave të reja ekonomike dhe atë si vijon: Zona Ekonomike në Budrigë të Epërme me gjithësej 31.97 Ha., Zona Ekonomike në Sllatinë me 3.6 Ha., Zona Ekonomike në Sadovinë të Jerlive me 42.6 Ha. si dhe Zona Ekonomike në Drobesh me 27.99 Ha.. Të gjitha këto zona ekonomike zënë një sipërfaqe totale prej 247.68 Ha..

Sa i përket sipërfaqes rrugore, zona kadastrale me sipërfaqen më të madhe rrugore është Vitia me 18.18 Ha., e pasuar nga Pozharani me 11.64 Ha., Smira me 6.86 Ha., Begunca me 6.29 Ha., Gjylekari me 6.18 dhe Kabashi me 6.15 Ha. sipërfaqe rrugore.

Sa i përket sipërfaqes ujore, në komunën e Vitisë kemi vetëm 107.70 Ha. sipërfaqe ujore.




Harta 27 Shfrytëzimi aktual i tokës

Më poshtë është paraqitur tabela e Shfrytëzimit të Tokës në komunën e Vitisë sipas vendbanimeve:

Tabela 75 Shfrytëzimi aktual I tokës në komunën e Vitisë, sipas vendbanimeve

| Vendbanimi | Sip. Bujqësore | Sip. Pyjore | Sip. e Ndërtuar | Sip. Rrugore |
|---|---|---|---|---|
| Ballancë | 162.61 | 548.26 | 44.29 | 2.76 |
| Beguncë | 334.14 | 16.90 | 129.49 | 6.29 |
| Binçë | 223.07 | 904.00 | 84.15 | 4.53 |
| Budrikë e Epërme | 352.23 | | 91.82 | 3.49 |
| Buzovik | 204.92 | 314.06 | 36.98 | 2.83 |
| Çifllak | 124.27 | | 10.06 | 0.72 |
| Debelldeh | 72.09 | 805.66 | 34.67 | 3.18 |
| Devajë | 176.76 | 169.94 | 18.05 | 1.40 |
| Drobesh | 187.71 | | 103.30 | 4.76 |
| Gërmovë | 522.80 | 18.39 | 79.14 | 3.13 |
| Goden i Madh | 49.75 | 131.75 | 9.83 | 1.08 |
| Gushicë | 317.47 | 775.02 | 60.57 | 3.53 |
| Gjylekar | 509.77 | 403.54 | 171.09 | 6.18 |
| Kabash | 235.11 | 349.32 | 131.48 | 6.15 |
| Letnicë | 46.65 | 352.39 | 34.07 | 1.15 |
| Lubishtë | 278.70 | 708.90 | 92.15 | 3.37 |
| Mjak | | 602.53 | 1.30 | 1.34 |
| Novosellë | 218.28 | 206.31 | 47.96 | 1.13 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Podgorc | 109.70 | 170.60 | 43.41 | 3.82 |
| Pozharan | 853.48 | | 236.82 | 11.64 |
| Radivojc | 275.44 | | 90.44 | 3.45 |
| Ramjan | 507.96 | 74.43 | 88.31 | 2.72 |
| Ramnishtë | 61.88 | | 32.88 | 1.62 |
| Remnik | 325.15 | 606.35 | 136.58 | 4.97 |
| Sadovinë e Çerkezve | 629.05 | 59.35 | 142.95 | 4.00 |
| Sadovinë e Jerlive | 195.38 | 24.02 | 66.15 | 4.38 |
| Sllatinë | 901.72 | 28.84 | 209.05 | 5.65 |
| Smirë | 351.18 | 1,202.26 | 146.33 | 6.86 |
| Stubëll e Epërme | 101.71 | 423.01 | 118.06 | 3.83 |
| Stubëll e Poshtme | 44.39 | 110.90 | 8.43 | 0.35 |
| Shashare | 259.21 | 751.78 | 34.96 | 1.39 |
| Tërpezë | 473.43 | 715.52 | 132.93 | 4.55 |
| Tërstenik | 225.29 | 13.25 | 122.90 | 2.45 |
| Vërban | 307.95 | 381.33 | 120.11 | 4.48 |
| Vërnakollë | 79.32 | 431.39 | 36.03 | 1.91 |
| Vërnez | 13.52 | 809.31 | 14.17 | 0.1 |
| Viti | 706.72 | | 426.92 | 18.18 |
| Zhiti | 703.18 | 91.22 | 69.82 | 3.07 |
| | 11,141.98 | 12,200.51 | 3,457.63 | 168.89 |
| TOTAL | | | | |

Një ndër elementet bazë për të përcaktuar kërkesën për tokë të nevojshme për të akomoduar zhvillimin e ardhshëm është dendësia e banimit. Dendësia neto e banimit është përcaktuar duke ndarë/pjesëtuar numrin e njësive të banimit me sipërfaqen për banim.

Tabela 76 Dendësia Banimore e vendbanimeve

| Zona | Vendbanimi | Sipërfaqja për banim (ha) | Totali i njësive të banimit | Dendësia banimore (njësi banimi/ha) |
|---|---|---|---|---|
| Urbane | Viti | 247.13 | 965 | 4 |
| Rurale | Ballancë | 40.12 | 100 | 3 |
| Rurale | Beguncë | 127.01 | 339 | 3 |
| Rurale | Binçë | 79.56 | 179 | 3 |
| Rurale | Budrikë e Epërme | 73.63 | 143 | 2 |
| Rurale | Buzovik | 33.28 | 83 | 3 |
| Rurale | Çifllak | 8.24 | 14 | 2 |
| Rurale | Debelldeh | 28.22 | 54 | 2 |
| Rurale | Devajë | 16.42 | 46 | 3 |
| Rurale | Drobesh | 93.71 | 293 | 3 |
| Rurale | Gërmovë | 77.85 | 141 | 2 |
| Rurale | Goden i Madh | 8.30 | 13 | 2 |
| Rurale | Gushicë | 53.60 | 127 | 3 |
| Rurale | Gjylekar | 148.65 | 397 | 3 |
| Rurale | Kabash | 123.12 | 369 | 3 |
| Rurale | Letnicë | 32.30 | 42 | 2 |
| Rurale | Lubishtë | 88.09 | 229 | 3 |
| Rurale | Mjak | 1.30 | 0 | 0 |
| Rurale | Novosellë | 33.33 | 87 | 3 |
| Rurale | Podgorc | 27.38 | 60 | 3 |
| Rurale | Pozharan | 221.73 | 674 | 3 |
| Rurale | Radivojcë | 89.84 | 198 | 2 |
| Rurale | Ramjan | 82.15 | 142 | 2 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Rurale | Ramnishtë | 32.74 | 70 | 2 |
| Rurale | Remnik | 106.38 | 293 | 3 |
| Rurale | Sadovinë e Jerlive | 56.45 | 175 | 3 |
| Rurale | Smirë | 144.83 | 615 | 4 |
| Rurale | Sadovinë e Çerkezve | 109.69 | 200 | 2 |
| Rurale | Sllatinë e Epërme | 112.97 | 368 | 3 |
| Rurale | Sllatinë e Poshtme | 6.84 | 187 | 3 |
| Rurale | Shashare | 29.31 | 23 | 1 |
| Rurale | Tërpezë | 118.66 | 289 | 2 |
| Rurale | Tërstenik | 54.119 | 122 | 2 |
| Rurale | Vërban | 106.97 | 319 | 3 |
| Rurale | Vërnakollë | 35.35 | 2 | 1 |
| Rurale | Vërnez | 14.16 | 1 | 1 |
| Rurale | Zhiti | 56.37 | 96 | 2 |

# 3. VLERËSIMI I GJENDJES EKZISTUESE

## 3.1. DEMOGRAFIA

### 3.1.1. Projeksonet e popullsisë

Bazuar në elementet bazë të zhvillimit demografik në komunën e Vitis, janë dhënë edhe rezultatet e parashikimit demografik. Këto rezultate japin vlera për rritjen e popullsisë dhe parashikimin demografik për të ardhmen deri në vitin 2030. Gjatë vlerësimit të popullsisë për komunën e Vitisë deri në vitin 2030 janë llogaritur dy komponentët themelore që ndikojnë drejtpërdrejtë në rritjen demografike siç janë: shtimi natyror dhe migrimi. Sipas të dhënave për numrin e lindjeve dhe të vdekjeve për vitin 2020 në komunën e Vitisë është llogaritur edhe shkalla e shtimit natyrorë që është 8.4 promil apo 0.84 përqind. Gjithashtu sipas të dhënave nga Agjencia e Statistikave të Kosovës rreth migrimit, komuna e Vitisë ka një bilanc negativ si në migrimin nderkombëtar ashtu edhe në migrimin kombëtar. Sipas të dhënave nga regjistrimi i popullsisë i realizuar në vitin 2011, kjo komunë kishte bilanc negativ të migrimit nderkombëtar me -21.9 banor, që nënkupton se kemi një bilanc negativ vjetor prej -21.9 personave në 1,000 banorë. Gjithashtu, komuna e vitis ka bilanc negativ edhe në migrimin e brendshë me -3.1 banor. Nëse llogaritet bilanci migrues kombëtar dhe ndërkombëtar së bashku, atëherë kjo komunë ka një bilancë migrues negativ me – 25 apo shprehur në përqindje kemi 2.5 përqind.

Bazuar në këtë shkallë të lartë të migrimit në komunën e Vitisë, numri i popullsisë do të shënoj rënie deri në vitin 2030. Sipas vlerësimit për vitin 2020, komuna kishte 47896 banorë dhe në vitin 2030 do të ketë 40711 apo 7185 banorë më pak.

Për përcaktimin e parashikimit demografik, analizat janë mbështetur në të dhënat zyrtare nga ASK për vitin 2020. Gjithashtu janë marrë elementet bazë që ndikojnë në parashikimin demografik si nataliteti dhe mortaliteteti si dhe emigrimi dhe imigrimi dhe atë sipas formulës së përcaktuar:

*P1=P0+(L-V)+(I-E), ku:*

*P1-Vlerësimi i popullsisë në fund të vitit*

*P0-Numri mesatar i popullsisë në mes të vitit*

*L-Lindjet*

*V-Vdekjet*

*I-Imigrimi*

*E-Emigrimi*

Në tabelën në vazhdim është dhënë tabela ku është paraqit trendi i popullsisë në komunën e Vitis nga viti 2012 deri në vitin 2020.

Tabela 77 Popullsia e kounës së Vitisë e vlerësuar sipas viteve

| Viti | Nr. i banoreve | % |
|---|---|---|
| **2012** | 47636 | 1.3 |
| **2013** | 47775 | 0.3 |
| **2014** | 47434 | -0.7 |
| **2015** | 46742 | -1.5 |
| **2016** | 47202 | 0.9 |

| | | |
|---|---|---|
| **2017** | 47615 | 0.8 |
| **2018** | 47681 | 0.1 |
| **2019** | 47507 | -0.3 |
| **2020** | 47896 | 0.8 |
| **2012-2020** | 260 | 0.54 |

Sipas vlerësimit zyrtar të paraqitur nga ASK, komuna e Vitis gjatë periudhës 2012 deri 2020 kishte rritje të vogël të popullsisë me 260 banorë më shumë apo 0.54%. Kjo paraqet mesataren vjetore dhe nese e paraqesim me këtë trend numrin e popullsisë për vitin 2030, atëherë popullsia në komunën e Vitisë do të jetë 50,236 banorë në vitin 2030.

Tabela 78 Popullsia rezidente dhe emigrantët e parashikuar për vitin 2030

| | 2011 | 2020 | 2030 |
|---|---|---|---|
| **Popullsia rezidente** | 46987 | 47896 | 50236 |
| **Emigrimi** | 13180 | 13803 | 14582 |
| **Gjithsej** | 60167 | 61926 | 64818 |

Në këtë tabelë është dhënë edhe numri i emigrantëve që është marrë nga mesatarje vjetrore e numrit të migrimit për vitet 2012-2020 dhe ai numër është shtuar në vitët vijuese. Në bazë këtij parashikimi, numri i përgjithshëm i banorëve në komunën e Vitis do të jetë 64895 banorë ku janë përfshi popullsia rezidente dhe ajo që ka emigruar.

Skenari i fundit i parashikimit të popullsisë është ai që bazohet në shtimin natyror prej +0.84%, ku popullsia e Vitis në vitin 2030 do ti ketë 51,516. Nëse kësaj ja llogaritim edhe mesatarën e numrit të emigrantëve që kanë lëshuar vendin për periudhën 2012 deri 2020, atëherë numri i përgjithshëm i emigranteve në vitin 2030 do të jetë 779 banorë. Pra numri i popullsisë në vitin 2030 për komunën e Vitis bazuar në shtimin natyror do të jetë 51,516 dhe 779 më pak që kanë migruar, atëherë nuri i popullsisë në vitin 2030 do të jetë 50,737.

Tabela 79 Parashikimi i popullsisë sipas natalitetit dhe numrit të emigrantëve për vitin 2030

| | 2011 | 2020 | 2030 |
|---|---|---|---|
| **Popullsia rezidente** | 46987 | 47896 | 50,737 |
| **Emigrimi** | 13180 | 13803 | 14582 |
| **Gjithsej** | 60167 | 61699 | 65319 |

Sipas këtij parashikimi, numri popullsisë në komunën e Vitis do të jetë 50,737 banorë dhe kur i shtohet edhe numri i emigranteve prej 14659, atëherë numri i përgjithshëm i popullsisë do të jetë 65,396 banorë.

Tabela 80 Projeksionet e popullsisë për komunë 2011 - 2030

| Viti | Ekonomitë Familjare | | Popullsia | |
|---|---|---|---|---|
| | Komuna | Qyteti | Komuna | Qyteti |
| **2011** | 7520 | 895 | 46987 | 4924 |
| **2020** | 7664 | 910 | 47896 | 5019 |
| **2030** | 8105 | 957 | 50737 | 5317 |

### 3.1.2. Projeksionet e popullsisë sipas vendbanimeve

Në vazhdim janë dhënë projeksionet për numrin e popullsisë dhe ekonomive familjare sipas vendbanimeve në komunën e Vitisë deri në vitin 2030.

Tabela 81 Projeksionet e popullsisë dhe ekonomive familjare sipas vendbanimeëve

| Vendbanimi | Viti 2020 | | Projeksioni 2030 | | Rritja në bazë të projeksionit | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Popullsia | Ekonomi familjare | Popullsia | Ekonomi familjare | Popullsia | Ekonomi familjare |
| Ballancë | 643 | 98 | 681 | 104 | 38 | 6 |
| Beguncë | 2174 | 328 | 2303 | 348 | 129 | 20 |
| Binçë | 1149 | 187 | 1218 | 197 | 69 | 10 |
| Budrikë e Epërme | 915 | 149 | 969 | 157 | 54 | 8 |
| Buzovik | 531 | 77 | 563 | 82 | 32 | 5 |
| Çifllak | 92 | 17 | 98 | 18 | 6 | 1 |
| Debelldeh | 346 | 50 | 367 | 53 | 21 | 3 |
| Devajë | 298 | 46 | 316 | 49 | 18 | 3 |
| Drobesh | 1880 | 303 | 1992 | 320 | 112 | 17 |
| Gërmovë | 903 | 141 | 957 | 150 | 54 | 9 |
| Goden i Madh | 82 | 11 | 87 | 12 | 5 | 1 |
| Gushicë | 817 | 139 | 866 | 147 | 49 | 8 |
| Gjylekar | 2547 | 361 | 2698 | 385 | 151 | 24 |
| Kabash | 2369 | 398 | 2510 | 420 | 141 | 22 |
| Letnicë | 272 | 54 | 288 | 56 | 16 | 2 |
| Lubishtë | 1473 | 221 | 1561 | 235 | 88 | 14 |
| Mjak | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Novosellë | 557 | 97 | 590 | 102 | 33 | 5 |
| Podgorc | 386 | 64 | 409 | 67 | 23 | 3 |
| Pozharan | 4329 | 727 | 4586 | 768 | 257 | 41 |
| Radivojc | 1269 | 212 | 1344 | 224 | 75 | 12 |
| Ramjan | 912 | 145 | 966 | 153 | 54 | 8 |
| Ramnishtë | 446 | 69 | 473 | 73 | 27 | 4 |
| Remnik | 1880 | 271 | 1992 | 288 | 112 | 17 |
| Sadovinë e Çerkezve | 1286 | 201 | 1352 | 211 | 66 | 10 |
| Sadovinë e Jerlive | 1122 | 178 | 1189 | 188 | 67 | 10 |
| Sllatinë e Epërme | 2362 | 388 | 2502 | 410 | 140 | 22 |
| Sllatinë e Poshtme | 1200 | 181 | 1271 | 192 | 71 | 11 |
| Smirë | 3947 | 581 | 4181 | 618 | 234 | 37 |
| Stubëll e Epërme | 1150 | 190 | 1219 | 201 | 69 | 11 |
| Stubëll e Poshtme | 78 | 18 | 83 | 19 | 5 | 1 |
| Shashare | 149 | 20 | 158 | 21 | 9 | 1 |
| Tërpezë | 1853 | 277 | 1963 | 294 | 110 | 17 |
| Tërstenik | 784 | 117 | 831 | 124 | 47 | 7 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Vërban** | 2047 | 323 | 2169 | 342 | 122 | 19 |
| **Vërnakollë** | 13 | 2 | 14 | 2 | 1 | 0 |
| **Vërnez** | 1 | 0 | 2 | 0 | 1 | 0 |
| **Viti** | 5019 | 910 | 5317 | 957 | 298 | 47 |
| **Zhiti** | 615 | 113 | 652 | 118 | 37 | 5 |
| **Komuna - Viti** | 47896 | 7664 | 50737 | 8105 | 2841 | 441 |

Gjithashtu janë analizuar edhe projeksionet e popullsisë sipas grup-moshë. Të dhënat janë marrë nga regjistri i popullsisë për vitin 2011 për strukturën e moshës. Më pas janë marr edhe shënimet nga statistikat e lindjeve në komunën e Vitisë për periudhën 2012-2020. Nga të dhënat për lindjet vërejmë se pas vitit 2011 kemi një rënie të natalitetit e cila ka ndikuar edhe në strukturën e popullsisë. Bazuar në këto të dhëna është dhë edhe parashikimi i grup-moshës për vitin 2030.

Tabela 82 Projeksionet e popullsisë sipas grup-moshës

| Viti | 0-4 | 5-9 | 10-14 | 15-19 | 20-24 | 25-29 | 30-34 | 35-39 | 40-44 | 45-49 | 50-54 | 55-59 | 60-64 | 65-69 | 70-74 | 75-79 | 80+ | Gjithsej |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **2011** | 8.7 | 10.2 | 11.3 | 10.9 | 8.8 | 7.4 | 7.1 | 7.4 | 6.4 | 5.3 | 4.0 | 3.1 | 3.0 | 2.5 | 1.7 | 1.3 | 0.9 | 100.0 |
| **2020** | 8.5 | 10.1 | 11.1 | 10.8 | 9.1 | 7.5 | 6.9 | 7.1 | 6.1 | 5.1 | 4.2 | 3.2 | 3.1 | 2.6 | 1.9 | 1.5 | 1.2 | 100.0 |
| **2030** | 8.6 | 9.7 | 10.7 | 10.6 | 8.7 | 8.2 | 7.1 | 6.5 | 6.6 | 5.1 | 4.3 | 3.4 | 2.9 | 2.8 | 2.1 | 1.4 | 1.3 | 100.0 |

### 3.1.3. Vlerësimi i gjendjes

Shikuar në tërësi, në bazë të numrave absolut të banorëve, mund të thuhet që komuna e Vitisë në vazhdimësi ka pasur rritje demografike. E vetmja rënie në numër te popullsisë, për rreth 10,918 banorë është dokumentuar ndërmjet periudhës 1991-2011. Kjo para se gjithash shpjegohet me pasojat e luftës së fundit që ka shkaktuar viktima të shumta, lëvizjen e banorëve brenda dhe jashtë komunës, si dhe efektet e ndryshimit të metodologjisë së regjistrimit në vitin 2011. Megjithatë, të dhënat dëshmojnë rritje konstante te popullsisë për 72 vitet e fundit (1948-2020), në vlerë mesatare prej rreth 286 banorë në vit, që afërsisht kemi dyfishim të numrit të popullsisë brenda kësaj periudhe kohore.

Kjo komunë ka një strukturë gjinore të baraspeshuar. Popullsia aktive, përben 61.8% të popullsisë, grup-mosha 0-14 vjeç merr pjesë me rreth 29% dhe grup-mosha mbi 65 vjeç, vetëm 7.2%.

Dendësia e popullsisë në komunë është rreth 177 banorë/km², ajo më e larta në qytetin e Vitisë dhe disa vendbanime përreth, dërsa në viset më të thella kodrinoro malore, dendësia është më e ulët.

Shtimi natyror i popullsisë në komunë është 8.4 promilë.

| Përparësitë | Dobësitë |
|---|---|
| **61.8% e popullsisë ekonomikisht aktive (15-65 vjeç);**<br>**Shtimi natyror-pozitiv;**<br>**Rritja e vazhdueshme e nivelit arsimor te të rinjët** | Migrimi i banorëve nga komuna;<br>Rënie në trendin e rritjes së popullsisë;<br>Rënie graduale e shkallëve të natalitetit<br>Shkalla e lartë e papunësisë<br>Shkalla e ulët e aktivitetit ekonomik te gjinia femrore |
| **Mundësitë** | **Rreziqet** |
| **Mbështetja e ekonomive familjare, sidomos familjeve te reja;**<br>**Programe socio-ekonomike, me synim te veçantë të rinjtë;** | Largimi i të rinjve jashtë vendit;<br>Largimi i popullsisë ekonomikisht aktive dhe te kualifikuar jashtë vendit; |

| | |
|---|---|
| | Migrimi selektiv: migrimi i burrave/djemve dhe të rinjëve jashtë vendit; |

**Sfidat:**

- Ndalimi i migrimit të banorëve jashtë komunës;
- Ruajtja e trendit të rritjes së popullsisë.

**Nevojat zhvillimore**

- Integrimi i të rinjve në zhvillimet në komunë.
- Zhvillimi i arsimit profesional

## 3.2. KAPACITETET NJERËZORE DHE FINANCIARE

Korniza Afatmesme Buxhetore komunale (KAB) dhe parashikimet për vitin 2030

Në përputhje me kërkesat ligjore, Komuna e Vitisë ka hartuar KAB-in me të cilën është planifikuar buxheti dhe orientimi i shpenzimeve publike në tri vitet e ardhshme 2021-2023, si dhe parashikimet deri në vitin 2030. Planifikimi i politikave në nivel komunal, është bazuar kryesisht në të dhënat e përgjithshme për rritjen buxhetore në nivel të Qeverisë qendrore, siç parashihet në KASH 2021-2023, si dhe bazuar në nevojat zhvillimore drejt sektorëve prioritarë të komunës.

Në bazë të planifikimeve, shpenzimet buxhetore për Komunën e Vitisë do të shënojnë rritje graduale për tre vitet e ardhshme, ndërsa vërehet se buxheti nuk do të pësojë ndryshime të theksuara në strukturën e tij. Krahas rritjes se tërësishme te buxhetit të komunës, shpenzimet kapitale dhe subvencionet gjatë kësaj periudhe tre vjeçare do të shënojnë ngritje të pjesëmarrjes në strukturën e tërësishme të buxhetit. Sipas planifikimeve, buxheti i komunës së Vitisë deri në vitin 2030 do të shënoj një rritje rreth 27%. Gjatë kësaj periudhe kohore, buxheti i komunës së Vitisë planifikohet të shënoj një rritje nga 12,490,686.00 në 17,022,774.75 apo 4,532,088.75 Euro.

Tabela 83 Buxheti per vitin 2021 vleresimet për vitin 2022 dhe 2023 si dhe parashikimet deri vitin 2030

| Nr | Kategoria | Viti 2021 | Viti 2022 | Viti 2023 | Viti 2024 | Viti 2025 | Viti 2026 | Viti 2027 | Viti 2028 | Viti 2030 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Paga dhe meditje | 7,437,105.00 | 7,457,631.00 | 7,494,920.00 | 7,532,394.60 | 7,570,056.57 | 7,645,757.14 | 7,722,214.71 | 7,799,436.86 | 7,877,431.23 |
| 2 | Sherbime dhe mallra | 1,918,949.00 | 2,003,382.00 | 1,966,386.00 | 2,005,713.72 | 2,045,827.99 | 2,107,202.83 | 2,170,418.91 | 2,257,235.67 | 2,347,525.10 |
| 3 | Shpenzime | 320,000.00 | 325,031.00 | 338,574.00 | 345,345.48 | 352,252.39 | 362,819.96 | 373,704.56 | 384,915.70 | 396,463.17 |
| 4 | Subvencione | 350,000.00 | 372,980.00 | 394,920.00 | 402,818.40 | 410,874.77 | 423,201.01 | 435,897.04 | 448,973.95 | 462,443.17 |
| 5 | Investime kapitale | 2,464,632.00 | 3,881,723.00 | 4,187,444.00 | 4,396,816.20 | 4,616,657.01 | 4,893,656.43 | 5,187,275.82 | 5,550,385.13 | 5,938,912.09 |
| | Totali | 12,490,686.00 | 14,040,747.00 | 14,382,244.00 | 14,683,088.40 | 14,995,668.74 | 15,432,637.37 | 15,889,511.04 | 16,440,947.30 | 17,022,774.75 |

Tabela 84 Diferencat buxhetore sipas viteve deri në vitin 2030

| Nr | Kategoritë | Diferenca | Diferenca | Diferenca | Diferenca | Diferenca | Diferenca | Diferenca | Diferenca |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Paga Dhe Meditje | 20,526.00 | 37,289.00 | 37,474.60 | 37,661.97 | 75,700.56 | 76,457.58 | 77,222.15 | 77,994.37 |
| 2 | Sherbime Dhe Mallra | 84,433.00 | -36,996.00 | 39,327.72 | 40,114.27 | 61,374.84 | 63,216.09 | 86,816.75 | 90,289.43 |
| 3 | Shpenzime | 5,031.00 | 13,543.00 | 6,771.48 | 6,906.91 | 10,567.57 | 10,884.60 | 11,211.14 | 11,547.47 |
| 4 | Subvencione | 22,980.00 | 21,940.00 | 7,898.40 | 8,056.37 | 12,326.25 | 12,696.03 | 13,076.91 | 13,469.22 |
| 5 | Investime | 1,417,091.00 | 305,721.00 | 209,372.20 | 219,840.81 | 276,999.42 | 293,619.39 | 363,109.31 | 388,526.96 |
| | Totali | 1,550,061.00 | 341,497.00 | 300,844.40 | 312,580.33 | 436,968.64 | 456,873.67 | 551,436.26 | 581,827.46 |

Tabela 85 Buxheti per vitin 2021 vleresimet për vitin 2022 dhe 2023 si dhe parashikimet deri vitin 2030

| Nr | Kategoria | Viti 2021 | Viti 2022 | Viti 2023 | Viti 2024 | Viti 2025 | Viti 2026 | Viti 2027 | Viti 2028 | Viti 2030 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Paga dhe meditje | 7,437,105.00 | 7,457,631.00 | 7,494,920.00 | 7,532,394.60 | 7,570,056.57 | 7,645,757.14 | 7,722,214.71 | 7,799,436.86 | 7,877,431.23 |
| 2 | Sherbime dhe mallra | 1,918,949.00 | 2,003,382.00 | 1,966,386.00 | 2,005,713.72 | 2,045,827.99 | 2,107,202.83 | 2,170,418.91 | 2,257,235.67 | 2,347,525.10 |
| 3 | Shpenzime | 320,000.00 | 325,031.00 | 338,574.00 | 345,345.48 | 352,252.39 | 362,819.96 | 373,704.56 | 384,915.70 | 396,463.17 |
| 4 | Subvencione | 350,000.00 | 372,980.00 | 394,920.00 | 402,818.40 | 410,874.77 | 423,201.01 | 435,897.04 | 448,973.95 | 462,443.17 |
| 5 | Investime kapitale | 2,464,632.00 | 3,881,723.00 | 4,187,444.00 | 4,396,816.20 | 4,616,657.01 | 4,893,656.43 | 5,187,275.82 | 5,550,385.13 | 5,938,912.09 |
| | Totali | 12,490,686.00 | 14,040,747.00 | 14,382,244.00 | 14,683,088.40 | 14,995,668.74 | 15,432,637.37 | 15,889,511.04 | 16,440,947.30 | 17,022,774.75 |

Tabela 86 Diferencat buxhetore sipas viteve deri në vitin 2030

| Nr | Kategoritë | Diferenca | Diferenca | Diferenca | Diferenca | Diferenca | Diferenca | Diferenca | Diferenca |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Paga Dhe Meditje | 20,526.00 | 37,289.00 | 37,474.60 | 37,661.97 | 75,700.56 | 76,457.58 | 77,222.15 | 77,994.37 |
| 2 | Sherbime Dhe Mallra | 84,433.00 | -36,996.00 | 39,327.72 | 40,114.27 | 61,374.84 | 63,216.09 | 86,816.75 | 90,289.43 |
| 3 | Shpenzime | 5,031.00 | 13,543.00 | 6,771.48 | 6,906.91 | 10,567.57 | 10,884.60 | 11,211.14 | 11,547.47 |
| 4 | Subvencione | 22,980.00 | 21,940.00 | 7,898.40 | 8,056.37 | 12,326.25 | 12,696.03 | 13,076.91 | 13,469.22 |
| 5 | Investime | 1,417,091.00 | 305,721.00 | 209,372.20 | 219,840.81 | 276,999.42 | 293,619.39 | 363,109.31 | 388,526.96 |
| | Totali | 1,550,061.00 | 341,497.00 | 300,844.40 | 312,580.33 | 436,968.64 | 456,873.67 | 551,436.26 | 581,827.46 |

## 3.3. ZHVILLIMI EKONOMIK

Sa i përket klasifikimit të ndërmarrjeve ekonomike sipas pronësisë, në komunën e Vitisë 97.5 % e ndërmarrjeve i takojnë sektorit privat. Kjo don të thotë që zhvillimi ekonomik në komunën e Vitisë, para së gjithash varet nga përkrahja e sektorit privat për të ushtruar dhe për të shtuar aktivitetin ekonomik. Prandaj, politikat për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, para së gjithash, do të orientohen në përkrahjen e sektorit privat, brenda përgjegjësive, kompetencave dhe mundësive të pushtetit lokal.

Sa i përket klasifikimit të sektorëve ekonomik sipas numrit të ndërmarrjeve të regjistruara dhe numrit të të punësuarve, dominojnë: Aktivitet shërbyese (58.2 %), Bujqësia (28.8 % e numrit të përgjithshëm të të punësuarve), Ndërtimtaria (12.3 %) dhe Tregëtia me shumicë dhe pakicë (9.9 %). Ndërësa, në vendin e fundit në këtë klasifikim renditet sektori i Furnizimit me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër për kondicionim (0.3%). Meqenëse komuna e Vitisë ka potencial të mjaftueshëm për ekonomi të bazuar në bujqësi, politikat zhvillimore të komunës duhet të bazohen kryesisht në këtë sektor. Përveç kësaj, sektori i shërbimeve, i cili është sektori me pjesëmarrjen më të madhe në ekonominë e komunës, do të vazhdojë të rritet, kryesisht edhe për shkak të rritjes potenciale të sektori të turizmit, i cili do të mbëeshtetet me politika dhe intervenime konkrete.

Sa i përket shpërndarjes së bizneseve sipas vendbanimeve, në kontekst të raportit vendbanim urban dhe periferik, 77.2 % e ndërmarrjeve janë të vendosura (ose veprimtarinë primare e zhvillojnë në) në zona periferike (jashtë zones urbane), ndërsa vetëm 22.8 % e tyre janë të vendosura (ose veprimtarinë primare e zhvillojnë në) në zonën urbane. Kjo shpërndarje e bizneseve e tregon më së miri rëndësine dhe fuqinë ekonomike të vendbanimeve jashtë zonës urbane, ndërsa fuqizimi i bizneseve ekzistuese dhe përkrahja e binzeseve të reja, do të sigurojë vazhdimësinë e këtij raporti, duke siguruar kështu një zhvillim të balancuar socio-ekonomik. Megjithatë, ndërmarrjet ekonomike – përveç atyre në zonën urbane, kryesisht janë të fokusuara në vendbanimet përreth zonës urbane (22.8 % e bizneseve), me Pozharanin (14.5 % e bizneseve), Drobeshin (4.8 % e bizneseve), Kabash (3.8 % e bizneseve). Të gjitha këto vendbanime përmbajnë 45.9 % të bizneseve të regjistruara në komunën e Vitisë. Prandaj, hartimi i politikave dhe intervenimeve konkrete për një balancim më të madh hapësinor të zhvillimit të aktiviteteve ekonomike është i domosdoshëm, ndërsa funksionalizimi i zonave ekonomike të planifikuara me PZHK 2010-2020+ (të cilat janë trajtuar tek pjesa e profilit ekonomik të këtij PZHK) si dhe përkrahja e bizneseve të reja (sidomos në bujqësi, blegtori dhe turizëm) janë shumë të nevojshme.

### 3.3.1. Sektorët kryesor ekonomik

#### *3.3.1.1. Bujqësia*

Nga analizat e situatës në komunë vlerësohet se Komuna e Vitisë ka fond të konsiderueshëm të tokës bujqësore (15,531 Ha. e sipërfaqes së komunës i takojnë klasave I-IV të bonitetit) dhe të pyjeve e kullosave, që paraqesin potencial të rëndësishëm ekonomik. Sa i përket rendimentit të kulturave bujqësore në komunën e Vitisë, rendimenti i grurit sillet diku rreth 5000 kg/ha, ai i misrit diku rreth 6500 kg/ha, kurse rendimentet e perimeve sillen diku rreth 35.000 kg/ha. PZHK 2010-2020+ ka paraparë që me ndërmarrjen e masave adekuate do të mund të rritej shumë prodhimi i grurit dhe i misrit, por edhe ai i prodhimeve industriale kopshtare dhe të bimëve foragjere.

Arritja e efekteve ekonomike në bujqësi, është e lidhur me ristrukturimin e prodhimit të përcjellë me ngritjen e rendimentit në të gjitha llojet e produkteve bujqësore, sidomos rendimentit të grurit, misrit, prodhimeve industriale kopshtare dhe të bimëve foragjere.

Realizimi i një koncepti të tillë para se gjithash kërkon parandalimin e humbjes së tokës bujqësore nga ndërtimet, konsolidimin e saj dhe shtimin e sipërfaqeve të tokës së punueshme. Kushtet pedologjike,

klimatike, bashkë me shtrirjen e sistemit të ujitjes do të bëjnë të mundshëm që të ndryshojë struktura e shfrytëzimit të tokës së punueshme dhe të rritet vëllimi i prodhimit bujqësor. Përveç kësaj, partneritetet e prodhimit bujqësorë me industrinë përpunuese si dhe plasimi i produkteve bujqësore në treg janë ndër parakushtet themelore të zhvillimit të bujqësisë në funksion të zhvillimit ekonomik. Andaj, ky PZHK, i cili ka për qëllim që të orientoj zhvillimin ekonomik kah bujqësia, blegtoria, turizmi dhe industria e lehtë përpunuese, do të propozojë masa konkrete në funksion të këtij qëllimi, duke përfshirë të gjitha elementet e trajtuara më lartë.

Pas luftës është vërejtur dukuria e shpërndarjes së pa kontrolluar urbane, e cila e degradon tokën bujqësore, ky fenomen Komunës së Vitisë i ka kushtuar me humbjen e 8.6 ha tokë bujqësore vetëm gjatë periudhës 2015-2020. Andaj, ruajtja strikte e tokës bujqësore (sidomos të pjesës që i takon bonitetit I-IV) është e domosdoshme.

**Nevojat zhvillimore në bujqësi, blegtori dhe pylltari** janë renditur si më poshtë:

- Hartimi i një plani të integruar për zhvillim të qëndrueshëm të bujqësisë dhe blegtorisë;
- Mbrojtja dhe konsolidimi i tokës bujqësore dhe parandalimi e humbjes së saj nga ndërtimet;
- Hartimi dhe implementimi i politikave dhe masave konkrete për përkrahjen e sektorit të bujqësisë dhe blegtorisë, duke e shndërruar këtë sektor në promotor të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik të komunës;
- Mbështetja e fermerëve në ngritjen e pemishteve, serave dhe kapaciteteve konservuese;
- Mbështetja e fermerëve për zhvillimin e më tutjeshëm të blegtorisë;
- Ndërmarrja e masave për ngritjen profesionale të fermerëve dhe nxitjen e bashkimit të tyre në organizata bujqësore përkatëse me qëllim të konsolidimit të tokës;
- Modernizimi i sistemit të ujitjes dhe ofrimi i ujit të mjaftueshëm dhe cilësor për ujitje;
- Diversifikimi i prodhimtarisë dhe hulumtimi i tregjeve, lidhja me industritë përpunuese;
- Implementimi i planit për zhvillimet optimale bujqësore dhe blegtorale sipas PZHK 2010-2020+, i përshkruar detajisht në pjesën e profilit ekonomik në këtë PZHK,
- Parandalimi i shkatërrimit dhe degradimit të sipërfaqeve pyjore
- Rritja e aftësisë reproduktive të pyjeve, ashtu edhe të funksioneve tjera, përmes rritjes së shumëfishtë të vëllimit të punëve kultivuese pyjore (pyllëzim, kujdesim etj.);
- Implementimi i planit të pyllëzimit, melorizimit, mirëmbajtjes dhe shfrytëzimit të sipërfaqeve pyjore, i paraparë me PZHK 2010-2020+, i përshkruar detajisht në pjesën e profilit ekonomik në këtë PZHK

#### *3.3.1.2. Tregtia*

Nga të gjitha ndërmarrjet e regjistruara 119, apo 9.9% e totalit të ndërmarrjeve të regjistruara i takojnë sektorit të Tregtisë. Duke u bazuar në këto të dhëna, konstatohet se tregtia është sektori i katërt më i rëndësishëm ekonomik në komunën e Vitisë. Ndërsa sa i përket numrit të të punësuarve, me gjithsej 135 të punësuar, tregtia është sektori i pestë më i madh në komunën e Vitisë. Në komunën e Vitisë kemi një treg të gjelbërt dhe dy tregej të kafshëve (në Viti dhe në Pozharan).

PZHK 2010-2020+ tregtinë e ka cilësuar si sektor primar ekonomik, ndërsa ka paraparë fuqizimin e këtij sektori përmes koncentrimit të bizneseve të tregtisë me shumicë në zona ekonomike, ofrimit të

infrastrukturës së nevojshme për këto lloje të biznesit si dhe përkrahjen edhe të bizneseve të tregtisë me pakicë. Andaj, funksionalizimi i këtyre zonave ekonomike, përveç që do të siguronte një zhvillim më të balancuar të aktiviteteve ekonomike në komunë, do të ndikonte drejt për së drejti edhe në fuqizimin dhe zhvillimin e qëndrushëm edhe të sektorit të tregtisë.

### *3.3.1.3. Industria*

Gjendja eksistuese e industrisë në komunën e Vitisë është mjaft e pa volitshme. Nga të gjitha ndërmarrjet e regjistruara, 120 ndërmarrje, 10% e totalit të ndërmarrjeve të regjistruara i takojnë sektorit të Industrisë. Prej tyre: 112 ndërmarrje, apo 9.4 % e totalit të ndërmarrjeve të regjistruara i takojnë Industrisë Përpunuese, ndërsa 8 ndërmarrje, apo 0.7 % e totalit të ndërmarrjeve të regjistruara i takojnë sektorit të Xeheroreve dhe Gurëthyesve. Për të gjeneruar zhvillim më të madh ekonomik dhe për të rritur numrin e punësimit, Komuna e Vitisë në planet paraprake (Plani Zhvillimor Komunal 2010-2020, Plani Zhvillimor Urban 2010-2015+, Plani Rregullues i Hollësishëm "Zona Ekonomike me Statusin Parku Industrial") ka paraparë ruajten e Zonës Ekonomike Viti-Kllokot si dhe krijimin e 4 zonave të reja ekonomike, prej të cilave edhe Zonën Ekonomike me Status "Park Industrial" në Budrigë të Epërme. Këto zona ekonomike janë përshkruar hollësisht në profilin ekonomik të këtij PZHK. Mirëpo, me përjashtim të Zonës Ekonomike me status të Parkut Industrial, për të cilën është hartuar edhe Plani Rregullues i Hollësishëm (PRRH), deri më sot nuk është ndërmarrë ndonjë hap konkret për funksionalizimin e plotë të asnjëres nga këto zone ekonomike.

Funksionalizimi i disa prej këtyre zonave ekonomike, ashtu siç është paraparë në pjesën e planifikimit të këtij dokumenti, përveç që do të siguronte një zhvillim më të balancuar të aktiviteteve ekonomike në komunë dhe do të ndikonte drejt për së drejti edhe në fuqizimin dhe zhvillimin e qëndrushëm të sektorit të tregtisë, ai po ashtu do të ndikonte drejtë për së drejti në fuqizimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm edhe të sektorit të industrisë, sidomos industrisë së lehtë përpunuese dhe asaj ushqimore.

Bazën e zhvillimit industrial do ta përbëjnë industria e lehtë përpunuese, industria e përpunimit të drurit dhe plastikës, industria ushqimore dhe potencialisht industria e materialeve ndërtimore dhe ajo e përpunimit të metaloideve, sidomos të bentonitit.

Zhvillimi i mëtejshëm i këtyre degëve industriale do të bëhet me zgjerimin e kapaciteteve tashmë të ndërtuara, por edhe me përkrhajen për ndërtimin kapaciteteve të reja, në përputhje me nevojat e tregut dhe gjithnjë në kuadër të përgjegjësive, kompetencave por edhe mundësive të qeverisë lokale në Viti. Ndërsa zhvillimi i industrisë ushqimore është i lidhur ngushtë me zhvillimin më intensiv të bujqësisë dhe me ndryshimin e rëndësishëm të strukturës së prodhimit, sidomos pas ndërtimit të sistemit për ujitje.

### *3.3.1.4. Zejtaria*

Pavarësisht se zejtaria vazhdon të mbetet një fushë me potencial të mirë për zhvillimin ekonomik në komunën e Vitisë dhe pavarësisht ekzistimit të një përvoje të konsiderueshme në veprimtaritë zejtare, qoftë në zejtarinë prodhuese, shërbyese, artistike dhe të artizanateve konsiderohet përparësi për zhvillimin ekonomik, ky sektor aktualisht vazhdon të ketë një ndikim të papërfillshëm në zhvillimin ekonomik të komunës së Vitisë, ndërsa edhe interesimi për të është gjithnjë në rënje. Hapja e qendrave të karrierrës, qendrave të mësimit tërë ditor si dhe qendrave për aftësim profesional, potencialisht do të rizgjonte interesimin për zejtari.

### 3.3.1.5. *Turizmi*

Edhe përkundër mundësive të mjaftueshme dhe potencialit zhvillimor, në komunën e Vitisë turizmi nuk është i zhvilluar. Në ditët e sotme, turizmi kulturor është i bazuar kryesisht në vizitat e objekteve të trashëgimisë arkitekturore si dhe në numrin e madh të vizitorëve gjatë festave të ndryshme fetare.

Ashtu siç është tratuar në pjesën e Potencialit Zhvillimor, komuna e Vitisë ka potencial të mirë për zhvillim edhe të turizmit natyror e rural, por edhe të atij kulturor dhe shëndetësor. PZHK 2010-2020+ i komunës së Vitisë ka trajtuar në mënyrë të detajuar potencialet turistike të komunës, duke propozuar hapa dhe masa konkrete për zhvillimin e këtij sektori me potencial të madh zhvillimor. Këto potenciale dhe masa konkrete të parapara janë trajtuar detajisht në pjesën e profilit ekonomik të këtij PZHK.

Kështu; fshatrat Debelldeh, Letnicë, te Shushtë dhe pjesa mbi Kabash janë konsideruar si fshatra me potencial të madh për këtë lloj turizmi, ndërsa me po të njëjtin plan janë paraparë edhe zhvillimi i infrastrukturës dhe përmbajtjeve për sporte malore si shtigje të ecjes dhe shëtitje, vrapime dhe çiklizmi malor, kalërimi etj.. Fshati Debëlldeh është konsideruar si zonë me potencial për zhvillimin e hotelerisë, në funksion të përkrhajes së turzimit veror dhe atij dimëror. Fshati Letnicë, për shkak të natyrës dhe peizazhit, karakteristikave arkitekturore dhe trashëgimisë shpirtërore është konsideruar si vendbanime me potencial të madh për zhvillimin e turizmit natyror dhe rural, por edhe turizmit kulturor. Smira, Stublla, Letnica, Tërpeza, Pozherani, Binqa, Gërmova, Gërnçari, Tërpeza dhe Qiflaki janë vendbanime me trashëgimi të pasur arkeologjike, arkitektonike dhe shpirtërore, si të tilla, këto fshatra përbëjnë potencial të madh për zhvillimin e turizmit kulturor. Tutje, ajri i pastër, mjedisi i qetë dhe peizazhet e bukura në malet e Letnicës dhe Dobulldehit si dhe uji termal dhe termo mineral në Radivojc, konsiderohen si potenciale të rëndësishme për zhvillimin e turizmit shëndetësor.

Me këtë PZHK është propozuar që sektori i turizmit, bashkë me bujqësinë, blegtorinë dhe industrinë e lehtë përpunuese të jenë bartës dhe katalizatorët kryesor të zhvillimit ekonomik të komunës së Vitisë, prandaj, hartimi i politikave të mirëfillta dhe implementimi i masave konkrete janë të domosdoshme për zhvillimin e qëndrueshëm të këtij sektori, në funskion të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik të komunës.

### 3.3.1.6. *Shërbimet*

Përveç si reflektim i natyrshëm i trendit kombëtar të zhvillimit ekonomik, sektori i shërbimeve në komunën e Vitisë pritet të rritet edhe për shkak të zhvillimit të planifikuar të turizmit. Kështu, zhvillimi i planifikuar i sektorit të turizmit do të ndikojë drejtpërdrejt edhe në zhvillimin e sektorit të shërbimeve, sidomos nënsektorit të hotelerisë dhe gastronomisë, përderisa të dyja këto sektore kanë një lidhje dhe varshmëri të ndërsjelltë. Zhvillimi më i madh dhe i mirë planifikuar i turizmit, bashkë me sektorin e shërbimeve do të mundësojë edhe zhvillimin e më tutjeshëm të sistemit bankar, qoftë për shkak të rritjes së nevojës për kredi për investime në këto sektore, qoftë për shkak të rritjes së nevojave dhe kërkesave për pagesa dhe transaksione.

### 3.3.1.7. *Pasuritë Nëntokësore*

Brenda territorit të komunës së Vitisë, si pasoj e zhvillimeve të proceseve të ndryshme e të shumëllojshme gjeologjike dhe ndërtimit gjeologjik janë formuar vendburime të rëndësishme të lëndëve të para minerale, jominerale dhe lëndëve të para ndërtimore. Aktualisht, edhe për kundër vlerës së madhe ekonomike, lëndët e para minerale në komunën e Vitisë nuk eksploatohen.

Edhe pse pasuritë minerale dhe jominerale (pasuri nëntokësore) me të cilat posedon komuna e Vitisë, përfshirë edhe metaloidet si Bentonit, janë një bazë e fuqishme për zhvillim ekonomik, mungesa e kapaciteteve dhe infrastrukturës në nivel kombëtar për përpunimin dhe përdorimin e këtyre pasurive pritet ta lë këtë sektor në plan të dytë.

Bazën e zhvillimit industrial në komunën e Vitisë do ta përbëjnë industria e lehtë përpunuese, industria e përpunimit të drurit dhe plastikës, industria ushqimore dhe potencialisht industria e materialeve ndërtimore. Ndërsa sa i përket pasurive nëntokësore, në rastin më të mirë, mirëpo me shumë pak gjasa, mund të ketë orientim nga përpunimi i metaloideve, sidomos të bentonitit. Pavarësisht kësaj, me Planin Zhvillimor Komunal 2010-2020+, komuna e Vitisë ka paraparë edhe masat për mbrojtjen e resurseve natyrore, përfshirë edhe pasuritë minerale. Implementimi i këtyre masave, të paraqitura në pjesën e profilit ekonomik të këtij PZHK, është i domosdoshëm.




Harta 28 Pasuritë Minerale

### 3.3.2. Fuqia punëtore, punësimi dhe papunësia

Dominimi i popullsisë së re në Komunë (mbi 40 % të popullsisë së përgjithshme në Komunë janë me moshë të re 0 deri 19 vjeç), përqindja e lartë e popullsisë të aftë për punë (61.8 % nga popullsia e përgjithshme janë populli e aftë për punë (15-64/m dhe 15-59/f)) si dhe shkalla e lartë e shkollimit të popullsisë (64 % e popullsisë janë me shkollim të mesëm të ulët dhe shkollim të mesëm të lartë, ndërsa 6 % e popullsisë janë të diplomuar dhe me diploma pasuniversitare), përbëjnë resurse humane për sektorë të ndryshëm ekonomik.

Nga të dhënat e siguruara nga ARBK për vitin 2020 rezulton se në komunën e Vitisë aktualisht aktivitetin e tyre e zhvillojnë 1197 ndërmarrje, me gjithsej 1882 të punësuar. Kjo don të thotë që mesatarja e numrit të punëtorëve për një ndërmarrje në komunën e Vitisë është 1.57 punëtorë/ndërmarrje. Grupi punues vlerëson se kjo statistikë, përtej pasqyrimit të gjendjes reale në komunën e Vitisë më shumë pasqyron shkallën e lartë të ekonomisë informale në komunë. Andaj, në këtë PZHK do të propozohen politika të mirëfillta dhe efikase për luftimin e ekonomisë informale.

Grupi punues ka identifikuar pabarazi të zhvillimit ekonomik në komunën e Vitisë, në 3 aspekte:

- Pabarazi në punësim ndërmjet grupmoshave të ndryshme;

- Pabarazi në punësim ndërmjet dy gjinive;
- Pabarazi në shpërndarjen hapësinore të ndërmarrjeve të regjistruara (koncentrim i kapitalit).

Bazuar në rezultatet nga regjistrimi i popullsisë nga viti 2011 del se shkalla e papunësisë në komunën e Vitisë është më e lartë se ajo e Kosovës. Papunësia në këtë komunë është 48%. Popullsia e moshës mbi 15 vjeç në komunën e Vitisë është 32.819 banorë apo rreth 70%. Nga ky numër, popullsi aktive janë 13.147 banorë apo rreth 40%. Shkalla e papunësisë tek gjinia femërore është rreth 65%. Ndërsa tek gjinia mashkullore shkalla e papunësis është 42%.

Bazuar në të dhënat për punëkërkuesit sipas statistikave nga Agjencia e Punësimit, në komunën e Vitisë gjatë vitit 2019 kemi të regjistruar 6.584 punëkërkues. Shkalla e lartë e papunësisë ka prekur pothuaj të gjitha grup moshat e popullsisë, por më e theksuar është tek grup moshat e mesme (35-44 vjeç) me një shkallë papunësie prej 33.5 %.

Me shkallë më të lartë të papunësisë paraqitet popullsia me kualifikime fillore (56.78%), më pas popullsia me nivel të shkollimit të mesëm (42.87%) dhe krejt në fund popullsia me shkollim të lartë (0.33%).

| Përparësitë | Dobësitë |
|---|---|
| **-Dominimi i popullsisë së re në Komunë<br>- Kontingjenti i lartë i punës<br>- Shkalla e lartë e shkollimit të popullsisë<br>-Ekzistimi i insturmenteve të nevojshme për luftimin e informalitetit në ekonomi;<br>- Ekzistimi i kapaciteteve institucionale dhe resurseve humane/profesionale për hartim të politikave për luftimin e zhvillimit të pa barabart ekonomik;<br>- Potencial real për orientim të zhvillimit ekonomik nga Bujqësia dhe Blegtoria, Industria Bujqësore, e Lehtë dhe Përpunuese si dhe Turizmi Kulturor dhe Natyror<br>- Potencial i lartë për zhvillimin e prodhimtarisë bujqësore, me 57.6% të tokës të klasit 1–4 të përshtatshmërisë,<br>- Pozita gjeografike dhe kushtet klimatike shumë të favorshme për zhvillim të Bujqësisë;<br>- Resurset natyrore: 57.6% tokë bujqësore, 34.6% tokë pyjore, pasuritë nëntokësore<br>- Potenciali i kullosave dhe i livadheve si garancë e mirë për zhvillimin e blegtorisë;<br>- Ekzistimi i planit për komasacion;<br>- Potencial i madh për zhvillimin e turizmit natyror/malor, rural dhe atij kulturor;<br>- Planifikimi i Zonave të reja Ekonomike, me PZHK 2010-2020+, Hartimi i Planit Rregullues Urban për Zonën Ekonomikë me status Park Industrial;<br>- Tradita në zejtari;** | - Shkalla e lartë e papunësisë në komunë<br>- Shkalla e lartë e ekonomisë informale;<br>- Zhvillimi i pabarabart ekonomik, në kuptim të: Pabarazisë në punësim ndërmjet grupmoshave të ndryshme, Pabarazisë në punësim ndërmjet dy gjinive, si dhe Pabarazisë në shpërndarjen hapësinore të ndërmarrjeve të regjistruara (koncentrim i kapitalit);<br>-Menaxhimi jo i mirë i tokës bujqësore - fragmentimi i tokave bujqësore;<br>-Mungesa e sistemit te ujitjes së tokës bujqësore;<br>-Aplikimi i teknologjisë së vjetruar në prodhimin e produkteve bujqësore;<br>- Pjesëmarrje e ulët e sektorit të Industrisë (10 %) në ekonominë e përgjithshme të komunës<br>-Mos funksionalizimi i Zonave Ekonomike të parapara me PZHK 2010-2020+;<br>-Regresi në sektorin e zejtarisë deri gati në shuarje të të gjitha aktiviteteve zejtare;<br>-Mos shfrytëzimi i potencialit për zhvillimin e sektorit të turzimit;<br>-Mos eksploatimi dhe mos shfrytëzimi i pasurive nëntokësore të komuës. |
| **Mundësitë** | **Rreziqet** |
| **-Shfrytëzimi i potencialit të madh njerëzor, sidomos ai i popullsisë së re;<br>-Shfrytëzimi i kontigjentitë të lartë të punës;<br>-Shfrytëzimi i potencialit të madh të popullsisë së shkolluar, sidomos i pjesës me shkollim të mesëm të lartë dhe me shkollim universitar dhe posuniversitar;<br>-Shfrytëzimi i instrumenteve të nevojshme për luftimin e informalitetit në ekonomi;<br>-Shfrytëzimi i kapaciteteve institucionale dhe resurseve humane/profesionale për hartim të politikave për luftimin e zhvillimit të pa barabart ekonomik;<br>-Ekzistimi i mekanizmave për parandalimin e shndërrtimit** | -Mungesa e politikave të qarta dhe strategjive konkrete për shfrytëzimin e potencialit njerëzor<br>-Mungesa e politikave të qarta për luftimin e informalitetit në ekonomi;<br>-Mungesa e politikave të qarta dhe mungesa e efikasitetit të instrumenteve për luftmin e zhvillimit të pa barabart ekonomik;<br>-Mos-shfrytëzimi i potencialit real për orientim të zhvillimit ekonomik nga Bujqësia dhe Blegtoria, Industria Bujqësore, e Lehtë dhe Përpunuese si dhe Turizmi Kulturor dhe Natyror<br>-Shëndërrimi i tokës bujqësore në tokë ndërtimore;<br>-Mos implementimi i planit të komasacionit; |

| | |
|---|---|
| **të tokës bujqësore në tokë ndërtimore;**<br>**-Shfrytëzimi i potencialit real për orientim të zhvillimit ekonomik nga Bujqësia dhe Blegtoria, Industria Bujqësore, e Lehtë dhe Përpunuese si dhe Turizmi Kulturor dhe Natyror;**<br>**-Futja e teknologjive të reja në prodhimin bimorë;**<br>**-**<br>**-Përkrahja e përpunimit të prodhimeve bujqësore;**<br>**-Ngritjen e pemishteve, serave dhe kapaciteteve për ruajtjen e prodhimeve bujqësore;**<br>**-Mundësi për qasje në programe e projekte për përfitim nga fondet dhe skemat mbështetëse;**<br>**-Modernizimin e sistemit të ujitjes dhe ofrimi i ujit të mjaftueshëm dhe cilësor për ujitje;**<br>**-Rregullimi i infrastrukturës bujqësore në gjithë teritorin e Komunes;**<br>**-Funksionalizimi i dy Zonave Ekonomike të parapara me PZHK 2010-2020+;**<br>**-Ndërtimi i kapaciteteve të nevojshme për eksploatimin dhe shfrytëzimin e pasurive nëntokësore të komuës.** | -Mos mbulimi i të gjitha sipërfaqeve bujqësore me sistem të ujitjes;<br>-Interesimi i ulet i rinisë për veprimtari bujqësore;<br>-Mungesa e kredive të favorshme afatgjata bër bujqësi;<br>-Pasiguria e efikasitetit afatgjatë të investimeve në bujqësi;<br>-Mungesa e mbrojtjes së prodhimeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera;<br>-Mungesa e strategjive konkrete për rritjen e pjesëmarrjes së industrisë në ekonominë e përgjithshme të Komunës;<br>-Vazhdimi i mosfunksionalizimit të Zonave Ekonomike të parapara me PZHK 2010-2020+;<br>-Mungesa e politikave dhe programeve konkrete për përkrahjen e sektorit të zejtarisë<br>-Vazhdimi i gjendjes së mos shfrytëzimit të potencialit në sektorin e turzimit;<br>-Vazhdimi i gjendjes së mos eksploatimit dhe mos shfrytëzimit të pasurive nëntokësore |

## 3.4. INFRASTRUKTURA TEKNIKE

### 3.4.1. Infrastruktura e Ujsjellësit dhe Kanalizimit

Në komunën e Vitisë, vetëm 46% e popullsisë së përgjithshme është e kyçur në sistemin e kanalizimit të ujërave të zeza. Përderisa 94 % e popullsisë e cila jeton në zonën urbane ka kyçje në sistemin e kanalizimit, gjendja qëndron shumë e rënduar në pjesët rurale të komunës, me vetëm 40 % të popullsisë rurale e cila ka kyçje në sistemin e kanalizimit.

Vendbanimet që kanë pjesërisht rrjet të kanalizmit janë si vijon: Binça, Buzoviku, Debelldehu, Devaja, Letnica, Pozhorani, Vitia

Vendbanimet e vetme që nuk kanë rrjet të kanalizimit janë si vijon: Ballanca, Goden i Madh, Mjaku, Stubell e Poshtme, Vërnakolla dhe Vërnezi

Mirëpo, pavarësisht se fshatrat Goshicë, Binqë, Beguncë, Smirë, Stubell, Radivojcë dhe Sadovinë kanë sistem të kanalizimit, gjenda e këtij sistemi nuk është e mirë, madje sistemi është jasht funksioni.

Përveç kësaj, edhe në vendbanimet ku ekziston rrjeti i kanalizimit, ai nuk trajtohet nga impiantet, për pasojë, ujërat e zeza derdhen në gropa septike dhe në lumin Morava. Gropat septike të hapura në disa lokalitete kanë zbutur gjendjen, por nuk e kanë zgjidhur problemin tërësisht.

Në fund të 2009, qendra e qytetit të Vitisë është rregulluar me kanalizim, trotuare, ndriçim dhe asfalt të ri. Mirëpo, kanalizimi është jo funksional dhe me rastin e reshjeve më të vogla të shiut qendra e Vitisë vërshohet nga uji, në disa raste duke hyrë edhe në lokalet përreth. Po ashtu, sistemi i kanalzimit në qytet nuk e bënë trajtimin e ujërave të zeza, por i derdhë ato direkt në lumin Morava.

Përderisa 95 % e popullsisë urbane janë të kyçur në rrjetin publik të furnizimit me ujë, edhe përqindja e popullsisë rurale të kyçur në këtë rrjet është e lartë (mbi 90 %). Pjesa tjetër e popullsisë rurale, e mbetur jashtë rrjetit në fjalë, përdorë ujin e puseve të cekta dhe të pambrojtura.

Disa lagje të qytetit, për shkak të kaptazhit në Letnicë, përballen me reduktime në furnizim, e të cilat zgjasin deri 8 orë në ditë. Këto reduktime, ndër të tjera vijnë edhe si pasojë e humbjeve të mëdha teknike dhe administrative në sistemin e ujësjellësit.

Fabrika e ujit në Letnicë furnizon me ujë të pijes zonën urbane dhe fshatin Ramnishtë, mirëpo humbjet teknike dhe administrative në sistemin e ujësjellësit, janë s

humë të mëdha.

Vendbanimet të cilat nuk kanë rrjet të ujësjellsit, mirëpo me planet paraprake është planifikuar ndërtimi i sistemit të ujësjellësit janë si vijon: Ballancë, Buzovik, Dobelldeh, Goden i Madh, Lubishtë, Mjak, Podgorc, Shashare, Vërnakollë dhe Vënez.

Nga të gjitha të dhënat e paraqitur më sipër, rezulton se nga 39 vendabanime sa ka komuna e Vitisë; 29 fshatra kanë sistem të ujësjellësit, përderisa vetëm 10 fshatra nuk kanë ende sistem të ujësjellësit.

| Përparësitë | Mundësitë |
|---|---|
| Qasja e popullsisë në rrjetin e kanalizimit dhe ujësiellësit mbi 90%<br>Qasja e lehtë e vendbanimeve në rrjetin primar të ujësiellësit.<br>Shtrirja e rrjetit ë ujësiellësit dhe kanalizimit në mbi 85% të vendbanimeve | Konfiguracioni i relievit i përshtatshem për shtrirjen e rrjetit të kanalizimit dhe ujësiellësit<br>Mundësi të mira për ndërtimin e kolektorit kryesor të ujrave të zeza.<br>Mundësi e lehtë e kyqjes së kolektorit kryesor të ujrave të zeza në Impiantin e planifikuar me PHK.<br>Mundësia e monitorimit të ujit të pijes nga ISHPK |
| **Dobësitë** | **Kërcënimet** |
| Gjendja fizike jo e mirë e rrjetit të ujësiellësit në disa vendbanime<br>Mosfunksionaliteti i rrjetit të ujësiellësit<br>Mos menaxhimi i të gjithë rrjetës së furnizimit me ujë<br>Mungesa e ujëmatësve digjital (SMART) tek shfrytëzuesit<br>Mungesa e qasjes së shumicës së popullsisë në sistem të rrjetit të kanalizimit<br>Mungesa e kolektorit kryesor për ujrat e zeza<br>Mungesa e rrjetit për mbledhjen e ujrave të bardha | Mungesa e investimeve kapitale në infrastrukturë të ujësiellësit dhe kanalizimit<br>Demtimi i rrjetit egzistues të kanalizimit dhe ujësiellësit<br>Shfrytëzimi i pakontrolluar i ujit të pijes (për ujitje, etj.)<br>Vonesa në ndërtimin e impiantit për trajtimin e ujrave të zeza<br>Mungesa e infrastrukturës për trajtimin e ujrave të bardha<br>Nodtja e vazhdueshme e ujrave sipërfaqësore, si pasojë e mostrajtimit të ujrave të zeza. |

### 3.4.2. Infrastruktura e Energjisë Elektrike

Rrjeti elektrik i përçuesve ajror dhe kabllor për nivelin e tensionit 10(20)/04 kV/kV i Komunës së Vitisë është i shtrirë në të gjitha vendbanimet e Komunës. Nënstacioni i nivelit 400KV në Sojevë paraqet një mundësi të mirë për furnizim dhe zhvillim të qëndrueshëm energjetik të rrymës elektrike në Komunën e Vitisë duke eliminuar dobësitë e vazhdueshme furnizuese me energji elektrike në Komunë ku karakterizohet me këto mangësi:

- Jo statibiliteti i rregullt i furnizimit me energji elektrike për zhvillimin ekonomik industrial (nderprejet e shumta pa mundësojn punën normale industriale);
- Mos ndjekja e hapave zhvillimore në mes të industrisë dhe infrastrukturës energjetike me kapacitete e instaluara furnizuese energjetike;
- Humbje e mëdha teknike të energjisë për shkak të mosdimensionimit të perçuesve për linjat ajrore dhe kabllore duke i vazhduar daljet furnizuese të TM dhe TU për konsumatoret e rinjë.
- Humbjet e energjisë nga numri i madhe i kyçjeve në daljet e TM dhe TU dhe numrit të madh të TS-ve në një linjë dhe mungesës së balancës në TRD (>70% të ngarkuar, të ngarkuar<35%);
- Jo stabilitet energjetike dhe mungesë e sigurisë së furnizimit me energji elektrike për shkak të pajisjeve të vjetërsuara, ndërtimeve të egra dhe linjave të gjata radiale me shumë degëzime të shtërngakuara;

- Prishja e shpeshtë e stabilimenteve energjetike nga vjetersia e tyre dhe prishja e pajisjeve industriale dhe rrezidenciale nga ndërprejet e shpeshta të linjave furnizuese;
- Cilësia e ulët e tensionit për shkak të humbjeve të mëdha teknike dhe komerciale deri në 25% total, prej të cilave 15% janë humbje teknike dhe rënie të mëdha të tensionit;
- Cilësia e tensionit është e ndërlidhur me aspektin teknik të sistemit të energjisë elektrike dhe krahasohet ndaj tensionit nominal, që kryesisht gjatë kësaj periudhe është monitoruar përmes regjistrimit të ankesave të konsumatorëve lidhur me cilësinë e tensionit;
- Cilësia komerciale përcakton efikasitetin dhe saktësinë e zgjidhjes së ankesave dhe kërkesave të konsumatorëve. Rregullimi i cilësisë komerciale merr parasysh marrëdhëniet e ndërsjella ndërmjet konsumatorëve dhe furnizuesit;
- Mungesës së nismave konkrete për zhvillimin e infrastrukturës së sistemeve të energjisë termike nga ana e komunave ku ka një përqendrim të madh të objekteve të banimit kolektiv;
- Mungesës së nismave konkrete për përdorimin e sistemit termik për ftohjen e hapësirave, ngrohjen e ujit sanitar, avullit për nevoja të industrisë etj..

| Përparësitë | Dobësitë |
|---|---|
| Plani i ri investiv masterplani i miratuar i KEDS-it<br>Nënstacionet furnizuese të tensionit të lartë dhe të mesëm me rritje të daljeve furnizuese plotësojnë nevojat aktuale<br>Nënstacioni 400/220 kV/kV në Sojevë mundësi e re furnizuese për zhvillim të qëndrueshem<br>Dimensionimi i përquesve ajror dhe kabllor nga Sojeva zvoglon humbjet teknike dhe rrit efikasitetin e furnizimit me energji elektrike.<br>Pajisjet e reja të stabilimenteve energjetike nga nënstacioni i Sojevës, sigurojn stabilitet furnizues me energji elektrike dhe cilësi furnizuese | Infrastruktura ajrore energjetike në shumicen e fshatrave është e vjetruar dhe cilesi të dobet furnizuese<br>Mungesa e incizimit gjeodezi të rrjetit nëntokësor dhe mbitokësor<br>Ndërprerjet e qakorduara dhe të shpeshta të furnizimit me energji elektrike<br>Mungesë e kapaciteteve të shpërndarjes, trafo dhe largpërçues<br>Vonesa e shfrytëzimit të energjisë së ripërtërishme në ndërtesa publike ndriçim të rrugëve publike, objekte rrezidenciale dhe komercilae kanë problem me furnizim të rregullt me energji elektrike |
| **Mundësitë** | **Kërcënimet** |
| Ndrrimi i përçuesve ajror dhe nëntokësor për linjat e TM dhe TU ndikon në zvogëlimin e humbjeve teknike dhe komerciale<br>Rritja e kapaciteteve të reja instaluese të linjave të TM dhe TU rrit kualitetin e tensionit dhe rrit sigurin furnizuese<br>Ngritja e kapaciteteve transformuese ekzistuese dhe ndërtimi i kapaciteteve të reja furnizuese distributive me rrjetin shpërndarës<br>Kalimi i nivelit të tensionit TM 10 kV në nivelin e tensionit 20kV, rrit sigurin energjetike dhe cilësin furnizuese<br>Rregullimi i zonave të reja industriale për zhvillim të qëndrueshëm energjetik<br>Kalimi i transformimit të tensionit 35/10 kV/kV në ndërtimin e trafostacionit 110/10 (20) kV<br>Formimi i lidhjeve unazore energjetike përreth zonës urbane dhe parkut industrial<br>Ndertimi trafostacioneve të reja të nivelit 10(20)/0.4 kV<br>Gjenerimi i energjisë elektrike nga BER-i dhe identifikimii hapësirave të përshtatshme për instalimin e elementeve që gjenerojnë energji elektrike alternative | Stabilimentet e vjetra energjetike 2 here me afat të skaduar<br>Rrjeti ekzistues mbitokësor paraqet rrezik në të gjitha qënjet<br>Shtyllat elektrike të vjetra dhe të amortizuara paraqet rrezik për të gjithë<br>Përçuesit e vjetruar dhe të pa dimensionuar paraqesin rrezik<br>Transformatoret energjetik të mbingarkuar paraqesin rrezik nga havarit ( shpërthim zjarri)<br>Rrjedhja e varave nga transformatoret energjetik të vjetruar kërcnojnë zhvillimin e qëndrueshëm mjedisor<br>Sistemi i punës së stabilimneteve energjetike në formën klasike kërcnon sigurin në punë dhe sigurin furnizuese<br>Mungesa e mbrojtjës së stabilimneteve energjetike kërcnon sigurin në punë;<br>Sistemi i funksionit të punës klasike pa mundëson efikasitet dhe efiçenc në punë; Mosfunksionimi i tregut të hapur dhe konkurrent të energjisë elektrike në rajon; |

### 3.4.3. Infrastruktura e Telekomunikimit

Posta dhe telekomunikimi në komunën e Vitisë realizohen përmes rrjetit të telefonisë fikse (33% të vendbanimeve), mobile (mbi 95% të vendbanimeve) dhe internetit (mbi 80% të vendbanimeve). Telefonia fikse është e organizuar përmes kabllit optik dhe teknologjisë me bakër, ndërsa shërbimet e telefonisë mobile mbulohen përmes antenave.

Nga të dhënat e evidentuara rezulton se telekomunikimi në komunën e Vitisë është mbuluar mjaftë mirë, mirëpo është e nevojshme shtrirja e rrjetit optik në fshatrat të cilat nuk furnizohen përmes teknologjisë Optike dhe asaj me Bakër. Ndërsa sa i përket telefonisë mobile shërbimet janë të shtrira mirë dhe i plotësojnë kërkesat e qytetarëve për këto shërbime. Tabela 54 Fshatrat ku duhet të shtrihet kablli optik. Fshatrat ku duhet të shtrihet kablli optik: Ballancë, Budrikë e Epërme, Buzovik, Çifllak, Debelldeh, Goden i Madh, Gushicë, Gjylekar, Letnicë, Lubishtë, Mjak, Novosellë, Ramjan, Remnik, Sadovinë e Çerkezve, Sllatinë e Epërme, Sllatinë e Poshtme, Stubëll e Epërme, Stubëll e Poshtme, Shashare, Tërpezë, Tërstenik, Vërban, Vërnakollë, Vërnez dhe Zhiti.

### 3.4.4. Infrastruktura e Menaxhimit të Mbeturinave

Grumbullimi i mbeturinave në Komunën e Vitisë, sipas të dhënave të mundësuara nga komuna, kryhet me konenierë të përbashkët të vendosur në 6 pika kolektive në qytetin e Vitisë me kapacitet 1.1m3, rreth 60 kontenierë pika të ndryshme të qytetit. Këto pika kolektive në pjesën më të madhe të rasteve janë të bizneseve apo institucioneve, të cilat kanë një kontratë me kompanië dhe marrin shërbimin e grumbullimit dhe transportit të mbeturinave. Ndërsa në shërbimin derë më derë në amviseri komuna nuk ka shpërndarë shporta apo qese. Ato janë pronë dhe zgjedhje e konsumatorit. Ndërkohë Komuna e Vitisë në varësi të tipologjisë së zonave ku ka pika për grumbullimin e mbeturinave, ka evidentuar disa lloje të pikave të grumbullimit:

| Grumbullimi Derë më derë në të gjitha ekonomitë familjare që janë pjesë e sistemit me shporta ose qese të cilat janë pronë e komunitetit | |
|---|---|
| Në pikat institucione (kontenier 1.1m3) |  |
| Në Pika kolektive të përbashkëta (kontenier 1.1m3) |  |

| Në pikat biznese (kontenier 1.1m3) |  |
|---|---|

Shërbimi i grumbullimit dhe transportit të mbeturinave në Komunën Vitisë kryhet gjatë orarit 06:00-14:00, si në tabelën më poshtë:

Tabela 87 Frekuanca e ofrimit të shërbimit për grumbullimin e mbeturinave në Komunën e Vitisë[28]

| Frekuenca | Lokacioni & orari |
|---|---|
| 6 ditë në javë | Qyteti i Vitisë qendra (06:00 – 14:00) |
| 1 herë në javë | Në 28 fshatrat e komunës + pjesa tjetër e Qytetit të Vitisë |

Komuna ofron shërbimin e grumbullimit dhe transportit të mbeturinave në 6 ditë të javës në qytetin e Vitisë, dhe 1 ditë të javës në 28 fshatra. Sipas të dhënave të deklaruara nga komuna, 9 fshtatra nuk janë të mbuluar me shërbim e grumbullimit të mbeturinave pasi që në ato fshatra nuk ka banorë. Në tabelën më poshtë tregohet më qartë se në cilat njësi administrative kryhet shërbimi i grumbullimit dhe transportit të mbeturinave gjatë 6 ditëve të javës:

Tabela 88 Kalendari i ofrimit të shërbimit të grumbullimit dhe transportimit të mbeturinave në Komunës së Vitisë[29]

| Zona | E Hënë | E Martë | E Mërkurë | E Enjte | E Premte | E Shtunë |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Qyteti Viti | Viti (qendra zona e parë | Viti (qendra +zona e dytë | Viti (qendra) | Viti (qendra) | Viti (qendra) | Viti (qendra) |
| Fshatrat | Drobesh<br>Smirë<br>Lubishta<br>Begunca | Pozhoran (zona e parë)<br>Qifllak<br>Terpez (zona e parë)<br>Potgorc<br>Binçë | Sllatina e ulët dhe e Epërme<br>Terpeza (pjesa e dytë)<br>Fshat i Ri<br>Tresteniku<br>Ballancë dhe Zhiti<br>Kabash | Germovë,<br>Sadovinë e Çerkezve,<br>Sodovinë e Jerlive<br>Verban Budrik<br>Radivojc<br>Remik | Ramjan;<br>Pozheran (zona e dytë)<br>Stublla e Epërme<br>Devajë | Ramishte,<br>Gjylekar,<br>Goshicë. |

Ndërkohë në hartën më poshtë tregohet se si është i shpërndarë shërbimi i grumbullimit dhe transportit të mbeturinave në Komunë e Vitisë, bazuar në të dhënat nga AMMK dhe GIZ.

Kompania Eko-Hygjiena njesi në Viti ka 16 punëtor, 6 punëtor administrativ, kurse ka të angazhuar 3 vozitës dhe 7 punëtorë pastrimi, për të kryer shërbimin e grumbullimit dhe transportin e mbeturinave në Komunën e Vitisë. Kompania ka 3 mjete (2 kompaktorë 12ton dhe 9 ton) dhe një kamion i hapur me kapacitet 1.5 ton për të kryer shërbimin e grumbullimit dhe transportit të mbeturinave për konsumatorët që janë pjesë e sistemit.

[28] Kompania “Eco-Higjiena sh.p.k Gjilan, Njësia Operative Viti

[29] Kompania “Eco-Higjiena sh.p.k Gjilan, Njësia Operative Viti

Menaxhimi i mbeturinave në komunën e Vitisë realizohet përmes mbledhjës së mbeturinave në modelin derë me derë në tri nivele: ekonomi famljare, biznese dhe institucione. Në ekonomi familjare grumbullimi i mbeturinave bëhët në 45% të tyre, përderisa vetëm 39% e bizneseve janë të kyqura në ketë sistem, ndërsa 100% të institucioneve. Të gjitha këto mbeturina grumbullohen dhe dërgohen në deponinë regjionale në Gjilan për trajtim.




Harta 29 Menaxhimi i mbeturinave në komuën e Vitisë

## 3.5. TRANSPORTI DHE INFRASTRUKTURA E TRANSPORTIT

Infrastruktura rrugore në komunën e Vitisë është e shtirë në katër nivele (rrugë regjionale, urbane, publike dhe të pakatergorizuara. Tri kategoritë e para përbëjnë rreth 56% të rrugëve në nivel komune dhe janë të mbulura me asfalt, shtrirja e këtyre mundëson qasjen me mbi 95% të popullsisë në rrugë të asfaltuara. Ppërderisa rrugët e pa kategorizuara përbëjën mbi 43% të rrugëve në nivel komune dhe janë të pa mbuluara me asfalt. Mirëmbajtja e rrugëve, mungesa e sinjalizimit dhe tretuarëve në zonat e banuar mbeten problematike për qytetarët. Ndërtimi i urave për lehtësimin e lidhjes së zonave të banuara dhe atyre ekonomike ka ndihmuar në rritjen e funksionalitetit përmes rrjetit të rrugëve.

### 3.5.1. Shtrirja dhe gjendja ekzistuese e rrugëve

Shtrirja e rrugëve të katër kategorive të cilat lidhin të gjitha vendbanimet e komunës si në nivel lokal po ashtu edhe atë regjional, i plotësojnë mjaftueshëm nevojat e qarkullimit të qytetrëve dhe mallërave për të gjitha kategoritë sociale dhe ekonomike të komunës. Nga të dhënat e nxjerra del se komuna e Vitisë e ka përmbyllur pothuajse në plotëni infrastrukturen rrugore të të gjitha kategorive duke siguruar qasje të plotë të të gjitha vendbanimeve në rrugë të asfaltuara, prandaj investiimet e mëtutjeshmë në përmisimin e infrastrukturës rrugore duhet të fokusohen vetëm në mirëmbajtjen e rrugëve lokale dhe urbane, përderisa

për mirëmbajtjen e rrugëve regjionale përgjegjëse është Ministria e Infrastrukturës. Gjendja e rrugeve ekzistuese të të gjitha kategorive është e mirë dhe i plotësojnë standardet e infrastrukturës rrugore.

Tabela 89 Gjendja e rrugëve sipas kategorive në komunën e Vitisë

| Nr | Përshkrimi | Gjatësia / Km | Gjendja e rrugëve |
|---|---|---|---|
| 1 | Rrugë regjionale | 14.1 | Asfalt |
| 2 | Rrugë lokale | 133.5 | Asfalt |
| 3 | Rrugë urbane | 30.88 | Asfalt |

### 3.5.2. Shtrirja dhe kategoria e rrugeve te planifikuara nga niveli qendror

Shtrirja e rrugëve të planifikuara nga niveli qendror është kërkuar me qëllim të plotësimit të infrastrukturës rrugore dhe lidhjës së saj në nivel rajonal dhe nacional e cila do të bëhet përmes lidhjes me autostradën "Arbër Xhaferi" dhe pikën kufitare në Debëllde. Kuvendi Komunal i Vitisë ka kërkuar (është aprovuar) nga MI që të krijoj një lidhje të veçant të infrastrukturës rrugore me këtë autostradë duke bërë zgjerimin e rrugës së kategorisë locale e cila kalon përmes zonës urbane të Vititisë në drejtim: Drobesh-Gërmovë-Sudovinë e Jerlive, pastaj kalon në territorin e komunës së Kaçanikut, drejtimi i Gërlicës, ku është kërkuar edhe qasjë në autostradë. Kjo rrugë do të ndryshonte qasjen në kategorizimin e infrastrukturës rrugore sepse traseja e lartëshnuar do të kalonte nga kategoria e rrugëve lokale në atë regjionale, për faktin se edhe ndertimi i kësaj traseje ka karakter regjional sepse kërkon bashkëpunim në mes të komunës së Vitisë dhe asaj të Kaqanikut.

### 3.5.3. Vleresimi i intensitetit të qarkullimit të udhëtarëve dhe mallrave

Vleresimi i intensitetit të qarkullimit të udhëtarëve dhe mallrave, ka evidentuar nevojen e plotësimit të infrastrukturës rrugore me rreth rrotullime në kryqëzime të rrugëve të të gjitha kategorive, prandaj, me qëllim të lehtësimit të qarkullimit është e nevojshme që të ndërtohen 26 rreth rrotullime të cilat do të plotësonin infrastrukturën rrugore dhe do të lehtësonin qarkullimin në rrugët të cilat shtrihen në vendbanimet si në vijim: Viti, Rimanishtë, Kabash, Binqë, Simirë, Verban, Mogille, Verboc, Gërncar, Remnik, Budrigë, Balance, Terpezë, Novosellë. Për të lehtësuar dhe siguruar qarkullimin me standard të komunikacionit rrugorë, gjithashtu është e nevojshme që të ndërtohen edhe 8 ura të reja në vendbanimet: viti, Binqë, Smirë, Gërmovë, Gushincë, Sllatinë.

Për të përmisuar kaualitetin e qarkullimit si dhe për të rritur sigurin e lëviyjes së këmbësorëve është e nevojshme që në zonat e banuara – përgjatë rrugës kryesore në drejtim të shkollës dhe institucioneve të tjera, infrastruktura rrugore duhet të përcillet me trotuare, të cilat duhet të kenë gjerësinë sipas standardeve deri në 120 cm.

Pozita gjeografike e komunës si urë lidhëse në mes dy regjioneve (Gjilanit dhe Ferizait) i ka krijuar mundësi të mira komunës për organizimin e transportit të njerëzve dhe mallrave. Transporti publik për qytetarët e Vitisë është i orbanizuar në dy nivele: në atë regjional dhe lokal. Kjo ka bërë që mbi 78% e qytetarëve të komunës të kenë qasje në transport publik. Organizimi i itinerarit të transportit publik është funksional me pikënisje në zonën urbane të Vitisë.

Nga të dhënat e evidentuara rezulton se telekomunikimi në komunën e Vitisë është mbuluar mjaftë mirë, mirëpo është e nevojshme shtrirja e rrjetit optik në fshatrat të cilat nuk furnizohen përmes teknologjisë Optike dhe asaj me Bakër. Ndërsa sa i përket telefonisë mobile shërbimet janë të shtrira mirë dhe i

plotësojnë kërkesat e qytetarëve për këto shërbime. Tabela 54 Fshatrat ku duhet të shtrihet kablli optik. Fshatrat ku duhet të shtrihet kablli optik: Ballancë, Budrikë e Epërme, Buzovik, Çifllak, Debelldeh, Goden i Madh, Gushicë, Gjylekar, Letnicë, Lubishtë, Mjak, Novosellë, Ramjan, Remnik, Sadovinë e Çerkezve, Sllatinë e Epërme, Sllatinë e Poshtme, Stubëll e Epërme, Stubëll e Poshtme, Shashare, Tërpezë, Tërstenik, Vërban, Vërnakollë, Vërnez dhe  Zhiti.

### 3.5.4. Modelet e qarkullimit të trafikut

Mungesa e deritashme e organizimit të trafikut urban në nivel të komunës dhe trendet e zhvillimit të qarkullimit në nivel të zonës urbane drejt venbanimeve me zhvillim dinamik (Pozharan dhe Skifteraj) parashtron nevojen e **organizimit të modelit ndërurban të trafikut**, duke krijuar linjen ndërurbane që do të mbulonte zonën urbane të Vitisë, përfshirë edhe vendbanimin e Pozharanit dhe Skifterajt.

Organizimi i modelit të transportit ndërurban do të kërkon edhe krijimin e një linje të re të qarkullimit për pransport ndërurban e cila do të ketë gjatësi maksimale prej 24 kilometrave dhe do të shtrihet në tri vendbanime: Viti, Pozharan dhe Skifteraj. Transporti në linjat nderkomunale duhet të vazhdoj njëjt dhe të ketë karakter rajonal në drejtim të komunës së Gjilanit dhe asaj të Ferizajit. Linjat rurale duhet të mbulohen nga tetë operator transportues të cilet do të ofrojnë shërbime kualitative në drejtim të të gjitha fshatrave duke shfrytëzuar trasetë e rrugëve urbane, locale dhe regjionale.

### 3.5.5. Vlerësimi I nevojave në të ardhmen për infrastrukturë transportuese

Mungesa e objektit të stacionit të autobusëve në zonën urbane dhe organizimi joadekuat dhe jasht standardeve i vendstacioneve në vendbanimet e komunës, vlerësohet si problem kryesor i infrastrukturës transportuese prandaj, është e nevojshme që stacioni kryesor i autobusëve të riorganizohet dhe rregullohet si për nga struktura e ndertimit poashtu edhe për nga ajo funksionale. Prandaj është e nevojshme të rregullohet objekti i stacionit të autobusëve sipas standardeve të ndërtimit dhe të paiset me paisje TI të kohës. Gjithashtu duhet të ndërtohen gjithësejtë 39 vendëstacione të modelit SMART, prej të cilave 5 vendndalje të autobusëve në zonën urbane dhe 34 në vendbanimet rurale.

### 3.5.6. Vleresim i kapaciteteve financiare dhe teknike te komunes per realizimin e infrastruktures se transportit

Vlerësimi I kapaciteteve financiare dhe teknike të komunës për realizimin e infrastrukturës së transportit janë paraqitur si aktivitete në kuadër të planit të veprimit në pikën 4.4. të këtij dokumenti.

Tabela 90 SWOT analiza - Infrastruktura e trasnportit

Tabela 91 SWOT analiza - Infrastruktura e transportit

| Përparësitë | Mundësitë |
|---|---|
| Lidhje të mira përmes rrugëve regjionale<br>Qasja e vendbanimeve në infrastrukturë të asfaltuar<br>Qasja e popullsisë në transport publik m<br>bi 96%<br>Qasja e vendbanimeve në telefoni mobile mbi 95%<br>Qasja e popullsisë në rrugë të asfaltuara 93% | Mirëmbajtja e rrugëve lokale të asfaltuara<br>Menaxhimi adekuat i rrjetit të ujit të pijes<br>Menaxhim adekuat i transportit publik<br>Shtrirje e internetit në të gjitha vendbanimet<br>Përmirësimi i rrjetit të energjisë elektrike<br>Shtrirja e rrjetit të kanalizimit në vendbanime ku mungon<br>Ndriçimi i rrugëve në zona të frekuentuara me popullsi të dendur |
| **Dobësitë** | **Kërcënimet** |

| | |
|---|---|
| Gjendja fizike jo e mirë e rrugëve lokale<br>Mos menaxhimi i të gjithë rrjetës së furnizimit me ujë<br>Menaxhimi i dobët i linjave të transportit publik në viset rurale<br>Mungesa e qasjes së shumicës së vendbanimeve në internet<br>Gjendja fizike jo e mirë e rrjetit të energjisë elektrike.<br>Funksionim jo adekuat i linjave hekurudhore<br>Mungesa e qasjes së shumicës së popullsisë në sistem të rrjetit të kanalizimit<br>Mungesa e qasjes së shumicës së popullsisë në menaxhim të | Popullata nuk ka qasje në infrastrukturë teknike (rrjetit të kanalizimit, ujit të pijes, telefonisë mobile dhe fikse, etj..)<br>Mungesa e investimeve kapitale në infrastrukturë |

# 3.6. INFRASTRUKTURA PUBLIKE DHE SOCIALE

## 3.6.1. Administrata publike

Hapësirat për veprim të institucioneve të administratës në komunë në aspektin hapësinor i plotëson kërkesat për hapësirë/ parcela kadastrale të destinuara, dhe ndërtesa me hapësirë të mjaftueshme të ndërtuar. Sa i përket vlerësimit të plotësimit të kërkesave minimale hapësinore të NTPH-së prej 0.62m² për parcela kadastrale mund të vërejm se në këtë komunë ka hapësirë të mjaftueshme administrative.

Tabela 92 Vlerësimi i plotësimit të kërkesave minimale hapësinore të NTPH-së për parcela kadastrale të institucioneve administrative

| Numri i prognozuar i banorëve 2030 | Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale (m²) | Sipërfaqja e kërkuar me NTPH për kokë banori (m²) | Sipërfaqja e pergjithshme që kërkohet me NTPH (m²) | Sipërfaqja e nevojshme shtesë (m²) |
|---|---|---|---|---|
| 50,737 | 38,652.6 | 0.62 | 31,457 | +7,195.6 |

Nga të dhënat mund të konstatohet se e gjithë infrastruktura e administrates është e vendosur në qytetin e Vitisë, ndërësa në vendbanimet tjera sidomos në ato më të mëdha mungon një infrastructure e till. Në vendbanimet që kanë numër më të madh të popullsisë kërkohet të kemi hapësirë dhe infrastrukturë për administrat. Propozimet janë që të kemi hapësirë për administrat në këto vendbanime: Pozharan (2907 m²), Smirë (2459 m²), Gjylekar (1587 m²) dhe Kabash (1475 m²).

## 3.6.2. Institucionet Arsimore

Institucionet e arsimit parafillor: Në Komunën e Vitisë gjendet vetëm dy çerdhe: çerdhja "Gëzimi Ynë" në qytetin e Vitis për fëmijë të moshës nën 5 vjet, me kushte solide. Kjo çerdhe ka 100 nxënë me një hapësirë prej 520 m² dhe oborrin me një hapësirë prej 2800 m². Poashtu kemi edhe një çerdhe private „Hello" me 70 fëmijë dhe me haëpsirë të brendshme 150 m2. Nndërësa, hapsire të jashtme nuk ka. Bazuar në normat teknike minimale të planifikimit hapësinor që e përcaktojnë sipërfaqen e parcelave të institucioneve të arsimit parashkollor ku parashihet sipërfaqe prej 0.30 m²/banor për çerdhe, dhe 1m² / banor për kopsht. Nëse minusohet sipërfaqja ekzistuese e Çerdheve/ Kopshtit prej 0.28 ha, atëherë për nevojat e ardhme paraqiten këto kërkesa bazuar në numrin e popullsisë së parashikuar për vitin 2030. Sipas projksionit për vitin 2030, komuna e Vitis do ti ketë 50737 banorë dhe kur planifikojmë një sipërfaqe në minimum prej 1.3 m² për kok banori, atëherë do të na nevoiten rreth 65958 m² po rreth 6.59 ha. 0.28 ha ekzistojn aktualisht, atëherë hapësira e re e nevojshme është rreth 6.31 ha. Nëse analizohet madhësia mesatare e sipërfaqeve të parcelave për çerdhe/ kopsht prej 0.5-1 ha, rezulton se për të ardhmen nevojiten rreth 5 çerdhe/ kopsht të reja.

Përcaktimi i lokacioneve për çerdhe/kopshte varet nga disponueshmeria e pronës publike dhe largësisë së institucioneve të tjera, apo edhe nga faktorë të tjerë lokal.

Sipas Udhëzimit Administrativ MMPH-Nr.30/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor, infrastruktura e institucioneve të arsimit parashkollor, duhet të planifikohet në lokacione, si në vijim:

1. Në kuadër të zonës së banimit;
2. Në lokacion të rrafshët ose me pjerrtësi të vogël;
3. Në lokacion të diellosur dhe të mbrojtur nga erërat e forta;
4. Në afërsi të infrastrukturës rrugore, shtigjeve për këmbësorë dhe biçikleta si dhe qasjes në transport publik;
5. Në largësi nga lokacionet e ndotura;
6. Në largësi nga lokacionet e ekspozuara ndaj rreziqeve natyrore- vërshimet;
7. Në largësi nga trafiku i rëndë (infrastruktura rrugore dhe hekurudhore);
8. Në largësi më të madhe se 150 m nga lokacionet me rrezikshmëri nga zjarret;
9. Në largësi më të madhe se 800 m nga ndërtesat industrial

Dizpozitat për këtë infrastrukturë të përcaktohen në mënyrë fleksibile dhe duke u bazuar në faktorët lokal.

Tabela 93 Kërkesat minimale hapësinore të NTPH-së për parcela kadastrale për Arsimin Parashkollor

| Numri i prognozuar i banorëve 2030 | Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale ($m^2$) | Sipërfaqja e kërkuar me NTPH për kokë banori ($m^2$) | Sipërfaqja e pergjithshme që kërkohet me NTPH ($m^2$) | Sipërfaqja e nevojshme shtesë ($m^2$) |
|---|---|---|---|---|
| 50,737 | 2,800 | 1.3 | 65,958 | -63,158 |

Nga këto vlerësime mund të konstatohet se në këtë komunë kemi mungesë të konsiderueshme të hapësirave për çerdhe/kopshte dhe përcaktimi i hapësirave të nevojshme duhet të shpërdahet kryesisht në vendbanimet me më shumë banorë. Në këtë rast ne do të marrim vendbanimet me mbi 2,500 banor dhe do të analizojmë mungesat e hapësirave të nevojshme:

Tabela 94 Vendbanimet me mbi 2300 në komunën e Vitisë dhe sipërfaqja e nevojsjme sipas NTPH për parcela kadastrale për institucionet parashkollore

| Vendbanimi | Numri i parashikuar i banorëve 2030 | Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale ($m^2$) | Sipërfaqja e kërkuar me NTPH për kokë banori (m2) | Sipërfaqja e pergjithshme që kërkohet me NTPH ($m^2$) | Sipërfaqja e nevojshme shtesë ($m^2$) |
|---|---|---|---|---|---|
| Viti | 5317 | 2800 | 1.3 | 6912 | -4112 |
| Pozharan | 4586 | 0 | 1.3 | 5962 | -5962 |
| Smirë | 4181 | 0 | 1.3 | 5435 | -5435 |
| Gjylekar | 2698 | 0 | 1.3 | 3507 | -3507 |
| Kabash | 2510 | 0 | 1.3 | 3263 | -3263 |
| Sllatinë e Epërme | 2502 | 0 | 1.3 | 3252 | -3252 |

Institucione të arsimit fillor dhe të mesëm të ulët dhe të lartë: Përmirësimi i infrastrukturës në shkollat e komunës së Vitisë ka qenë vazhdimisht si prioritet me rëndësi dhe me ndihmen edhe të donatorëve të ndryhëm janë bërë përmirësime të vazhdueshme. Megjithatë, komuna e Vitis ende përballet me sfida të shumta në kompletimin e infrastrukturës së nevojshme. Në vazhdim do të analizohen normat minimale teknike të planifikimit hapësinor për sipërfaqen e parcelave të infrastrukturës së institucioneve të arsimit parauniversitar fillor dhe të mesëm të ultë, që përcakton se për çdo banor duhet të planifikohet sipërfaqe prej $1.6m^2$/banor për shkollë fillore, dhe $1.2m^2$ / banor për shkollë të mesme të ulët që në total kërkohen 2.8 $m^2$ për banorë për këtë nivel të shkollimit.

Në komunën e Vitisë aktualisht mësimi fillor dhe i mesëm i ulët zhvillohet në 35 objekte shkollore. Hapësira ekzistuese e këtyre objekteve shkollore është gjithsej 306169.5 m². Nga kjo hapësirë, 32826.33 m² janë hapësirë e objektit të shkollës apo rreth 10%, ndërësa hapësira e oborrit të shkollave është 273343.2 m² apo rreth 90% e hpësirës së përgjithshme. Sipas NTPH ky proporcion do të duhej të ishte 40% /60%. Bazuar në parashikimin e popullsisë për vitin 2030 ku kjo komunë do të ketë 50,737 banorë, atëherë kërkesat e hapësirës së përgjithshme për shkolla fillore dhe shkolla të mesme të ulëta është 142,063m².

Tabela 95 Kërkesat minimale hapësinore të NTPH-së për parcela kadastrale për Arsimin fillor dhe shkolla të mesme të ulëta

| Numri i prognozuar i banorëve 2030 | Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale (m²) | Sipërfaqja e kërkuar me NTPH për kokë banori (m²) | Sipërfaqja e pergjithshme që kërkohet me NTPH (m²) | Sipërfaqja e nevojshme shtesë (m²) |
|---|---|---|---|---|
| 50,737 | 306169.5 | 2.8 | 142,063 | +164,106 |

Aktualisht mund të konstatojmë se hapësira shkollore në komunëne vitis nuk është e pamjaftueshme por përkundrazi, kemi hapësir edhe një herë më të madhe se ajo që kërkohet me NTPH. Hapësira shkollore ndryshon varësisht nga shkollat në vendbanimet e dryshme të komunës. Ekzistojnë vetëm 5 shkolla në 5 vendbanime të komunës që kemi munges të hapësirës shkollore sipas NTPH. Të gjitha shkollat e tjera sipas këtyre normave e plotësojn dhe e tejkalojn hapësirën shkollore.

Tabela 96 Vendbanimet me mbi 1,000 banorë që nuk plotësojnë kërkesat minimale të kërkuara me NTPH për parcela kadastrale për SHFMU dhe sipërfaqet shtesë që nevojiten të destinohen

| Vendbanimi | Numri i parashikuar i banorëve 2030 | Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale (m²) | Sipërfaqja e kërkuar me NTPH për kokë banori (m2) | Sipërfaqja e pergjithshme që kërkohet me NTPH (m²) | Sipërfaqja e nevojshme shtesë (m²) |
|---|---|---|---|---|---|
| Binçë | 1218 | 3352 | 2.8 | 3410 | -58 |
| Sadovinë e Jerlive | 1189 | 689 | 2.8 | 3329 | -2140 |
| Smirë | 4181 | 5296 | 2.8 | 11,706 | -6410 |
| Tërpezë | 1963 | 4967 | 2.8 | 5496 | -529 |
| Vërban | 2169 | 1322 | 2.8 | 6073 | -4751 |

Institucione të arsimit të mesëm të lartë: Në arsimin e mesëm të lartë në komunën e Vitis ekzistojnë 3 shkolla të mesme ku mësimet i vijojn 1862 nxënës dhe janë të angazhuar 160 mësimdhënës në një sipërfaqe totale të parcelave kadastrale prej 44495.13 m² apo rreth 4.4 ha. Normat teknike të planifikimit hapësinor kanë vendosur një normë minimale për sipërfaqen e parcelave të infrastrukturës së institucioneve të arsimit të mesëm të lartë, që përcakton se për çdo banor duhet të planifikohet sipërfaqe prej 1m²/ banor për shkollë të mesme të lartë.

Tabela 97 Vlerësimi i plotësimit të kërkesave minimale hapësinore sipas NTPH-së për parcela kadastrale për ShML

| Numri i prognozuar i banorëve 2030 | Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale (m²) | Sipërfaqja e kërkuar me NTPH për kokë banori (m²) | Sipërfaqja e pergjithshme që kërkohet me NTPH (m²) | Sipërfaqja e nevojshme shtesë (m²) |
|---|---|---|---|---|
| 50737 | 44495.13 | 1 | 50737 | -6242 |

Sipas këtyre shënimeve kërkohet që të plotësohet hapësira edhe me 6242 m².

Bazuar në NTPH, Infrastruktura e institucioneve të arsimit para-universitar, duhet të planifikohet në lokacione, si në vijim:

1. në afërsi të zonës së banimit në vendbanime urbane;
2. në kuadër të zonës së banimit në vendbanime rurale;
3. në lokacion të rrafshët ose me pjerrtësi të vogël;
4. në lokacion të diellosur dhe të mbrojtur nga erërat e forta;
5. në afërsi të infrastrukturës rrugore, shtigjeve për këmbësorë dhe biçikleta si dhe qasjes në transport publik;
6. në largësi nga ndërtesat të cilat krijojnë ndotje të mjedisit dhe zhurmë;
7. në largësi nga lokacionet e ekspozuara ndaj rreziqeve natyrore- vërshimet;
8. në largësi nga trafiku i rëndë (infrastruktura rrugore dhe hekurudhore);
9. në largësi më të madhe se 150 m nga lokacionet me rrezikshmëri nga zjarret;
10. në largësi më të madhe se 800 m nga ndërtesat industriale

Dizpozitat për këtë infraktrukturë të përcaktohen në mënyrë fleksibile dhe duke u bazuar në faktorët lokal.

### 3.6.3. Institucionet Shëndetësore

Shërbimet shëndetësore publike në komunën e Vitisë janë të organizuara në tri nivele: Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) në qytein e Vitisë, Qendra e Mjekësisë Familjare (QMF) në Pozharan dhe 10 ambulanca (AMF).

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Viti ka 2761 m² hapësirë të ndërtuar, ndërësa sipërfaqja e zones kadastrale është 0.99 ha. Qendra e Mjekësis Familjare në Pozharan ka hapësirë të ndërtuar prej 850 m² dhe sipërfaqe të zonave kadastrale prej 0.3 ha. 10 ambulantat e komunës së Vitisë kanë hapësirë të ndërtuar 1743.86 m² dhe sipërfaqe të zonave kadastrale prej 7.62 ha.

Tabela 98 Numri dhe hapësira e objekteve shëndetësore të ofruara në komunën e Vitisë

| | QKMF | QMF | AMF | Gjithsej |
|---|---|---|---|---|
| Numri i institucioneve | 1 | 1 | 10 | 12 |
| Sipërfaqja në m² | 9900 | 3000 | 76200 | 89100 |

Bazuar në sipërfaqet e përgjithshme aktuale prej 89100m² dhe numrin e parashikuar të banorëve për vitin 2030 prej 51867 banorë, rezulton se Komuna ka përmbushur kërkesat minimale hapësinore të përcaktuara sipas Normave Teknike për Planifikim Hapësinor për infrastrukturë të institucioneve shëndetësore, dhe ka tejkaluar ato për 78953m².

Tabela 99 Vlerësimi i plotësimit të kërkesave minimale hapësinore të NTPH-së për parcela kadastrale të institucioneve shëndetësore

| Numri i parashikuar i banorëve 2030 | Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale (m²) | Sipërfaqja e kërkuar me NTPH për kokë banori (m²) | Sipërfaqja e pergjithshme që kërkohet me NTPH (m²) | Sipërfaqja e nevojshme shtesë (m²) |
|---|---|---|---|---|
| 50737 | 89100 | 0.2 | 10147 | +78953 |

### 3.6.4. Institucionet Kulturore dhe Sportive

Shtëpia e kulturës - gjendet në qytetin e Vitisë që shërben për aktivitete të ndryshme kulturore dhe rinore. Ky është objekti i vetëm kulturor në këtë komunë. Në vazhdim është paraqitur hapësira dhe kërkesat sipas NTPH-së për infrastrukturën e institucioneve kulturore:

Tabela 100 Vlerësimi i plotësimit të kërkesave minimale hapësinore të NTPH-së për parcela kadastrale të institucioneve kulturore

| Lloji i institucionit kulturor | Numri i prognozuar i banorëve 2030 | Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale (m²) | Sipërfaqja e kërkuar me NTPH për kokë banori (m²) | Sipërfaqja e pergjithshm e që kërkohet me NTPH (m²) | Sipërfaqja e nevojshme shtesë (m²) |
|---|---|---|---|---|---|
| **Shtëpia e kulturës** | 50737 | 1971.9 | 0.20 | 10147 | -8176 |

Sic shihet edhe nga tabele mund të konstatojmë se hapësira për shtëpi të kulturës në këtë komunë është e pa mjaftueshme dhe kërkohen edhe 8176 meter katror më tepër. Gjithashtu kjo hapësirë nuk duhet të jetë e koncentruar vetëm në qytetin e Vitisë.

Bibliotekat: Komuna e Vitisë ka bibloteka në qytetin e Vitisë, Pozharan dhe Sllatinë e epërme. Në vazhdim është paraqitur hapësira dhe kërkesat sipas NTPH-së për infrastrukturën të bibliotekës.

Tabela 101 Vlerësimi i plotësimit të kërkesave minimale hapësinore të NTPH-së për parcela kadastrale të bibliotekave

| Lloji i institucionit kulturor | Numri i prognozuar i banorëve 2030 | Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale (m²) | Sipërfaqja e kërkuar me NTPH për kokë banori (m²) | Sipërfaqja e pergjithshm e që kërkohet me NTPH (m²) | Sipërfaqja e nevojshme shtesë (m²) |
|---|---|---|---|---|---|
| Bibliotekë | 50737 | 2693.2 | 0.25 | 12684.25 | -9991.05 |

Siç shihet edhe nga tabela mund të konstatojmë se hapësira për bibliotek në këtë komunë është e pa mjaftueshme dhe kërkohen edhe 9991.05 meter katror më tepër. Gjithashtu kjo hapësirë nuk duhet të jetë e koncentruar vetëm në qytetin e Vitisë.

Komuna e Vitisë ka gjithsej 17 klube sportive që e zhvillojnë aktivitetin e tyre në 16 fusha sportive. Fushat sportive të mbuluara janë 10 dhe 6 të tjera janë hapësira sportive të hapura.

Tabela 102 Hapësirat sportive në komunën e Vitisë

| Vendbanimi | Klube sportive | Fusha sportive të mbuluara | Fusha sportive të pa mbuluara |
|---|---|---|---|
| Viti | 14 | 2 | 1 |
| Pozharan | 2 | 2 | 1 |
| Sadovinë e Jerlive | 1 | 1 | 2 |
| Beguncë | | | 1 |
| Budrikë e Epërme | | 1 | |
| Drobesh | | 1 | |
| Kabash | | | 1 |
| Novosellë | | 1 | |
| Ramnishtë | | 1 | |
| Sadovinë Çerkezve | | 1 | |
| Stubëll e Epërme | | 1 | |
| **Gjithsej** | **17** | **10** | **6** |

Bazuar në vlerësimin e gjendjes aktuale dhe kërkesave sipas Normave minimale Teknike për Planifikim Hapësinor dhe numrin e parashikuar të banorëve për vitin 2030, janë paraqit hapësirat e nevojshme sportive dhe rekreative në komunën e Vitisë.

Tabela 103 Vlerësimi i plotësimit të kërkesave minimale hapësinore të NTPH-së për parcela kadastrale të hapësirave sportive dhe rekreative

| Numri i prognozuar i banorëve 2030 | Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale (m²) | Sipërfaqja e kërkuar me NTPH për kokë banori (m²) | Sipërfaqja e pergjithshme që kërkohet me NTPH (m²) | Sipërfaqja e nevojshme shtesë (m²) |
|---|---|---|---|---|

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 50737 | 96453.7 | 2.5 | 126842 | -30389 |

Tabela 104 Vendbanimet me 1,000-5,000 banorë që nuk plotësojnë kërkesat minimale të kërkuara me NTPH për parcela kadastrale të hapësirave sportive dhe rekreative që nevojiten të destinohen

| Vendbanimi | Numri i prognozuar i banorëve 2030 | Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale (m²) | Sipërfaqja e kërkuar me NTPH për kokë banori (m²) | Sipërfaqja e pergjithshme që kërkohet me NTPH (m²) | Sipërfaqja e nevojshme shtesë (m²) |
|---|---|---|---|---|---|
| Beguncë | 2303 | 0 | 2.5 | 5757 | -5757 |
| Binçë | 1218 | 0 | 2.5 | 3045 | -3045 |
| Drobesh | 1992 | 25706.3 | 2.5 | 4980 | +20726.3 |
| Gjylekar | 2698 | 0 | 2.5 | 6745 | -6745 |
| Kabash | 2510 | 0 | 2.5 | 6275 | -6275 |
| Lubishtë | 1561 | 0 | 2.5 | 3902 | -3902 |
| Pozharan | 4586 | 19276.3 | 2.5 | 11465 | +7811.3 |
| Radivojc | 1344 | 0 | 2.5 | 3360 | -3360 |
| Remnik | 1992 | 0 | 2.5 | 4980 | -4980 |
| Sadovinë e Çerkezve | 1352 | 0 | 2.5 | 3380 | -3380 |
| Sadovinë e Jerlive | 1189 | 22713.1 | 2.5 | 2972 | +19741.1 |
| Sllatinë e Epërme | 2502 | 0 | 2.5 | 6255 | -6255 |
| Sllatinë e Poshtme | 1271 | 0 | 2.5 | 3177 | -3177 |
| Smirë | 4181 | 0 | 2.5 | 10452.5 | -10452.5 |
| Stubëll e Epërme | 1219 | 6000 | 2.5 | 3047.5 | +2952.5 |
| Tërpezë | 1963 | 0 | 2.5 | 4907.5 | -4907.5 |
| Vërban | 2169 | 0 | 2.5 | 5422.5 | -5422.5 |
| Viti | 5317 | 22758 | 2.5 | 13292.5 | +9465.5 |

### 3.6.5. Hapësirat e Gjelbërta dhe Parqet Publike

Tabela 105 Vlerësimi i plotësimit të kërkesave minimale hapësinore të NTPH-së për parcela kadastrale të hapësirave të hapura publike

| Numri i prognozuar i banorëve 2030 | Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale (m²) | Sipërfaqja e kërkuar me NTPH për kokë banori (m²) | Sipërfaqja e pergjithshm e që kërkohet me NTPH (m²) | Sipërfaqja e nevojshme shtesë (m²) |
|---|---|---|---|---|
| **50737** | 128269 | 2.00 | 101474 | +26795 |

### 3.6.6. Objektet Fetare dhe Varrezat Publike

Bazuar në vlerësimin e gjendjes aktuale, normat minimale për sipërfaqen e parcelës të Normave Teknike për Planifikim Hapësinor dhe numrin e prognozuar të banorëve për vitin 2030, Komuna ka plotësuar kërkesat hapësinore për varreza dhe tejkaluar ato për 401046.6 m2 , kështu që Komuna nuk ka nevojë të përcaktojë sipërfaqe shtesë.

Tabela 106 Vlerësimi i plotësimit të kërkesave minimale hapësinore të NTPH-së për parcela kadastrale të hapësirave për varreza

| Numri i prognozuar i banorëve 2030 | Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale (m²) | Sipërfaqja e kërkuar me NTPH për kokë banori (m²) | Sipërfaqja e pergjithshm e që kërkohet me NTPH (m²) | Sipërfaqja e nevojshme shtesë (m²) |
|---|---|---|---|---|
| **50737** | 477152.1 | 1.50 | 76105.5 | +401046.6 |

Gjatë analizës së sipërfaqeve kadastrale për kokë banori në numrin e parashikuar për vitin 2030 për secilin vendbanim të komunës së Vitisë, del se hapësira ekzistuese e varrezave është e mjaftueshme edhe për periudhën e ardhme deri në vitin 2030.

### 3.6.7. Vlerësimi i kapaciteteve financiare dhe teknike të komunës për realizimin e infrasturkturës publike dhe sociale

Vlerësimi I kapaciteteve financiare dhe teknike të komunës për realizimin e infrastrukturës publike dhe sociale janë paraqitur si aktivitete në kuadër të planit të veprimit në pikën 4.4. të këtij dokumenti.

| Përparësitë | Dobësitë |
|---|---|
| **Një çerdhe për fëmjë**<br>**35 objekte shkollore për mësimin fillor dhe të mesëm të ulët**<br>**Hapësirë e mjaftueshme shkollore për mësimin fillor dhe të mesëm të ulët**<br>**3 shkolla të mesme**<br>**Hapësirë e mjaftueshme shëndetësore (Një Qendër Kryesore e Mjekësisë Familjare në Viti, 4 Qendra të Mjekësisë Familjare, 5 Ambulanta)**<br>**Hapësirë e mjaftueshme administrative**<br>**Qendra e kulturës Viti**<br>**Fusha sportive dhe hapësira rekreative**<br>**Biblioteka**<br>**Hapësira të gjelbërta dhe publike që I plotësojnë normat teknike për kok banorei**<br>**Objekte fetare gati në të gjitha vendbanimet**<br>**Hapësira të mjaftueshme për varreza dhe plotësimi I normave teknike që kërkohen për kok banori** | Mungesa e hapësirës shkollore për insitucione parashkollore (63158 $m^2$ shtesë kërkohen)<br>Mungesa e institucioneve parashkollore në 5 vendbanimet më të mëdha të komunës<br>Në disa fshatra mungon hapësira e nevojshme shkollore për shkollimin fillor dhe të mesëm të ulët (Binç, Sadovinë e Jerlive, Smirë, Tërpezë dhe Vërban)<br>Mungesa e hapësirave shkollore sipas normave teknike në shkollimin e mesëm të lartë (6242 $m^2$)<br>Shpërndarje jo e barabart e objekteve administrative<br>Kërkohen 8176 meter katror më tepër për shtëpi të kulturës. Gjithashtu kjo hapësirë nuk duhet të jetë e koncentruar vetëm në qytetin e Vitisë<br>Sipas normave teknike kërkohen edhe 30389 $m^2$ hapësira sportive dhe rekreative<br>10 mijë meter katror më tepër për bibliotek dhe kjo hapësirë nuk duhet të jetë e koncentruar vetëm në qytetin e Vitisë. |
| **Mundësitë** | **Rreziqet** |
| **Përcaktimi i sipërfaqeve për të plotësuar kriteret minimale të NTPH për parcela kadastrale të destinuara për institucionet e arsimit parauniversitar;**<br>**Përcaktimi i sipërfaqeve për të plotësuar kriteret minimale të NTPH për parcela kadastrale të destinuara për institucionet e shëndëtësore të kujdesit primar;**<br>**Përcaktimi i sipërfaqeve për të plotësuar kriteret minimale të NTPH për parcela kadastrale të destinuara për hapësira kulturore;**<br>**Mundësia e shpërndarjës së infrastrukturës sociale, publike dhe administrative edhe në vendbanimet tjera më të mëdha** | Mungesa e mjeteve financiare për të plotësuar kriteret minimale të NTPH<br>Mungesa e fondeve të nivelit qendror për të paguar punëtorë shtesë në institucionet publike dhe sociale<br>Problemet me pronësi |

## 3.7. MJEDISI DHE SIPËRFAQET ME RREZIKSHMËRI

Në këtë kapitull janë trajtuar dhe vlerësuar mjedisi dhe sipërfaqet me rrezikshmëri në territorin e komunës. Duke marrë parasysh mungesën e të dhënave për disa nga aspektet që duhet të trajtohen në kuadër të kësaj tematike, vlerësimi është bërë në lidhje me ndotjen e mjedisit, ajrit, ujit, zhurmës dhe sipërfaqet me rrezikshmëri duke përfshirë tërmetet dhe erozionin.

Gjendja e mjedisit në komunën e Vitisë nuk është e mirë. Problemet kryesore në fushën e mjedisit janë: urbanizimi i pa kontrolluar dhe ndërtimet e egra, cilësa e dobët e ujit në lumenjë, cilësia e dobët e ujit të pijshëm, përdorimi i papërshtatshëm i tokës bujqëesore, zhurma etj.. Ndërsa, ndotësit kryesor të mjedisit janë mbeturinat komunale, kanalizimi dhe aktivitetet bujqësore.

### 3.5.1. Ndotja e ajrit

Aktualisht kontribuesit më të mëdhenjë të ndotjes së ajrit në Viti janë burimet statike dhe ato lëvizëse. Si ndotës kryesorë mund të llogaritet sektori i transportit, gurëthyesit dhe lokacionet ku ilegalisht hudhen dhe digjen mbeturinat.

Rrugët rajonale Gërlicë-Viti dhe Viti-Letnicë, si dhe magjistralja Ferizaj- Gjilan janë vendet të cilat më së shumti i ekspozohen ndotjes nga transporti. Këto rrugë janë mjaftë të ngarkuara me automjete të të gjitha llojeve, ndërsa i përshkojnë këto vende: qytetin e Vitisë me fshatrat që shtrihen për gjatë këtyre rrugëve, pastaj fshatrat Budrikë, Radivojcë, Ramjan dhe Pozharan. Sektori i transportit karakterizohet me numër të madh të makinave të vjetëruara dhe përdorim të karburanteve jo adekuate dhe jo cilësore andaj edhe ndikon në ndotjen e ajrit. Prandaj për të parandaluar apo së paku për të zvogëluar ndikimin negativ të këtyre mjeteve në cilësinë e ajrit, duhet të planifikohet kontrollimi i rregullt teknik i automjeteve të transportit, duke zvogëluar kështu emetimin e gazërave të dëmshme për shëndetin e njeriut.

Po ashtu njëri ndër sektorët të cilët kontribojnë në ndotjen e ajrit, kryesisht përmes djegies së biomasës (hamulloreve, mbetjeve të drunjëve), është edhe ai i bujqësisë. Tutje, sikur në të gjithë Kosoven, edhe në komunën e Vitisë krijohen zona ilegale për hudhjen dhe djegien e mbeturinave të cilat paraqesin një burim serioz të ndotjes së ajrit. Prandaj duhet të planifikohet parandalimi i hedhjes së mbeturinave në këto vende, dhe të krijohen deponi të cilat kanë për qëllim grumbullimin e mbeturinave duke minimizuar ndikimin negativ në cilësinë e ajrit në komunë.

### 3.5.2. Ndotja e ujit

Duke marrë parasysh se vetëm 30% e banorëve llogaritet të kenë kyçje në rrjetën e kanalizimit, rrjedhja e ujërave të zeza në gjithë territorin e komunës është problem mjaftë i madh. Ujërat e zeza barten në lumin " Morava" dhe janë të pa trajtuara, ndërsa rrjetat e kanalizimit të ndërtuara pas luftës në disa fshatra paraqesin problem në vete ngasë derdhja e tyre bëhet në ambient të hapur, jashtë standardeve dhe në mënyrë të egër.

Ndotja e ujërave në lumin Morava vërehet edhe në florën algale. (Metallari, N. 2009). Me hulumtimet algologjike në një pjesë të lumit Morava e Binçës në tetor 2007 dhe shkurt 2008, janë regjistruar 35 lloje të algave. Prej tyre boshtin kryesor e përbëjnë algat Bacillariophyta (30 lloje). Nga algat Bacillariophyta, gjinitë dominuese kanë qenë: Nitzschia me (7 lloje), dhe Navicula me (6 lloje). Ndarja Cyanophyta ka qenë e njohur me (2 lloje), ndarja Chlorophyta me (2 lloje) dhe ndarja Rhodophyta me (1 lloj).

### 3.5.3. Ndotja nga zhurma

Në mënyrë që vendbanimet të mbrohen nga tejkalimi i nivelit të zhurmës së lejuar, është e nevojshme të ndërtohen pengesa dhe të zhvillohen breza të gjelbër në mes të korridoreve të automjeteve motorike dhe vendbanimeve. Shfrytëzuesi i pajisjeve, të cilat prodhojnë zhurmë dhe vibracion, mund të vë në qarkullim ose të përdorë pajisjet sipas kushteve të parapara për aplikimin e masave mbrojtëse, për zvogëlimin e zhurmës dhe vibracionit, respektivisht të bëjë përdorimin e impianteve, pajisjeve, makinave, mjeteve transportuese dhe aparateve, të cilat lirojnë zhurmë deri në nivelin e paraparë me ligj të veçantë.

### 3.5.4. Sipërfaqet me rrezikshmëri

#### *3.5.4.1. Tërmetet*

Territori i komunës së Vitisë ka për karakteristikë zonën e burimeve sizmike të njohur si Zona sizmogjene Ferizaj – Viti – Gjilan, me magnitude maksimale M= 6.1 shkalla Riter.

Si rezultat i të dhënave të cekura në kapitullin e profilit komunal, mund të themi se territori i komunës së Vitisë si dhe pjesa më e madhe e territorit të Kosovës, janë nën ndikimi sizmik aktiv, e me rrezikshmëri sizmike të lartë, njëlloj si vendet fqinje me të.

Kështu, është e domosdoshme të planifikohen masa parandaluese për të evituar viktimat dhe dëmet e mundshme.

### 3.5.4.2. *Erozioni*

Territori i komunës së Vitisë, karakterizohet me një pjesëmarrje të sipërfaqeve të konsiderueshme erozive. Prandaj, në zonat me erozion shumë të fortë dhe të fortë duhet të ndërmerren masat e nevojshme si meliorimi i pyjeve, ndalimi i prerjeve ilegale të pyjeve dhe ndërtimi i brezave mbrojtëse në shpatijet e rrëpishme.

Tabela 107 SWOT analiza - Mjedisi

| Përparësitë | Dobësitë |
|---|---|
| **Pozita gjeografike dhe hapësira e përshtatshme e Komunës;**<br>**Mungesa e një industrie të zhvilluar që ka efekte në fushën e mjedisit.**<br>**Ekzistimi i pyjeve të lartësisë mesatare. -Mungesa e komunikacionit ajror dhe intenziteti i ulët i atij rrugor**<br>**Sasi të mjaftueshme të burimeve të ujit të pijes.**<br>**Burimet e ujërave minerale (Pozheran, Zhiti etj.)**<br>**Lumi Morava e Binçës me degët e tij,**<br>**Sasia të madhe të ujërave nëntokësor (rezerva).**<br>**Toka bujqësore e mjaftueshme me bonitet të lartë.**<br>**Kullosa të mjaftueshme për zhvillim të blegtorisë.** | Mungesa e pikave monitoruese të cilësisë së ajrit.<br>Pozita Gjeografike-gazrat që lirohen gjatë djegieve të ndryshme largohen me vështirësi nga territori i Vitisë për shkak se erërat fryjën me shpejtësinë mesatare 1.0-2.4 m/s.<br>Mungesa e impianteve për trajtimin e ujit të pijes, në aspektin biologjik, kimik dhe fizik.<br>Mungesa e impianteve për trajtimin e ujërave të zeza urbane,<br>Infrastruktura jo e zhvilluar (uji jo cilësor, kanalizimet, hedhja e mbeturinave të ngurta).<br>Shfrytëzimi i ujit të pijes nga sektorët ekonomik<br>Shfrytëzimi i pakontrolluar i ujit në amvisëri.<br>Ndotja e lumenjve nga shkarkimi i ujërave të zeza dhe industriale, hedhja e mbeturinave në to.<br>Humbja e tokës bujqësore nga ndërtimet dhe deponitë.<br>Zvogëlimi i tokave pyjore nga prerja e pakontrolluar e drunjve,<br>Zjarret |

| Mundësitë | Kërcënimet |
|---|---|
| **Vetëdijësimi dhe edukimi i popullsisë për shfrytëzim racional të resurseve ujërave.**<br>**Konfiguracioni i terrenit i mundëson shpërndarje disperse pa shfrytzim te pompave apo formave tjera te energjisë.**<br>**Hartimi i politikave dhe planeve për ruajtjen e tokës bujqësore dhe pyjore.**<br>**Informimi i qytetarëve për rendësin e ruajtjes së tokës bujqësore.**<br>**Fuqizimi i institucioneve dhe mekanizmave për të implementuar ligjin për ruajtjen e tokës buqësore dhe aktet tjera nënligjore.** | Rreziku më i madh i ndotjes së ajrit në Komunës së Vitisë i vije nga djegiet e biomasës (kashta, talla, ashklat e drurit dhe djegiet e qëllimshme dhe të pa qëllimshme të pyjeve) dhe mbeturinave komunale në mënyrë të pakontrolluar dhe të jashtëligjshme<br>Mos ekzistimi i ngrohtores së qytetit dhe e pjesëve tjera rurale. Ngrohja gjatë dimrit bëhet në mënyrë individuale, kështu duke shkarkuar gazra të cilët ndikojnë në zvogëlimin e kualitetit të ajrit.<br>Derdhja e ujërave të zeza dhe mbeturinave të ngurta në lumenj dhe shfrytëzimi jo racional i ujërave të pijes do të jetë kërcënim serioz dhe rrezikon që Vitia të mbetet pa këtë resurs që ka vlerë jetike.<br>Humbja ireverzibile e resurseve tokësore dhe të tokës më pjellore në komunën e Vitisë, që janë krijuar me miliona vite për ne, do të ishte rrezik permanent për shëndetin e njerëzve dhe kualitetin e jetës në Viti. |

## 3.8. TRASHËGIMIA KULTURORE, NATYRORE DHE ASETET TURISTIKE

Duke vlerësuar se aktivitetet e planifikuara në Planin Zhvillimor Komunal të Vitisë dhe Kllokotit 2010-2020+ ende nuk janë implementuar, është shumë e rëndësishme që planifikimet e tilla të përjetësohen sa

më shpejtë në mënyrë që të promovohet zhvillimi lokal i turizmit dhe veprimtarive ekonomike të ndërlidhura me të, duke kontribuar në krijimin e vendeve të punës dhe të hyrave për popullsinë lokale.

Komuna e Vitisë është e pasur me lokalitete të trashëgimisë arkeologjike, një pjesë e të cilave janë shpallur edhe nën mbrojtje të përkohshme, ndërsa një prej tyre, Manastiri i Binaçit është shpallur si zonë e vecantë e mbrojtur dhe si e tillë, çdo lloj intervenimi në këtë zonë rregullohet sipas ligjit nr.03/L-039 për Zonat e Veçanta të Mbrojtura. Por, shumë prej këtyre lokaliteteve nuk janë në gjendje të mirë fizike dhe kërkojnë intervenime restauruese dhe zhvilluese. Gjithashtu këto lokalitete të trashëgimisë arkeologjike nuk e kanë të përcaktuar perimetrin dhe zonën mbrojtëse ashtu siç kërkohet me Ligjin për Trashëgimi Kulturore, si dhe sipërfaqen e mbrojtur, ashtu siç kërkohet me Ligjin për Planifikimin Hapësinor.

Njëherazi, këto pasuri kulturore cilësohen kapital i çmuar nacional me vlera dhe rëndësi për zhvillime të qëndrueshme shumëdimensionale, përfshirë aspektin ekonomik, politik, kulturor dhe të mirëqenies shoqërore. Zhvillimi dhe ruajtja e duhur e trashëgimisë kulturore për brezat pasardhës, është detyrim dhe përgjegjësi kolektive e shoqërisë bashkëkohore.

Për arsye të mbrojtjes dhe promovimit të aseteve të trashëgimisë kulturore dhe natyrore, duhet të merren masa teknike, profesionale dhe legale që parandalojnë dukuritë negative nga shërbimet e turizmit kulturor e natyror.

Si potencial për komunën e Vitisë vlerësohet promovimi si qytet i turizmit rinor dhe kongresial. Vendbanimi i Letnicës gjithashtu vlerësohet si potencial për turizëm kulturore, rurale dhe agroturizëm si njëra ndër pikat botërore të shtegtimeve të Nënës Terezë. Vendbanimi Stubëll vlerësohet si potencial i rëndësishëm i turzimit kulturor dhe rekreativ.

Zonat arkeologjike në Vërban, Smirë dhe Tërpezë vlerësohen si potencial i rëndësishëm të cilat mund të zhvillohen si pika turistike kulturore, edukative dhe historike. Krijimi i një muzeu arkeologjik që do të vendoste eksponatet arkeologjike të gjetura në këtë komunë do të ndihmonte promovimin e këtyre aseteve arkeologjike për turistët vendor dhe të huaj.

Sa i përket trashëgimisë arkitektonike, vendosja nën mbrojtje dhe restaurimi i xhamisë në fshatin Gërmovë, meremetimi i xhamisë në fshatin Sllatinë, renovimi i mullirit me valovicë në fshatin Binçë, renovimi i mullirit në Letnicë, rikonstruimi i shtëpisë kullë në Radivojc, Skifteraj, Stubëll, restaurimi i njërës prej shkollave të para shqipe në Kosovë ajo në Stubëll dhe fuqizimi i saj si muze kanë rëndësi të madhe për konservimin e vlerave të trashëgimisë kulturore dhe natyrore të komunës së Vitisë.

Trashëgimia e luajtshme në komunën e Vitisë paraqet potencial për promovimin e vlerave tona tradicionale ndër shekullore të cilat duhet të përcillen brez pas brezi.

Tabela 108 SWOT analiza - Trashëgimia kulturore dhe natyrore

| Përparësitë | Dobësitë |
| --- | --- |
| **Florë dhe faunë e pasur;**<br>**Zona dhe peizazhe të pasura me biodiversitet;**<br>**Monumente Natyrore Botanike;**<br>**Monumente Natyrore Hidrologjike;**<br>**Monumente Natyrore Gjeomorfologjike;**<br>**Peizazhe të mbrojtura;**<br>**Prezenca e lokaliteteve arkeologjike dhe objekteve të trashëgimisë arkitektonike të cilat i japin identitet komunës;**<br>**Shenjtore e shpellës, nga periudha parahistorike, që tregon gjurmët e lashtësisë së kësaj ane;**<br>**Manastiri i Binaçit, si zonë e vecantë e mbrojtur.**<br>**Shkolla e parë shqipe;**<br>**Objekte banimi – shtëpi të vjetra tradicionale;** | Resurset natyrore nuk janë mirë të hulumtuara dhe studiuara;<br>Mungon efikasiteti për menaxhimin e zonave dhe monumenteve të mbrojtura;<br>Mungesa e investimeve në mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë natyrore<br>Mungesa e politikave për ruajtjen e trashëgimisë arkeologjike dhe arkitektonike<br>Mungesa e inventarizimit të zonave arkeologjike dhe trashëgimisë arkitektonike si dhe monitorimi;<br>Mungesa e vetëdijes dhe respektit të autoriteteve dhe popullatës ndaj ruajtjes së trashëgimisë natyrore dhe kulturore;<br>Mungesa e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe përfshirja e akterëve të ndryshëm; |

| | |
|---|---|
| Objekte të ndryshme të trashëgimisë fetare (xhami, kisha);<br>Mullinj të vjetër tradicional;<br>Zejet tradicionale;<br>Ritualet;<br>Manifestimet;<br>Kategorizimi i trashëgimisë së luajtshme. | Infrastrukturë e dobët për qasje të kënaqshme nga publiku dhe shenjëzim i varfër në rrugë drejt zonave të trashëgimisë natyrore dhe kulturore;<br>Mungesa e inventarit gjithëpërfshirës të integruar mbi koleksionet e muzeve; |
| **Mundësitë** | **Kërcënimet** |
| Zhvillimi i turizmit malor;<br>Mundësi për rekreacion dhe aktivitete sportive malore;<br>Shfrytëzimi i programeve të ndryshme ndërkombëtare për menaxhimin dhe promovimin e peizazheve, trashëgimisë natyrore dhe kulturore, menaxhimin e resurseve, etj.<br>Shfrytëzimi i trashëgimisë arkeologjike dhe arkitektonike si potencial për të zhvilluar ekonominë e Vitisë (turizmin, hotelierinë, zejtarinë, tregtinë);<br>Fuqizimi i imazhit të komunës;<br>Kampanja informuese. | Shkatërrimi i pyjeve që ndikon në humbjen e arealeve dhe habitateve të llojeve të ndryshme bimore dhe shtazore;<br>Dëmtimi i pakthyeshëm i resurseve natyrore<br>Humbja e vlerave të monumenteve dhe zonave natyrore;<br>Ndërtimet e egra në zonat arkeologjike dhe në afërsi të objekteve të trashëgimisë,<br>Humbjet e monumenteve arkeologjike,<br>Dëmtimi i imazhit historik të qytetit dhe komunës nga degradimi i objekteve të trashëgimisë;<br>Humbja e këtyre objekteve si rezultati i mosmirëmbajtjes dhe mosrestaurimit të tyre.<br>Fatkeqësitë natyrore;<br>Mos futja e trashëgimisë shpirtërore dhe të luajtshme në listën për mbrojtje të përkohshme; |

## 3.9. VENDBANIMET

Zona e ndërtuar kryesisht përfshinë objekte të banimit dhe objekte të tjera përciellëse, Pastaj apartamente që dominojnë kryesisht në qytetin e Vitisë dhe objekte bujqësore. Ekzistojnë gjithësej rreth 11552 objekte banimi me objekte tjera përciellëse, 351 apartamente dhe rreth 268 objekte bujqësore. Kjo hapësirë e ndërtuar, përfshinë Brenda saj edhe infrastrukturën tjetër pëciellëse siq janë rrugët, trotuaret, parkingjet, objektet e shërbimëve, pastaj ato sportive, rekreative etj.

Tabela 109 SWOT analiza - Vendbanimet

| Përparësitë | Dobësitë |
|---|---|
| Infrastruktura teknike bazë relativisht e mirë e vendbanimeve në përgjithësi;<br>Lidhja e mirë e vendbanimeve me qendrën e Vitisë;<br>Qasja e mirë e vendbanimeve në shërbime komunale;<br>Vendbanimet kryesisht janë të koncentruara<br>Kanë dendësi të lartë ndërtimore<br>Kufizimi i ndërtimeve në raport me token bujqësore<br>Pjesa më e madhe e vendbanimeve ka shënuar rritje të popullsisë<br>Pjesa më madhe e tyre shtrihen në hapërë të rrafshtë | Zgjerimi i ndertimeve në tokë bujqësore dhe humbja e tokës bujqësore<br>Zhvillime të shpërqendruara jashtë zonës urbane<br>Fragmentimi i tokës bujqësore në parcel të vogla<br>Mungesa e konsolidimit të tokës (komasacionit)<br>Disa vendbanime me shtrirje lineare<br>Inspektimi i ulët i ndërtimeve; |
| **Mundësitë** | **Kërcënimet** |
| Hartimi Ligjit për Rregullim të tokës urbane<br>Miratimi i Ligjit për Pronën Publike.<br>Ndërprerja e ndërtimeve në zonat bujqësore<br>Përcaktimi i zonave urbane dhe për ndërtim të reja në sipërfaqe të përshtatshme për urbanizim<br>Përcaktimi dhe mbrojtja e zonave bujqësore<br>Caktimi i zonave turistike<br>Planet ekzistuese detaje rregullative | Depopullimi i venbanimeve kodrinoro-malore<br>2 vendbanime/fshatra gati tërësisht të braktisura<br>Migrimi i popullsisë<br>Pronësia e paqartë mund të pengojë zhvillimin e duhur.<br>Ndërtimet pa leje<br>Humbja e tokës bujqësore<br>Krijimi i vendbanimeve lineare |

## 3.10. BANIMI

Ndërtesat afaristo-banesore shtrihen përgjatë rrugëve kryesore, aty ku frekuentimi i banorëve është më i lartë. Në përgjithësi këto ndërtesa nuk janë të kualitetit adekuat dhe mirëmbajtja e tyre bëhet nga iniciativa e vet banorëve të cilët jetojnë në ato ndërtesa. Shtëpitë individuale zakonisht posedojnë etazhitet P apo

P+1, ndërsa ndërteshat shumë-banesore të cilat i hasim në qendër të qytetit posedojnë etazhitet P+3 deri në P+6. Viteve të fundit e sidomos periudha e pas luftës vitet 1999 e tutje karakterizohen me tendencë të ngritjes së etazhitetit te ndërtesat shumë-banesore. Hapësirat e ndërtuara me banim individual karakterizohen si hapësira në të cilat nuk janë respektuar rregullat dhe kriteret urbanistike.

Duke u bazuar në rritjen e numrit të popullsisë të paraparë për vitin 2030, është përcaktuar numri i njësive banimore të nevojshme për planifikim – ndërtim deri në vitin 2030. Duke u bazuar në prognozat demografike, pritet që popullsia e komunës së Vitisë deri në vitin 2030 të rritet për 7.2 %. Mirëpo, duka u bazuar në prtishmëritë që përveç rritjes së numrit popullsisë, faktor tjetër që ndikon në rritjen e kërkesës për banim është edhe rritja e standardit të jetës në përgjithësi, është vendosur që për vitin 2030 të propozohet rritje e hapësirës së banimit për 8 % në krahasim me hapësirën aktuale. Përveç kësaj; përjashtime në planifikimin e hapësirave të reja të banimit janë bërë për qytetin e Vitisë dhe për fshatin Pozharan. E para për shkak të karakterit dhe funksioneve si qendër urbane, ndërsa e dyta për shkak të qenit vendbanimi më i madh menjëherë pas zones urbane. Është vlerësuar se në këto dy vendbanime, krahas shtimit të numrit të popullsisë, kërkesa për hapësira të reja banimi edhe për shkak të karakterit dhe funksioneve të tyre. Në këtë mënyrë, për qyteitn e Vitisë është propozuar një rritje e hapësirave të banimit për 20%, ndërsa për Pozharanin një rritje prej 10 %.

**Tabela 110 Numri i popullsisë për vitin 2019 dhe numri i popullsisë së paraparë për vitin 2030 si dhe numri i njësive banesore në vitin 2019 dhe njësive banesore të parapara për vitin 2030**

| Nr. | Vendbanimi | Popullsia në vitin 2019 | Popullsia në vitin 2030 | Ndërtesa banimore në vitin 2019 | Apartament e në vitin 2019 | Ndërtesa banimore në vitin 2030 | Apartamente në vitin 2030 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Ballancë | 646 | 696 | 191 | | 206 | |
| 2 | Beguncë | 2185 | 2356 | 497 | | 537 | |
| 3 | Binçë | 1154 | 1244 | 349 | | 377 | |
| 4 | Budrikë e Epërme | 921 | 993 | 238 | | 257 | |
| 5 | Buzovik | 533 | 575 | 99 | | 107 | |
| 6 | Çifllak | 92 | 99 | 22 | | 24 | |
| 7 | Debelldeh | 347 | 374 | 89 | | 96 | |
| 8 | Devajë | 299 | 322 | 61 | | 66 | |
| 9 | Drobesh | 1889 | 2036 | 499 | | 539 | |
| 10 | Gërmovë | 907 | 978 | 170 | | 184 | |
| 11 | Goden i Madh | 82 | 88 | 31 | | 33 | |
| 12 | Gushicë | 820 | 884 | 193 | | 208 | |
| 13 | Gjylekar | 2560 | 2759 | 472 | | 510 | |
| 14 | Kabash | 2380 | 2565 | 624 | 2 | 674 | 2 |
| 15 | Letnicë | 273 | 294 | 97 | 1 | 105 | 1 |
| 16 | Lubishtë | 1480 | 1595 | 269 | | 291 | |
| 17 | Mjak | 0 | 0 | 2 | | 2 | |
| 18 | Novosellë | 559 | 603 | 129 | | 139 | |
| 19 | Podgorc | 388 | 418 | 77 | 1 | 83 | 1 |
| 20 | Pozharan | 4350 | 4689 | 1012 | | 1113 | |
| 21 | Radivojc | 1275 | 1374 | 315 | | 340 | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 22 | Ramjan | 917 | 988 | 183 | | 198 | |
| 23 | Ramnishtë | 448 | 483 | 112 | | 121 | |
| 24 | Remnik | 1889 | 2036 | 381 | | 411 | |
| 25 | Sadovinë e Çerkezve | 1292 | 1393 | 243 | | 262 | |
| 26 | Sadovinë e Jerlive | 1127 | 1215 | 225 | 1 | 243 | 1 |
| 27 | Sllatinë e Epërme | 2374 | 2559 | 801 | | 865 | |
| 28 | Sllatinë e Poshtme | 1205 | 1298 | | | | |
| 29 | Smirë | 3966 | 4275 | 697 | | 753 | |
| 30 | Stubëll e Epërme | 1155 | 1244 | 457 | | 494 | |
| 31 | Stubëll e Poshtme | 79 | 85 | 26 | | 28 | |
| 32 | Shashare | 150 | 162 | 15 | | 16 | |
| 33 | Tërpezë | 1862 | 2006 | 418 | | 451 | |
| 34 | Tërstenik | 788 | 849 | 190 | 1 | 205 | 1 |
| 35 | Vërban | 2057 | 2216 | 382 | | 413 | |
| 36 | Vërnakollë | 12 | 13 | 3 | | 3 | |
| 37 | Vërnez | 1 | 1 | 2 | | 2 | |
| 38 | Viti | 5044 | 5437 | 1833 | 345 | 2199 | 414 |
| 39 | Zhiti | 617 | 665 | 174 | | 188 | |
| **Komuna Viti** | | **48123** | **51867** | **11578** | **351** | **12743** | **420** |

Duke u bazuar në vlerësimin e nevojave për banim i cili është i bazuar në trendet e rritjes së popullsisë deri në vitin 2030, si dhe duke u bazuar në kufijtë aktual ndërtimorë, është vlerësuar se në komunën e Vitisë nuk ka nevojë për zgjerim të kufijëve ndërtimor për asnjë vendbanim (përjashtimisht zonës urbane), por vetëm plotësim të hapësirave brenda kufijëve aktual nderëtimorë, përjashtimisht zonave të cilat janë nën komasacion e të cilat janë paraqitur në Hartën e Shfrytëzimit të Tokës. Në zonën urbane është bërë një korrigjim i kufijëve ndërtimor krahasuar me Planin Zhvillimor Komunal Viti-Kllokot 2010-2020+. Me këtë PZHK është paraparë zgjerim i kufijëve ndërtimorë në zonën urbane për 22 hektarë.

Tabela 111 SWOT ANALIZA PËR BANIM

| Përparësitë | Mangësitë |
|---|---|
| **Mundësi ndërtimi brenda kufijëve aktual ndërtimorë;** | Mos respektimi i rregulloreve teknike gjatë ndërtimit;<br>Mungesa e njësive banimore sociale;<br>Ndërtesa shumë-banesore pa leje ndërtimore. |
| **Mundësitë** | **Kërcënimet** |
| **Planifikim adekuat i zonave të banimit bazuar në politikat e planifikimit**<br>**Rritje e cilësisë së banimit**<br>**Interesim i investitorëve privat për ndërtim në zonat urbane në përgjithësi** | Emigrimi i banorëve;<br>Rritja e numrit të banesave jorezidente |

## 3.11. SHFRYTËZIMI I TOKËS

Komuna e Vitisë ka një sipërfaqe totale prej 26.969 ha, nga e cila 45.48% janë pyje dhe kullosa, 42% janë tokë bujqësore, 10.93% banim i përhershëm, 0.55% rrjetet e transportit, 0.15% industri dhe pjesa tjetër e territorit të komunës shfrytëzohet nga kategori të tjera.

Sfidat kryesore për sa i përket shfrytëzimit të tokës kanë të bëjnë me zhvillimin e pakontrolluar të ndërtimit dhe atë të shprehur në dy forma:

1. Humbja e tokës bujqësore nga ndërtimet e objekteve të banimit dhe atyre të afarizmit. Ky fenomen Komunës së Vitisë i ka kushtuar me humbjen e 8.6 ha tokë bujqësore vetëm gjatë periudhës 2015-2020.
2. Zhvillimi i vendbanimeve edhe jashtë kufijëve ndërtimor të përcaktuar me PZHK 2010-2020+ edhe përkundër faktit që kufijtë ndërtimorë ishin më se të mjaftueshëm për nevojat zhvillimore të projektuara. Në këtë kontekst kemi vendbanime të cilët nuk janë zhvilluar brenda kufijëve ndërtimor edhe përkundërt hapësirës së lirë të mjaftueshme, por kanë dalur jashtë atyre kufijëve, ndërsa si shembull për këtë kemi vendbanimet Viti (e cila është zhvilluar në drejtim të Pozharanit) dhe Sadovinë e Çerkezëve.

Edhe projeksioni demografik për vitin 2030, por edhe nevojat për banim dhe aktivitete ekonomike konform këtij projeksioni diktojnë mos pasjen e nevojës për zgjerim të kufijëve ndërtimor nga ata që janë paraparë me PZHK 2010-2020+. Madje, në shumicën absolute të vendbanimeve, në 10 vitet e fundit kemi më pak zhvillime se sa ishin paraparë me PZHK 2010-2020+, rrjedhimisht, këto vendbanime kanë mbetur shumë brenda kufijëve ndërtimorë të përcaktuar. Prandaj, ky PZHK parasheh zvogëlim (tkurrje) të kufijëve ndërtimor në shumicën e vendbanimeve të Vitisë, duke përjashtuar vetëm zonën urbane. Edhe në zonën urbane, në masën më të madhe janë ruajtur kufijtë aktual ndërtimor, me dy përjashtimet si vijon:

a) Në pjesën perëndimore të zonës urbane 27.9 Ha tokë bujqësore të klasit I janë lënë jashtë kufijëve ndërtimorë;
b) Në pjesën veriore 22 Ha janë përfshirë brenda kufijëve ndërtimorë, kjo duke u bazuar në situatën faktike të diktuar nga zhvillimet në 10 vitet e fundit (ndërtimet).

Tutje; përveç faktit që në tokat e përshtatshme për zhvillimin e bujqësisë janë zhvilluar ndërtime, edhe Zona Ekonomike në Viti por edhe zonat tjera ekonomike të propozuara me PZHK 2010-2020+ janë propozuar pikërisht në sipërfaqe të cilat i takojnë cilësisë së lartë të tokës (Klasat I-IV të bonitetit). Kështu, zona ekonomike në Budrigë të Epërme, me status Park Industrial është propozuar të zhvillohet në tokë bujqësore të klasit I; Zona Ekonomike në Sllatinë është propozuar të ndërtohet në tokë bujqësore të klasit II dhe III; Zona Ekonomike në Sadovinë e Jerlive është propozuar të ndërtohet në tokë bujqësore të klasit III; ndërsa edhe Zona Ekonomike në Drobesh është propozuar të ndërtohet në tokë bujqësore të klasit III. Andaj, duke u bazuar në parimin e ruajtes së tokës bujqësore, por edhe në nevojën reale për zona ekonomike për 8 vitet e ardhshme, ky PZHK propozon mos zhvillimin dhe mos funksionalizimin e zonave ekonomike në Sadovinë të Jerlive dhe Sllatinë. Duke u nisur nga kjo, zonat ekonomike aktuale dhe ato të planifikuara për periudhën 2022-2030 janë si vijon:

- Zona Ekonomike në Viti, me sipërfaqe prej 141.5 Ha. (ekzistuese),
- Zona Ekonomike në Budrigë të Epërme me gjithësej 31.97 Ha. (e planifikuar)
- Zona Ekonomike në Drobesh me 27.99 Ha. (e planifikuar)

Të gjitha këto zona ekonomike zënë një sipërfaqe totale prej 201.46 Ha.

Sa i përket projeksioneve të PZHK 2010-2020+ për shfrytëzimin e tokës, është evidente se kufijtë ndërtimorë kanë qenë më se të mjaftueshëm për zhvillimet pasuese. Kjo duke u nisur nga fakti se shumë

hapësira brenda këtyre kufijëve ndërtimor kanë mbetur të pandërtuara. Ndërsa një zhvillim sfidues në këtë fushë ka të bëjë me faktin se një pjesë e tokës jashtë këtyre kufijëve ndërtimor është mbuluar me ndërtime, e kjo vlenë sidomos për zonën kadastrale Viti.

Humbja e tokës bujqësore përgjatë kësaj periudhe kohore është një tregues shtesë i pamundësisë për monitorim dhe kontroll cilësor të zbatimit të PZHK 2010-2020+.

# 4. KORNIZA E ZHVILLIMIT HAPËSINOR

Korniza Zhvillimit Hapësinor të Komunës së Vitisë paraqet zhvillimet e planifikuara dhe orientimet e zhvillimit socio-ekonomik, infrastrukturor dhe hapësinor në të ardhmen. Caqet e zhvillimit afatgjatë janë përcaktuar përmes një bashkëpunimi dhe pjesëmarrje në diskutime e debate gjithëpërfshirëse. Ndërsa e gjithë kjo është realizuar në bazë të vlerësimit të gjendjes ekzistuese të komunës, SWOT analizës si dhe kapaciteteve zhvillimore dhe investuese të komunës.

## 4.1. VIZIONI

Gjatë formulimit të vizionit për komunën e Vitisë, është marrë parasysh edhe Plani Hapësinor i Kosovës, i cili parasheh territorin e komunës si pjesë të tërësisë **Urat e Kosovës** - "Urë e zhvillimit të lidhjes së Kosovës me rajonin, rrjet funksional i fuqishëm i qyteteve dhe fshatrave, atraktive për të jetuar dhe punuar në to, me aktivitete ekonomike tregtare, industriale dhe turizëm, atraktive për investime dhe ndërmarrësi në industrinë përpunuese, agrobiznes, turizëm shërues e rekreativ me plotësimin e kritereve për mbrojtje të mjedisit."

Po ashtu, është marrë parasyshë edhe vizioni i planit paraprak zhvillimor komunal, PZHK 2010-2020+.

Bazuar në vizionin e PHK-së, vizionin e planit paraprak zhvillimor PZHK 2010-2020+ si dhe në nevojat dhe trendet e planifikuara të zhvillimit në komunë, synim kryesor i Planit Zhvillimor Komunal të Vitisë për periudhën 2022-2030 është që përmes strategjive të përcaktuara sektoriale, brenda 8 viteve të ardhshme, të arrihet ky vizion i komunës:

**"Vitia djep kulturor i shkollës shqipe.**

Urë e ndërlidhjeve dhe zhvillimit të qëndrueshëm, modern, të fuqishëm, funksional me të gjitha përmbajtjet dhe duke siguruar cilësi të lartë të jetës.

Komunë me zhvillim të balancuar hapësinor, socio-ekonomik dhe infrastrukturë të qëndrueshme, e fokusuar në mbrojtjen e mjedisit dhe resurseve natyrore dhe kulturore."

## 4.2. QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT ZHVILLIMORE

Axhenda e vitit 2030 është një kornizë globale 15-vjeçare e përqendruar në 17 Objektiva të Zhvillimit të Qëndrueshëm (Sustainable Development Goals), 169 synime dhe mbi 230 tregues.

Kjo axhendë synon një mjedis pa varfëri dhe uri, me arsim cilësor, mbulim shëndetësor universal, arritje të barazisë gjinore dhe fuqizim të grave dhe vajzave, dhe me një mjedis të qëndrueshëm, ndërsa 17 Objektivat për Zhvillim të Qëndrueshëm janë si vijon:

Objektivi 1: Eliminimi i varfërisë në të gjitha format kudo.

Objektivi 2: Eliminimi i urisë, arritja e sigurisë ushqimore dhe përmirësimit të ushqyerjes dhe nxitja e bujqësisë së qëndrueshme.

Objektivi 3: Sigurimi i jetës së shëndetshme dhe nxitja e mirëqenies për të gjithë njerëzit e çdo moshe.

Objektivi 4: Sigurimi i arsimit cilësor gjithëpërfshirës dhe të drejtë dhe nxitja e mundësive për mësim gjatë gjithë jetës për të gjithë.

Objektivi 5: Arritja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i të gjitha grave dhe vajzave.

Objektivi 6: Sigurimi i disponueshmërisë dhe menaxhimit të qëndrueshëm të ujësjellës-kanalizimeve për të gjithë.

Objektivi 7: Sigurimi i lidhjes me energji të përballueshme, të sigurt, të qëndrueshme dhe moderne për të gjithë.

Objektivi 8: Nxitja e rritjes ekonomike të vazhdueshme, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme, punësim të plotë dhe produktiv dhe punë të denjë për të gjithë.

Objektivi 9: Ndërtimi i infrastrukturave rezistuese, nxitja e industrializimit gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm dhe nxitja e novacionit.

Objektivi 10: Zvogëlimi i pabarazisë brendapërbrenda vendeve dhe mes tyre.

Objektivi 11: Kthimi i qyteteve dhe vendbanimeve në gjithëpërfshirës, të parrezikshëm, rezistues dhe të qëndrueshëm.

Objektivi 12: Sigurimi i modeleve të qëndrueshme të konsumit dhe prodhimit.

Objektivi 13: Marrja e masave për të luftuar ndryshimin klimatik dhe efektin e tij.

Objektivi 14: Ruajtja dhe përdorimi i qëndrueshëm i oqeaneve, deteve dhe burimeve detare për zhvillimin e qëndrueshëm.

Objektivi 15: Mbrojtja, restaurimi dhe nxitja e përdorimit të qëndrueshëm të ekosistemeve tokësore, administrimi i qëndrueshëm i pyjeve, lufta kundër kthimit të hapësirave në shkretëtirë dhe ndalimi dhe kthimi pas i procesit të degradimit të tokës dhe ndalimi i humbjes së biodiversitetit.

Objektivi 16: Nxitja e shoqërive paqësore dhe gjithëpërfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, ofrimi i mundësisë për drejtësi për të gjithë dhe ngritja e institucioneve të efektshme, llogaridhënëse dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet.

Objektivi 17: Fuqizimi i mjeteve të vënies në zbatim dhe rigjallërimi i partneritetit botëror për zhvillim të qëndrueshëm.




Figura 3 Objektivat e Zhvillim të Qëndrueshëm, të përcaktura nga OKB

Këto objektiva janë përvetësuar nga Plani Zhvillimor Komunal Viti 2022-2030 si objektiva të përgjithtshmë për zhvillim të qëndrueshëm hapësinor, socio-ekonomik, infrastrukturor dhe mjedisor, ndërsa si të tilla janë reflektuar në mënyre direkte dhe indirekte në Qëllimet dhe Objektivat e kësaj PZHK-je.

Objektivat  e propozuara me këtë PZHK janë Specifike, të Matshme, të Arritshme, Reale dhe të lidhura për afate të caktuara kohore.

### 4.2.1. Infrastruktura Publike (Arsimi, shëndetësia dhe administrata publike)

Infrastruktura publike në fushën e arsimit, shëndetësisë dhe administratës publike në komunë ka kapacitete për të ofruar shërbimet përkatëse, por këto kapacitete duhet plotësuar dhe kërkohet një shpërndarje më te balancuar si dhe ngritje e cilësisë dhe e mirëmbajtjes. Për të arritur nivel të kënaqshëm të funksionimit, e gjithë infrastruktura publike duhet të përmirësohet sipas qëllimeve dhe objektivave të paraqitura në vijim:

**Arsimi**

Infrastruktura e arsimit në komunë është relativisht e mirë si për nga numri i shkollave, aspektitfizik, si dhe qasjes në arsim. Vetëmse kemi hapësirë jo të mjaftueshme dhe numër të vogël të çerdheve/kopshteve dhe përfshirje jo të mjaftueshme të fëmijëve në këtë nivel shkollimi. Kërkohet edhe një balancim i hapësirave shkollore për shkollimin fillor. Një tjetër mangësi është edhe arsimi profesional i cili nuk është i ndërlidhur me tregun e punës. Komuna e Vitisë duhet të angazhohet në arritjen e qëllimeve dhe objektivave vijuese:

Qëllimi 1: Shërbime cilësore dhe gjithëpërfshirje në arsim

*O1.1: Qerdhe të reja në vendbanimet: Viti*, Pozharan, Smirë, Gjylekar, Kabash, Sllatinë e Epërme, Drobesh, Ramnishtë dhe Stubëll e Epërme.*

*O1.2: Zgjerimi i hapësirave shkollore për disa shkolla fillore*

*O1.3: Zgjerimi i hapësirave shkollore për shkollimin e mesëm të lartë edhe me 8,000 $m^2$*

*O1.4: Salla sportive në shkollat me numër më të madh të nxënësve*

*O1.5: Përfshirja e nxënësve në arsim profesional*

**Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale**

Shëndetësia si për nga infrastruktura ashtu edhe për nga shërbimet është në nivel të knaqshëm përveç në zonat më të thella. Krahas numrit të banorëve, kemi hapësirë të mjaftueshme të shërbimeve shëndetësore në komunën e Vitisë, por kërkohet mirëmbajtja e tyre dhe ngritja e nivelit të shërbimeve.

Mirëqenia sociale ka nevojë të përmirësohet dukshëm në shumë drejtime, si në përkujdesjen e organizuar për të moshuarit, zbutjen e varfërisë dhe papunësisë etj..

Qëllimi 2: Ngritja e nivelit të shërbimeve shëndetësore dhe mirëqenies sociale

*O2.1: Përmirësimi i shërbimeve shëndetësore dhe Avancimi i sistemit informativ shëndetësor*

*O2.2: Përmirësimi i gjendjes në banim social;*

*O2.3: Rritja e kujdesit ndaj grupeve sociale me gjendje të vështirë shëndetësore dhe ekonomike*

**Administrata Publike**

Administrata publike ka një hapësirë të mjaftueshe marrë në nivel të komunës dhe në krahasim me numrin e popullsisë. Është me rëndësi që të kemi një decentralizim të shërbimeve administrative dhe ngritje të nivelit të këtyre shërbimeve. Komuna në këtë aspekt duhet të angazhohet për të arritur qëllimin dhe objektivat vijuese:

Qëllimi 3. Administratë efikase

*O3.1: Decentralizim të shërbimeve administrative edhe në disa qendra të tjera lokale*

*O3.2: Përmirësimi i kushteve dhe ngritja e shërbimeve administrative.*

*O3.3: Ofrimi i shërbimeve administrative në formë elektronike – e-administrata.*

### 4.2.2. Infrastruktura sociale (kultura, sporti, hapësirat publike, varrezat)

Kapacitetet e hapësirave të bibliotekës, shtëpisë së kulturës dhe hapësirave sportive janë të pa mjaftueshme në komunën e Vitisë si dhe ke një koncentrim vetëm në qytetin e Vitisë. Kërkohet që të krijohen hapësira të reja të infrastrukturës sociale, decentralizimi i tyre si dhe përmirësim i ofrimit të shërbimeve. Për të arritur këtë janë hartuar Qëllimet dhe Objektivat si më poshtë:

Qëllimi 4. Sigurimi i infrastrukturës adekuate sociale dhe mirëmbajtja e saj

O4.1: *Ofrimi i objekteve të reja të kulturës dhe artit për të gjithë banorët e komunës së Vitisë deri në vitin 2030;*

O4.2: *Sigurimi i infrastrukturës për sport dhe rekreacion në gjithë territorin e komunës deri në vitin 2030;*

O4.3: *Sigurimi i hapësirave për sport dhe rekreacion nëpër shkolla deri në vitin 2030;*

O4.4: *Shtimi dhe rregullimi i hapësirave publike në zonën urbane dhe nën-qendrat e komunës së Vitisë deri në në vitin 2030;*

O4.5: *Mirëmbajtja e varrezave dhe objekteve të religjionit deri në vitin 2030.*

Qëllimi 5. Promovimi i artit, sportit dhe kulturës

*O5.1: Stimulimi I të rinjve për aktivitete sportive;*

*O5.2: Organizimi i aktiviteteve kulturore dhe artistike*

### 4.2.3. Zhvillimi Ekonomik

Qëllimet dhe Objektivat për Zhvillim Ekonomik janë hartuar në atë mënyrë që të arrihet një zhvillim i balancuar ekonomik, i bazuar në shfrytëzimin e resurseve dhe potencialit real zhvillimor dhe që u jep mundësi të barabarta të gjithë qytetarëve të komunës. Ky zhillim i qëndrueshëm ekonomik duhet të mundësoj rritje të punësimit të qëndrueshëm:

Qëllimi 6: Zhvillim i qëndrueshëm ekonomik i bazuar në shfrytëzimin e potencialit real zhvillimor, shtim të aktiviteteve ekonomike dhe rritje të punësimit, luftim të informalitetit dhe zbutje të zhvillimit të pa-balancuar ekonomik

*O6.1: Shfrytëzimi i resurseve njerëzore dhe natyrore si dhe shfrytëzimi i potencialit real zhvillimor, sidomos në Bujqësi, Industri të Lehtë, Industri Bujqësore dhe Përpunuese si dhe Turizëm Natyror, Rural dhe Kulturor përmes hartimit dhe implementimit të politikave të mirëfillta për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik.*

*O6.2: Përkrahja e shtimit të aktiviteteve ekonomike dhe rritjes së punësimit në sektorët ekzistues e sidomos në sektorët e targetuar si bartës të zhvillimit të ri ekonomik (Bujqësi, Industri të Lehtë, Industri Bujqësore dhe Përpunuese si dhe Turizëm Natyror, Rural dhe Kulturor)*

*O6.3: Luftimi i informalitetit në ekonomi përmes formalizimit të të gjitha aktiviteteve ekonomike dhe të punësuarve në komunën e Vitisë*

*O6.4: Luftimi i Zhvillimit të pabarabartë ekonomik përmes sigurimit të barazisë në punesim në baza gjinore, sigurimit të barazisë në punesim në baza të grupmoshave si dhe përmes sigurimit të shtrirjes së balancuar të investimeve dhe kapitalit. E gjithë kjo do të sigurojë gjithë përfshirje në aktivitete ekonomike dhe rrjedhimisht do të prodhojë kohezion socio-ekonomik në komunën e Vitisë.*

Qëllimi 7: Orientimi i zhvillimit ekonomik drejt ekonomisë së bazuar në Bujqësi, Industri të Lehtë, Industri Bujqësore dhe Përpunuese si dhe Turizëm Natyror, Rural dhe Kulturor

*O7.1: Zhvillimi i Bujqësisë Intenzive dhe Blegtorisë përmes orientimit të investimeve publike në këtë sektor, shtimit të subvencioneve dhe krijimit të kushteve të volitshme për kredi marrje për fermerët*

*O7.2: Rritja e pjesëmarrjes së sektorit të bujqësisë dhe blegtorisë në relacion me sektorët tjerë ekonomik përmes implementimit të politikave të cekura në Objektivin 1 si dhe përmes implementimit të planit për zhvillimin e bujqësisë, të paraparë me PZHK 2010-2020+ e të inkorporuar në këtë plan*

*O7.3: Ruajtja strikte e tokës bujqësore me bonitet të lartë (I-IV) si dhe burimeve tjera natyrore përmes kontrollit strikt të respektimit të kufijëve ndërtimor*

*O7.5: Shtrirja e rrjetit të ujitjes në sipërfaqet e targetuara me planin për zhvillimin e bujqësisë, të paraparë me PZHK 2010-2020+ e të inkorporuar në këtë plan.*

*O7.6: Ruajtja dhe zhvillimi i qëndrueshëm i sipërfaqeve pyjore.*

*O7.7: Zhvillimi i Industrisë së Lehtë, Industrisë Bujqësore dhe asaj Përpunuese përmes programeve promovuese - mbështetëse si dhe lehtesimeve fiskale*

*O7.8: Funksionalizimi i plotë dhe sigurimi i infrastrukturës së nevojshme teknike për zonat ekzistuese ekonomike si dhe zonat e planifikuara me këtë PZHK.*

*O7.9: Përkrahja e ndërmarrjeve ekzistuese në sektorin e industrisë përmes politikave mbështetëse, lehtësimeve fiskale dhe masave tjera të nevojshme*

*O7.10: Sinkronizimi i programeve arsimore në shkollat profesionale me potencialin real dhe nevojat për zhvillim ekonomik (Bujqëisa, Industria e lehte dhe përpunuese, Turizmi)*

*O7.11: Përkrahja e "Mësimit Gjatë Tërë Jetës" për ngritjen e kapaciteteve njerëzore dhe profesionale, me fokus në sektorët primar për zhvillim ekonomik*

*O7.12: Shfrytëzimi i potencialeve për Turizëm Natyror dhe Rural, sidomos në Debellde, Kabash, Letnicë, Sllatinë, Stublla e Eperme, Smira dhe Terpeza, duke hartuar Strategjinë Komunale për Zhvillimin e Turizmit si dhe përmes investimeve në infrastrukturë, kapacitete turistike, promovimit si dhe përkrahjes së sektorit të shërbimeve të ndërlidhura me turizmin natyrore dhe rural;*

*O7.13: Shfrytëzimi i potencialeve për Turizëm Kulturor, sidomos në Letnicë, Binçë, Gërnçar, Pozharan etj., duke hartuar Strategjinë Komunale për Zhvillimin e Turizmit si dhe përmes investimeve në infrastrukturë, kapacitete turistike, promovimit si dhe përkrahjes së sektorit të shërbimeve të ndërlidhura me turizmin kulturor*

*O7.14: Përkrahja ndaj krijimit të ndërmarrjeve të reja NVM, sidomos në sektorët primar ekonomik, përmes politikave stimuluese për ndërmarrësit e rinjë*

### 4.2.4. Infrastruktura Rrugore dhe Teknike

Qëllimet dhe Objektivat për këtë pjesë janë hartuar në atë mënyrë që të krijohet infrastrukturë e qëndrueshme dhe me kapacitete të mjaftueshme për t'i absorbuar kërkesat e popullsisë aktuale si dhe asaj të projektuar deri në vitin 2030. E gjithë kjo duhet të ndihmojë në rritjen e cilësisë së jetesës së qytetarëve në gjithë territorin e komunës:

<u>Qëllimi 8: Rrugë të asfaltuara të kualitetit të lartë dhe qasje për të gjithë banorët</u>

*O8.1: Asfaltimi i rrugëve në fshatrat perifeike*

*O8.2: Rregullimi i Trotuareve*

*O8.3: Rregullimi i Rrethrrotullimeve në rrugen magjistrale, përkatësisht vendbanimet: Dobresh (1), Viti (4), Rimanishtë (1), Kabash (1), Binqë (1), Simirë (3), Verban (2), Mogille (2), Verboc (4), Gërncar (1), Remnik (1), Budrigë (1), Balance (1), Terpezë (2), Novosellë (1)*

*O8.4: Rregullimi i trotuareve ne zonat qendër të vendbanimeve, me theks te vecant deri tek institucionet edukative*

*O8.5: Ndriqimi publik në vendbanime*

*O8.6: Riparimi i dy mbikalimeve në Lumin Morava, përkatësisht në zonën urbane të Vitisë*

*O8.7: Ndërtimi i urave në vendbanimet: Binqë (2), Remnik (1),*

<u>Qëllimi 9: Përmirësimi i sistemit aktual dhe ndërtimi i sistemit të ujit të pijes për vendbanimet periferike</u>

*O9.1: Shtirja e rrjetit të ujësjellësit ne vendbanimet perifeike*

*O9.2: Përmirësimi i rrjetit të ujësjellësit në lagjet periferike të zonës urbane me qëllim të zvogëlimit të humbjeve*

*O9.3: Kontrolli i kualitetit të ujit të pijës*

*O9.4: Paisja e sistemit të pompimit me energji solare*

*O9.5: Zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit në vendbanime të cilat aktualisht nuk kanë qasje*

Qëllimi 10: Trajtimi i ujrave të zeza për rrjetin e kanalizimit

*O10.1: Shtrirtja e rrjetit të kanalizimit në vendbanimet perifeike si: Ballanca, Goden i Madh, Mjaku, Stubell e Poshtme, Vërnakolla dhe Vërnezi*

*O10.2: Zgjerimi dhe përfundmi i rrjetit të kanalizimit për vendbanimet: Binça, Buzoviku, Debelldehu, Devaja, Letnica, Pozhorani, Vitia*

*O10.3: Përmirësimi dhe rehabilitimi i rrjetit ekzistues të kanalizimit për vendbanimet: Goshicë, Binqë, Beguncë, Smirë, Stubell, Radivojcë dhe Sadovinë.*

*O10.4: Ndërtimi i gropave septike për vendbanimet të cilat nuk janë të kycura në rrjetin kryesor*

*O10.5: Lidhja e rrjetit të kanalizimit në impiantin regjional për trajtimin e ujërave të zeza*

Qëllimi 11: Shtrija e rrjetit të kanalizimeve për ujëra të bardha (atmosferike)

*O11.1: Shtrirja e rrjetit të kanalizimit për ujërat e bardha në të gjitha vendbanimet rurale*

*O11.2: Rehabilitimi i rrjetit të kanalizimit për ujërat e bardha në zonën urbane*

Qëllimi 12: Përmirësim të rrjetit energjetik

*O12.1: Përmiresimi i rrjetit energjetik*

*O12.2: Rritja e kapaciteteve të trafostacioneve*

Qëllimi 13: Organizim i grumbullimit të mbeturinave dhe riciklimi i tyre

*O13.1: Vendosja e konteinereve ne te gjitha vendbanimet sipas kapaciteteve*

*O13.2: Rregullimi i orarit për mbledhjen e mbeturinave*

*O13.3: Ndertimi i pikës së transferit të mbeturinave*

*O13.4: Riorganizimi i deponive egzistuese apo ndërtim i deponive të reja për mbeturina inerte*

*O13.5: Trajtimi i mbetjeve ashtore të shtazëve*

Qëllimi 14: Ndriçimi publik i rrugëve në zona të frekuentuara

*O14.1: Ndriçimi publik i rrugëve në të gjithë zonën urbane si dhe zonat qendër te vendbanimeve tjera*

*O14.2: Orientimi drejt energjisë së ripërtërithsme / Vendosja e reflektorëve me energji solare*

Qëllimi 15 Shtrirja e internetit në të gjitha vendbanimet

*O15.1: Qasje ne rrjetin e internetit për të gjithë*

*O15.2: Shtrirja e kabllit optik në të gjitha vendbanimet*

Qëllimi 16: Shtrirja e telefonisë fikse në vendbanimet e dendura

*O16.1: Qasje ne rrjetin e telefonisë fikse për vendbanimet e rrafshit*

### 4.2.5. Mjedisi dhe Sipërfaqet me Rrezikshmëri

Qëllimi 17. Mbrojtja dhe shfrytëzimi i qëndrueshëm i resurseve mjedisore (uji, toka, ajri)

*O17.1: Stimulimi i shfrytëzimit të energjisë alternative deri në vitin 2030*

*O17.2: Promovimi i mobilitetit jo-motorik*

*O17.3: Rregullimi i shtretërve të lumenëjve dhe përroskave deri në vitin 2030*

*O17.4: Mbrojtja e veçantë për burimet ujore deri në vitin 2030*

*O17.5: Trajtimi i ujërave të zeza deri në vitin 2026*

*O17.6: Inventarizimi i florës dhe faunës në gjithë territorin e komunës deri në vitin 2026*

*O17.7: Revitalizimi i ekosistemeve të degraduara kryesisht në zonën jugore dhe juglindore të komunës së Vitisë deri në vitin 2027*

*O17.8: Mbrojtja e tokës bujqësore nga ndotja dhe degradimi si dhe ndërmarrja e masave për ruajtje dhe përmirësim të plleshmërisë*

*O17.9: Promovimi i sistemeve të reciklimit*

Qëllimi 18. Zvogëlimi i rrezikut nga fatkeqësitë natyrore

*O18.1: Marrja e masave dhe hartimi i politikave për mbrojtje ndaj rrezikut nga fatkeqësitë natyrore deri në vitin 2030*

### 4.2.6. Trashëgimia Kulturore dhe Natyrore

Qëllimet dhe Objektivat në këtë fushë janë hartuar në atë mënyrë që resurset natyrore dhe kulturore të ruhen, të promovohen dhe të shfrytëzohen në mënyrë optimale në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm.

Qëllimi 19: Mbrojtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore për zhvillim të qëndrueshëm

*O19.1: Konservimi i aseteve të trashëgimisë kulturore deri në vitin 2030*

*O19.2: Promovimi i aseteve të trashëgimisë kulturore në funksion të zhvillimit të turizmit të qëndrueshëm deri në vitin 2026*

Qëllimi 20: Mbrojtja dhe promovimi i trashëgimisë natyrore për zhvillim të qëndrueshëm

*O20.3: Konservimi i vlerave të trashëgimisë natyrore dhe peizazhit*

*O20.4: Promovimi i aseteve të trashëgimisë natyrore në funksion të zhvillimit të turizmit të qëndrueshëm*

### 4.2.7. Banimi, Vendbanimet dhe Vendbanimet Jo-Formale

Qëllimi 21: Krijimi i kushteve për zhvillimin e banimit cilësor e të qëndrueshëm

*O21.1: Përmirësimi dhe zhvillimi i infrastrukturës për banim të qëndrueshëm dhe cilësor deri në vitin 2030*

*O21.2: Rritja e proporcionit të banimit kolektiv deri në 2030*

*O21.3: Trajtimi i ndërtimeve pa leje deri në vitin 2023*

*O21.4: Ndërtimet cilësore sipas standardeve të aplikueshme*

Qëllimi 22. Shtrirja e vendbanimeve sipas parimit të kompaktësisë dhe multifunksionalitetit

*O22.1: Shfrytëzimi racional I tokës ndërtimore*

*O22.2: Rikonstruktimi i rrjeteve ekzistuese dhe zhvillimi i rrjeteve të reja infrastrukturore me koncepte te efiçiencës dhe shfrytëzitmit racional të resurseve*

### 4.2.8. Shfrytëzimi i Tokës

Qëllimi 23. Shfrytëzim racional i tokës dhe konsolidim i tokës bujqësore të klasit I-IV

*O23.1: Implementimi i konceptit të zhvillimit hapësinor të përcaktuar me këtë PZHK*

*O23.2: Aplikimi i modelit të qytetit dhe vendbanimit kompakt*

*O23.2: Ruatja strikte dhe konsolidimi i tokës bujqësore*

## 4.3. KONCEPTI I ZHVILLIMIT HAPËSINOR

**Koncepti i përgjithshëm i zhvillimit hapësinor** të komunës së Vitisë bazohet në vlerësime reale të përparësive krahasuese të komunës të tilla si pozita e saj gjeografike dhe resurset natyrore, dhe mundësive reale të zhvillimit konkurrues të potencialeve të saja zhvillimore: ekonomike, turistike, infrastrukturore dhe resurseve njerëzore. Planifikimi i shpërndarjes hapësinore të funksioneve dhe zhvillimeve mundëson arritjen e qëllimeve të përcaktuara për arritjen e vizionit, përmes një zhvillimi të balancuar dhe të qëndrueshëm hapësinor, socio-ekonomik dhe infrastrukturor të komunës, duke i vënë në funksion të zhvillimit potencialet e saj konkurruese. I gjithë zhvillimi i komunës do të bëhet në përputhje me politikat e ruatjes së mjedisit dhe resurseve të paripërtërishme natyrore dhe kulturore.

Për këtë qëllim, më poshtë janë analizuar tre skenarë zhvillimor (**Skenari 0**: Trendi aktual; **Skenari 1**: Zhvillim kompakt - Monocentrik; **Skenari 2**: Zhvillim Policentrik) bashkë me përparësitë dhe mangësitë e tyre, si dhe është vendosur për skenarin i cili më së miri reflekton politikat zhvillimore të qeverisjes lokale të komunës së Vitisë, nevojave të komunës si dhe potencialit real zhvillimor të saj.

Sa i përket zhvillimit të sektorëve të veçantë, komuna e Vitisë në 8 vjeçarin e ardhshëm do të fokusohet në politikat dhe qëllimet zhvillimore si vijon:

- Toka bujqësore kualitative, bujqësia si veprimtari tradicionale e popullatës si dhe potencialet agroindustriale paraqesin potenciale të rëndësishme zhvillimore për komunën. **Zhvillimi i bujqësisë intensive**, në veçanti pemëtarisë, perimtarisë, bimëve mjekuese dhe blegtorisë, do të jenë nxitëse të themelimit të kapaciteteve të ndryshme përpunuese ("zingjiri i shkurtër i furnizimit"). Zhvillimi i këtij sektori i cili do të jetë sektori primar ekonomik në komunën e Vitisë do të mbështetet në avancimin e strukturës agrare, aseteve fizike, pajisjeve teknike si dhe infrastrukturës së nevojshme për përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore, zhvillimin e bizneseve, edukimin e prodhuesve bujqësorë për prodhimin organik si dhe me hapjen e shkollave profesionale të cilat do të ndihmojnë në përgaditjen e profesionistëve të kualifikuar në këtë fushë.
- Për **veprimtaritë prodhuese,** sidomos për ato të **industrisë së lehtë, industrisë përpunuese dhe asaj bujqësore** do të sigurohet hapësira e nevojshme për zhvillim në kuadër të zonave ekonomike të planifikuara. Zonat ekonomike, por edhe hapësirat tjera ku janë të vendosura bizneset do të kompletohen me infrastrukturën e nevojshme teknike dhe do t'u sigurohet qasje e lehtë dhe e shpejtë në komunikacionin rrugor.
- **Turizmi** si sektor prioritar bazohet në **zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit natyror dhe kulturor**, që nënkupton mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit, natyrës dhe aseteve të shumta të trashëgimisë

natyrore dhe kulturore me të cilat disponon komuna e Vitisë. Në fokus do të jetë zhvillimi i ofertës së integruar turistike, të përcjellë me ndërtimin e kapaciteteve të reja dhe aktiviteteve përcjellëse, të cilat do të tërheqin vizitorë gjatë tërë vitit.

- **Zhvillimi i sektorëve tjerë të ekonomisë – tregtisë, shërbimeve etj.,** duhet të intensifikohet dhe të diversifikohet në përputhje me funksionet e qendrave të caktuara në rrjetin e vendbanimeve. Lidhur me këtë, zhvillimi i ekonomisë krahas **ngritjes së cilësisë së shërbimeve publike (arsim, shëndetësi, kulturë etj.)**, do të ndikojë në zvogëlimin e migrimit të popullatës nga zonat rurale. Kjo krijon një shpërndarje më të balancuar të popullsisë në territorin e komunës dhe përmirëson lidhjet funksionale ndërmjet qendrës komunale – Vitisë dhe nën-qendrave.
- **NVM-të** si një sektor i fuqishëm në komunë (në veçanti në industri të lehtë përpunuese, bujqësi dhe belgtori, tregti dhe shërbime) bashkë me bujqësinë intenzive dhe turizimin, sidomos atë natyror, do të jenë gjeneratorë të punësimit
- **Ndërtimi i sistemeve dhe objekteve të infrastrukturës teknike** dhe **përmirësimi i asaj ekzistuese** është i një rëndësie të veçantë për zhvillimin e ardhshëm hapësinor të komunës. Kjo nënkupton zgjerimin dhe përmirësimin e rrjetit rrugor dhe shërbimeve të transportit; zgjerimin dhe përmirësimin e sistemeve të ujësjellësit, kanalizimit dhe për kullimin e ujërave atmosferikë; menaxhim efikas të mbeturinave; rehabilitimin dhe zgjerimin e sistemeve të ujitjes.
- **Ndërtimi i infrastrukturës publike dhe sociale** në të gjitha vendbanimet ku është e nevojshme, krahas përmirësimit të infrastrukturës ekzistuese do të trajtohet me prioritet, në mënyrë që të sigurohet funksionim normal dhe cilësor i jetës publike dhe sociale në të gjithë territorin e banuar të komunës.
- **Forcimi i lidhjeve ndër-komunale dhe ndër-kufitare** do të zhvillohet në përputhje me interesat ekonomike dhe socio-kulturore të banorëve të komunës së Vitisë dhe komunave tjera me të cilat kufizohet Vitia. Ky forcim i lidhjeve përmes politikave zhvillimore dhe investimeve direkte do të ndihmojë parasëgjithash në shfrytëzimin e potencialit real zhvillimor dhe depopullimin e viseve kufitare.
- Një nga përcaktimet themelore të PZHK-së është **përdorimi racional dhe mbrojtja e burimeve natyrore**, sidomos **ruajtja e tokës bujqësore** dhe burimeve të tjera natyrore, si asete të rëndësishme strategjike për komunën. **Mbrojtja e burimeve ujore** nga ndotja dhe shfrytëzimi i pakontrolluar është e një rëndësie të veçantë prandaj do të merren masa adekuate parandaluese.
- Përcaktim tjetër i rëndësishëm i PZHK-së është **shfrytëzimi racional i tokës ndërtimore**. Dendësimi dhe zhvillimi i tokës së lirë ndërtimore brenda hapësirës ekzistuese të zonës urbane do të ketë prioritet para shfrytëzimit të zonave të parapara për zgjerim.
- PZHK angazhohet për **mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit** dhe **zonave të veçanta të trashëgimisë natyrore** dhe biodiversitetit, të cilat janë edhe asetet kryesore të zhvillimit të turizmit. Në **mbrojtjen dhe ruajtjen e trashëgimisë arkitekturore** do të aplikohet konzervimi si dhe qasja e ripërdorimit adaptiv (aty ku është e mundur) i cili mundëson shfrytëzimin e këtyre ndërtesave pa i cenuar vlerat e tyre.

### 4.3.1. Elementet e Konceptit

#### 4.3.1.1. *Tërësitë hapësinore funksionale*

Territori i komunës së Vitisë përbëhet nga disa tërësi hapësinore që dallojnë në mes veti. Brenda kësaj hapësire shtrihen toka bujqësore shumë kualitative e sidomos në pjesën qendrore. Pjesa jugore dhe jug-lindore përbëhet nga një reliev i ngritur malor me resurse pyjore dhe kushte të mira për zhvillim të turizmit dhe aktiviteteve blegtorale. Në territorin e komunës së Vitisë dallohen këto tërësi hapësinore me veçorit e tyre karakteristike:

- Zona bujqësore – Pjesa qendrore e komunës;
- Zona e Karadakut – Pjesa jugore dhe jug-lindore e komunës;
- Zona Kodrinore - Pjesa veriore e komunës;
- Zona urbane – qyteti i Vitisë me pozitë qendrore.

Bazuar në kushtet natyrore dhe resurset ekzistuese është përcaktuar edhe zhvillimi i komunës. Zhvillimi i bujqësisë dhe blegtorisë, ndërmarrësisë, turizmit, etj., është bazuar në resurset ekzistuese dhe janë përcaktues të zhvillimit të ardhshëm. Bazuar në tërësitë hapësinore që ka komuna e Vitisë, janë përcaktuar edhe orientimet zhvillimore.

**Zona bujqësore – Pjesa qendrore e komunës**

Tërësia hapësinore *Zona Bujqësore* shtrihet në pjesën qendrore të komunës dhe përbëhet nga tokat pjellore të kualitetit të lartë. Kemi 15,531.3 ha të tokës bujqësore të klasit I deri IV që shtrihen në këtë pjesë të komunës e që përbëjnë mbi 50 % të sipërfaqes totale të komunës. Po ashtu kemi edhe mbi 11 mijë hektar tokë të klasit V deri VIII. Në këtë hapësirë shtrihet edhe shumica e vendbanimeve të komunës së Vitisë. Pos qytetit të Vitisë, kemi edhe një numër të konsiderueshëm të vendbanimeve rurale që shtrihen në këtë zonë bujqësore dhe ku dominon bujqësia si aktiviteti kryesor ekonomik. Në konceptin e zhvillimit hapësinor kjo zonë është element i rëndësishëm strukturor në zhvillimin afatgjatë të komunës. Parimi themelor i zhvillimit të kësaj zone është shfrytëzimi racional i tokës bujqësore dhe kufizimi i zhvillimeve të cilat kanë ndikim negativ në mjedis dhe e rrezikojnë potencialin e saj zhvillimor.

Zhvillimi i ardhshëm i kësaj tërësie hapësinore, krahas funskioneve tjera ekzistuese (industri e lehtë dhe përpunuese, administratë dhe shërbime publike, edukim, tregti, turizëm, shërbime, rekreacion) bazohet në intensifikimin e prodhimtarisë bujqësore dhe blegtorale, ngritjen e pikave për grumbullimin dhe distribuimin e produkteve bujqësore, si dhe kapaciteteve të vogla përpunuese në kuadër të ekonomive bujqësore. Shtrirja e zonës urbane dhe lidhjet e mira rrugore përmes kësaj zone paraqesin një përparësi për shkak të mundësisë së plasimit të shpejtë të produkteve në treg, marrë parasysh edhe rritjen e kërkesës nga zhvillimi i turizmit. Përgjatë kësaj zone kalon rruga regjionale - M25-3 e cila lidhë Gjilanin me Ferizajn. Gjithashtu, në largësi prej 14 km gjendet edhe autostrada Arbër Xhaferi e cila mundëson një lidhje të mirë dhe të shpejtë jo vetëm me qytetet e Kosovës por edhe me rajonin. Rrugët lokale lidhin vendbanimet e ndryshme brenda zonës. Në këtë zonë, pos qytetit të Vitisë, shtrihen edhe dy nën qendrat e rëndësishme të komunës si Pozherani dhe Gjylekari që këto tri qendra do të paraqesin edhe organizimin hapësinor të zhvillimit të ardhëm policentrik të komunës së Vitisë. Pos qytetit të Vitisë, në të ardhmen do të fuqizohen dhe ofrohen shërbime administrative, publike dhe sociale për popullatën e zonës edhe në dy nën qendrat tjera: Pozheran dhe Gjylekar. Në këto qendra duhet të ofrohen edhe shërbime tregtare për konsum të përditshëm dhe periodik si dhe të transportit. Edhe sektori i shërbimeve pritet të zhvillohet, kryesisht për shkak të rritjes së qarkullimit të njerëzve në këto dy qendra të reja.

Zona duhet ta ruaj karakterin rural dhe zgjerimi i fshatrave duhet të kufizohet në nivel të nevojave për shtim natyror të popullsisë, në funksion të ruajtjes së tokës bujqësore. Zhvillim më intensiv planifikohet në nën-qendra, në kuadër të kufijëve të përcaktuar të zgjerimit.

Strategjia e Integruar për Zhvillim të Qëndrueshëm të Bujqësisë dhe Blegtorisë në komunën e Vitisë, hartimi i së cilës është paraparë me këtë PZHK do të hartojë politika dhe do të identifikojë resurse për shtimin e subvencioneve dhe ndihmave të tjera për të siguruar zhvillim të qëndrueshëm të bujqësisë dhe blegtorisë edhe në këtë zonë, krahas vendbanimeve dhe zonave tjera kadastrale të identifikuara gjatë analizës së potencialit për zhvillimin e bujqësisë. Ndërsa, zhvillimi i integruar dhe i balancuar i bujqësisë dhe blegtorisë, krahas shndërrimit të këtij sektori në njërën nga shtyllat kryesore për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik të komunës, po ashtu do të ndihmojë edhe në zbutjen e pabarazisë së zhvillimit ekonomik në terma të shpërndarjes jo të barabartë të kapitalit dhe koncentrimit të aktiviteteve ekonomike.

**Zona e Karadakut – Pjesa jugore dhe jug-lindore e komunës**

Zona jugore e komunës së Vitisë karakterizohet me një reliev të ngritur ku njëherit shtrihen edhe lartësitë më të mëdha mbidetare në nivel të komunës. Kjo hapësirë është e pasur me pyje, burime dhe rrjedha ujore, peizazhe natyrore dhe biodiversitet. Këto resurse paraqesin një potencial për zhvillimin e ardhshëm të kësaj pjese. Në skenarin për zhvillimin e ardhshëm të komunës së Vitisë, krahas funksioneve tjera ekzistuese, kjo tërësi hapësinore parashihet të jetë një mundësi e zhvillimit sidomos për aktivitete turistike, eko-turizëm, turizëm rural, rekreacion, aktivitete blegtorale dhe prodhime nga blegtoria e bletaria, ekoprodukte etj.

Kjo tërësi hapësinore ka një shtrirje gjatësore duke filluar nga pjesa jug-perëndimore e komunës, vazhdon me pjesën jugore e deri në anën jug-lindore të komunës. Pjesa jugore shtrihet në zonat kadastrale të vendbanimeve si vijon: Vërban, Gushicë, Smirë, Kabash, Binç, Mjak, Debelldeh, Buzovik, Shashare, Letincë, Vërnikoll dhe Vërnezë. Edhe pse kemi shumë zona kadastrale që përfshinë kjo tërësi hapësinore, megjithatë kemi pakë vendbanime që shtrihen në brendësi të zonës. Kemi vetë 4 fshatra që shtrihen në pjesët më të thella dhe më të larta malore siç janë: Mjak, Debelldeh, Vërnezë dhe Vërnakoll. Këto katër vendbanime thuaj se janë zbrazur tërësish dhe konsiderohen si vendbanime me depopullim të madh. Kemi edhe disa vendbanime në këtë zonë siç janë vendbanimet Shashare dhe Letincë. Edhe këto dy vendbanime kanë shënuar rënie të popullsisë. Në pjesën lindore kemi edhe vendbanimet Stubëll e Epërme, Stubëll e Poshtme dhe Goden i Madh. Të gjitha këto potenciale që ka kjo zonë, parashihet që në skenarin e zhvillimit të komunës të vihen në zhvillim të qëndrueshëm të kësaj zone. Kjo nënkupton që resurset të shfrytëzohen me qëllim të zhvillimit dhe në anën tjetër të kemi një mbrojtje të vlerave të trashëgimisë natyrore. Rrethanat aktuale të mos zhvillimit kanë ndikuar në largimin e banorëve nga këto vendbanime të thella malore e që aktualisht disa janë zbrazur plotësisht.

Përveç resurseve natyrore, kjo zonë është e pasur edhe me trashëgimi kulturore siç janë:

- Shkolla e parë shqipe legale e Kosovë në Stubëll të Epërme
- Binçë – Kalaja qytezë e shekullit IV-VI
- Kalaja e Mjakut
- Shtëpia e dëshmorit të kombit Rexhep Bislimi në fshatin Stubëll e Poshtme
- Letnicë truporja e drurit e zojës Cërnagore,
- Mulliri me valovicë në fshatin Binçë
- Shtëpia në fshatin Stubëll e Poshtme që shërbeu si spital gjatë luftës së UÇK-së
- Mullinjtë në Letnicë
- Mulliri në fshatin Binçë

- Kisha katolike në Letnicë
- Kolegji i rangut të institutit të lartë në Stubëll (1584)
- Themelet e Kishës së vitit 1866-1929, Letnicë

Të gjitha këto vlera të trashëgimisë kulturore që gjendën në këtë zonë, së bashku me vlerat e trashëgimisë natyrore, mundësojnë një zhvillim të mirëfilltë turistik të kësaj zone në të ardhmen.

Infrastruktura rrugore ekzistuese ofron mundësi që gjithë këto pjesë dhe vendbanime të kenë lidhje mes veti dhe me qendrën urbane të Vitisë. Lidhjet mes vendbanimeve janë me rrugë të asfaltuara. Në të ardhmen kërkohet që të kemi një përmirësim të infrastrukturës ekzistuese me qëllim të zhvillimit të turizmit dhe aktiviteteve tjera.

Ajo që parasheh koncepti zhvillimor për këtë zonë është investimi në ngritjen e kapaciteteve të nevojshme për zhvillimin e turizmit dhe aktiviteteve blegtorale. Zhvillimi i kësaj zone siç shihet është i mbështetur në resurset ekzistuese, mirëpo kjo kërkon investime në ngritjen e kapaciteteve. Në këtë mënyrë, kërkohet që të investohet në ngritjen e kapaciteteve dhe objekteve në zhvillimin e turizmit siç janë:

Kërkohet që të investohet në ngritjen e kapaciteteve dhe objekteve në zhvillimin e turizmit siç janë:

- Shtëpitë mikpritëse/ bujtina
- Ndërtimi i shtëpive malore
- Restorantet
- Rregullimi i shtigjeve të ecjes në natyrë

Gjithashtu kërkohet rritje e investimeve në prodhimtari blegtorale dhe ekoprodukte si:

- Rritja e grandëve për blegtor
- Rritja e grandeve për bletar
- Rritja e granteve për kultivimin e kulturave të ndryshme vendore
- Ngritja e shtallave për blegtori
- Ndërtimi i minifabrikave për përpunimin e produkteve blegtorale
- Pika grumbulluese të frutave malore dhe të tjera

Mjedisi natyror duhet të mbrohet nga aktivitetet e ndryshme të papërgjegjshme dhe ad-hoc që e dëmtojnë integritetin ekologjik si dhe peizazhin e zonës. Kjo ka rëndësi në mbrojtjen e ambientit si të ajrit, ujit, tokës dhe biodiversitetit të zonës me qëllim të një zhvillimi të qëndrueshëm dhe afatgjatë.

**Zona Kodrinore - Pjesa veriore e komunës**

Kjo zonë shtrihet në pjesën veriore të komunës së Vitisë dhe përfshinë territorin e disa zonave kadastrale si: Ballancë, Tërpezë, Novosellë, Zhiti dhe Devajë. Vendbanimet kryesisht janë të vendosura në pjesët më të ulëta të zonës. Kjo zonë përfshinë një sipërfaqe jo edhe aq të madhe dhe shtrihet në një terren kryesisht kodrinor me lartësi mbidetare rreth 700 – 800 m.. Është një hapësirë e cila ka një peizazh natyror ku në disa pjesë kemi edhe sipërfaqe pyjore. Ofron një mundësi për zhvillimin e disa llojeve të turizmit si: turizmi rekreativ, eko-turizmi, turizmi rural etj..

Gjithashtu kjo zonë ofron edhe mundësi për aktivitete bujqësore dhe blegtorale. Investimet në miniferma dhe subvencionet e ndryshme në aktivitete blegtorale do të ndikonin në zhvillimin e kësaj zone. Po ashtu do të kemi një kombinim të zhvillimeve mes turizmit rural, ekoturizmit, eko-prodhimeve bujqësore dhe blegtorale.

Lidhja e kësaj zone është mjaft e mirë si me qytetin e Vitisë ashtu edhe mes vendbanimeve. Të gjitha vendbanimet e kësaj zone si: Ballancë, Tërpezë, Novosellë, Zhiti dhe Devajë, kanë lidhje të mira me rrugë të

asfaltuara me qytetin e Vitisë dhe gjithashtu ka të organizuar edhe transport publik. Kjo paraqet një mundësi mjaft të mirë për zhvillimin e zonës në të ardhmen.




Harta 30 Tërësitë Hapësinore

## Zona urbane

Në aspektin e evolucionit urbanistik-fizionomik Vitia pati trende të zhvillimit linear dhe bashkëngjitjes së lagjeve, duke krijuar kështu korridore ndërtimore përgjatë rrugëve kryesore të cilat e lidhin qytezën e Vitisë me Kllokotin dhe magjistralen Gjilan-Ferizaj. Banimi është kryesisht i karakterit individual dhe me cilësi të mirë të ndërtimit. Shtëpitë individuale janë të shpërndara nëpër tërë zonën e qendrës, shumica prej të cilave të ndërtuara pa plan, por me oborre të rregulluara, të cilat i takojnë tipit të ekonomive jo-bujqësore. Vetëm 2 % e sipërfaqes së përgjithshme të territorit urban është e mbuluar me objekte të banimit kolektiv, që tregon se kjo formë e banimit është në fazën fillestare të zhvillimit; shumica e objekteve të banimit kolektiv deri në katër kate shtrihen përgjatë rrugës Viti-Drobesh.

Pozita e Vitisë ndërmjet dy qendrave regjionale, Gjilanit dhe Ferizajt, ka penguar diversifikimin dhe pajisjen e saj me funksione të reja, duke ngelur me ato funksione dhe veprimtari tipike për një qytezë mesatare për rrethanat e Kosovës. Qyteza e Vitisë ka arritur ta konsolidojë **zonën qendrore** të saj me sipërfaqe prej 10 ha dhe me formë të zgjatur rreth 1.500 m, e cila dallohet nga të tjerat me funksione të shumta dhe përmbajtësore, ku janë përqendruar objektet e administratës komunale, kulturës, arsimit, shëndetësisë, rendit dhe bizneset e ndryshme tregtare e zejtare. Në Lindje të kësaj qendre rrjedh lumi Morava me shtratin e rregulluar, që paraqet ambient të përshtatshëm për pushim dhe rekreacion, ndërsa kah ana Jugore, Perëndimore dhe Veriore preket me vijat e rëndësishme komunikative, sikurse rruga "Idriz Seferi" në Jug, "Lidhja e Prizrenit" në Perëndim dhe rruga Viti – Drobesh në Veri.

**Zona qendrore** do të funksionojë si pikë qendrore e qytetit që nëpërmes objekteve të administratës komunale dhe shërbimeve tjera publike, objekteve shëndetësore, të arsimit, të rendit, shtëpisë së kulturës, bankave dhe objekteve tjera afariste, sheshit, parkut të qytetit dhe hapësirave tjera publike si dhe ndërtimit të mesëm ofron kushte të mirëfillta për shërbime administrative, afarizëm, banim, argëtim dhe rekreacion etj..

Në procesin e zhvillimit urban përveç zonës qendrore dallohen edhe disa zona të tjera me karakteristikat e tyre, në radhë të parë me objketet dhe aktivitetet që disponojnë, sikurse janë Zona Veriore, Jugore, Lindore dhe Perëndimore.

**Zona Veriore** shtrihet në anën e djathtë të rrugës e cila lidhë qytezën e Vitisë me fshatin Drobesh në drejtimin Lindje-Perëndim, ndërsa në drejtimin Veri-Jug kufizohet me lumin Morava. Karakteristikë e kësaj zone është se përgjatë rrugës Viti – Drobesh zhvillohen aktivitete të shumta tregtare dhe me banim kryesisht individual. Në këtë zonë nuk ka asgjë nga infrastruktura publike dhe sociale, ndërsa sa i përket infrastrukturës fetare, në këtë zonë ka një xhami.

Kjo zonë do të vazhdojë të karakterizohet me banim kryesisht individual si dhe me koncentrim të aktiviteteve tregtare përgjatë rrugës Viti – Drobesh. Infrastruktura e nevojshme teknike, publike dhe sociale do të kompletohet edhe në këtë zonë. Ruajtja e tokës bujqësore do të ketë prioritet.

**Zona Jugore** nga lindja kufizohet me lumin Morava, që është me rëndësi për të, në veri me rrugën “Idriz Seferi” dhe “Dëshmorët e Kombit”, ndërsa kah jugu dhe perëndimi me fshatin Kabash. Është e mbuluar kryesisht me objekte të ndërtimit individual. Sa i përket infrastrukturës publike dhe sociale në këtë zonë gjendet një fushë sportive, ndërsa nga objektet me rëndësi shoqërore aty ndodhet objekti ri komunal-administrativ, shkolla e mesme si dhe një kishë ortodokse serbe

Kjo zonë do të trajtohet me një trajtim të veçantë, kryesisht për shkak të objekteve të infrastrukturës publike dhe religjioze që gjenden në këtë pjesë si dhe për faktin se Kabashi, kryesisht për shkak të ndërtimit të pakontrolluar të objekteve të banimit, gati se është ngjitur me zonën urbane dhe është shndërruar në para lagje të kësaj të fundit. Hapësira për rekreacion dhe aktivitete kulturore do të krijohen në këtë zonë, krejt kjo në shërbim edhe të nxënësve që vijojnë shkollimin në shkollën fillore dhe të mesme që gjenden aty. Parandalimi i mëtejmë I aglomeracionit urban, me fokus në ruajtjes e tokës bujqësore do të kenë prioritet në këtë zonë.

**Zona Lindore -** Në këtë zone aktualisht gjendet një shkollë fillore, një shkollë e mesme, qendra e zjarrëfikësve, kisha katolike, Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare, stadiumi, një sallë për not, stadiumi i futbollit të vogël si dhe varrezat ortodokse. Përveç kësaj, në këtë zone gjendet edhe Zona e Zhvillimit Ekonomik, në të cilën janë të koncentruar një numër i madh I bizneseve.

**Zona Perëndimore -** Kjo zonë është e destinuar kryesisht për banim, me ndërtim individual, por pa ndonjë funksion apo objekt me rëndësi shoqërore.

Zonat Lindje dhe Perëndim do të kompletohen me infrastrukturën e nevojshme teknike, publike dhe sociale, ndërsa karakteri i tyre si zona të destinuara kryesisht për banim me ndërtim individual do të ruhet edhe më tej.

Koncentrimi i aktiviteteve të shumta tregtare përgjatë rrugës Viti – Drobesh ka bërë që **Drobeshi** të zgjerohet në drejtim të zonës urbane dhe të merr tiparet e një paralagje të kësaj zone. Në këtë zonë aktualisht ekziston një shkollë fillore, palestër sportive, xhami, varreza të myslimanëve etj..

Edhe **Kabashi** thuajse ka marrë tiparet e një paralagjeje të zonës urbane, ndërsa kjo ka ardhur kryesisht si rezultat i ndërtitmit të shumtë të shtëpive të banimit. Në këtë zonë aktualisht ekziston një shkollë fillore, 1 xhami, 1 kishë katolike, varreza myslimane etj..

Infrastruktura e nevojshme teknike, publike dhe sociale do të kompletohet edhe në këto zona, ndërsa zgjerimi i ardhshëm i qytetit të Vitisë, në mënyrë të kontrolluar, është planifikuar pikërisht në këto dy drejtime. Megjithatë, ruajtja e tokës bujqësore do të ketë prioritet.

Trafiku mbështetet në atë automobilistik individual, ndërsa gjatësia e rrugëve të asfaltuara në territorin urban është 18,2 km, apo 5 % e strukturës urbane, duke përfshirë edhe vendparkimet dhe trotuaret që janë në gjendje relativisht të mirë.




Harta 31 Tërësitë urbane

### *4.3.1.2. Nyjet, korridoret mes nyjeve, plotësimi dendësimi, mbajtja nën kontroll, mbrotja dhe zonat e rritjes*

#### Nyjet

Në territorin e komunës së Vitisë janë planifikuar 3 nyje kryesore të zhvillimit që mbështetin dhe promovojnë intensitet të lartë të shfrytëzimit të tokës dhe aktiviteteve. Këto tri nyje kryesore janë: Vitia, Pozharani dhe Gjylekari. Nyja e parë e rëndësishme është zona urbane e Vitisë si qendër kryesore për tërë territorin e komunës së Vitisë, e cila njëherit konsiderohet edhe si nyje e rëndësishme për zhvillimin e shumë aktiviteteve socio-ekonomike si dhe nyje e rëndësishme e lidhjeve jo vetëm me vendbanimet brenda territorit të komunës por edhe me qytetet tjera përreth (Gjilan dhe Ferizaj). Pas kësaj vjen Pozharani, e cila njëherit është edhe

vendbanimi më i madh në nivel të komunës, pas Vitisë, ku janë të përqendruara shumë aktivitete socio-ekonomike. Përveç si nyje e rëndësishme Pozharani është planifikuar si njëra ndër 3 qendrat kryesore të komunës së Vitisë në funksion të zhvillimit policentrik të komunës. Nyja e tretë e rëndësishme në komunën e Vitisë është vendbanimi Gjylekar. Ky vendbanim është është planifikuar po ashtu si njëri ndër 3 vendbbanimet e rëndësishme për zhvillimin policentrik të komunës së Vitisë dhe rrjedhimisht janë planifikuar një numër i konsiderueshëm i aktivieteve zhvillimore.

Nyja e parë (Vitia) do të vazhdojë të mbetet qendra kryesore administrative, kulturore, edukative si dhe qendra kryesore e aktiviteteve bankare dhe shërbyese në komunën e Vitisë, me funksione dhe elemente të shtuara si: Shkolla Profesionale e Bujqësisë, Avancimi i shërbimeve në QKMF, rritjen e hapësirave sportive dhe recreative, shtimin e aktivitetit të afarizmit dhe rritjes ekonomike.

Nyja e dytë (Pozharani) do të jetë qendër e rëndësishme ku është planifikuar shtimi i aktiviteteve socio-ekonomike dhe shërbimeve administrative. Kjo nyje gjendet në korridorin më të rëndësishëm në komunën e Vitisë, pëkatësisht shtrihet përgjatë rrugës rajonale Gjilan-Ferizaj. Pozita e përshtatshme gjeografike dhe zhvillimi aktual socio-ekonomik ofron mundësi dhe potencial të rëndësishëm zhvillimor për këtë nyje. Vendbanimet tjera përreth kësaj nyje, të tilla si: Sllatinë e Epërme, Sllatinë e Poshtme, Ramjani, Novosellë, Tërpezë, Çifllak, Tërstenik dhe Sadovinë e Çerkezëve do të marrin shërbime administrative dhe socio-ekonomike nga Pozharani.

Gjithashtu do të investohet në përmirësimin e infrastrukturës teknike, transportit dhe në mbrojtjen e mjedisit.

Nyja e tretë (Gjylekari) është një nyje me rëndësi të veçantë e cila planifikohet të zhvillohet jo vetëm në aspektin administrativ e socio-ekonomik, por edhe në aspektin e zhvillimit të turizmit natyror dhe kulturor, të shoqëruar me politika të ruajtjes së mjedisit. Kjo nyje shtrihet në pjesën veri-lindore të komunës së Vitisë dhe do të jetë një mundësi e mirë për ofrimin e shërbimeve për vendbanmet e asaj pjese të komunës.

Mes këtyre tri nyjeve, ekziston një qendër e rëndësishme e turizmit shëndetësor (Kllokoti) e cila gjendet jashtë kufijëve administrative të komunës së Vitisë, por territorialisht dhe funksionalisht është në mes të territorit të komunës dhe njëherit në mes të këtij trekëndëshi të nyjeve zhvillimore. Kjo lidhje funksionale e forcon edhe më tepër zhvillimin e tri nyjeve të përcaktuara në komunën e Vitisë.

**Korridoret mes nyjeve**

Lidhja mes nyjeve të Vitisë, Pozharanit dhe Gjylekarit bëhet përmes korridoreve të rëndësishme në komunën e Vitisë. Këto korridore janë si vijon: Korridori mes nyjeve Viti dhe Pozharan shtrihet përgjatë Rrugës Rajonale R22 e cila lidhë Ferizajn me Gjilanin. Ky korridor kalon pashmangshëm nëpër territorin e komunë së Kllokotit dhe rrjedhimisht ofron potencial të madh për zhvillim të ardhshëm socio-ekonomik.

Përgjatë këtij korridori është planifikuar zgjerimi i zonës aktuale ekonomike, hapësira edukative, kulturore dhe sportive si dhe zhvillimi i qëndrueshëm i bujqësise, duke marrë parasyshë kualitetin e tokës bujqësore (bonitetin e lartë) që shtrihet përgjatë këtij korridori.

Lidhja mes nyjeve të Vitisë dhe Gjylekarit bëhet përmes Rrugës Rajonale R211 (Viti-Vërboc) dhe rrugës lokale Vërboc-Skifteraj. Ky korridor kalon nëpër vendbanimet Viti, Ramnishtë, Vërboc dhe Gjylekar ndërsa përgjatë tij janë planifikuar kryesisht aktivitetet dhe funksionet si vijon: Aktivitetet të shtuara socio-ekonomike dhe edukative në Viti, infrastrukturë teknike dhe publike-sociale në Ramnishtë, Vërboc, si dhe aktivitete të shtuara administravie dhe socio-ekonomike në Gjylekar. Pjesa tjetër e cila gjendet jashtë kufijëve ndërtimor përgjatë këtij korridori është e destinuar për zhvillimin e qëndrushëm të bujqësisë.

Lidhja mes nyjeve Pozharan-Skifteraj pëhet përmes Rrugës Rajonale M25-3 (Pozharan – Budrikë) dhe rrugës lokale Budrikë-Skifteraj. Edhe lidhja e këtyre dy nyjeve kalon për komunës së Kllokotit, ndërsa një vendbanim tjetër të cilin e përfshinë ky korridor është Radivojci.

Përgjatë këtij korridori lidhës janë planifikuar aktivitete administrative, edukative dhe socioekonomike (Pozharan dhe Skifteraj), infrastrukturë teknike dhe publike-sociale (në të gjitha vendbanimet e përfshira nga korridori), ndërsa përgjatë këtij korridori, përkatësisht në vendbanimin Budrikë është planifikuar edhe një zonë ekonomike, plani rregullues i së cilës tashmë është i aprovuar nga kuvendi komunal Viti. Pjesa tjetër e cila gjendet jashtë kufijëve ndërtimor përgjatë këtij korridori është e destinuar për zhvillimin e qëndrushëm të bujqësisë.

**Plotësimi dhe dendësimi**

Kufijtë ndërtimor në zonën urbane në masë të madhe janë përcaktuar duke u bazuar në PZHK Viti 2010-2020+, me vetëm dy përjashtimet si vijon:

a) Në pjesën perëndimore të zonës urbane 27.9 Ha tokë bujqësore të klasit I janë lënë jashtë kufijëve ndërtimorë;
b) Në pjesën veriore 22 Ha janë përfshirë brenda kufijëve ndërtimorë, kjo duke u bazuar në situatën faktike të diktuar nga zhvillimet në 10 vitet e fundit ((ndërtimet

Ndërsa kufijtë e zonave rurale janë përcaktuar duke u bazuar në gjendjen e fundit të marrë nga imazhet satelitore (ortofoto) të vitit 2018, projeksionin e popullsisë për secilin vendbanim për periudhën deri në vitin 2030 si dhe nevojat zhvillimore për këtë periudhë të ardhshme kohore. Prandaj, duke u nisur nga këto analiza dhe parashikime, ky PZHK përveç që nuk parasheh zgjerim të kufijëve ndërtimorë në këto vendbanime, i njëjti parasheh zvogëlim (tkurrje) të këtyre kufijëve.

Në vend të zgjerimit të kufijëve ndërtimor është paraparë tkurrje e këtyre kufijëve dhe dendësim më i madh brenda kufijëve të rinjë, kjo për të siguruar një zhvillim më kompakt hapësinor, socio-ekonomik dhe

infrastrukturor të komunës.  Kjo për faktin se popullsia e komunës pritet të mbetet relativisht e njëjtë me atë aktualen, me vetëm 5.6 % rritje.

Dendësia më e madhe do të jetë në zonën urbane të komunës, ndërsa duke u mbështetur në pikën 1.5 të kapitullit II të Udhëzimit Administrativ nr. 08/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor, ky PZHK parasheh që e gjithë zona urbane të ketë dendësi mesatare të popullsisë deri në 200 ban./ha..

### Mbajtja nën kontroll

Duke u bazuar në projeksionin e popullsisë për secilin vendbanim për periudhën deri në vitin 2030, nuk është paraparë zgjerim i kufijëve ndërtimorë në vendbanimet e komunës së Vitisë, kjo për faktin se popullsia e komunës pritet të mbetet relativisht e njëjtë me atë aktualen, me vetëm 5.6 % rritje. Duke u nisur nga kjo; kufijtë ndërtimor në zonën urbane janë përcaktuar duke u bazuar në PZHK Viti 2010-2020+ me vetëm dy përjashtime, ndërsa ata të zonave rurale janë përcaktuar duke u bazuar në gjendjen e fundit të marrë nga imazhet satelitore (ortofoto) të vitit 2018 si dhe në nevojat zhvillimore. E gjithë kjo është bërë me qëllim të kufizimit të zhvillimit jo efikas me dendësi të ulët.

### Mbrojtja

*Mbrojtja e sipërfaqeve ujore*

Masat mbrojtëse për sipërfaqet ujore përcaktohen bazuar në UA. nr. 08/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor. Burimet e ujërave klasifikohen në burime nëntokësore dhe sipërfaqësore. Me qëllim të mbrojtjes se burimeve të ujerave përcaktohen zonat e mbrojtura ujore, të cilat ndahen në:

a) *Zona e mbrojtjes së regjimit të rreptë,* e cila ka për qellim të siguroj mbrojtjen e burimit të ujit dhe ndërtesave me instalime për marrjen e ujit si dhe të mbrojë burimin nga shkarkimet e ndotësve që mund të ndikojnë drejtpërdrejt në ujë nga aktivitetet e njeriut;
b) *Zona e mbrojtjes së regjimit të kufizuar*, e cila ka për qellim të sigurojë mbrojtjen e burimit të ujit nga lëvizjet e ndotësve mikrobiologjik, kimik dhe llojeve të tjera të ndotësve;
c) *Zona e mbrojtjes së regjimit të lehtë,* e cila ka për qellim të siguroj mbrojtjen parandaluese për pellgun përkatës të burimit të ujit dhe të rris efikasitetin e mbrojtjes nga ndotja kimike dhe radioaktive.

Ndër të tjera është parashikuar si vijon:

- Të gjitha burimet e ujërave natyrale,termale dhe termo - minerale dhe ujërave tjerë nëntokësorë dhe sipërfaqësor të mbrohen siç shihet në hartën hidrologjike të komunës së Vitisë, bashkë me caktimin e zonës së mbrojtjes së obligueshme rreth burimeve, kaptazheve, rrjedhave të lumenjve dhe akumulacioneve, me regjim të caktuar të mbrojtjes, varësisht nga destinimi i objektit. Në këto zona nuk mund të ndërtohen objekte e të zhvillohen punime tjera, as të shfrytëzohet toka në mënyrën e cila rrezikon sasinë dhe kualitetin e ujit;

- Merren masat për mos lejimin e ndotjes së lumenjve, ujërave nëntokësore dhe sipërfaqësore nga ujërave të përdorura dhe ndyta prej vendbanimeve duke rekomanduar trajtim në dalje me gropa septike dhe forma tjera vendosja e aparateve për pastrim deri te impianti;
- Merren masat për mos lejimin e ndotjes së lumenjve, ujërave nëntokësore dhe sipërfaqësore nga ujërave të përdorura dhe ndyta prej kapaciteteve industriale duke përfshirë edhe VINEKS-in duke montuar dhe kompletuar aparate pastrimi të ujërave të përdorura.
- Në të ardhmen është e domosdoshme të merren masa afatshkurtra dhe afatgjatë që ujërat e përdorura, ndyta (urbane, industriale) para se të lëshohen, të pastrohen në pikëpamje fizike biologjike dhe kimike. Për ketë qellim, është e nevojshme.
- Dokumentacioni investivo-teknik për industritë e reja duhet të përmbajë edhe vendimin e pastrimit të të gjitha ujërave të përdorura, ndyta. Puna e kapaciteteve të reja industriale nuk duhet të lejohet pa u montuar më parë aparatet të cilat do të sigurojnë pastrimin e ujërave të ndyta në mënyrën e duhur.
- Sigurimi i sasisë së nevojshme të ujit të shendosh të pijes për popullsinë e kësaj komune. Pos kësaj shfrytëzimi racional i ujërave në ketë komunë, është detyrë me rëndësi e të gjithë faktorëve të planifikimit dhe të shfrytëzimit të ujit dhe hapësirës.
- Parashihet mbrojtja e veçantë për burimet gurrën e Binçës, gurrën e Letnices, gurrat e Terpezes e të Shoshares në komunën e Vitisë; Për rrjedhat e epërme të terreneve të Golemarekes, të lumit të Letnices, lumi Uji i Mirë dhe lumi i Mullajve në fshatin Gushicë.

*Mbrojtja e tokës bujqësore*

Toka bujqësore, si vlerë e çmuar për zhvillimin ekonomik të komunës së Vitisë duhet të mbrohet nga degradimi, erozioni e fragmentimi me masat mbrojtëse të përcaktuara me ligjin nr. 02/L-26 për Tokën Bujqësore dhe me UA nr. 08/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor.

*Mbrojtja e pyjeve*

Duke marrë parasysh përqindjen e madhe të sipërfaqeve pyjore në komunë, pylltaria konsiderohet si potencial shumë i mirë për zhvillimin ekonomik të komunës. Kështu, mbrojtja e këytre sipërfaqeve planifikohet të bëhet konform ligjit nr. 03/L-153 për Pyjet e Kosovës dhe aktet nënligjore relevante, si dhe UA nr. 08/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor.

Mbrojtja dhe rregullimi i tokës pyjore bëhet nëpërmjet formave si në vijim:

1. Mbrojtja e tokës pyjore nga shpyllëzimi- prerja e të gjitha bimëve pyjore dhe më pas përdorimi i kësaj toke për shfrytëzime të tjera jo-pyjore;
2. Mbrojtja dhe rregullimi i tokës pyjore nëpërmjet pyllëzimit- krijimi i një pylli apo të një grumbulli të bimëve pyjore (ekskluzivisht autoktone) në një tokë ku nuk kishte pyll;
3. Mbrojtja dhe rregullimi i tokës pyjore nëpërmjet ripyllëzimit- rivendosja e mbulesës pyjore (ekskluzivisht autoktone), në forme të natyrshme (nëpërmjet mbjelljes natyrore, nëpërmjet kthimit të

pyjeve cungishte në trungishte) ose në forme artificiale (nëpërmjet mbjelljes së drejtpërdrejtë të bimës dhe farës).

*Mbrojtja e Trashëgimisë Natyrore*

Vlerat e mbrojtura të natyrës mund të përdoren dhe avancohen në mënyrën e cila e mundëson mbrojtjen dhe avancimin e tyre afatgjate, në përputhje me Ligji Nr. 02/L-18 Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës.

Në pjesën e mbrojtur të natyrës nuk mund të zhvillohen aktivitete të cilat e rrezikojnë ekuilibrin natyror, llojllojshmërinë biologjike dhe peizazhore, hidrografinë, gjeomorfologjinë, gjeologjinë, vlerat kulturore ose në çfarëdo mënyrë degradojnë cilësitë dhe veçoritë e vlerave të natyrës.

Duhet ndërmarrë masa të veçanta për ruajtjen dhe shfrytëzimin e vlerave të mbrojtura të kulturës dhe të natyrës.

Shfrytëzimet e lejuara të veçanta për zonat e trashëgimisë natyrore me karakter botanik janë:

- Aktivitetet hulumtuese, mbledhja e të dhënave profesionale dhe mbikëqyrja e zbatimit të masave dhe kushteve të përcaktuara për mbrojtjen e natyrës
- Përdorimi i mjeteve për mbrojtjen e bimëve dhe plehrave minerale

Shfrytëzimet e ndaluara për këto zona janë:

- Në sipërfaqen e monumentit ndalohet:
    - Prerja e trungut, thyerja e degëve, mbledhja e gjetheve apo fryteve, kositja e barit si dhe çfarëdo veprimtarie e cila ndryshon gjendjen e tanishme;
    - Ndezja e zjarrit në sipërfaqen e mbrojtur;
    - Mbjellja e bimëve me qëllim të gjelbërimit të sipërfaqes së mbrojtur;
    - Ndryshimi i pamjes së sipërfaqes së mbrojtur;
    - Grumbullimi i mbeturinave në sipërfaqen e mbrojtur;
    - Punimi (lëvrimi, shfrytëzimi) i tokës në sipërfaqen e mbrojtur
    - Aktivitetet tjera të cilat mund të shkaktojnë ndryshime ose dëmtime të monumentit të natyrës
- Në zonën buferike të monumentit ndalohet:
    - Rrjedhja (lëshimi) i ujërave të ndotura, deponimi i mbeturinave dhe mbetjeve të tjrea;
    - Përdorimi i mjeteve mbrojtëse kimike;
    - Ndërrimi i kulturës;

- Mbjellja e bimëve ose ngritja e objekteve tjera të cilat mund të ndikojnë në pengimin e pamjes së monumentit

Për monumentet e trashëgimisë natyrore me karakter hidorlogjik, lejohen këto shfrytëzime:

- Shfrytëzimi i ujit duke mos penguar rrjedhën e tij, nën mbikëqyrjen e organit kompetent
- Objekte në funksion të mbrojtjes së monumentit
- Në zonën buferike lejohen ndërhyrjet që nuk dëmtojnë dhe nuk ndryshojnë veçoritë për shkak të cilave zona është shpallur e mbrojtur

Shfrytëzimet e lejuara të veçanta janë:

- Aktivitetet hulumtuese, mbledhja e të dhënave profesionale dhe mbikëqyrja e zbatimit të masave dhe kushteve të përcaktuara për mbrojtjen e natyrës

Shfrytëzimet e ndaluara për zonat e këtyre monumenteve janë:

- Ndërtimi i ndërtesave të infrastrukturës;
- Ndërtimi i ndërtesave të reja transite, komunale, energjetike, të telekomunikacionit dhe rrugëve;
- Mbulimi i terrenit, mihja dhe nxjerrja e gurëve, mineraleve, shtresimeve ose fosileve;
- Deponimi i mbeturinave dhe lëshimi i ujërave të ndotura;
- Ndryshimi i regjimit të ujërave;
- Evitimi i përmbytjeve, përdorimi i të mirave të natyrës për qëllime ekonomike;
- Kryerja e veprimtarive përmirësuese, mënjanimi i mureve të gjalla dhe përbërësve tjerë të natyrës;
- Gjuetia, peshkimi, veprimtaritë rekreative- sportive;
- Vendosja e reklamave dhe shenjave të tjera;
- Aktivitetet tjera të cilat munden me rrezikuar vlerën e mbrojtur të natyrës.

Në zonën buferike të monumentit ndalohet:

- Aktivitetet ushtarake të cilat mund të rrezikojnë vlerat e natyrës

*Mbrojtja e Trashëgimisë Kulturore*

Trashëgimia kulturore cilësohet si një ndër elementet kryesore për fuqizimin e identitetit të komunës së Vititsë. Kjo komunë është e pasur me monumente të trashëgimisë kulturore, duke numëruar kështu 7 asete të trashëgimisë arkeologjike, 22 asete të trashëgimisë arkitekturore dhe 1 Zonë të Veçantë të Mbrojtur.

Edhe pse këto asete të trashëgimisë kulturore janë shpallur nën mbrojtje të përkohshme, shumë prej tyre nuk janë në gjendje të mirë fizike dhe kërkojnë intervenime restauruese. Gjithashtu këto objekte të trashëgimisë nuk e kanë të përcaktuar perimetrin dhe zonën mbrojtëse ashtu siç kërkohet me Ligjin për Trashëgimi

Kulturore, si dhe sipërfaqen e mbrojtur, ashtu siç kërkohet me Ligjin për Planifikimin Hapësinor. Me shpalljen e tyre si zona të mbrojtura, do të kontrollohen zhvillimet e ardhme në këto zona, dhe do të parandalohet degradimi i mëtutjeshëm i vlerave të tyre dhe mjedisit rrethues.

Objektet e trashëgimisë kulturore në komunë duhet të mbrohen dhe te kufizohen zhvillimet përreth tyre bazuar në UA nr.08/2017 për Norma Teknike të Planifikimit Hapësinor. Sipas këtij UA, objektet e trashëgimisë arkitekturore duhet të kufizojnë zhvillimet përreth me zonë mbrojtëse me radius prej 50 metrash, ndërsa 100 metra prej perimetrit të objekteve të trashëgimisë arkeologjike.

Në sipërfaqet e zonave dhe sipërfaqeve të mbrojtura të trashëgimisë kulturore ndalohen aktivitetet në vijim:

- Ndërtimi i ndërtesave më të larta dhe atyre që nuk janë në harmoni me ndërtesat ekzistuese fqinje;
- Ndërtimi i auto-udhëve, rrugëve nacionale dhe rajonale;
- Zhvillimi i veprimtarisë së industrisë së rëndë;
- Instalimi mbitokësor i furnizimit të rrymës elektrike, telekomunikacionit, përçuesve digjitale.

Duke vlerësuar rëndësinë e numrit të madh të objekteve të trashëgimisë kulturore në komunë, si element për fuqizim të identitetit të komunës planifikohet të zhvillohen projekte të cilat do të mbrojnë nga degradimi i mëtutjeshëm asetet dhe në të njejtën kohë të vë në pah vlerat artistike, estetike, historike dhe tradicionale të këtyre aseteve nga të gjithë banorët e komunës dhe më gjerë.

*Zona e veçantë e mbrojtur*

Zona e veçantë e mbrojtur Manastiri i Binaqit në Buzovik është e definuar me hartë dhe me kufirin i cili e rrethon atë, në funksion të mbrojtjes nga çdo zhvillim apo aktivitet i cili mund të dëmtojë kontekstin e saj historik, kulturor dhe arkitektural. Kjo zonë gëzon trajtim të veçantë të mbrojtjes që garantohet me Ligjin NR. 03/L-039 për Zonat e Veçanta të Mbrojtura. Masat për mbrojtjen e saj duhet t'i përmbahen U. A. për Normat teknike të planifikimit MMPH Nr.08/2017 (shtojca, Kapitulli II paragrafi 7.)

Në zonat e veçanta të mbrojtura ndalohen / kufizohen aktivitetet në vijim:

Aktivitetet e ndaluara:

- Ndërtimet apo zhvillimet industriale, si gërmimi dhe shfrytëzimi i burimeve minerale, ndërtimi i pendëve, centraleve elektrike apo linjave të tensionit, furrave, fabrikave dhe rrugëve transite;
- Ndërtimet apo zhvillimet që çojnë në shpyllëzimin apo ndotjen e mjedisit.

Aktivitetet e kufizuara janë si në vijim:

- Strukturat ose godinat më të larta se monumenti kulturor që duhet të mbrohet;

- Ndërtimi i rrugëve, magazinave, punëtorive, shitoreve, restoranteve, bareve, kafeneve, hoteleve/moteleve, tezgave dhe kioskave ushqimore, stacioneve të karburanteve dhe riparimit të automjeteve, 'supermarket'-eve, klubeve të natës, apo ndonjë ndërtimi tjetër;
- Tubimet, argëtimi dhe zbavitja publike;

Në sipërfaqet apo hapësirat në të cilën ekzistojnë vlera arkeologjike, historike dhe zona tjera të mbrojtura ndalohet ndërtimi i deponisë për mbeturina.

Në lokacionin ku ndërtohet apo planifikohet deponia e mbeturinave, paraqitet zona neutrale (së paku 50 m) përreth deponisë e cila duhet të jetë 600 m në distancë nga zonat e veçanta të mbrojtura.

## Zonat e rritjes

Në vend të zgjerimi të kufijëve ndërtimor është paraparë dendësim më i madh brenda kufijëve aktual, kjo për të siguruar një zhvillim më kompakt hapësinor, socio-ekonomik dhe infrastrukturor të komunës. Duke u nisur nga kjo, sipërfaqja totale e ndërtuar në komunën e Vitisë do të jetë 3,313 Ha., nga kjo, 521 Ha. janë në zonën urbane ndërsa 2792 Ha. janë në vendbanimet tjera të komunës. Dendësia më e madhe do të jetë në zonën urbane të komunës, ndërsa duke u mbështetur në pikën 1.5 të kapitullit II të Udhëzimit Administrativ nr. 08/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor, ky PZHK parasheh që e gjithë zona urbane të ketë dendësi mesatare të popullsisë deri në 200 ban./ha.

Edhe projeksioni demografik për vitin 2030, por edhe nevojat për banim dhe aktivitete ekonomike konform këtij projeksioni diktojnë mos pasjen e nevojës për zgjerim të kufijëve ndërtimor nga ata që janë paraparë me PZHK 2010-2020+. Madje, në shumicën absolute të vendbanimeve, në 10 vitet e fundit kemi më pak zhvillime se sa ishin paraparë me PZHK 2010-2020+, rrjedhimisht, këto vendbanime kanë mbetur shumë brenda kufijëve ndërtimorë të përcaktuar. Prandaj, ky PZHK parasheh zvogëlim (tkurrje) të kufijëve ndërtimor në shumicën e vendbanimeve të Vitisë, duke përjashtuar vetëm zonën urbane. Edhe në zonën urbane, në masën më të madhe janë ruajtur kufijtë aktual ndërtimor, me dy përjashtimet si vijon:

a) Në pjesën perëndimore të zonës urbane 27.9 Ha tokë bujqësore të klasit I janë lënë jashtë kufijëve ndërtimorë;
b) Në pjesën veriore 22 Ha janë përfshirë brenda kufijëve ndërtimorë, kjo duke u bazuar në situatën faktike të diktuar nga zhvillimet në 10 vitet e fundit (ndërtimet).




Harta 32 Zhvillimi Hapësinor i Planifikuar

### 4.3.1.3. *Koncepti i zhvillimit të zonës urbane*

**Qendra**

Zona qendrore do të funksionojë si pikë qendrore e qytetit që nëpërmes objekteve të administratës komunale dhe shërbimeve tjera publike, objekteve shëndetësore, të arsimit, të rendit, shtëpisë së kulturës, bankave dhe objekteve tjera afariste, sheshit, parkut të qytetit dhe hapësirave tjera publike si dhe ndërtimit të mesëm ofron kushte të mirëfillta për shërbime administrative, afarizëm, banim, kulturë, sport, argëtim dhe rekreacion etj..

Dendësia e Popullsisë e planifikuar me Planin Zhvillimor Urban 2010-2015+ në këtë zonë është 150-300 ban./ha. Ndërsa Lartësia Banimore e planifikuar me po të njëjtin plan është nga P+3 deri në P+8 etazha. Mirëpo, Plani Rregullues Urban për Zonën Qendër, Jug dhe Lumin Morava ka paraparë dendësi të popullsisë deri në 429 ban/ha si dhe lartësi banimi nga P+2 deri në P+6 etazha.

Mirëpo, duke u mbështetur në pikën 1.5 të kapitullit II të Udhëzimit Administrativ nr. 08/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor, ky PZHK parasheh që e gjithë zona urbane të ketë dendësi të popullsisë deri në 200 ban./ha..

Përveç kësaj, me Planin Zhvillimor Urban 2010-2015+ si dhe me Planin Rregullues Urban në këtë zonë janë planifikuar edhe hapësirat për tregun, zonën e zhvillimit ekonomik, parking privat, shtëpinë e mallrave si dhe muzeun e qytetit, e po ashtu janë paraparë edhe vendet për evakuim, pikat ndalëse të transportit, hapësira për

vendosjen e pikave monitoruese të ajrit si dhe shtrirja e plotë e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit. Ky PZHK synon vazhdimin e realizimit të veprimeve dhe projekteve të parapara me planet e lartëcekura.

### Zona Veriore

Kjo zonë do të vazhdojë të karakterizohet me banim kryesisht individual si dhe me koncentrim të aktiviteteve tregtare përgjatë rrugës Viti – Drobesh. Infrastruktura e nevojshme publike dhe sociale do të kompletohet edhe në këtë zonë. Ruajtja e tokës bujqësore do të ketë prioritet.

Dendësia Banimore e planifikuar me Planin Zhvillimor Urban 2010-2015+ në këtë zonë është 80-150 ban./ha. Ndërsa Lartësia Banimore e planifikuar me po të njëjtin plan është nga P+2 deri në P+5 etazha. Mirëpo, Plani Rregullues Urban Zona Veriore ka paraparë një dendësi nga 143 ban./ha deri në 600 ban./ha si dhe lartësi banimore nga P+2 deri në P+6 etazha. Është e rëndësishmë të ceket se dendësia prej 600 ban./ha është planifikuar vetëm për katër blloqe banimi, aty ku është i koncentruar banimi kolektiv, ndërsa në pjesën më të madhe të zonës dominon dendësia prej 143 ban./ha. Po ashtu duhet të ceket se etazhiteti P+6 është caktuar vetëm për dy blloqe banimi, të parapara për banim kolektiv, ndërsa në tërë zonën dominon etazhiteti P+2.

Mirëpo, duke u mbështetur në pikën 1.5 të kapitullit II të Udhëzimit Administrativ nr. 08/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor, ky PZHK parasheh që e gjithë zona urbane të ketë dendësi të popullsisë deri në 200 ban./ha.

Përveç kësaj, me Planin Zhvillimor Urban 2010-2015+ si dhe me Planin Rregullues në këtë zonë janë planifikuar edhe hapësira për park, parking privat, shkollë, antenë, pika ndalëse të transportit, shtrirja e plotë e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit.

Tutje; sa i përket aktiviteteve bujqësore, me Planin Zhvillimor Urban 2010-2015+ në këtë zonë është paraparë kultivimi i dredhezës dhe i mollës.

Ky PZHK synon vazhdimin e realizimit të veprimeve dhe projekteve të parapara me planet e lartëcekura.

### Zona Jugore

Kjo zonë do të trajtohet me një trajtim të veçantë, kryesisht për shkak të objekteve të infrastrukturës publike dhe religjioze që gjenden në këtë pjesë si dhe për faktin se Kabashi, kryesisht për shkak të ndërtimit të pakontrolluar të objekteve të banimit, gati se është ngjitur me zonën urbane dhe është shndërruar në para lagje të kësaj të fundit. Hapësira për rekreacion dhe aktivitete kulturore do të krijohen në këtë zonë, krejt kjo në shërbim edhe të nxënësve që vijojnë shkollimin në shkollën fillore dhe të mesme që gjenden aty. Parandalimi i mëtejmë I aglomeracionit urban, me fokus në ruajtjes e tokës bujqësore do të kenë prioritet në këtë zonë.

Dendësia Banimore e planifikuar me Planin Zhvillimor Urban 2010-2015+ në këtë zonë është 50-80 ban./ha. Ndërsa Lartësia Banimore e planifikuar me po të njëjtin plan është nga P+1 deri në P+3 etazha. Mirëpo, Plani Rregullues Urban për Zonën Qendër, Jug dhe Lumin Morava ka paraparë dendësi 100-250 ban/ha si dhe lartësi banimi deri në P+2 etazha.

Mirëpo, duke u mbështetur në pikën 1.5 të kapitullit II të Udhëzimit Administrativ nr. 08/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor, ky PZHK parasheh që e gjithë zona urbane të ketë dendësi të popullsisë deri në 200 ban./ha..

Përveç kësaj, me Planin Zhvillimor Urban 2010-2015+ dhe me Planin Rregullues Urban në këtë zonë janë planifikuar edhe hapësirat për parking privat, poligon i shejtarisë, sport dhe rekreacion, si dhe objekt i ri i

komunës i cili tashmë është ndërtuar, vendet për evakuim, park, qendër e mjekësisë familjare, hapësirat për tregun si dhe shtrirja e plotë e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit.

Ky PZHK synon vazhdimin e realizimit të veprimeve dhe projekteve të parapara me planet e lartëcekura

**Zona Lindje**

Në këtë zone aktualisht gjendet një shkollë fillore, një shkollë e mesme, qendra e zjarrëfikësve, kisha katolike, Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare, stadiumi, një sallë për not, stadiumi i futbollit të vogël si dhe varrezat ortodokse. Përveç kësaj, në këtë zone gjendet edhe Zona e Zhvillimit Ekonomik, në të cilën janë të koncentruar një numër i madh I bizneseve.

Dendësia Banimore e planifikuar me Planin Zhvillimor Urban 2010-2015+ në këtë zonë është 50-80 ban./ha. Ndërsa Lartësia Banimore e planifikuar me po të njëjtin plan është nga P+1 deri në P+3 etazha. Për këtë zonë aktualisht nuk ka asnjë Plan Rregulles të Hollësishëm, mirëpo, duke u mbështetur në pikën 1.5 të kapitullit II të Udhëzimit Administrativ nr. 08/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor, ky PZHK parasheh që e gjithë zona urbane të ketë dendësi të popullsisë deri në 200 ban./ha..

Përveç kësaj, me Planin Zhvillimor Urban 2010-2015+ në këtë zonë janë planifikuar edhe hapësirat për parking privat, qerdhe, shkollë e mesme, vendet për evakuim, pikë ndalëse e transportit, parking, FAMI, hapësira për vendosjen e pikave monitoruese të ajrit si dhe shtrirja e plotë e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit. Edhe Zona e Zhvillimit Ekonomik, në të cilën janë të koncentruar një numër i madh I bizneseve, është paraparë me Planin Zhvillimor Urban 2010-2015+.

Tutje; sa i përket aktiviteteve bujqësore, me Planin Zhvillimor Urban 2010-2015+ në këtë zonë është paraparë kultivimi i dredhëzës.

Ky PZHK synon vazhdimin e realizimit të veprimeve dhe projekteve tjera të parapara me planet e lartëcekura.

**Zona Perëndim**

Kjo zonë është e destinuara kryesisht për banim, me ndërtim individual, por pa ndonjë funksion apo objekt me rëndësi shoqërore.

Dendësia Banimore e planifikuar me Planin Zhvillimor Urban 2010-2015+ në këtë zonë është 50-80 ban./ha. Ndërsa Lartësia Banimore e planifikuar me po të njëjtin plan është nga P+1 deri në P+3 etazha.

Për këtë zonë aktualisht nuk ka asnjë Plan Rregulles të Hollësishëm, mirëpo, duke u mbështetur në pikën 1.5 të kapitullit II të Udhëzimit Administrativ nr. 08/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor, ky PZHK parasheh që e gjithë zona urbane të ketë dendësi të popullsisë deri në 200 ban./ha..

Përveç kësaj, me Planin Zhvillimor Urban 2010-2015+ në këtë zonë janë planifikuar edhe hapësirat për qerdhe, qendër të mjekësisë familjare, objekt të gjykatës, objekt të policisë, hapësirë për park si dhe shtrirja e plotë e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit.

Zonat Lindje dhe Perëndim do të kompletohen me infrastrukturën e nevojshme teknike, publike dhe sociale, ndërsa karakteri i tyre si zona të destinuara kryesisht për banim me ndërtim individual do të ruhet edhe më tej.

Koncentrimi i aktiviteteve të shumta tregtare përgjatë rrugës Viti – Drobesh ka bërë që **Drobeshi** të zgjerohet në drejtim të zonës urbane dhe të merr tiparet e një paralagje të kësaj zone. Në këtë zonë aktualisht ekziston një shkollë fillore, palestër sportive, xhami, varreza të myslimanëve etj..

Edhe **Kabashi** thuajse ka marrë tiparet e një paralagjeje të zonës urbane, ndërsa kjo ka ardhur kryesisht si rezultat i ndërtitmit të shumtë të shtëpive të banimit. Në këtë zonë aktualisht ekziston një shkollë fillore, 1 xhami, 1 kishë katolike, varreza myslimane etj..

Infrastruktura e nevojshme teknike, publike dhe sociale do të kompletohet edhe në këto zona, ndërsa zgjerimi i ardhshëm i qytetit të Vitisë, në mënyrë të kontrolluar, është planifikuar pikërisht në këto dy drejtime. Megjithatë, ruajtja e tokës bujqësore do të ketë prioritet.

### 4.3.2. Skenarët e propozuar

Krijimit të konceptit të zhvillimit hapësinor i ka paraprirë analiza e mundësive të ndryshme në lidhje me mënyrën e zhvillimit hapësinor të komunës. Planifikimi i skenarëve për zhvillim është mjet i cili shërben për të analizuar rezultatet e së ardhmes të cilat vijnë si pasojë e vendimeve të sotme. Për më shumë "skenarët janë përshkrime të një apo disa të ardhme të mundshme duke u bazuar në trendët e të së kaluarës, të tashmes, dhe të ardhmes" (Van Notten, 2003). Vendimet të cilat i marrim sot do të ndikojnë në kahje të zhvillimit të komunës sonë. Në këtë kontekst bëhet edhe analiza e skenarëve që shërben për të menduar në mënyrë kritike se si do të duket e ardhmja e komunës. Hartimi dhe vlerësimi i skenarëve është punuar duke përdorur të dhëna nga gjendja ekzistuese, kërkesat për të ardhmën dhe potencialet e komunës për zhvillim.

Komuna e Vitisë është duke ndërtuar zhvillimin e saj mbi potencialet e saja natyrore dhe të krijuara për zhvillim të mirëfilltë: natyra, toka bujqësore, bizneset dhe industria. Bujqësia konsiderohet si sektor kyç për të udhëhequr këtë zhvillim. Trashëgimia kulturore mbase luan një rol të rëndësishëm, ajo mund të pasurojë dhe integrojë përvojën turistike që ofron Vitia. Duke u bazuar në trendët e kaluar të zhvillimit dhe gjendjes së tashme urbane dhe hapësinore në komunë, janë analizuar tre skenarë të zhvillimit.

**Skenari 0**: Trendi aktual

**Skenari 1**: Zhvillim kompakt - Monocentrik

**Skenari 2**: Zhvillim Policentrik

Pika kyçe për të mbajtur nën kontroll këtë rrugë të zhvillimit është duke siguruar se të gjitha fushat (çështjet) e duhura të planifikimit të merren parasysh në mënyrë të integruar gjatë trajtimit të skenarëve (shih figurën më poshtë);




#### *4.3.2.1. Skenari 0 - Trendi aktual*

**Pikat e favorshme:** Komuna e Vitisë kishte një buxhet që ka shënuar rritje të vazhdueshme në 10 vitet e fundit, edhe pse në periudha të caktuara kishte rënie. Në vitin 2015, kjo komunë kishte rreth 10 milion euro buxhet dhe në vitin 2021 kishte mbi 12 milion euro. Varësisht nga mundësit buxhetore, por edhe përkrahja me donacione nga institucione vendore dhe ndërkombëtare, kjo komunë ka realizuar projekte që kanë ndikuar dukshëm në zhvillimin ekonomik. Projektet janë realizuar në infrastrukturë sociale dhe publike, infrastrukturë të transportit dhe infrastrukturë teknike. Investimet më të mëdha në këto vitet e fundit kanë qenë në infrastrukturë publike dhe sociale.

**Pikat kritike:** Përkundër zhvillimeve aktuale dhe projekteve të realizuara deri më tani në komunën e Vitisë, ky skenar nuk ofron mundësi për një zhvillim të qëndrueshëm në të ardhmen. Aktualisht kemi një zhvillim ekonomik jo të qëndrueshëm me shkallë të lartë të informalitetit. Trendët aktuale të zhvillimit të vendbanimeve po ndikojnë negativisht në zënien e tokës bujqësore që konsiderohet si njëri nga resurset kryesore të komunës së Vitisë. Bujqësia përballet me shumë probleme si në aspektin e investimeve, fragmentim të pronave, mungesës së sistemit të ujitjes etj. Industria ende mbetet në shkallë të ulët të zhvillimit si dhe potencialet turistike nuk shfrytëzohen në nivelin e duhur. Infrastruktura në përgjithësi kërkon të ketë një përmirësim si dhe mirëmbajtje më të mirë. Edhe infrastruktura publike kërkon një shtrirje më të balancuar hapësinore dhe të mirëmbahet. Edhe në aspektin e mbrojtjes së mjedisit kemi trendë aktuale jo të favorshme siç janë: ndotja e lumenjve dhe ujërat e zeza, degradimet e tokës, degradimet e vazhdueshme të pyje etj. Kjo komunë ka një pasuri të çmuar të trashëgimisë kulturore, por aktualisht ka mungesë të investimeve dhe menaxhim e promovim jo të mirë.

- Shkalla e lartë e ekonomisë informale;

- Menaxhimi jo i mirë i tokës bujqësore dhe  fragmentim i saj, mungesa e sistemit të ujitjes;
- Zhvillim i ulët i industrisë dhe mos funksionalizimi i Zonave Ekonomike të parapara me PZHK 2010-2020;
- Mos shfrytëzimi i potencialit për zhvillimin e sektorit të turizmit;
- Hapësira e infrastrukturës publike edhe pse e mjaftueshme ajo nuk ka një shpërndarje të duhur hapësinore;
- Hapësira jo të mjaftueshme për kulturë, rini, sport e rekreacion;
- Ndotja e lumenjve, degradimi i tokës dhe pyjeve
- Mungon efikasiteti për menaxhimin e zonave dhe monumenteve të mbrojtura;
- Mungesa e investimeve në mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë natyrore;
- Ndërtimet e egra në zonat arkeologjike dhe në afërsi të objekteve të trashëgimisë;
- Zgjerimi i vendbanimeve në pjesë e rrafshët dhe me tokë pjellore, duke u de populluar vendbanimet kodrinore-malore dhe migrime të vazhdueshme si brenda ashtu edhe jashtë komunës dhe jashtë vendit;
- Kanë ndodhur edhe një numër i konsiderueshëm i ndërtesave shumë-banesore pa leje ndërtimi;




Harta 33 Skenari 0: Trendi aktual i zhvillimeve në komunën e Vitisë

Duke marrë parasysh analizën e skenarit të trendit aktual është evidente që komuna e Vitisë ka nevojë për orientim të ri zhvillimor, prandaj ky skenar konsiderohet i pa përshtatshëm për komunën që të krijojë parakushte dhe të vazhdojë trendin e zhvillimit konform kërkesave prioritare.

### 4.3.2.2. *Skenari 1 – Zhvillimi Monocentrik*

**Pikat e favorshme:** Ky skenar planifikon zhvillim kompakt të qendrës komunale të Vitisë, duke koncentruar të gjitha shërbimet dhe veprimtaritë kryesore ekonomike në këtë pjesë të komunës. Në të gjithë sektorët reflektohet zhvillimi i bujqësisë, industrisë së lehtë përpunuese dhe industrisë bujqësore si veprimtari kryesore të këtij skenari.

*Shërbimet dhe veprimtaritë kryesore publike dhe sociale* përmirësohen varësisht nga nevoja për zhvillim. Këto shërbime do të mbështesin bujqësinë si veprimtaria kryesore ekonomike, duke ndihmuar zhvillimin e saj në të gjitha vendbanimet e komunës. Zhvillimi i industrisë bujqësore do ta mbështesë po ashtu zhvillimin e bujqësisë.

Zhvillimi monocentrik i komunës së Vitisë mundëson efiçiencë në investime kapitale duke i fokusuar ato kryesisht në një qendër të vetme.

*Shërbimet nga sektori publik, social dhe teknik* do të mbështesin investimet në sektorin e turizmit natyror dhe kulturor, kryesisht në zonat periferike të komunës. Ndërlidhja e edukimit adekuat të resurseve humane që korrespondojnë me nevojat dhe kërkesat e sektorëve të Bujqësisë, Turizmit, dhe Industrisë së lehtë përpunuese janë prioritet i zhvillimit te qëndrueshëm ekonomik dhe udhërrëfyes i pa shmangshëm.

*Qasja në Viti* është përmirësuar; vëmendje e veçantë duhet dhënë promovimit të lidhjeve që lidhin qytetin e Vitisë me qendrat e afërta (Gjilan dhe Ferizaj), me kryeqytetin si dhe me rajonin. Mobiliteti i qëndrueshëm urban, i propozuar edhe me Planin e Mobilitetit 2016-2020, bashkë me revidimin dhe modifikimet e nevojshme do të përbënte skenarin kryesor të mobilitetit brenda zonës urbane të Vitisë.

Për më tepër, duhet ndërmarrë masa për të përmirësuar lëvizshmërinë e brendshme duke vlerësuar masat për të ofruar qasje më të lehtë në pjesën qendrore të qytetit, sipas logjikës së lëvizshmërisë pa ndikim negativ në atmosferë (ndikim 0).

**Pikat kritike:** Ky skenar ndjek pjesërisht një qasje të integruar hapësinore/territoriale. Ai kërkon sinergji të menjëhershme për t'u lidhur me shtytësit e zhvillimit, që janë zhvillimi i bujqësisë dhe turizmit.

Në këtë kuptim, ky skenar vë në funksion vetëm ato fusha të planifikimit ku ekziston një lidhje / ndikim i menjëhershëm i aktiviteteve të lidhura me bujqësinë dhe turizmin, por nuk merr parasysh një qasje të strukturuar dhe gjithëpërfshirëse.

Për më tepër, koncentrimi i gjithë kapitalit dhe investimeve zhvillimore në një qendër të vetme nuk është në funksion të zhvillimit gjithëpërfshirës dhe koheziv të të gjithë territorit të komunës.




Harta 34 Skenari 1 - Zhvillimi Monocentrik

### 4.3.2.3. *Skenari 2 - Zhvillim gjithëpërfshirës dhe i integruar: Zhvillim Policentrik*

**Pikat e favorshme:** Skenari i zhvillimit policentrik promovon zhvillimin gjithëpërfshirës, koheziv, multi-sektoral dhe multi-funksional për të siguruar zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe social, gjithnjë në harmoni me mbrojtjen dhe promovimin e mjedisit.

Ky skenar merr parasyshë të gjitha fushat që mbështesin zhvillimin e bazuar parimisht në bujqësi, turizëm dhe industri të lehtë, por edhe sektorët tjerë si: NVM-të, tregtia dhe shërbimet. Fushat që do të mbështesin këtë zhvillim fokusohen në:

1. Promovim dhe menaxhim të politikave efektive lokale për shfrytëzimin e tokës:
    a. Shfrytëzimi i tokës, sidomos për banim, biznese dhe industri, do të harmonizohet me nevojën e domosdoshme për ruajtjen e sipërfaqes bujqësore dhe resurseve tjera natyrore, në funksion të zhvillimit të bujqsisë, por edhe me nevojën për zhvillimin e turizmit dhe

industrisë së lehtë përpunuese, si dhe nevojave lokale për banim dhe aktivitete ekonomike. Në këtë kontekst, rëndësi të veçantë do t'i kushtohet raportit për mbështetje të kërkesave për banim/biznese në mes të qendrës dhe pjesëve tjera qytetit/komunës. Qendra e qytetit do të jetë në fokus për zhvillim duke mbështetur zhvillimin me intensitet më të ulët për të vënë në pah burimet natyrore. Për më shumë shfrytëzimi i tokës do të mbështesë zhvillimin e balancuar dhe kompakt brenda zonës urbane dhe në zonat periferike/rurale.

b. Krijim të një sistemi për mobilitet të qëndrueshëm me fokus në qarkullimin e ngadaltë në zonën urbane, këmbësorë, biçikleta, masa efektive për parkim si dhe lidhje rajonale: Qasja në zonën urbane, me theks të veçantë në qendër të qytetit do të përmirësohet duke hartuar politika që inkurajojnë qarkullimin e ngadaltë në zonën urbane, transportin jo-motorik, politikat e parkimit, rrjetin e hapësirave publike dhe parqet. Për më tepër, politikat do të fokusohen në qasje më të lehtë në pjesën qendrore të qytetit, sipas logjikës së lëvizshmërisë pa ndikim negativ në atmosferë (ndikim 0). Mobiliteti i qëndrueshëm urban i propozuar edhe me Planin e Mobilitetit 2016-2020, bashkë me revidimin dhe modifikimet e nevojshme do të përbëjë skenarin kryesor të mobilitetit brenda zonës urbane të Vitisë. E gjithë kjo, ndër të tjera, plotëson edhe lidhjen veri-jug dhe perëndim-lindje për këmbësorë dhe biçikleta. Nën-qendrat e komunës do të lidhen edhe me shumë me qytetin e Vitisë me transport ndërurban dhe rrjet të rrugëve, duke krijuar mundësi për zhvillim të bujqësisë dhe biznese lokale dhe duke kontribuar në shfrytëzim kompakt të tokës. Vëmendje e veçantë duhet dhënë promovimit të lidhjeve që lidhin qytetin e Vitisë me qendrat e afërta (Gjilan dhe Ferizaj), me kryeqytetin si dhe me rajonin.
c. Organizim i NVM-ve dhe aktiviteteve të ndërlidhura prodhuese rreth modelit të zhvillimit të qëndrueshëm: Një politikë lokale do të tentojë t'i grumbullojë ato në aspekt hapësinor dhe tematik, duke shprehur një kërkesë të qartë për shërbimet e tyre në nivel lokal dhe më gjerë. Grumbullimi i sektorit prodhues në një hapësirë, jo shumë larg zonës urbane, do të ofrojë të gjitha shërbimet e nevojshme teknike dhe logjistike.
d. Lidhja e arsimit të mesëm të lartë me nevojat e ekonomisë lokale: I gjithë sistemi shkollor, veçanërisht ai i nivelit të lartë, do të trajnojë personat e gatshëm për të mbështetur biznesin e lidhur me bujqësinë, industrinë e lehtë përpunuese dhe turizmit natyror e kulturor si një strategji e duhur dhe e përshtatur për kontekstin lokal.
e. Definimi i skemës së qartë të raporteve (përgjegjësive) të qeverisjes horizontale dhe vertikale: Përcaktimi i përgjegjësive në mënyrë të qartë në mes të gjithë sektorëve në administratën e komunës, si dhe definimi i raporteve me të gjithë akterët në komunë do të ndihmojnë në proces të identifikimit dhe zbatimit të projekteve strategjike. E gjithë kjo do të bëhet në harmonizim të plotë me politikat e nivelit qendror si dhe në bashkëpunim me ministritë e linjës.

**Pikat kritike:** Ky skenar propozon një qasje territoriale gjithëpërfshirëse dhe të integruar duke marrë parasysh:

- të gjitha fushat (çështjet) e identifikuara të planifikimit;
- identifikimin dhe gjetjen e logjikës së zbatimit të skemave të qeverisjes (horizontale dhe vertikale), dhe
- krijimin e një mekanizmi të përhershëm dhe të qasshëm për publikun, me një program specifik aktivitetesh të cilat do të mundësojnë që projektet lokale t'i përgjigjen çështjeve/sfidave në

zhvillim. Përmes qasjes pjesëmarrëse, ky mekanizëm zgjeron arenën e vendimmarrjes në nivel lokal / dhe akterëve vendor (PPP-Partneritet Publik-Privat)




Harta 35 Skenari 2 - Zhvillim Policentrik

Skenari 2 - **Zhvillimi gjithëpërfshirës dhe i integruar** është vlerësuar nga komuna dhe akterët pjesëmarrës si skenari më i favorshëm për zhvillimin e komunës gjatë 8 viteve të ardhshme. Prandaj, koncepti i zhvillimit hapësinor të komunës së Vitisë është bazuar në këtë skenar, pra Vitia do të zhvillohet si **Komunë Policentrike.**

## 4.3.3. Zhvillimi sipas Sektorëve

### *4.3.3.1. Zhvillimi ekonomik*

**Bujqësia, Blegtoria dhe Pylltaria**

Sa i përket zhvillimit të bujqësisë, duke u bazuar në planfikimin për zhvillimet optimale në bujqësi të paraparë me PZHK 2010-2020+ e i cili është adoptuar edhe në këtë PZHK, janë identifikuar kulturat bujqësore bashkë me hapësirat për kultivimin e tyre. Në këtë mënyrë, në pjesën më të madhe të sipërfaqeve bujqësore është planifikuar mbjellja e mollës dhe kumbullës, në pjesën qendrore dhe jugore të komunës është planfikuar mbjella e dredhëzës, në pjesën jug-lindore të komunë është planifikuar mbjellja e mjedrës dhe manaferës.

Zhvillimi i perimtarisë është planifikuar kryesisht në pjesën qendrore dhe në pjesen veri-lindore të komunës, duke përfshirë këto vendbanime dhe zona kadastrale: Viti, Pozharan, Radivojc, dhe Gjylekar.

Kultivimi i drithërave është planfikuar në mënyrë të shpërndarë në pothuajse gjithë territorin e komunës, duke përjashtuar vetëm qendrën dhe pjesën veri-lindore të komunës, aty ku është planifikuar zhvillimi i perimtarisë. Në këtë mënyrë, kultivimi i drithërave në pjesën veriore është planifikuar në këto vendbanime dhe zona kadastrale: Ballanca, Tërpeza, Novosella, Ramjani, Zhitia, Devaja si dhe një pjesë e vogël e Radivojcit.

Kultivimi i drithërave në pjesën lindore është planifikuar në këto vendbanime dhe zona kadastrale: Budriga e Epërme, Remniku, gjysma e Gjylekarit, pjesa më e madhe e Gërnçarit, një pjesë e vogël e Stubllës së Poshtme, një pjesë e vogël e Godenit të Madh, pjesa më e madhe e Stubllës së Epërme si dhe një pjesë e vogël e Vërnakollës.

Vërboci, Podgorci, Ramnishta, Begunca në Jug-Lindje; Drobeshi, Gërmova, Sadovina e Jerlive në perëndim janë planifikuar tërësisht si vendbanime dhe zona kadastrale për kultivimin e drithërave.

Binça, Kabashi, Smira dhe Gushica në Jug; Sadovina e Çerkezëve, Tërsteniku dhe Sllatina në perëndim janë planifikuar pjesërisht si vendbanime dhe zona kadastrale për kultivimin e drithërave.

Përveç kësaj, në zonat kadastrale në Gushicë, Gërmovë dhe Sllatinë janë planifikuar Zona për Zhvillime Bujqësore.

Me hartimin e Strategjisë së Integruar për Zhvillim të Qëndrueshëm të Bujqësisë dhe Blegtorisë, hartimi i së cilës është paraparë me këtë PZHK do të hartohen politika më konkrete dhe do të identifikohen resurse për shtimin e përkrahjes dhe subvencioneve për të siguruar zhvillim të qëndrueshëm të bujqësisë në vendbanimet dhe zonat kadastrale të lartëcekura.

Krijimi i kushteve në sektorin privat për ngritjen e plantazheve me fidane dhe pemishte (molla, dardha, kumbulla etj.) dhe fruta të imëta (mjedra, lajthi, dredhëza etj.) si dhe për ngritjen e serrave të reja dhe zgjerimi dhe modernizimi e atyre ekzistuese janë ndër mundësitë të cilat do të analizohen dhe të planifikohen detajisht në Strategjinë e Integruar për Zhvillim të Qëndrueshëm të Bujqësisë dhe Blegtorisë në komunënën e Vitisë. Zhvillimi i qëndrueshëm i bletarisë si dhe zhvillimi potencial i vreshtarisë do të analizohen dhe planifikohen po ashtu me këtë strategji të integruar.

Zhvillimi i blegtorisë është bazuar në PZHK 2010-2020+ propozimet e të cilit janë adoptuar edhe në këtë PZHK. Në këtë mënyrë, zhvillimi i blegtorisë është planfikuar në vendbanimet dhe zonat kadastrale si vijon:

Në pjesën veriore të komunës: Ballancë, Terpezë, Novosellë, Ramjan, Zhiti, Devajë, Radivojc, Budrigë e Epërme,

Në pjesën lindore të komunës: Remnik, Stubëll e Poshtme, Goden i Madh,

Në pjesën jug-lindore të komunës: Vërnakollë, Vërnez, Letnicë, Shashare

Në pjesen jugore të komunës: Lubishtë, Buzovik, Debëlldeh, Binqi, Mjak, Kabash, Smirë, Gushicë,

Në pjesën perëndimore të komunës: Vërban, Sadovinë e Çerkezëve, Sllatinë, Tërstenik.

Strategjia e Integruar për Zhvillim të Qëndrueshëm të Bujqësisë dhe Blegtorisë në komunën e Vitisë, hartimi i së cilës është paraparë me këtë PZHK do të hartojë politika dhe do të identifikojë resurse për shtimin e subvencioneve dhe ndihmave të tjera për të siguruar zhvillim të qëndrueshëm të blegtorisë në vendbanimet dhe zonat kadastrale të lartëcekura.

Ndërsa, zhvillimi i integruar dhe i balancuar i bujqësisë dhe blegtorisë, krahas shndërrimit të këtij sektori në njërën nga shtyllat kryesore për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik të komunës, po ashtu do të ndihmojë edhe në zbutjen e pabarazisë së zhvillimit ekonomik në terma të shpërndarjes jo të barabartë të kapitalit dhe koncentrimit të aktiviteteve ekonomike.

### Ujitja e Sipërfaqeve Bujqësore dhe Masat e Komasacaionit

Sa i përket ujitjes së tokës bujqësore, me hartimin e Strategjisë së Integruar për Zhvillim të Qëndrueshëm të Bujqësisë dhe Blegtorisë, hartimi i së cilës është paraparë me këtë PZHK do të dizajnohet edhe sistemi i ujitjes së sipërfaqeve bujqësore, bashkë me identifikimin e burimeve potenciale të ujit për ujitje.

Ndërsa sa i përket procesit të komasacionit të tokës bujqësore, duke u bazuar në planin e komasacionit të tokave në PZHK 2010-2020+ e i ciliështa adoptuar edhe në këtë PZHK, është planfikuar qe procesi i komasacionit, në zonat të cilat i përkasin kategorisë së tokave bujqësore I-IV, të zhvillohet në zonat e Budrigës së Epërme, Remnikut, Gjylekarit, Podgorcit, Ramnishtës, Beguncës si dhe Binçës. Sipas të dhënave të siguruara nga Ministria e Bujqësisë këto sipërfaqe nën komasacion arrijnë në 1080 ha. Sipërfaqe të tjera nuk planifikohen të fillojnë procesin e komasacionit brenda kufijve të komunës së Vitisë. Sipërfaqet e lartcekura janë paraqitur në Hartën e Shfrytëzimit të Planifikuar të Tokës.

### Pylltaria

Duke u bazuar në propozimet e PZHK 2010-2020+ e të cilat janë adoptuar në këtë PZHK, është paraparë pyllëzimi i një sipërfaqe totale prej 506 Ha., në vendbanimet dhe zonat kadastrale si vijon: Ramjan (gjysma e zonës kadastrale) si dhe Novosellë (një pjesë e vogël e zonës kadastrale). Budriga e Epërme (një pjesë e vogeël), Devaja (një pjesë e vogël), Radivojci (një pjesë e vogël), Gjylekari (një pjesë e vogël), Gërnçari (një pjesë e vogël), Stublla e Epërme (një pjesë e vogël), Lubishta (një pjesë e vogël), Buzoviku (një pjesë e vogël), Debelldehu (një pjesë e vogël), Smira (një pjesë shumë e vogël), Gushica (një pjesë shumë e vogël) dhe Vërbani (një pjesë shumë e vogël) janë po ashtu ndër zonat kadastrale për të cilat është planifikuar pyllëzimi. Në kuadër të këtij pyllëzimi është planifikuar edhe favorizimi i drurit të vlefshëm që rritet shpejtë. Tutje, shndërrimi gradual (natyral dhe artificial ) i pyjeve të ulëta në pyje të larta, përmes metodës së konversionit dhe përmes pyllëzimit është planifikuar po ashtu. Në këtë mënyrë, zona në Tërpezë, Vërban, Goshicë, Smirë, Kabash, Letnicë, Podgorc, Gërnçar, me një sipërfaqe totale prej 218 Ha., janë planifikuar të trajtohen me metodën e konversionit.

Përveç pyllëzimit, duke u bazuar po në propozimet e PZHK 2010-2020+ e të cilat janë adoptuar në këtë PZHK, është paraparë edhe melorizimi i pyjeve dhe atë në dy lokacione, me një sipërfaqe totale prej 33 Ha. Kështu, në pjesën lindore të komunës është planifikuar melorizimi i pyjeve, sipërfaqja e të cilave përshinë një

pjesë të Remnikut dhe Gjylekarit. Sipërfaqja e planifikuar për melorizim në pjesën veriore të komunës përfshnië një pjesë të Ballancës dhe një pjesë të Tërpezës.

Mirëmbajtja intensive e pyjeve të larta të ruajtura është po ashtu ndër masat e parapara dhe planfikuara me këtë plan. Zonat pyjore në të cilat duhet pasur kujdes dhe angazhim maksimal profesional me qëllim të ruajtjes dhe përmirësimit të gjendje së pyjeve të larta janë: Zona e pyjeve të Letnicës, Shasharës, Lubisht – Buzovik, Dobëlldeh, Mjak, Smirë dhe kulturat pyjore në zonën e Tërpezës – Novosellës.

Tutje: sa i përket shfrytëzimit të masës drusore, është propozuar orientimi në shfrytëzimin e drurit teknik së pari, e pastaj mbetja në dru zjarri, ndërsa vëllimi i përgjithshëm I prerjes do të orientohej në baza reale me gjendjen e pyllit, duke u harmonizuar me rritjen.

Ndërtimi i rrugëve pyjore në 1. Letnicë- Ibrishim – kufiri me Maqedoninë e Veriut dhe 2. Buzovik - Kufiri me Maqedoninë e Veriut është planfikuar në funksion të realizimit dhe implementimit të masave të parapara me këtë plan.

Masat për pyllëzim dhe melorizim të sipërfaqeve pyjore janë paraparë në hartën e planit për mbrojtjen nga rreziqet natyrore, si më poshtë:




Harta 36 Plani për mbrojtjen nga rreziqet natyrore

Përveç kësaj, për zhvillimin e planifikuar të bujqësisë, blegtorisë dhe pylltarisë shih hartën e Planit të Zhvillimit Ekonomik në Komunën e Vitisë.

## Tregtia

Duke u bazuar edhe në PZHK 2010-2020+, propozimet e pjesëshme të të cilit janë adoptuar në këtë PZHK, fuqizimi i sektorit të tregtisë do të bëhet kryesisht përmes koncentrimit të bizneseve të tregtisë me shumicë në

zonat e parapara ekonomike. Ofrimi i infrastrukturës së nevojshme për këto zona ekonomike, por edhe për bizneset e këtij sektorit të koncentruara në zona të tjera janë po ashtu ndër masat e parapara me këtë PZHK. Në këtë mënyrë, infrastruktura e nevojshme teknike do të ofrohet edhe për zonën ekzistuese ekonomike në Viti, por edhe për zonat tjera ekonomike të parapara me këtë plan.

Edhe bizneset e tregtisë me pakicë do të përkrahen përmes politikave stimuluese dhe lehtësuese të të bërit biznes, ndërsa masat konkrete do të planifikohen në Strategjinë e Integruar për Zhvillim të Qëndrueshëm Ekonomik në komunën e Vitisë, hartimi i së cilës është paraparë më këtë PZHK. Tutje; për zhvillimin e planifikuar të tregtisë shih Hartën e Planit të Zhvillimit Ekonomik në Komunën e Vitisë.

**Industria**

Ky Plan Zhvillimor Komunal synon të orientojë zhvillimin ekonomik drejt zhvillimit të bazuar në Industri të Lehtë, Industri Bujqësore dhe Përpunuese krahas zhvillimit të bazuar në Bujqësi si dhe Turizëm Natyror, Rural dhe Kulturor.

Duke u bazuar edhe në PZHK 2010-2020+, propozimet e pjesëshme të të cilit janë adoptuar në këtë PZHK, fuqizimi i sektorit të industrisë përmes lehtësimit të të bërit biznes të ndërmarrjeve aktuale, shtimit të numrit të ndërmarrjeve të reja si dhe shtimit të punësimit do të bëhet kryesisht përmes koncentrimit të bizneseve të industrisë në zonat e parapara ekonomike. Ofrimi i infrastrukturës së nevojshme për këto zona ekonomike, por edhe për bizneset e këtij sektorit të koncentruara në zona të tjera janë po ashtu ndër masat e parapara me këtë PZHK. Në këtë mënyrë, infrastruktura e nevojshme teknike do të ofrohet për zonat ekonomike si vijon: Zona Ekonomike në Viti, Zona Ekonomike me statusin Parku Industrial, në Budrigë të Epërme (parcela kadastrale P-70101012-00641-1), Zona Ekonomike në Drobesh. Për këto arsye, në pjesën e planifikimit të infrastrukturës teknike, janë planifikuar edhe rritja e kapaciteteve të furnizimit me ujë të pijës dhe ujë industrial (përmes puseve), shtrirja e kolektorit kryesor për mbledhjen e ujrave të zeza, shtrirja e rrjetit të kanalizimit për ujra të bardha, rritja e kapaciteteve të trafove elektrike për nevoja të bizneseve, shtrirja e kabllit optic deri tek zonat industriale, ndërtimi i depozive për mbledhjen e mbeturinave inerte dhe atyre të mbetjeve shtazore.

Përveç kësaj, zonat kadastrale Binçë dhe Gjylekarë janë identifikuar si vendbanimet me mundësi për zhvillimin e industrisë së përpunimit të drurit; zonat kadastrale Viti dhe Pozharan janë identifikuar si vendbanimet me mundësi për zhvillimin e industrisë së përpunimit të drurit, plastikës dhe metalit. Shiriti hapësinor që kalon përmes Gërnçarit, kufirit perëndimorë të Stubllës së Epërme, kufirit perëndimorë të Vërnakollës si dhe kufirit veriorë të Letnicës është identifikuar si hapësirë me mundësi për zhvillimin e industrisë së lehtë.

Zonat e parapara ekonomike janë planifikuar për zhvillim kryesisht të blegtorisë dhe industrisë së përpunimit dhe finalizimit të produkteve nga blegtoria, për industrinë e lehtë, të përpunimitt të drurit, industrinë e përpunimit të plastikës si dhe industrinë ushqimore.

Funksionalizimi i këtyre zonave ekonomike, bashkë më gjithë infrastrukturën përcjellëse, përveç që do të ndihmojë në zhvillimin dhe fuqizimin e sektorit të industrisë, po ashtu do të ndihmojë edhe në zbutjen e pabarazisë së zhvillimit ekonomik në terma të shpërndarjes jo të barabartë të kapitalit dhe koncentrimit të aktiviteteve ekonomike.

Politikat fiskale dhe lehtësirat tjera stimuluese për sektorin e industrisë do të analizohen dhe planifikohen në Strategjinë e Integruar për Zhvillim të Qëndrueshëm Ekonomik në komunën e Vitisë, hartimi i së cilës është paraparë më këtë PZHK e cili do të reflektojë qëllimin e këtij plani për orientim të zhvillimit ekonomik të bazuar në Industri të Lehtë, Industri Bujqësore dhe Përpunuese krahas zhvillimit të bazuar në Bujqësi si dhe

Turizëm Natyror, Rural dhe Kulturor. Për zhvillimin e planifikuar të industrisë shih Hartën e Planit të Zhvillimit Ekonomik në Komunën e Vitisë.

### Turizmi

Ky Plan Zhvillimor Komunal synon të orientojë zhvillimin ekonomik drejt zhvillimit të bazuar në Turizëm Natyror, Rural dhe Kulturor krahas zhvillimit të bazuar në Bujqësi si dhe Industri të Lehtë, Industri Bujqësore dhe atë Përpunuese.

Planifikimi për zhvillimin e turizmit natyror, rural dhe kulturor është bërë kryesisht duke u bazuar në propozimet e Planit Zhvillimor Komunal 2010-2020+ të komunës së Vitisë e të cilat janë adoptuar edhe në këtë PZHK. Arsyeja e adoptimit të këtyre propozimeve qëndron në faktin se propozimet sit ë tilla janë vlerësuar si të qëndrueshme dhe në funksion të plotë të shfrytëzimit të potencialit real që posedon komuna, mirëpo për shkaqe të ndryshme shumica dërrmuese e tyre nuk kanë gjetur zbatim në terren. Në këtë mënyrë, zhvillimi i turizmit në komunën e Vitisë është planifikuar si vijon:

### Turizmi natyror dhe rural

Fshatrat Debelldeh, Letnicë, te Shushtë dhe pjesa mbi Kabash janë fshatra me potencial të madh për këtë lloj turizmi, ndërsa zhvillimi i infrastrukturës dhe përmbajtjeve për sporte malore si shtigje të ecjes dhe shëtitje, vrapime dhe çiklizëm malor janë të domosdoshme. Në Strategjinë e Integruar për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit Natyror, Rural dhe Kulturor në komunën e Vitisë, hartimi i së cilës është paraparë me këtë PZHK, këto aktivitete të rekreacionit do të planifikohen së bashku me shërbimet e akomodimit privat nëpër fshatra, ndërsa masa të tilla pritet të sjellin të ardhura shtesë për banorët e zonave përkatëse. Ndërsa, për t'i paraprirë zhvillimit të këtij lloji të turizmit në këto vendbanime si dhe për të lehtësuar implementimin e propozimeve potenciale nga strategjia e lartëcekur, në pjesën e planifikimit të infrastrukturës teknike, janë planifikuar edhe asfaltimi i rrugëve lokale në zonat turistike, rregullimi i ndriqimit, hapja e stazave për ecje, shtrirja e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit, shtrirja e shërbimeve të transportit dhe shtrirja e shërbimeve për mbledhjen e mbeturinave.

Përveç kësaj, fshati Debëlldeh është konsideruar si zonë me potencial për zhvillimin e hotelerisë, në funksion të përkrhajes së turzimit veror dhe atij dimëror. Fshati Letnicë, për shkak të natyrës dhe peizazhit, karakteristikave arkitekturore dhe trashëgimisë shpirtërore është konsideruar si vendbanim me potencial të madh për zhvillimin e turizmit natyror dhe rural, por edhe turizmit kulturor.

Në zonat e lartpërmendura ka potencial edhe për zhvillimin e turizmit rural, i cili gjithsesi është i lidhur ngushtë edhe me zhvillimin e bujqësisë dhe blegtorisë, mirëpo gjithnjë i kushtëzuar me zhvillimin dhe përmirësimin e infrastrukturës së nevojshme teknike. Për këto arsye, në pjesën e planifikimit të infrastrukturës teknike, janë planifikuar edhe asfaltimi i rrugëve locale në zonat turistike, rregullimi i ndriqimit, hapja e stazave për ecje, shtrirja e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit, shtrirja e shërbimeve të transportit dhe shtrirja e shërbimeve për mbledhjen e mbeturinave.

### Turizmi kulturor

Smira, Stublla, Letnica, Tërpeza, Pozherani, Binqa, Gërmova, Gërnçari, Tërpeza dhe Qifllaki janë vendbanime me trashëgimi të pasur arkeologjike, arkitektonike dhe shpirtërore, si të tilla, këto fshatra përbëjnë potencial të madh për zhvillimin e turizmit kulturor. Planifikim i detajuar i zhvillimit të turizmit kulturor në këto vendbanime do të bëhet në Strategjinë e Integruar për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit Natyror, Rural dhe Kulturor në komunën e Vitisë, hartimi i së cilës është paraparë me këtë PZHK. Mirëpo, për t'i paraprirë zhvillimit të këtij lloji të turizmit në këto vendbanime si dhe për të lehtësuar

implementimin e propozimeve potenciale nga strategjia e lartëcekur, në pjesën e planifikimit të infrastrukturës teknike, janë planifikuar  edhe afaltimi i rrugëve locale në zonat turistike, rregullimi i ndriqimit, hapja e stazave për ecje, shtrirja e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit, shtrirja e shërbimeve të transportit dhe shtrirja e shërbimeve për mbledhjen e mbeturinave.

Shfrytëzimi i potencialit turistik, sidomos në zonat dhe vendbanimet e lartë cekura, përveç që do të ndikojë në zhvllim ekonomik të bazuar në turizëm, krahas bujqësisë dhe industrisë së lehtë e përpunuese, po ashtu do të ndihmojë edhe në zbutjen e pabarazisë së zhvillimit ekonomik në terma të shpërndarjes jo të barabartë të kapitalit dhe koncentrimit të aktiviteteve ekonomike. Për shfrytëzimin e potencialit turistik për turizëm kulturor shih Hartën e Planit të Zhvillimit Ekonomik në Komunën e Vitisë.

E gjithë infrastruktura e nevojshme për zhvillimin e turizmit natyror dhe atij kulturor do të ndërtohet brenda kufijëve ndërtimorë të përcaktuar me këtë PZHK, si dhe në parcelat e përcaktuara me Hartën Zonale të Komunës, e cila duhet të hartohet pas miratimit të këtij PZHK. Destinimi i sipërfaqeve me HZK për nevoja të infrastrukturës për zhvillimin e turizmit natyror dhe kulturor do të bëhet në përputhje të plotë me kërkesat e Ligjit nr.03/l-098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural, Ligjit nr. 02/l-26 për Tokën Bujqësore si dhe Ligjit nr. 2003/3 për Pyjet e Kosovës.

### Zejtaria

Në PZHK 2010-2020+ zejtaria është trajtuar si një fushë e cila vazhdon të mbetet e rëndësishme për zhvillimin ekonomik në komunën e Vitisë, gjendja aktuale në terren dëshmon se ky sektor nuk është i zhvilluar në nivelin e pritshëm, ndërsa edhe interesimi për të është gjithnjë në rënje. Me Strategjinë e Integruar për Zhvillim të Qëndrueshëm Ekonomik në komunën e Vitisë, hartimi i së cilës është paraparë më këtë PZHK do të analizohen detajisht mundësitë reale dhe masat e nevojshme për zhvillimin e këtij sektori.

### Shërbimet

Përkrahja e sektorit të shërbimeve, edhe duke fuqizuar ndërmarrjet ekzistuese përmes politikave lehtësuese fiskale si dhe politikave tjera stimuluese, por edhe duke përkrahur krijimin e ndërmarrjeve të reja dhe shtimin e punësimit do të ndikojë që ky sektor të vazhdojë të jetë ndër shtyllat kryesore të zhvillimit ekonomik të komunës. Zhvillimi i sektorëve tjerë ekonomik në mënyrë të integruar me atë të shërbimeve, në mënyrë që të gjithë sektorët të zhvillohen në atë mënyrë që të kenë impakt pozitiv tek sektorët tjerë të ndërlidhur, do të sigurojë një zhvillim më të balancuar mes sektorëve ekonomik. Ndërsa zhvillimi dhe fuqizimi i më tutjeshëm i sektorit të shërbimeve do të mundësojë edhe zhvillimin e më tutjeshëm të sistemit bankar, qoftë për shkak të rritjes së nevojës për kredi për investime në këto sektore, qoftë për shkak të rritjes së nevojave dhe kërkesave për pagesa dhe transaksione.

Politikat fiskale si dhe masat tjera lehtësuese për biznes, bashkë me instrumentet për përkrahjen e bizneseve të reja dhe shtimit të punësimit në sektorin e shërbimeve do të analizohen dhe planifikohen detajisht në Strategjinë e Integruar për Zhvillim të Qëndrueshëm Ekonomik në komunën e Vitisë, hartimi i së cilës është paraparë më këtë PZHK.

Zhvillimi dhe fuqizimi i mëtutjeshëm i shërbimeve, sidomos në zonat ku parashihet zhvillim më i madh i turizmit, por edhe në dy nënqendrat e reja në Pozharan dhe Skifteraj, ndër të tjera do të ndihmojë edhe në zbutjen e pabarazisë së zhvillimit ekonomik në terma të shpërndarjes jo të barabartë të kapitalit dhe koncentrimit të aktiviteteve ekonomike. Për shfrytëzimin e potencialit të shërbimeve shih Hartën e Planit të Zhvillimit Ekonomik në Komunën e Vitisë.

### Pasuritë Nëntokësore

Bazën e zhvillimit industrial në komunën e Vitisë do ta përbëjnë Industria e Lehtë, Industria Bujqësore dhe Përpunuese, industria ushqimore dhe potencialisht industria e materialeve ndërtimore. Ndërsa sa i përket pasurive nëntokësore, rekomandohet studim i fizibilitetit për orientim nga përpunimi i metaloideve, sidomos të bentonitit. Pavarësisht kësaj, duke u bazuar në Planin Zhvillimor Komunal 2010-2020+, ky plan parasheh implementimin e masave konkrete për mbrojtjen e resurseve natyrore, përfshirë edhe pasuritë minerale.




Harta 37 Plani i Zhvillimit Ekonomik

## *4.3.3.2. Infrastruktura Teknike*

Përkundër investimeve të mëdha që janë bërë në përmirësimin e infrastrukturës teknike, sidomos në asfaltimin e rrugëve, ndërtimin e sistemit të ujësjellësit dhe kanalizimit, mirëmbajtjen e rrjetit të energjisë elektrike dhe telekomunikimit, ka endë hapësirë për të planifikuar zgjërimin dhe avancimin këtyre shëbimeve të cilat ndikojnë drejtëpërdrejt në përmirësimin e kualitetit të jetës së qytetarëve dhe ndihmojnë në zhvillimin ekonomik të komunës. Për të arritur objektivat e parapara në realizimin e synimeve është e nevojshme që të bëhen investime direkte në infrastrukturë teknike si në vijim.

### Infrastruktura e ujësjellësit

Shtrirja e rrjetit të ujësjellësit në territorin e komunës së Vitisë ka shënuar zgjërim të konsiderueshëm përmes të cilit mbi 92% e qytetarëve të komunës kanë qasje në shërbimet e furnizimit me ujë të pijës. Mirëpo është shumë me rendësi të përmendim se furnizimi me ujë nuk është i knaqshëm, pasiqë shumica e vendbanime të zonës fushore i nënshtrohen reduktimeve të ashpra, si pasojë e mungesës së kapaciteteve furnizuese, humbjes së ujit gjatë rrugës, si pasojë e rrjetit jo të mirë të ujësjellësit. Prandaj, për të përmirësuar kualitetin e

shërbimeve të furnizimit me ujë është me rendësi të investohet në ngritjen e kapaciteteve furnizuese, nga kaptazhi i ujit deri tek fabrika e ujit në Letnicë. Kjo bëhet e mundur duke bërë ndrrimin e gypit kryesorë me një gyp të rri me kapacitet më të madh furnizues. Gjithashtu duhet të përcillen zhvillimet hapësinore në zonat e banuara duke ofruar rrjetin e ujësjellësit në secilen pjesë të zonave të banuara.

Për të përmbushur kërkesat e qytetarëve dhe për të kompletua shtrirjen e rrjetës së furnizimit me ujë të pijës, për vendbanimet të cilat nuk mund të kyqen në rrejeten aktuale të furnizimit me ujë nga sistemi i furnizimit actual, është e nevojshme që në vendbanimet periferike të komunës të ngriten kapacitete individuale të furnizimit me ujë përmes shfrytëzimit të burimeve në zonat malore të vendbanimeve si: Balancë, Stubëll e Poshtme dhe e Epërme, Goden, Vërnakollë, Vrenez, Shashare, Lubishtë, Buzovikë, Debëllde dhe Mjak.

Me qëllim që përcielljës së kualitetit të ujit të pijës duhet që në bashkëpunim me ISHPK-në, të bëhet monitorimi i kualitetit të ujit në bazë ditore, javore ose mujore.

Me qëllim të përmirësimit të furnizimit me ujë dhe kontrollit të shpenzimit të ujit është me rendësi që të vendosen ujëmatë të modelit SMART për të gjithë shfrytëzuesit, si dhe të sanksionohen rigorozitet të gjitha kyqjet ilegale.

**Rrjeti i planifikuar për ujërave të zeza**

Shkalla e ulët e qasjes së qytetaëve në rrjeten sekondare të kanalizimit (rreth 40% në nivel komune) dhe mungesa e kolektorit kryesor, tregojnë për nevojen e rritjes së investimeve në këtë fushë me qëllim që të përmirësohet kualiteti i jetës së qytetarëve, me theks të veqant atyre që jetojnë në viset rurale. Rrjeti i kanalizimit në territorin e komunës mbetet problem i pazgjidhur, jo për faktin se nuk është punuar në zgjërimin e rrjetit sekondar në disa vendbanime, por për arsye të mungesë së kolektorit kryesor dhe impiantit për trajtimin e ujrave të zeza. Në këtë pjesë problematike e trajtimit të ujrave të zeza mbetet: ndërtimi i kolektorit kryesor përgjatë rjedhës së lumit Morava, zgjërimi i rrjetit të kanalizimit në vendanimet periferike të komunës, dhe lidhja e kolektorit kryesor me impiantin e trajtimit të ujrave të zeza në nivel regjional (territorin e komunës së Kaçanikut). Për vendbanimet në të cilat konfiguracioni i terrenit nuk lejon qasje ne kolektorin kryesor duhet të ndërtohen gropa septike, sipas standardeve të aplikuara ndërkombëtare.

Për të përmbushur kërkesat e qytetarëve dhe përmirësimin e kualitetit të jetës së tyre, duke iu krijuar qasje në rrjetin e kanalizimit për të gjithë, është e nevojshme që të ndërrmerren disa veprime konkrete në ndërtimin dhe përmirësimin e infrastrukturës së kanalizimit. Kjo do të arrihet nese ndërmerren këto veprime:

- Ndërtimi i kolektorit kryesor për ujrat e zeza, i cili do të ketë shtrirje VL – JP përgjat rrjedhës së lumit Morava (16.5km gjatësi në territorin e komunës së Vitisë). Kjo do të mundësoj mbledhjen e mi 90% të ujrave të zeza në nivel komune duke iu dhënë drejtimin e impiantit për trajtimin e ujrave të zeza i cili është planifikuar të ndërtohet me PHK, në territorin e komunës së Kaçanikut).
- Ndërtimin e rrjetit primar dhe sekondar për ujra të zeza, i cili bënë lidhjen e rrjetit sekondar me kolektorin kryesor, për vendbanimet: Viti, Pozhaoran, Ramjan, Sllatine, Drobesh, Begunce, Rimanisht, Podgorc, Kabash, Binq, Gjylekar, Vërboc, Budrike, Remnik, Radivojcë, Devajë, Çifllak, Sllatinë, Sadovine e Çerkezve, Sadovine e Jerlive, Gërmovë, Smire, Gushincë, Verban, Podgoc, Zhiti dhe Terpeze. Totali i gjatësisë së rrjetit sekondar I cili I lidhe vendbanimet me kolektorin kryesore është rreth 48 km.
- Shtrirja e rrjetit sekondar dhe ndertimi i gropave septike për vendbanimet: Stubell e Poshtme, Goden i Madh, Stubell e Eperme, Vrenez, Vernakolle, Letnice, Shashare, Lubizhde, Buzovik, Debelldeh, Mjak dhe Korbliq. Gjithësejtë gropa septike që planfikohen të ndërtohen jane 12.




<u>Harta 38 Plani i Ujësjellësit dhe Kanalizimit</u>

## Energjia elektrike

Në komunën e Vitisë rrjeti elektrik është i shtrirë në të gjithë hapësiren e komunës, prandaj edhe konstatohet se të gjitha aktivitetet sociale dhe ekonomke kanë qasje në rrjetin e furnizimim me EE. Por, është e rendësihsme që të punohet në përmisimin e rrjetit dhe forcimin e kapacteteve shprendarëse në të gjithë hapësiren gjeografike të komunës, me theks të veçant në vendbanimet e thella malore. Kjo propozohet të bëhet në dy mënyra, duke bërë:

- Investime në rrjetin shprendarës (shtylla elektrike dhe lartëpërques) dhe
- Avandcimin e kapaciteteve të trafostacioneve (konform kërkesës nga zhvillimet sociale dhe ekonomike).




Harta 39 Harta e planit të Energjisë Elektrike

## Grumbullimi i Mbeturinave

Në komunën e Vitisë mbledhja e mbeurinave ka nje itinerar të rregull i cili është i shtrirë në baza javore, duke përfshirë edhe vendbanimet e mëdha ku mbeturinat mblidhen edhe dy here ne jave. Ndërsa, në zonën urbane të Vitisë itinerari i mbledhjës së mbeturinave është në baza ditore. Nga të dhënat e vlerësimit të gjendjes kuptojmë që mbi 97% e popullsisë së komunës kanë qasje në sistemin e grumbullimit të mbeturinave, përfshirë këtu edhe të gjitha bizneset dhe institucionet. Vendbanimet të cilat nuk janë përfshirë në sistemin e mbledhjës së mbeturinave janë: Buzoviku, Debelldeh, Goden i Madh, Letnicë, Mjak, Shashare, Vërnakollë dhe Vrenez. Të gjitha së bashku kanë popullësi në 3% në nivel të komunës.

Përkundër organizimit të mirë të sistemit dhe itinerarit që përmbushë kërkesat e qytetarëve të vitisë është planifikuar që në vendbanimet të cilat nuk janë pjesë e sistemit të mbledhjës së mbeturinave, të bëhet mbledhja e mbeturinave në itinerarë dy herë në muaj.

Gjithashtu është planifikuar që të bëhet edhe caktimi i lokacionit për grumbullimin e mbeturinave si vijon:

1. Pikë transferuese e mbeturinave të përditëshme
2. Pikë grumbullimi e mbeturinave inerte

#### 4.3.3.3. *Infrastruktura e Transportit dhe Transporti*

Përkundër investimeve të vazhdueshme në infrastrukturën rrugore e cila mbulon qasjen në rrugë të asfaltuara të mbi 95% të qytetarëve është e nevojshme të vazhdohet me investime në rrugë të reja dhe në mirëmbajtjen e atyre egzistuese, me qëllim që të përmirësohet kualiteti i jetës së qytetarëve. Në funksion të zhvillimit të infrastrukturës rrugore dhe lehtësimit të qasjës në rrugë për të gjithë qytetarët dhe aktivitetet ekonomike në tërë territorin e komunës së Vitisë është e nevojshme që të investohet në projekte të reja për hapjen e traseve të rrugëve, asfaltimin e traseve egzistuese, ndërtimin e trotuareve dhe mirëmbajtjen e rrugëve në të gjitha kategoritë e rrugëve. Bazuar në gjendjen ekzistuese, vizionin dhe qëllimet e përcaktuara në këtë dokument, kërkohet që të kemi një mbulueshmeri të mjaftueshme hapësinore me infrastrukturë rrugore, plotësimin e nevojave për popullsinë dhe ekonominë në tërë territorin e komunës. Planifikimi i infrastrukturës teknike në komunën e Vitisë do të jetë i bazuar në:

- Hapjen e traseve të reja në kategorinë e rrugëve regjionale dhe nacionale
- Asfaltimin e rrugëve lokale që lidhin vendbanimet përiferike dhe hapësirat brenda zonave të banuara
- Rregullimin e trotuareve përgjatë rrugëve kryesore në zonat e banuara
- Ndërtimin dhe riparimin e urave në rrugët locale
- Ndëtimin i rrethrrotullimeve në rrugët të gjitha katgoritë e rrugëve
- Ndërtimin e mureve mbrojtëse në rrugët regjionale, për mbrojtje nga zhurma në hapërsirat e banuara
- Rregullimi i sinjalistikës rrugore në të gjitha kategoritë e rrugëve




Harta 40 Plani i Infrastrukturës së Transportit

**Rrugë regjionale -** Në kategorinë e rrugëve nacionale është e nevojshme që të hapet traseja e cila do të mundësonte lidhjen e infrastrukturës rrugore të komunës me autostraden Arbër Xhaferi. Kjo do të realizohet duke shfrytëzuar trasene (zgjërimi i rrugës) egzistuese të rrugës lokale e cila ka shtrirje hapësionre Viti-Drobesh-Gërmovë-Sudovinë e Jerlive (6km), pastaj kalon në territorin e komunës së Kaçanikut, drejtimi i Gërlicës. Ky projekt është i karakterit nacional dhe duhet të realizohet në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastruktuës. Gjatësia totale e kësaj traseje është 13km (Viti-Gërlicë). Në kuadër të ndërtimit të kësaj traseje rrugore duhet të ndërtohen edhe 3 rrethrrotullime (2 në zonën kadastrale të Vitisë dhe 1 në vendbanimin e Drobeshit). Gjithashtu në kategorinë e rrugëve nacionale duhet të investohet në hapjen e trasesë së rrugës nacionale në drejtim të pikës kufitare në Debëllde.

**Rrugë lokale -** Në kategorinë e rrugëve lokale është e nevojshme që të investohet në asfaltimin e rrugëve që lidhin vendbanimet periferike, si dhe të asfaltohen rrugët që lidhin lagjet e caktuara brenda zonave të banuaa. Me qëllim të lehtësimit të qarkullimit është e nevojshme që të ndërtohen 26 rrethrrotullime në vendbanimet (*Viti (2), Rimanishtë (1), Kabash (1), Binqë (1), Simirë (3), Verban (2), Mogille (2), Verboc (4), Gërncar (1), Remnik (1), Budrigë (1), Balance (1), Terpezë (2), Novosellë (1)). Për të lehtësuar dhe siguruar qarkullimin me standard të komunikacionit rrugorë është e nevojshme që të ndërtohen edhe 8 ura të reja, si në vendbanimet: viti (1), Binqë (2), Smirë (1), Gërmovë (1), Gushincë (1), Sllatinë (1).*

**Transporti** - Duke pasur parasysh që zona urbane e Vitisë, shtrihet ne largesi të ndryshme nga vendbanimet periferike të komunës (nga 2 deri 16 km), është e nevojshmë që transporti i udhëtarëve të organizohet në

funksion të lehtësimit për qarkullimin e qytetarëve. Prandaj, propozohet që në trekendëshin e zhvillimit policentrikë të organizohet transporti në dy nivele: Transporti ndërurban dhe lokal.

- Stacioni i autobuseve të rregullohet sipas standardeve dhe të paiset me pajisje të TI të kohës.
- Të ndërtohen stacionet e vendnaljes së autobusëve për linjat ndërurbane dhe lokale të tipit SMART station (stacione të menqura).
- Të gjithë autobusët e linjave urbane dhe lokale të jenë të paisur me GPS.
- Transporti ndër urban do të përfshijë zonen urbane të Vitisë, vendbanimin e Pozharanit dhe vendbanimin e Gjylekar-it (Skifterajt). Kjo linjë do të ketë gjatësi maksimale 24 kilometer, dhe do te mbulohet nga dy autobus urban të cilët do të kenë itinerar levizeje çdo 60 minuta, me diferencë të nisjes ndermjet 30 minuta. Orari i qarkullimit teë nisjes ndermjet 30 minuta. Orari i qarkullimit te linje do të jetë nga ora 6:30 deri 20:00. Në zonën ubane do të jenë gjithësejtë 10 vendndalime të autobusëve.
- Transorti lokal do të mbulohet nga 8 operator të cilet do të mbulojnë të gjitha vendbanimet lokale, varësishtë nga distanca. Itinerari i levizjës do të jetë nga 60 deri 120 minura, varësishtë nga distanca e vendbanimit. Orari i qarkullimit te linje do të jetë nga ora 6:30 deri 20:00. Të gjitha linjat lokale do të kenë piknisje stacionin e autobusëve në Viti, si në tabelën në vijim:

Tabela 112 Vendbanimet sipas transporti lokal

| Nr. | Vendbanimi | Nr. i pop. | Qasje | Drejtimi | Distanca/km | Itinerari(minuta) |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Ballancë | 643 | Me tran. publik | Viti - Bllacë | 10.4 | 60 |
| 2 | Beguncë | 2174 | Pa tran. publik | | 4.6 | 30 |
| 3 | Binçë | 1149 | Pa tran. publik | | 3.6 | 30 |
| 4 | Budrikë e Epërme | 915 | Me tran. publik | Viti-Remnik | 10.2 | 30 |
| 5 | Buzovik | 531 | Pa tran. publik | | 6.4 | 60 |
| 6 | Çifllak | 92 | Pa tran. publik | | 7.2 | 60 |
| 7 | Debelldeh | 346 | Pa tran. publik | | 11.1 | 180 |
| 8 | Devajë | 298 | Me tran. publik | Devajë - Viti | 10 | 180 |
| 9 | Drobesh | 1880 | Me tran. publik | Smirë - Viti - Remnik i Ri | 2.3 | 30 |
| 10 | Gërmovë | 903 | Me tran. publik | Verban - Viti - Remniku i ri | 3.7 | 30 |
| 11 | Goden i Madh | 82 | Pa tran. publik | | 13 | 180 |
| 12 | Gushicë | 817 | Me tran. publik | Gushicë - Viti | 6.9 | 60 |
| 13 | Gjylekar | 2547 | Me tran. publik | Gjylekar - Viti | 8.7 | 60 |
| 14 | Kabash | 2369 | Pa tran. publik | | 2.8 | 30 |
| 15 | Letnicë | 272 | Pa tran. publik | | 12.4 | 120 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 16 | Lubishtë | 1473 | Pa tran. publik | | 8.5 | 60 |
| 17 | Mjak | 0 | Pa tran. publik | | 15.1 | 180 |
| 18 | Novosellë | 557 | Me tran. publik | Sudovinë - Viti | 9 | 60 |
| 19 | Podgorc | 386 | Pa tran. publik | | 6.8 | 60 |
| 20 | Pozharan | 4329 | Me tran. publik | Terstenik - Viti & Sudovinë - Viti | 6.2 | 60 |
| 21 | Radivojc | 1269 | Me tran. publik | Devajë – Viti - Remnik | 8 | 60 |
| 22 | Ramjan | 912 | Me tran. publik | Sudovinë Ç - Viti | 9.6 | 60 |
| 23 | Ramnishtë | 446 | Me tran. publik | Gjylekar - Viti | 3.4 | 30 |
| 24 | Remnik | 1880 | Me tran. publik | Viti - Remnik - Remnik i ri- Viti | 14 | 180 |
| 25 | Sadovinë e Çerkezve | 1286 | Me tran. publik | Terstenik - Viti - Sudovine e Ç. | 9 | 60 |
| 26 | Sadovinë e Jerlive | 1122 | Me tran. publik | Sudovine e Ç.- Viti - Verban - Remnik i Ri - Viti | 5.5 | 60 |
| 27 | Sllatinë e Epërme | 2362 | Me tran. publik | Terstenik - Viti - Sudovine e Ç. | 10.6 | 60 |
| 28 | Sllatinë e Poshtme | 1200 | Me tran. publik | Terstenik - Viti | 9.4 | 60 |
| 29 | Smirë | 3947 | Me tran. publik | Smirë – Viti - Remniku i Ri | 5.1 | 30 |
| 30 | Stubëll e Epërme | 1150 | Pa tran. publik | | 11.8 | 120 |
| 31 | Stubëll e Poshtme | 78 | Pa tran. publik | | 13.3 | 120 |
| 32 | Shashare | 149 | Pa tran. publik | | 9 | 60 |
| 33 | Tërpezë | 1853 | Me tran. publik | Viti - Tërpezë | 9.2 | 60 |
| 34 | Tërstenik | 784 | Me tran. publik | Terstenik - Viti | 10 | 60 |
| 35 | Vërban | 2047 | Me tran. publik | Gjylekar - Viti | 8.7 | 60 |
| 36 | Vërnakollë | 13 | Pa tran. publik | | 14.1 | 120 |
| 37 | Vërnez | 1 | Pa tran. publik | | 14.5 | 120 |
| 38 | Viti | 5019 | Me tran. publik | | 0 | 30 |
| 39 | Zhiti | 615 | Me tran. publik | Viti - Ballancë | 9.4 | 60 |
| **Popullsi** | | **47896** | **Distanca mesatare** | | **8.55 km** | |




Harta 41 Plani i Transportit Urban-Rural

### *4.3.3.4. Infrastruktura publike e planifikuar*

Përmirësimi i infrastrukturës publike ndikon në përmirësimin e cilësisë së jetës për qytetarët që jetojnë në atë zonë. Kjo arrihet me përmirësimin e infrastrukturës përmes ofrimit të shërbimeve më cilësore dhe qasjes më të lehtë në objekte. Bazuar në gjendjen ekzistuese, vizionin dhe qëllimet e përcaktuara në këtë dokument, kërkohet që të kemi një mbulueshmeri të mjaftueshme hapësinore me infrastrukturë publike, plotësimin e nevojave për popullsinë në tërë territorin e komunës. Planifikimi i infrastrukturës publike në komunën e Vitisë do të jetë i bazuar në:

- Përmirësimi i shërbimeve në të gjitha vendbanimet përmes rehabilitimit të objekteve ekzistuese apo ndërtimit të objekteve të reja
- Sshtrirja e balancuar e shërbimeve në tërë territorin e komunës
- Nxitja dhe promovimi i aktiviteteve që ndikojnë në përmirësimin e shërbimeve publike.

Në periudhën e zbatimit të planit, duhet të monitorohet zhvillimi hapësinor dhe demografik i secilit vendbanim dhe struktura e moshës së popullatës, dhe në përputhje me këtë dhe funksionet e tyre themelore, të sigurohen shërbimet e nevojshme publike.

**Institucionet arsimore**

Sa i pëtrket shërbimeve arsimore, gjendja është relativisht e mirë dhe në të ardhmen synohet të arrihet qëllimi që ka të bëjë me përmirësimin e infrastrukturës dhe cilësisë në arsim.

Për ta siguruar hapësirën e nevojshme me objekte parashkollore – çerdhe, kërkohet që të ndërtohen objekte të reja për ti plotësuar kërkesat. Aktualisht kemi vetëm dy çerdhe në qytetin e Vitisë, një publike dhe një private të cilat nuk i plotësojn nevojat e zonës urbane. Për të ardhmen parashihet edhe 9 objekte të tjera për çerdhe në komunën e Vitisë. Çerdhet janë planifikuar në: Viti, Pozharan, Smirë, Gjylekar, Kabash, Sllatinë e Epërme, Drobesh, Ramnisht dhe Stubëll e Epërme. Në këtë drejtim do të inkurajohen edhe investime nga sektori privat në sigurimin e këtij shërbimi në bashkëpunim me komunën.

Në Pozharan është funksionalizuar objekti dhe pritet të filloj së shpejti çerdhja. Në Sllatinë të Epërme, ambulanca e re është lëshuar në funksion dhe objekti i ambulancës së vjetër të rregullohet dhe të përdoret për çerdhe. Në fshatin ballancë të bëhet një paralele për parashkollor.

Sa i përket arsimit parafillor, ky nivel i shkollimit është i organizuar në hapësirat ekzistuese të shkollave fillore të mesme të ulëta. Në të ardhmen kërkohet që të rishikohet kjo hapësir për shkollimin parafillor dhe të plotësohet hapsira shkollore sipas nevojave që kërkohet për këtë nivel të shkollimit.

Në nivelin e arsimit fillor dhe të mesëm të ulët planifikohet zgjërimi i hapësirave të objekteve shkollore në: Binç, Sadovinë e Jerlive, Smirë, Tërpezë dhe Vërban. Për zgjerimin e hapësirës së shkollës fillore në Smirë, planifikohet pastrimi i parcelës që gjendet afër me parcelën e shkollës fillore dhe zgjerimi i hapësirës së shkollës të bëhet në drejtim të kësaj parcele. Kjo parcelë është pronë private

Në nivelin e arsimit të mesëm të lartë është planifikuar ndërtimi i objektit të Shkollës Profesionale Bujqësore. Kjo shkollë është e planifikuar edhe me Planin Urban të Vitisë ku është e përcaktuar edhe parcela për ndërtim.

Gjatë përmirësimit të infrastrukturës shkollore është me rëndësi që të intervenohet edhe në hapësirat përcjellëse të shkollave me rregullimin e oborreve, parqe dhe hapësira rekreative dhe sportive.

**Institucionet shëndetësore dhe të përkujdesjes sociale**

Objektet shëndetësore në komunën e Vitisë kanë një shtrirje të mirë hapësinore dhe gjithashtu ka edhe infrastrukturë dhe hapësirë të mjaftueshme. Në të ardhmen si qëllim parashihet të arrihet ngritja e nivelit të shërbimeve shëndetësore duke synuar: përmirësimin e shërbimeve shëndetësore, sigurimin e paisjeve dhe mjeteve bashëkohore në shëndetësi si dhe stimulimin e mjekëve për të shërbyer edhe në vendbanimet më periferike.

Gjendja jo e mirë fizike është në QKMF Viti dhe planifikohet të bëhet një vlerësim i gjendjes dhe renovimi i tij.

Në vendbanimin Zhiti ambulantat nuk është funksionale dhe kërkohet të funksionalizohet.

Në ambulancat ku nuk ka mjek të organizohet shërbimi

Ambulanta në Skifteraj të shëndërrohet në QMF.

**Administrata publike**

Hapësira për shërbime administrative në komunën e Vitisë është e mjaftueshme por ajo është e koncentruar kryesisht në qytetin e Vitisë. Në të ardhmen kërkohet që të ofrohen shërbime administrative edhe në vendbanimet Pozharan dhe Skifteraj si dy qendra që do të zhvillohen në të ardhmen.

Në aspekt të përmirësimit të shërbimeve, parashihet avancimi i sistemit elektronik në ofrimin e shërbimeve për qytetarë.

### *4.3.3.5. Infrastruktura Sociale e Planifikuar*

**Ndërtesat kulturore**

Bazuar në të dhënat ekzistuese si dhe vlerësimin e gjendjes për ndërtesat kulturore, në komunën e Vitisë kemi munges të hapësirave dhe ndërtesave kulturore. Në qytetin e Vitisë gjendet shtëpia e kulturës që shërben për aktivitete të ndryshme kulturore dhe rinore. Ky është objekti i vetëm kulturor në këtë komunë. Për përmirësimin e gjendjes për ndërtesa dhe hapësira të kulturës, si dhe promovimin e aktiviteteve kulturore e artistike planifikohet të arrihen objektiva si: O*frimi i objekteve të reja të kulturës dhe artit për të gjithë banorët e komunës së Vitisë; si dhe promovimin e aktiviteteve kulturore.*

Propozohen të ndërtohen tri qendra kulturore në Vendbanimet: Pozharan, Skifteraj dhe Smirë. Lokacioni për ndërtimin e Qendrës kulturore në fshatin Smirë është propozuar të jetë në përfundim të rrugës së Shkupit.

**Bibliotekat**

Komuna e Vitisë ka bibloteka në qytetin e Vitisë, Pozharan dhe Sllatinë e epërme. Hapësirat e bibliotekave janë të pa mjaftueshme dhe sipas normave teknike kërkohet që në të ardhmen të kemi hapësira shtes për biblioteka dhe ato hapësira të mos jenë koncentruara vetën në zonën urbane por edhe në vendbanime të tjera rurale e sidomos në vendbanimet më të mëdha.

Parashihet që të ndërtohet një bibliotekë në fshatin Pozharan dhe Stubëll e Epërme.




Harta 42 Plani i Hapësirave Publike/Scoiale

## Ndërtesat dhe hapësirat sportive

Komuna e Vitisë ka 17 klube sportive që e zhvillojnë aktivitetin e tyre në 16 fusha sportive. Fushat sportive të mbuluara janë 10 dhe 6 të tjera janë hapësira sportive të hapura. Hapësirat dhe ndërtesat aktuale sportive në komunën e Vitisë nuk i plotësojnë kërkesat sipas vlerësimit të gjendjes ekzizstuese si dhe normave teknike.

Për përmirësimin e gjendjes sa i përket ndërtesave dhe fushave sportive, kërkohet që në të ardhmen deri në vitin 2030 të krijohen hapësira të reja sportive në disa vendbanime të komunës si: Beguncë, Binçë, Gjylekar, Kabash, Lubishtë, Radivojc, Remnik, Sadovinë e Qerkezve, Sllatinë e Epërme, Sllatinë e Poshtme, Smirë, Tërpezë, Vërban, Stubëll e Epërme. Për fshatin Drobesh parashihet të përfundohet palestra sportive.

Kur jemi te hapësirat sportive, në këtë plan parashihen edhe hapësira të reja sportive nëpër shkolla të ndryshme të komunës së Vitisë dhe kjo do të ofroj mundësi të mira për zhvillimin e aktiviteteve sportive në shkolla. Hapësira të reja sportive që parashihen nëpër shkolla janë:

- Në fshatin Qifllak parashihet një fushë sportive afër shkollës
- Ndërtimin e sallës së sportit për shkollën “Bafti Haxhiu” në Viti
- Ndërtimin e sallës së mbyllur spotive për shkollën fillore “Dom Mikel Tarabulluzi” në Stubëll të Epërme.




Harta 43 Plani i Hapësirave Sporitve

**Hapësirat e Gjelbërta dhe Parqet publike**

Bazuar në gjendjen ekzistuese, komuna e Vitisë ka mjaft hapësira të gjelbërta dhe parqe publike. Sipas vlerësimit të gjendjes dhe bazuar në normat teknike, hapësirat e gjelbërta dhe parqet publike janë të mjaftueshme. Megjithate, në të ardhmen ka nevojë edhe disa hapësira të reja në vendbanimet e komunës. Planifikohet që në të ardhmen të kemi hapësira të reja të gjelbërta dhe parqe publike si:

- Në fshatin Pozharan të rregullohet një shesh dhe një park
- Në fshatin Ramjan të zyrtarizohet Blini Park
- Në fshatin Skifteraj një park
- Në Smirë një park
- Në Drobesh një shesh dhe një park
- Në Gërmovë një sheshë dhe një Park
- Në qendrën e fshatit Sadovinë e Jerlive të ndërtohet një park afer memorialit si dhe të rregullohet memoriali
- Hapësirë gjelbruese te sokolt - mes Vërbanit dhe Gushicës
- Staza e ecjes Vërban – Trena
- Hapësirë publike dhe park në fshatin Stubëll e Epërme

**Objektet Fetare dhe Varrezat Publike**

Gjatë analizës së sipërfaqeve kadastrale për kokë banori në numrin e parashikuar për vitin 2030 për secilin vendbanim të komunës së Vitisë, del se hapësira ekzistuese e varrezave është e mjaftueshme edhe për periudhën e ardhme deri në vitin 2030. Poashtu, edhe objektet fetare janë të mjaftueshme per periudhën e ardhme deri në vitin 2030. Thuja se të gjitha vendbanimet e komunës kanë objekte fetare.

Për periudhën e ardhme deri në vitin 2030 është me rëndësi që të mirmbahen objektet fetare dhe hapësirat e varrezave. Poashtu në disa vendbanime kërkohet edhe zgjerim i hapësirave për varreza, ndërsa disa objekte fetare që janë të vjetra dhe konsiderohen pjesë e rëndësishme e trashegimisë kulturore tu kushtohet një kujdes i veçantë. Për objektet fetare dhe varrezat publike në të ardhmen kërkohet që:

- Të zgjerohet hapësira për varreza në fshatin Pozharan
- Të organizohet një mirëmbajtje më e mirë e varrezave në fshatin Smirë
- Zgjerimi i hapësirave për varreza në fshatin Sllatinë e Epërme - propozimi i ndonjë parcele të re pasi që hapësira për varreza në oborr të gjamisë tani nuk është e mjaftueshme
- Xhamia në fshatin Drobesh ka rëndësi në aspektin e trashëgimisë kulturore pasi është e vjetër dhe duhet të ruhet e mirmbahet




Harta 44 Plani i menaxhimit të varrezave

### 4.3.3.6. *Mbrojtja e mjedisit*

Duke konsideruar mbrojtjen e mjedisit jo vetëm problematikë ekologjike ose teknologjike, por edhe problematikë më e thellë dhe më e gjerë që shkon drejt dimensionit social e politik, planifikohet përcaktimi dhe implementimi i masave mbrojtëse përkatëse për amortizim të efekteve, mbrojtje ndaj ndotësve dhe kërcënuesëve të tjerë mjedisor, si dhe masa për zhvillim kualitativ mjedisor.

Vlerat natyrore të komunës si ato pyjore, ujore e bujqësore të cilat konsiderohen potenciale të rëndësishme, planifikohen të shfrytëzohen për zhvillim të turizmit.

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM) përcakton masa dhe veprime për zvogëlimin e ndikimit negativ në mjedis të zhvillimeve të parapara me PZHK të cilat janë të integruara në fushën e mbrojtjes së mjedisit.

**Mbrojtja e sipërfaqeve ujore**

Masat mbrojtëse për sipërfaqet ujore përcaktohen bazuar në UA. nr. 08/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor. Burimet e ujërave klasifikohen në burime nëntokësore dhe sipërfaqësore. Me qëllim të mbrojtjes se burimeve të ujerave përcaktohen zonat e mbrojtura ujore, të cilat ndahen në:

1. *Zona e mbrojtjes së regjimit të rreptë,* e cila ka për qellim të siguroj mbrojtjen e burimit të ujit dhe ndërtesave me instalime për marrjen e ujit si dhe të mbrojë burimin nga shkarkimet e ndotësve që mund të ndikojnë drejtpërdrejt në ujë nga aktivitetet e njeriut;

2. *Zona e mbrojtjes së regjimit të kufizuar*, e cila ka për qellim të sigurojë mbrojtjen e burimit të ujit nga lëvizjet e ndotësve mikrobiologjik, kimik dhe llojeve të tjera të ndotësve;
3. *Zona e mbrojtjes së regjimit të lehtë,* e cila ka për qellim të siguroj mbrojtjen parandaluese për pellgun përkatës të burimit të ujit dhe të rris efikasitetin e mbrojtjes nga ndotja kimike dhe radioaktive.

Ndër të tjera është parashikuar si vijon:

- Të gjitha burimet e ujërave natyrale,termale dhe termo - minerale dhe ujërave tjerë nëntokësorë dhe sipërfaqësor të mbrohen siç shihet në hartën hidrologjike të komunës së Vitisë, bashkë me caktimin e zonës së mbrojtjes së obligueshme rreth burimeve, kaptazheve, rrjedhave të lumenjve dhe akumulacioneve, me regjim të caktuar të mbrojtjes, varësisht nga destinimi i objektit. Në këto zona nuk mund të ndërtohen objekte e të zhvillohen punime tjera, as të shfrytëzohet toka në mënyrën e cila rrezikon sasinë dhe kualitetin e ujit;
- Merren masat për mos lejimin e ndotjes së lumenjve, ujërave nëntokësore dhe sipërfaqësore nga ujërave të përdorura dhe ndyta prej vendbanimeve duke rekomanduar trajtim në dalje me gropa septike dhe forma tjera vendosja e aparateve për pastrim deri te impianti;
- Merren masat për mos lejimin e ndotjes së lumenjve, ujërave nëntokësore dhe sipërfaqësore nga ujërave të përdorura dhe ndyta prej kapaciteteve industriale duke përfshirë edhe VINEKS-in duke montuar dhe kompletuar aparate pastrimi të ujërave të përdorura.
- Në të ardhmen është e domosdoshme të merren masa afatshkurtra dhe afatgjatë që ujërat e përdorura, ndyta (urbane, industriale) para se të lëshohen, të pastrohen në pikëpamje fizike biologjike dhe kimike. Për ketë qellim, është e nevojshme.
- Dokumentacioni investivo-teknik për industritë e reja duhet të përmbajë edhe vendimin e pastrimit të të gjitha ujërave të përdorura, ndyta. Puna e kapaciteteve të reja industriale nuk duhet të lejohet pa u montuar më parë aparatet të cilat do të sigurojnë pastrimin e ujërave të ndyta në mënyrën e duhur.
- Sigurimi i sasisë së nevojshme të ujit të shendosh të pijes për popullsinë e kësaj komune. Pos kësaj shfrytëzimi racional i ujërave në ketë komunë, është detyrë me rëndësi e të gjithë faktorëve të planifikimit dhe të shfrytëzimit të ujit dhe hapësirës.
- Parashihet mbrojtja e veçantë për burimet gurrën e Binçës, gurrën e Letnices, gurrat e Terpezes e të Shoshares në komunën e Vitisë; Për rrjedhat e epërme të terreneve të Golemarekes, të lumit të Letnices, lumi Uji i Mirë dhe lumi i Mullajve në fshatin Gushicë.

### Mbrojtja e ajrit

Sipas ligjit nr. 03/L-160 për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja, komuna në bashkëpunim me MMPHI duhet të bëjë kontrollimin e vazhdueshëm të emetimeve të pluhurit dhe tymit nga ndotësit kryesor të ajrit në komunë. Planifikohet krijimi i brezave të gjelbër përgjatë rrugëve kryesore dhe rrjedhave të lumenjëve, me qëllim të amortizimit të ndotjes nga pluhuri, gazrat dhe zhurma.

### Mbrojtja e tokës bujqësore

Toka bujqësore, si vlerë e çmuar për zhvillimin ekonomik të komunës së Vitisë duhet të mbrohet nga degradimi, erozioni e fragmentimi me masat mbrojtëse të përcaktuara me ligjin nr. 02/L-26 për Tokën Bujqësore dhe me UA nr. 08/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor.

**Mbrojtja e pyjeve**

Duke marrë parasysh përqindjen e madhe të sipërfaqeve pyjore në komunë, pylltaria konsiderohet si potencial shumë i mirë për zhvillimin ekonomik të komunës. Kështu, mbrojtja e këytre sipërfaqeve planifikohet të bëhet konform ligjit nr. 03/L-153 për Pyjet e Kosovës dhe aktet nënligjore relevante, si dhe UA nr. 08/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor.

Mbrojtja dhe rregullimi i tokës pyjore bëhet nëpërmjet formave si në vijim:

1. Mbrojtja e tokës pyjore nga shpyllëzimi- prerja e të gjitha bimëve pyjore dhe më pas përdorimi i kësaj toke për shfrytëzime të tjera jo-pyjore;
2. Mbrojtja dhe rregullimi i tokës pyjore nëpërmjet pyllëzimit- krijimi i një pylli apo të një grumbulli të bimëve pyjore (ekskluzivisht autoktone) në një tokë ku nuk kishte pyll;
3. Mbrojtja dhe rregullimi i tokës pyjore nëpërmjet ripyllëzimit- rivendosja e mbulesës pyjore (ekskluzivisht autoktone), në forme të natyrshme (nëpërmjet mbjelljes natyrore, nëpërmjet kthimit të pyjeve cungishte në trungishte) ose në forme artificiale (nëpërmjet mbjelljes së drejtpërdrejtë të bimës dhe farës).

**Mbrojtja nga fatkeqësitë natyrore dhe të tjera**

Duke konsideruar rreziqet e mëdha që paraqiten në sipërfaqe të ndryshme të komunës për shkak të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera, për menaxhimin e këtyre fatkeqësive, parandalimin e tyre dhe zvogëlimin e numrit të viktimave dhe pasojave tjera në natyrë, planifikohet zbatimi i masave mbrojtëse të përcaktuara me ligjin nr. 04/L-027 për Mbrojtjen nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera.

**Mbrojtja nga Erozioni**

Me qëllim të parandalimit të aktivitetit eroziv, parashikohet të ndërmerren hapa konkret dhe të menjëhershëm, siç janë:

1. Ndalimi i prerjeve dhe degradimi i pyjeve.
2. Ndalimi i mbi kullotjes
3. Ndalimi i shfrytëzimit të mirave materiale që shkaktojnë erozion,
4. Ndalimi i shfrytëzimit të dheut dhe rërës etj.

Si veprime anti-erozive, parashikohen këto veprime hidroteknike, bujqësore dhe biologjike.

Masat hidroteknike

- Ndërtimi i teracave, gardoneve dhe pendave në shtretërit e përroskave dhe përrenjve, si masa mbrojtëse hidroteknike për ta minimizuar fuqinë gërryese.
- Ndërtimi i argjinaturave në brigjet e lumenjve, si masë parandaluese e gërryerjes.
- Mbjellja e fidaneve pyjore në shtretërit e lumenjve.
- Ndalimi i nxjerrjes së inerteve në shtretërit e lumenjve.

Masat bujqësore

- Të mirëmbahen tokat bujqësore.
- Të aplikohen drejtë praktikat bujqësore.
- Përdorimi i sistemit të ujitjes dhe kullimit, të bëhet në bazë të udhëzimeve të ekspertëve.
- Rritja e investimeve për mbrojtjen e tokës në brigjet e lumenjve.

Masat biologjike

- Mbrojtja e pyjeve ekzistuese nga prerjet e pa kontrolluara dhe nga zjarri.
- Ndalimi i kullotjes në masivet e varfra me bimësi.
- Pyllëzimi i viseve të zhveshura dhe atyre të degraduara.
- Krijimi i brezave të gjelbër në ato rajone, e ku shkalla e erozionit është e lartë.

Erozioni duhet të kufizohet në brigjet e lumenjve kryesor me mbjelljen e drunjëve që do të mbulonin brezin prej 10 metra largësi nga lumi.

Shfrytëzimi i tokave bujqësore në fushat lumore të lumenjve kryesor duhet të kufizohet me kullota të përhershme ose pyje.




Harta 45 Plani për mrbojtjen nga rreziqet natyrore

### *4.3.3.7. Mbrojtja e trashëgimisë kulturore dhe natyrore*

**Mbrojtja e Trashëgimisë Kulturore**

Trashëgimia kulturore cilësohet si një ndër elementet kryesore për fuqizimin e identitetit të komunës së Vititsë. Kjo komunë është e pasur me monumente të trashëgimisë kulturore, duke numëruar kështu 7 asete të trashëgimisë arkeologjike, 22 asete të trashëgimisë arkitekturore dhe 1 Zonë të Veçantë të Mbrojtur.

Edhe pse këto asete të trashëgimisë kulturore janë shpallur nën mbrojtje të përkohshme, shumë prej tyre nuk janë në gjendje të mirë fizike dhe kërkojnë intervenime restauruese. Gjithashtu këto objekte të trashëgimisë nuk e kanë të përcaktuar perimetrin dhe zonën mbrojtëse ashtu siç kërkohet me Ligjin për Trashëgimi Kulturore, si dhe sipërfaqen e mbrojtur, ashtu siç kërkohet me Ligjin për Planifikimin Hapësinor. Me shpalljen e tyre si zona të mbrojtura, do të kontrollohen zhvillimet e ardhme në këto zona, dhe do të parandalohet degradimi i mëtutjeshëm i vlerave të tyre dhe mjedisit rrethues.

Objektet e trashëgimisë kulturore në komunë duhet të mbrohen dhe te kufizohen zhvillimet përreth tyre bazuar në UA nr.08/2017 për Norma Teknike të Planifikimit Hapësinor. Sipas këtij UA, objektet e trashëgimisë arkitekturore duhet të kufizojnë zhvillimet përreth me zonë mbrojtëse me radius prej 50 metrash, ndërsa 100 metra prej perimetrit të objekteve të trashëgimisë arkeologjike.

Duke vlerësuar rëndësinë e numrit të madh të objekteve të trashëgimisë kulturore në komunë, si element për fuqizim të identitetit të komunës planifikohet të zhvillohen projekte të cilat do të mbrojnë nga degradimi i mëtutjeshëm asetet dhe në të njejtën kohë të vë në pah vlerat artistike, estetike, historike dhe tradicionale të këtyre aseteve nga të gjithë banorët e komunës dhe më gjerë.

<u>Zona e veçantë e mbrojtur</u>

Zona e veçantë e mbrojtur Manastiri i Binaqit në Buzovik është e definuar me hartë dhe me kufirin i cili e rrethon atë, në funksion të mbrojtjes nga çdo zhvillim apo aktivitet i cili mund të dëmtojë kontekstin e saj historik, kulturor dhe arkitektural. Kjo zonë gëzon trajtim të veçantë të mbrojtjes që garantohet me **Ligjin NR. 03/L-039 për Zonat e Veçanta të Mbrojtura**. Masat për mbrojtjen e saj duhet t'i përmbahen U. A. për Normat teknike të planifikimit MMPH Nr.08/2017 (shtojca, Kapitulli II paragrafi 7.)

**Mbrojtja e Trashëgimisë natyrore**

Vlerat e mbrojtura të natyrës mund të përdoren dhe avancohen në mënyrën e cila e mundëson mbrojtjen dhe avancimin e tyre afatgjate, në përputhje me Ligji Nr. 02/L-18 Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës.

Në pjesën e mbrojtur të natyrës nuk mund të zhvillohen aktivitete të cilat e rrezikojnë ekuilibrin natyror, llojllojshmërinë biologjike dhe peizazhore, hidrografinë, gjeomorfologjinë, gjeologjinë, vlerat kulturore ose në çfarëdo mënyrë degradojnë cilësitë dhe veçoritë e vlerave të natyrës.

Duhet ndërmarrë masa të veçanta për ruajtjen dhe shfrytëzimin e vlerave të mbrojtura të kulturës dhe të natyrës.

### *4.3.3.8. Vendbanimet*

Komuna e Vitisë karakterizohet me vendbanime kryesisht të shpërndara, sidomos në zonën rurale. Për të kontrolluar zhvillimin e banimit dhe funksioneve të tjera në pajtueshmëri, është përcaktuar kufiri ndërtimor për secilin vendbanim. Plani Zhvillimor Komunal rekomandon zhvillim kompakt dhe të balancuar, duke ofruar shërbime bazë në funksion të këtij zhvillimi.

Bazuar në parashikimet demografike të komunës, vendbanimet do të zhvillohen sipas këtyre funksioneve të përcaktuara me UA nr. 08/2017 për Normal Teknike të Planifikimit Hapësinor:

Tabela 113 Planifikimi i zhvillimit të vendbanimeve në komunën e Vitisë

| Vendbanimi | Funksioni | Klasifikimi sipas madhësisë |
|---|---|---|
| Vitia | Qendër komunale | Vendbanim shumë i vogël urban |
| Pozheran, Skifteraj | Nën-qendër komunale | Vendbanim rural i madh |
| Smirë | Vendbanim | Vendbanim rural i madh |
| Binçë, Drobesh, Kabash, Lubishtë, Radivojcë, Remnik, Sadovinë e Çerkezve, Sadovinë e Jerlive, Sllatinë, Stubëll e Epërme, Tërpezë, Vërban | Vendbanim | Vendbanim i mesëm i madh rural |
| Ballancë, Budrikë e Epërme, Buzovik, Gërmovë, Gushicë, Novosellë, Ramjan, Tërstenikë, Zhiti | Vendbanim | Vendbanim i mesëm rural |
| Debëlldeh, Devajë, Letnicë, Podgorc, Ramnishtë | Banim | Vendbanim i vogël rural |
| Çifllak, Goden i Madh, Mjak, Stubëll e Poshtme, Shasharë, Vërnakollë, Vërnez | Banim | Vendbanim shumë i vogël rural |

Dendësia e banimit në të gjitha vendbanimet e komunës është përcaktuar duke u bazuar në trendet e zhvillimit të ndërtimit si dhe parashikimit të popullsisë. Gjithashtu janë marrë parasysh edhe vlerat e dendësisë së banimit të përcaktuara me Planin Zhvillimor Urban 2010-2020+ si dhe Planet Rregulluese Urbane "Qendër, Jug, lumi Morava" dhe "Zona Veri". Alokimi i saktë i dendësive të banimit për zona të ndryshme të vendbanimeve, sidomos në zonën urbane, do të përcaktohet detajisht me Hartën Zonale të Komunës. Me ç'rast, do të llogaritet edhe sipërfaqja e saktë e tokës së nevojshme për zhvillimin e ardhshëm në komunë, varësisht nga tipologjia e ndërtimit.

Në tabelën e mëposhtme janë renditur vendbanimet dhe dendësia e popullsisë dhe ajo banimore e përcaktuar konform UA nr. 08/2017 për Normat Teknike për Planifikim Hapësinor:

Tabela 114 Dendësia e planifikuar e popullsisë

| Vendbanimi | Dendësia aktuale njësi banimi/ha | Dendësia e planifikuar njësi banimi/ha | Dendësia e popullsisë banorë/ha | Kategoria e sipërfaqeve sipas dendësisë së planifikuar | Sipërfaqja e rezervuar për zgjerim (ha) |
|---|---|---|---|---|---|
| Vitia | 10 | 10-40 | 200 | Sipërfaqe urbane e përgjithshme | 20.87 |
| Pozharan, Skifteraj | 8 | 10-30 | 100 | Sipërfaqe sub-urbane | - |
| Drobesh, Kabash | 5 | 5-15 | 80 | Sipërfaqe sub-urbane | - |
| Binçë, Lubishtë, Radivojcë, Remnik, Smirë, Sadovinë e Çerkezve, Sadovinë e Jerlive, Sllatinë, Stubëll e Epërme, Tërpezë, Vërban | 5 | 5-10 | 50 | Sipërfaqe rurale me intensitet të lartë | - |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Ballancë, Budrikë e Epërme, Buzovik, Gërmovë, Gushicë, Novosellë, Ramjan, Tërstenikë, Zhiti | 3 | | 25 | Sipërfaqe rurale me intensitet të lartë | - |
| Debëlldeh, Devajë, Letnicë, Podgorc, Ramnishtë, Çifllak, Goden i Madh, Mjak, Stubëll e Poshtme, Shasharë, Vërnakollë, Vërnez | 2 | 2-6 | 10 | Sipërfaqe rurale me intensitet të ulët | - |




Harta 46 Madhësia e vendbanimeve

### 4.3.3.9. *Shfrytëzimi i tokës*

Shfrtyëzimi i planifikuar i tokës përcakton llojin e shfrtyëzimit të tokës bazuar në vizionin, qëllimet dhe objektivat e Planit Zhvillimor Komunal. Sipas konceptit të përzgjedhur të zhvillimit hapësinor, territori i komunës së Vitisë ndahet në katër tërësi hapësinore:

1. Zona e Karadakut
2. Zona Bujqësore
3. Zona Kodrinore
4. Zona Urbane

**Zona e Karadakut** përfshinë pjesën jugore dhe jug-lindore të territorit të komunës. Duke marrë parasysh relievin shumë të ngritur dhe pasuritë pyjore, burimet dhe rrjedhat ujore, peizazhet natyrore dhe biodiversitetin, në këtë zonë planifikohet zhvillim i aktiviteteve turistike, ekoturizem, turizëm rural, rekreacion, aktivitete blegtorale dhe prodhime nga blegtoria. Gjithashtu planifikohet të shfrtyëzohen resurset e trashëgimisë kulturore dhe natyrore me qëllim të zhvillimit të qëndrueshëm të kësaj zone.

**Zona Bujqësore** përfshinë pjesën qendrore të territorit të komunës. Mbi 50% e tokës bujqësore në komunë është klasifikuar si tokë bujqësore e klasit I-IV, e cila mbrohet me ligjin për tokën bujqësore dhe konsiderohet si potenciali më i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të komunës në përgjithësi. Zhvillimi i ardhshëm i kësaj tërësie hapësinore bazohet në intensifikimin e prodhimtarisë bujqësore dhe blegtorale, ngritjen e pVeikave për grumbullimin dhe distribuimin e produkteve bujqësore, si dhe kapaciteteve të vogla përpunuese në kuadër të ekonomive bujqësore.

**Zona Kodrinore** shtrihet në pjesën veriore të territorit të komunës. Në këtë zonë do të fokusohen zhvillimi i turizmit rekreativ, eko-turizmit dhe turizmit rural, duke shfrytëzuar potencialin që peizazhet natyrore dhe sipërfaqet pyjore i ofrojnë.

**Zona urbane** përveç qytetit të Vitisë, përfshinë edhe vendbanimin e Kabashit dhe Drobeshit të cilat përshkak të zhvillimeve të hovshme të ndërtimit janë shndërruar në paralagje urbane të kësaj komune. Brenda kufijve ndërtimor të kësaj zone planifikohet ri-zhvillim, plotësim e densifikim i zonës urbane. Përveç shfrytëzimit të banimit, në këtë zonë planifikohet zhvillimi i shfrytëzimeve të tjera në pajtueshmëri me karakterin urban të zonës, duke përfshirë shërbimet publike dhe sociale, shërbimet e komunitetit, shërbime argëtuese e rekreative, shërbime komerciale, etj..

Sa i përket sipërfaqes ndërtimore; kufijtë ndërtimorë të cilët janë përcaktuar me këtë PZHK do të respektohen në mënyrë strikte, ndërsa duke u mbështetur në pikën 1.5 të kapitullit II të Udhëzimit Administrativ nr. 08/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor, ky PZHK parasheh që e gjithë zona urbane të ketë dendësi mesatare të popullsisë deri në 200 ban./ha. Ky kufizim i dendësisë do të respektohen në 8 vitet e ardhshme, pa marrë parasyshë dendësinë e planifikuar me PZHU 2010-2015+ si dhe Planet Rregulluese të cilat janë hartuar para hyrjes në fuqi të këtij Plani Zhvillimor Komunal.




Harta 47 Shfrytëzimi i planifikuar i tokës

Tabela 115 Shfrytëzimi i planifikuar i tokës

| KODI HILUCS | LLOJI I SHFRYTËZIMIT | SIPERFAQJA (Ha) | % |
|---|---|---|---|
| 1.1. | Bujqësi | 11002.27 | 40.82% |
| 1.2. | Pylltari | 12247.23 | 45.44% |
| 2.2. | Industri prodhimeve të rënda | 168.92 | 0.63% |
| 2.3. | Industri e prodhimeve të lehta | 36.07 | 0.13% |
| 3.1. | Shërbim tregtar | 31.40 | 0.12% |
| 3.3. | Shërbim i komunitetit | 106.39 | 0.39% |
| 3.4. | Shërbim kulturor, argëtues dhe rekreativ | 10.61 | 0.04% |
| 4.1. | Rrjetet e transportit | 150.71 | 0.56% |
| 5.1. | Banim i përhershëm | 2925.17 | 10.85% |
| 6.3 | Siperfaqe Ujore | 83.81 | 0.31% |
| KODI KHRrP | LLOJI I SHFRYTËZIMIT | SIPERFAQJA (Ha) | % |
| 6.1.4.3 | Hapësirë e zgjeruar urbane | 59.73 | 0.22% |
| 1.4.4. | Hapësirë bujqësore ose natyrore urbane | 5.53 | 0.02% |
| 1.3. | Hapësirë e energjisë së ripërtrishme | 122.73 | 0.46% |
| | TOTALI | 26950.57 Ha | 100 |

## 4.4. PLANI I VEPRIMIT DHE PRIORITETET STRATEGJIKE

LEGJENDA

| Lloji i Implikimit | Vlera në EUR. |
|---|---|
| MINIMALE | 1 - 20.000 |
| ULËT | 20.001 - 50.000 |
| MESËM | 50,001 - 200.00 |
| LARTË | 200.000+ |

| Veprimet Sipas Prioritetit | Ngjyra e Fushës |
|---|---|
| Veprimet me Pr. të Lartë | (jeshile) |
| Veprimet me Pr. të Mesëm | (e verdhë) |
| Veprimet me Pr. të Ulët | (portokalli) |

| Kohëzgjatja | Vitet |
|---|---|
| AFATSHKURTËR | 2021-2022 |
| AFATMESËM | Deri në vitin 2025 |
| AFATGJATË | Deri në vitin 2030 |
| VAZHDIMËSI | |

| VEPRIMET/PROJEKTET/PROGRAMET | INSTITUTICONI PERGJEGJES | SUBJEKTE TJERA TË PËRFSHJIRA | PRIORITETET | KOHËZGJATJA | IMPLIKIMET FINANCIARE | BUXHETI | INDIKATORËT | VITI I PËRFUNDIMIT |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Qëllimi 1: Shërbime cilësore dhe gjithëpërfshirje në arsim** | | | | | | | | |
| **O.1.1: Qerdhe të reja në vendbanimet Viti, Pozharan, Smirë, Gjylekar, Kabash dhe Sllatinë e Epërme, Drobesh, Ramnisht dhe Stubëll e Epërme** | | | | | | | | |
| **Aktivizimi i çerdhës në Pozharan** | Komuna e Vitisë Drejtoria e Arsimit | | L | ASH | Mi | 0 | Aktivizimi i cerdhes | 2022 |
| **Në Sllatinë të Epërme, objekti i ambulancës së vjetër të rregullohet dhe të përdoret për çerdhe.** | Komuna e Vitisë, MASHT | | L | ASH | Mi | 20,000 | Fillimi i funksionimit te cerdhes | 2022 |
| **Ndërtimi I çerdheve të reja në vendbanimet: Viti, Smirë, Gjylekar, Kabash , Drobesh, Ramnisht dhe Stubëll e Epërme** | Komuna e Vitisë, MASH | Sektori Privat | M | AM | Mesëm | 200.000 | Ndertimi i cerdheve te reja ne vendbanimet e cekura | 2025 |
| **O.1.2: Zgjerimi i hapësirave shkollore për disa shkolla fillore** | | | | | | | | |
| **Zgjërimi i hapësirave të objekteve shkollore në Binç, Sadovinë e Jerlive, Smirë, Tërpezë dhe Vërban** | Komuna e Vitisë, MASH | | U | AGJ | Mesëm | 150.000 | Zgjerimi i hapesirave | 2030 |
| **O.1.3: Zgjerimi I hapësirave shkollore për shkollimin e mesëm të lartë edhe me 8000m²** | | | | | | | | |
| **Ndërtimi i objektit të Shkollës Profesionale Bujqësore** | Komuna e Vitisë, MASH | | L | AM | Mesëm | 150.000 | Ndertimi i objketit dhe funksionalizimi i shkolles | 2025 |
| **O.1.4: Përfshirja e nxënësve në arsim profesional** | | | | | | | | |
| **Inkurajimi I nxënësve për arsim profesional** | Komuna e Vitisë | | M | AM | Mi | 5000 | Hartimi i politikave | 2025 |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | per inkurajimin e nxenesve | |
| **Qëllimi 2: Ngritja e nivelit të shërbimeve shëndetësore dhe mirëqenies sociale** | | | | | | | | |
| **O.2.1: Përmirësimi i shërbimeve shëndetësore dhe avancimi i Sistemit Informativ Shendetesor** | | | | | | | | |
| Renovimi i QKMF - Viti | Komuna e Vitisë, MSH | | M | AM | U | 30.000 | Renovimi i objektit | 2025 |
| Ambulanca në Skifteraj të shëndrrohet në QMF | Komuna e Vitisë, MSH | | M | AM | Mesëm | 100.000 | Funksionalizimi i QMF-se | 2025 |
| Në ambulancat ku nuk ka mjek të organizohet shërbimi | Komuna e Vitisë, MSH | | L | Vazhdimësi | Mesëm | 100.000 | Ofrimi i sherbimev te plota ne te gjitha ambulantat | 2030 |
| Funksionalizimi I ambulancës në Zhiti | Komuna e Vitisë, MSH | | L | ASH | U | 5,000 | Funksionalizimi i ambulantes | 2022 |
| **O.2.2: Përmirësimi gjendjes në banim social** | | | | | | | | |
| Objekte të reja për banim social | Komuna e Vitisë, | Investitor privat | L | Vazhdimësi | L | 300.000 | Ndertimi i objekteve te reja | 2030 |
| **O.2.3: Rritja e kujdesit ndaj grupeve sociale me gjendje të vështirë shëndetësore dhe ekonomike** | | | | | | | | |
| Stimulimin e mjekëve për të shërbyer edhe në vendbanimet periferike | Komuna e Vitisë, MSH | | L | ASH | U | 50.000 | Hartimi i politikav per stimulimin e mjekeve | 2022 |
| **Qëllimi 3 Administratë efikase** | | | | | | | | |
| **O.3.1: Decentralizim të shërbimeve administrative edhe në disa qenra të tjera lokale.** | | | | | | | | |
| Objekt administrativ në vendbanimet Pozharan dhe Skifteraj | Komuna e Vitisë | | L | Vazhdimësi | Mesëm | 100.000 | Ndertimi i objekteve administrative | 2030 |
| **O.3.2: Përmirësimi i kushteve dhe ngritja e shërbimeve administrative.** | | | | | | | | |
| Ngitja e efikasitetit në administratë | Komuna e Vitisë | | L | Vazhdimësi | U | 10.000 | | 2030 |
| **O.3.3: Ofrimi i shërbimeve administrative në formë elektronike – e-administrata.** | | | | | | | | |
| Avancimi i sistemit elektronik në ofrimin e shërbimeve për qytetarë | Komuna e Vitisë | | L | Vazhdimësi | U | 20.000 | Funksionalizimi i plote i sistemit elektronik | 2030 |
| **Qëllimi 4. Sigurimi i infrastrukturës adekuate sociale dhe mirëmbajtja e saj** | | | | | | | | |
| **O.4.1: Ofrimi i objekteve të reja të kulturës dhe artit për të gjithë banorët e komunës së Vitisë deri në vitin 2030** | | | | | | | | |
| Ndërtimi I tri objekteve të kulturës në vendbanimet: Pozharan Skifteraj dhe Smirë | Komuna e Vitisë, Ministria e kulturë | Donatorë | M | AGJ | L | 250.000 | Ndertimi i objekteve te | 2030 |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | kultures | |
| **O.4.2:Sigurimi i infrastrukturës për sport dhe rekreacion në gjithë territorin e komunës deri në vitin 2030** | | | | | | | | |
| **Hapësira të reja sportive në vendbanimet: Beguncë, Binçë, Gjylekar, Kabash, Lubishtë, Radivojc, Remnik, Sadovinë e Qerkezve, Sllatinë e Epërme, Sllatinë e Poshtme, Smirë, Tërpezë, Vërban, Stubëll e Epërme** | Komuna e Vitisë, Ministria e kulturës | Donatore | M | AGJ | L | 250.000 | Krijimi i hapesirave te reja sportive ne te gjitha vendbanimet e cekura | 2030 |
| **Përfundimi i palestrës sportive në fshatin Drobesh** | Komuna e Vitisë, Ministria e kulturë | | M | ASH | U | 30.000 | Perfundimi dhe funksionalizimi i palestres sportive | 2022 |
| **O.4.3:Sigurimi i hapësirave për sport dhe rekreacion nëpër shkolla deri në vitin 2030** | | | | | | | | |
| **Një fushë sportive afër shkollës në fshatin Qifllak** | Komuna e Vitisë, MA | | M | AM | U | 20.000 | Ndertimi i fushes sportive | 2025 |
| **Ndërtimi i sallës së sportit për shkollën “Bafti Haxhiu” në Viti** | Komuna e Vitisë, MA | | M | AM | U | 30.000 | Ndertimi dhe funksionalizimi i salles se sportit | 2025 |
| **Ndërtimi i sallës së mbyllur spotive për shkollën fillore “Dom Mikel Tarabulluzi” në Stubëll të Epërme** | Komuna e Vitisë, MA | | M | AM | U | 50 | Ndertimi dhe funksionalizimi i salles se sportit | 2025 |
| **O.4.4: Shtimi dhe rregullimi i hapësirave publike në zonën urbane dhe nën-qendrat e komunës së Vitisë deri në në vitin 2030** | | | | | | | | |
| **Rregullimi i shesheve dhe parqeve në fshatrat: Pozharan, Skifteraj, Smirë, Drobesh, Gërmov dhe Stubëll e Epërme** | Komuna e Vitisë | Donatorë | M | AGJ | U | 60.000 | Rregullimi dhe funksionalizimi i shesheve dhe parqeve ne te gjitha vendbanimet e cekura | 2030 |
| **Në fshatin Ramjan të zyrtarizohet Blini Park** | Komuna e Vitisë | | M | ASH | Mi | 5000 | Zyrtarizimi i "Blini Park" | 2022 |
| **Në qendrën e fshatit Sadovinë e Jerlive të ndërtohet një park afer memorialit si dhe të rregullohet memoriali** | Komuna e Vitisë | Donatorë | M | ASH | U | 20.000 | Rregullimi i memorialit dhe ndertimi i parkut | 2022 |
| **Hapësirë gjelbruese te sokolt - mes Vërbanit dhe Gushicës** | Komuna e Vitisë | Donatorë | M | ASH | U | 20.000 | Ndertimi dhe funksionalizimi i hapesires gjelberuese | 2022 |
| **Staza e ecjes Vërban - Trena** | Komuna e Vitisë | Donatorë | M | ASH | U | 10.000 | Ndertimi i stazes se ecjes | 2022 |
| **O.4.5: Mirmbajtja e varrezave dhe objekteve të religjionit deri në vitin 2030** | | | | | | | | |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Zgjerimi i hapësirës për varreza në fshatin Pozharan | Komuna e Vitisë | Donatorë | M | AGJ | U | 10.000 | Zgjerimi i hapesires per varreza | 2030 |
| Mirmbajtja e Varrezave në fshatrat e komunës | Komuna e Vitisë, Bashkësitë Fetare | Donatorë | M | Vazhdimësi | U | 30.000 | | 2030 |
| Zgjerimi i hapësirës për varreza në fshatin Sllatinë e Epërme | Komuna e Vitisë | Donatorë | M | AGJ | U | 10.000 | Zgjerimi i hapesires per varreza | 2030 |
| Ruajtja dhe mirëmbajtja e Xhamisë në fshatin Drobesh | Komuna e Vitisë, Bashkësitë Fetare | Donatorë | M | Vazhdimësi | U | 30.000 | | 2030 |
| Qëllimi 5. Promovimi i artit, sportit dhe kulturës | | | | | | | | |
| O.5.1:Stimulimi i të rinjëve për aktivitete sportive; | | | | | | | | |
| Organizimi i garave, formimi dhe financimi I klubeve sportive | Komuna e Vitisë | Donatorë | M | Vazhdimësi | U | 30.000 | Lista e aktiviteteve | 2030 |
| O.5.2: Organizimi i aktiviteteve kulturore dhe artistike | | | | | | | | |
| Organizimi i aktiviteteve kulturore dhe artistike, përkrhahja e shoqërive në aktivitetet e tyre | Komuna e Vitisë | Donatorë | M | Vazhdimësi | U | 30.000 | Lista e aktiviteteve | 2030 |
| Qëllimi 6: Zhvillim i qëndrueshëm ekonomik i bazuar në shfrytëzimin e potencialit real zhvillimor, shtim të aktiviteteve ekonomike dhe rritje të punësimit, luftim të informalitetit dhe zbutje të zhvillimit të pa-balancuar ekonomik | | | | | | | | |
| 0.6.1: Shfrytëzimi i resurseve njerëzore dhe natyrore si dhe shfrytëzimi i potencialit real zhvillimor, sidomos në Bujqësi, Industri të Lehtë, Industri Bujqësore dhe Përpunuese si dhe Turizëm Natyror, Rural dhe Kulturor përmes hartimit dhe implementimit të politikave të mirëfillta për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. | | | | | | | | |
| O.6.2: Përkrahja e shtimit të aktiviteteve ekonomike dhe rritjes së punësimit në sektorët ekzistues e sidomos në sektorët e targetuar si bartës të zhvillimit të ri ekonomik (Bujqësi, Industri të Lehtë, Industri Bujqësore dhe Përpunuese si dhe Turizëm Natyror, Rural dhe Kulturor) | | | | | | | | |
